
UNIVERSITETI
MESDHETAR

EURO MEDITERRANEAN

REVISTË SHKENCORE

Botim i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë

Nën drejtimin e Akademik Prof. Dr. Anastas Angjeli

Bordi i Nderit

Akademik Prof. Dr. Gudar Beqiraj

Prof. Dr. Adrian Civici

Akademik Prof. Dr. Vasil Tole

Prof. Dr. Aristotel Pano

Prof. Dr. Ilia Kristo

Redaktorë Shkencorë

Prof. Asoc. Nevila Rama

PhD (C) Kriton Kuci

MA Eros Angjeli

Kryeredaktor

MA Ilir Hebovija

Redaktore

Dr. Morena Bracaj

MA Zirina Llambro

Bordi Drejtues – Shkencor – Editorial

Kryetar

Akademik Prof. Dr. Anastas Angjeli

Anëtarë

Akademik Prof. Dr. Gudar Beqiraj

Prof. Dr. Adrian Civici

Prof. Dr. Paskal Milo

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Prof. Asoc. Greta Angjeli

Prof. Asoc. Nexhmi Dumani

Prof. Asoc. Përparim Kabo

Prof. Asoc. Niko Pano

Prof. Asoc. Nevila Rama

Prof. Asoc. Alqi Naqellari

Prof. Dr. Ilia Kristo

Prof. Dr. Orfea Dhuci

Prof. Dr. Dhimitër Tole

Prof. Asoc. Nevila Xhindi

Dr. Holta Heba

Dr. Hysen Cela

Dr. Altin Hoti

Dr. Fatos Ibrahimi

MA Gjergj Teneqexhi

MA Jona Marashi

MA Besnik Leskaj

Dr. Emilio Cika

Dr. Edon Qesari

PhD (C) Kriton Kuci

U.S. policy in the Western Balkans


the


MESDHETAR
US Policy in
e Western Balkans
INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE

SHËNIM I REDAKSISË.

Ky numër i revistës periodike shkencore EUROMEDITERRANEAN përmban referatat dhe diskutimet e mbajtura në sesionin plenar dhe në sesionet tematike të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Politika e SHBA në Ballkanin Perëndimor të organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në datat 28-29 tetor 2019.

Qëllimi i kësaj Konference ishte trajtimi shkencor i ridimensionimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të politikës së jashtme në kontekstin e një sistemi ndërkombëtar gjithmonë e më shumë dinamik nga perspektiva e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe studimeve të sigurisë. Fokusi i kësaj konference ishte politika e jashtme e SHBA-ve për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Konferenca bashkoi në një tryezë debati komunitetin akademik dhe kërkues të rinj si dhe politikanë të lartë të rajonit dhe kontribues në politikbërje, për shkëmbimin e ideve dhe divulgimin e punës së tyre kërkimore shkencore për politikën e jashtme të SHBA-ve karshi rajonit, por edhe të gjitha aspektet e tjera të fushave ndërdisiplinare si marrëdhëniet ndërkombëtare, studimet diplomatike, studimet historike, studimet ne fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe studimet ekonomike dhe politike.

Në panelin kryesor të sesionit plenar të konferencës referuan Presidenti i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Prof. Dr. Anastas Angjeli, E Ngarkuara me Punënë Ambasadën e SHBA në Shqipëri, Leyla Moses-Ones, Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, Ambasadori i Karrierës dhe ish nën Sekretar i Shtetit për Çështje Politike z. Thomas A. Shannon, Jr., Drejtori i Programit të Menaxhimit të Konflikteve dhe Politikës së Jashtme Amerikane në Shkollën e Studimeve Ndërkombëtare të Avancuara të Universitetit "John Hopkins" Prof. Daniel Serwer, Ambasador Bashkimit Europian në Shqipëri Z. Luigi Soreca, ish Ministri i Jashtëm i Shqipërisë Prof. Dr. Paskal Milo, ish ministri i Punëve të Jashtme të Kroacisë z. Miomir Zuzul, ish ministri i Ekonomisë dhe Financave të Kosovës, Prof.Dr. Ahmet Shala, si dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Prof. Dr. Ksenofon Krisafi. Gjatë ditës së dytë të Konferencës u zhvilluan sesionet tematike të organizuara në tre panele.

EDITORIAL NOTE

This number of the periodic scientific review EUROMEDITERRANEAN contains the discussions and papers held in the plenary session and in the thematic sessions of the International Scientific Conference "U.S. policy in the Western Balkans" organized dy the Mediterranean University of Albania on 28-29 October 2019.

This conference addressed the new dimensions of international relations in a dynamic international system from the perspectives of international relations theories and security studies, with special focus on the US foreign policy toward the Western Balkans.

This conference provided a unique opportunity by bringing together academia, political leaders of the region, foreign policy makers, researchers and scholars to exchange information and share experiences and research results about the US foreign policy toward the Western Balkans but also about all aspects of interdisciplinary fields such as international relations, diplomacy studies, history, international law, political and economic sciences.

The main panel of the plenary session of the conference consisted of the President of the Mediterranean University of Albania Prof. Dr. Anastas Angjeli, Chargé d'Affaires, U.S Embassy in Albania a.i. Leyla Moses-Ones, H. E. Mr. Edi Rama – Prime Minister, Republic of Albania, Thomas A. Shannon, Jr. - Career Ambassador, Former Under Secretary for Political Affairs, Prof. Daniel Serwer - Director of Conflict Management and American Foreign Policy Programs at the Johns Hopkins School of Advanced International Studies, Mr. Luigi Soreca - European Union Ambassador to Albania, Former Foreign Minister of Albania Prof. Dr. Paskal Milo, Former Minister of Foreign Affairs of Croatia Prof. Dr. Miomir Zuzul, Former Minister of Economy and Finance of the Republic of Kosova Prof. Ahmet Shala and Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Dean of Faculty of Law and International Relations at Mediterranean University of Albania.

During the second day of the Conference the thematic session were held at the Mediterranean University of Albania.



PARATHËNIE PËR BOTIMIN E KONFERENCËS "POLITIKA E SH.B.A NË BALLKANIN PERËNDIMOR"

Tetor 2019

H.E. Yuri Kim
U.S. Ambassador to the Republic of Albania

Siç ka theksuar Sekretari Pompeo, Evropa sot është pa dyshim një qendër e konkurrencës gjeopolitike. Ky është një fakt që po riformaton rajonin. Vitet e fundit, Moska ka provuar të përdorë forcën për të riformatuar kufijtë në Ukrainë, ka zhvilluar fushata dezinformuese për të prishur demokracitë dhe u përpoq pa sukses të pengojë aderimin në NATO të Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. Ndërkohë, Kina ka përdorur platformën 16 + 1 dhe nismës "Një Brez një dhe Rrugë për të krijuar varësi dhe dëmtuar liritë.

Shtetet e Bashkuara dhe Evropa duhet të punojnë së bashku më ngushtë se kurrë për të siguruar që paqja dhe prosperiteti që kemi ndërtuar - vlerat dhe institucionet mbi të cilat ato janë mbështetur - do të vazhdojnë të zgjerohen dhe të forcohen. Për këtë arsye, Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara për të mbështetur aspiratat e anëtarësimit në BE të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë. Mundësitë, si dhe sfidat janë më të rritura tani që BE ka rënë dakord për një qasje të kushtëzuar për hapjen e negociatave të pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Liderët e rajonit duhet të marrin vendime të vështira të domosdoshme për të çuar vendet e tyre përpara në rrugën demokratike.

Shtetet e Bashkuara janë krenarë ta quajnë Shqipërinë një mik, partner dhe aleat, dhe ne jemi të përkushtuar të mbështesim të ardhmen e Shqipërisë si një anëtare e plotë e familjes Trans-Atlantike.



PREFACE FOR THE PUBLICATION OF THE OCTOBER 2019 CONFERENCE ON U.S. POLICY IN THE WESTERN BALKANS

October 2019

H.E. Yuri Kim
U.S. Ambassador to the Republic of Albania

As Secretary Pompeo has emphasized, Europe today is undeniably a center of geopolitical competition. This is a fact that is reshaping the region. In recent years, Moscow has attempted to use force to redraw borders in Ukraine, launched disinformation campaigns to disrupt democracies, and attempted without success to derail the NATO accession of Montenegro and North Macedonia. Meanwhile, China has used the 16+1 platform and Belt and Road Initiative to create dependencies and erode freedoms.

The United States and Europe must work together more closely than ever to ensure that the peace and prosperity we have built – and the value and institutions that undergird them – will continue to expand and endure. For this reason, the United States remains staunchly committed to supporting the EU membership aspirations of all the countries of the Western Balkans, including Albania. The opportunities as well as stakes are higher now that the EU has agreed to a conditioned approach to opening accession negotiations with Albania and North Macedonia. The region's leaders must make the tough decisions necessary to move their nations forward on the democratic path.

The United States is proud to call Albania a friend, partner, and Ally, and we are committed to supporting Albania's future as a full member of the Trans-Atlantic family.

PROGRAM I KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "POLITIKA E SHBA NË BALLKANIN PERËNDIMOR"

28 - 29 tetor 2019
Hotel Tirana International
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

28 TETOR 2019

Sesioni Plenar, Hotel Tirana International 10:30 – 13:00

Politika e Jashtme e SHBA në një Botë që Ndryshon

Tematikat kryesore:
- Politika e jashtme amerikane në një sistem ndërkombëtar dinamik
- Rajoni i Ballkanit ndërmjet ndikimit të historisë dhe sfidave aktuale
- Vlerësim kritik i politikës së jashtme amerikane për rajonin
- Bashkëpunimi SHBA-BE për integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor

10:00 – 10:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve

10:30 – 10:40 Prof. Dr. Anastas Angjeli
– President i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë – SHQIPËRI
"Rendësia historike e politikës së SHBA në Ballkanin Perëndimor"
(Fjala e hapjes së Konferencës)

10:40 – 10:50 Leyla Moses-Ones – E Ngarkuara me Punë,
Ambasada e SHBA në Shqipëri, SHBA

10:50 – 11:10 Sh.T.Z. Edi Rama
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, SHQIPËRI
"Shqipëria, marrëdhënie speciale me SHBA"

11:10 – 11:25 Thomas A. Shannon, Jr. – Ambasador Karriere- SHBA, ish nën Sekretar Shteti për Çështje Politike, SHBA (Keynote Speaker)
"Politika e jashtme e SHBA në një periudhë pasigurie
- Çfarë mund të presë Shqipëria"

11:25 – 11:40 Prof. Daniel Serwer - Drejtor i Programit të Menaxhimit të Konflikteve dhe Politikës së Jashtme Amerikane në Shkollën e Studimeve Ndërkombëtare të Avancuara të Universitetit "John Hopkins". SHBA (Keynote Speaker)
"Shqipëria dhe konteksti i saj"

11:40 – 11:50 Z. Luigi Soreca - Ambasador Bashkimit Europian në Shqipëri, BE

12:00 – 12:10 Prof. Dr. Paskal Milo – Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, SHQIPËRI
"Politika e SHBA në Ballkanin Perëndimor - Sfida dhe perspektiva"

12:10 – 12:20 Prof. Dr. Miomir Zuzul, SHBA, – Ambasador, Profesor, Ish ministër i Punëve të Jashtme të Kroacisë, SHBA
"Komisioni i ri Europian - Çfarë pritet për Shqipërinë dhe rajonin"

12:20 – 12:30 Prof.Dr. Ahmet Shala – Ambasador, Profesor, Ish ministër i Ekonomisë dhe Financave të Kosovës, REPUBLIKA E KOSOVËS "Roli i SHBA në themelimin dhe finalizimin e shtetësisë së Kosovës"

12:40 – 12:50 Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Dekan i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, SHQIPËRI
"Historia dyshekullore e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane."

Fjala përmbyllëse Prof. Dr. Anastas Angjeli – President i Universitetit
e konferencës Mesdhetar të Shqipërisë– SHQIPËRI

13:00 – 13:30 Kokteil

29 TETOR 2019

Sesionet tematike, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, 09:30 – 13:00
09:00 – 09:30 Regjistrimi
09:30 – 13:00 Paneli I:
Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Diplomacisë - Nga Orientalizmi në Socializëm drejt Integrimit Euro-Atlantik. Ballkani Perëndimor në shek. XX-XXI
Drejtues Prof. Dr. Paskal MILO; Prof. Asoc. Dr.
Përparim KABO & PhD Edon QESARI
Salla 306

- Historia e rajonit: Nga pavarësia drejt integrimit europian – Një rrugë e shënjuar nga nacionalizmi dhe konfliktet ideologjike.
- Roli i historisë dhe memories kolektive në studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Multikulturalizmi kundër të djathtës ekstreme dhe populizmit. Impakti i ideologjive politike në marrëdhëniet ndërkombëtare.
- Sistemet politike dhe nevoja për ndryshim. Raste studimore nga rajoni.
- Gjendja aktuale e demokracisë në rajon. Raste konkrete.

09:30 – 13:00 Paneli II:
Gjendja aktuale e Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- Politika e SHBA dhe ajo e BE kundrejt Ballkanit Perëndimor.
Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI; Dr. Emilio CIKA & Dr. Skënder DEMALIAJ
Room 304

- Politika energjitike dhe roli i saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. Pasojat për rajonin.
- Roli i SHBA dhe BE në sistemin ndërkombëtar. Ndikimet në rajon.
- Ballkani Perëndimor, më shumë siguri dhe integrim apo vazhdimësi i status quo-së?
- Bashkëpunimi rajonal drejt anëtarësimit në BE.
- Roli i shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor si faktor sigurie dhe stabiliteti në rajon.

09:30 – 13:00 Paneli III:
Qasje Teorike të Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Studimeve të Sigurisë - Sfidat e Sigurisë Trans- Atlantike në Ballkanin Perëndimor.
Prof. Asoc. Dr. Nevila RAMA; PhDc Kriton KUÇI
& PhDc Gertjan VESHAJ

Room 303

- Debatet aktuale në BE në periudhën e krizës dhe post krizës. Ndikimi në rajon. Raste nga rajoni.
- Roli i krizës ekonomike në zhvillimet e fundit ndërkombëtare. Raste nga rajoni.
- Gjendja aktuale e sistemit ndërkombëtar: Probleme, rreziqe dhe sfida. Pasojat për rajonin.
- Zhvillimet e fundit teorike të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë rajonale
- Siguria rajonale, stabiliteti dhe emigrimi.
- Siguria kolektive në një sistem ndërkombëtar dinamik. Gjendja aktuale dhe sfidat. Rreziku nga terrorizmi ndërkombëtar. Pasojat për rajonin.

PROGRAM OF THE INTERNATIONAL SCIENTIFIC CONFERENCE "US POLICY IN THE WESTERN BALKANS"

28 - 29 October 2019
Hotel Tirana International
Mediterranean University of Albania, Tirana, Albania

28 OCTOBER 2019

Plenary Session at Hotel Tirana International 10:30 – 13:00
US Foreign Policy in a Changing World
Main Topics:
- US foreign policy in a dynamic international system.
- The Western Balkans region between the impact of history and challenges of modern era.
- Contribution of US foreign policy in the stability and security of Western Balkans.
- US and EU cooperation for the integration process of the Western Balkans toward the EU.

10:00 – 10:30 Registration of the Participants

10:30 – 10:40 Prof. Dr. Anastas Angjeli
– President of Mediterranean University of Albania, ALBANIA
The significative role of U.S. policy in Western Balkans Conference opening remarks

10:40 – 10:50 Chargé d'Affaires, a.i. Leyla Moses-Ones
– U.S Embassy in Albania, USA

10:50 – 11:10 H. E. Mr. Edi Rama – Prime Minister, Republic of Albania- Albania, ALBANIA
Albania, special relations with the United States

11:10 – 11:25 Thomas A. Shannon, Jr. - Career Ambassador,
Former Under Secretary for Political Affairs, USA (Keynote Speaker)
"American Foreign Policy in an Age of Uncertainty: What can Albania Expect?"

11:25 – 11:40 Prof. Daniel Serwer
- Director of Conflict Management and American Foreign Policy
Programs at the Johns Hopkins School of Advanced International Studies, USA
(Keynote Speaker) "Albania and its context"

11:40 – 11:50 Mr. Luigi Soreca - European Union Ambassador to Albania, EU

12:00 – 12:10 Prof. Dr. Paskal Milo – Mediterranean University of Albania, ALBANIA
"US policy in the Western Balkans. Challenges and perspectives"

12:10 – 12:20 Prof. Dr. Miomir Zuzul – Ambassador, Professor,
Former Minister of Foreign Affairs of Croatia, USA
"Is the new European Commission bringing anything
new to Albania and the region"

12:20 – 12:30 Prof. Ahmet Shala – Ambassador, Professor,
Former Minister of Economy and Finance of the
Republic of Kosova, KOSOVA
"US role in establishing and consolidating
Kosova's statehood"

12:40 – 12:50 Prof. Dr. Ksenofon Krisafi, Dean of Faculty of Law
and International Relations at Mediterranean
University of Albania, ALBANIA
"Two centuries of Albanian-American relations"

Closing remarks Prof. Dr. Anastas Angjeli – President of
Mediterranean University of Albania – ALBANIA
Announcing the second day of conference

13:00 – 13:30 Cocktail

29 OCTOBER 2019

Thematic Sessions, Mediterranean University of Albania, 09:30 – 13:00

09:00 – 09:30 Registration

09:30 – 13:00 Session I:
History of International Relations and Diplomacy - From Orientalism, through Socialism, to Euro-Atlantic Integration: Western Balkan Countries, in the XXth and XXIst Century
Chair Prof. Dr. Paskal MILO; Co-chairs Prof. Asoc.
Dr. Përparim KABO & PhD Edon ÇESARI
Room 306

- The history of the Region: From Independence to European Integration – A Path marked of Nationalism and Ideological Conflicts
- History and collective memory's impact in the study of international relations.
- Multiculturalism against far right and the impact of political ideology for the international relations
- The political system and the necessity for changes. Cases from the region.
- The current state of democracy in the Region. Cases from the region.

09:30 – 13:00 Session II:
Current State of International Relations - US and European Foreign Policies toward Western Balkan
Countries

Chair Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI; Co-chairs Dr. Emilio CIKA & Dr. Skënder DEMALIAJ
Room 304

- The energy policy and its role in international relations. Cases from the region.
- US and EU role in the international system. Implications for the Region.
- Western Balkans, more democracy and integration or continues status quo?
- Regional cooperation towards EU membership.
- The role of Albanians in Western Balkans as a factor of security and stability in the region

09:30 – 13:00 Session III:
Theoretical Approach of International Relations and
Security Studies - Challenges of Trans-Atlantic security in
Western Balkans countries.

Chair Prof. Asoc. Dr. Nevila RAMA; Co-chairs PhD
c Kriton KUÇI & PhD c Gertjan VESHAJ
Room 303

- The current debates in the EU in the period of crisis and the impact in the Region. Cases from the region.
- The role of economic crisis in the recent international developments. Cases from the Region.
- The current state of the international system: Problems, risks and challenges. Implications for the Region.
- Evaluation of the respective theories of International Relations of security issues in the region
- Regional security, stability and migration flows.
- Collective Security and Development Systems in a dynamic international system. Current situation and challenges. The threat of regional and international

PËRMBAJTJA

DITA E PARË E KONFERENCËS

Diskutimet e Sesionit Plenar

Rendësia historike e politikës së SHBA në Ballkanin Perëndimor

Parathënie për botimin e Konferencës
"Politika e Sh.B.A në Ballkanin Perëndimor" Tetor 2019 ..... **8**
Preface for the publication of the October 2019 Conference on
U.S. Policy in the Western Balkans October 2019 ..... **9**

Fjala e hapjes së Konferencës **18**
Conference opening remarks **22**
Anastas Angjeli

Fjala e të Ngarkuarës me Punë, Ambasada e SHBA në Shqipëri, SHBA **25**
Remarks by Chargé d'Affaires, a.i. Leyla Moses-Ones **28**
Leyla Moses-Ones

"Shqipëria, marrëdhënie speciale me SHBA" **31**
Albania, special relations with the United States **35**
Edi Rama

"Politika e jashtme e SHBA në një periudhë pasigurie -
Çfarë mund të presë Shqipëria" **39**
American Foreign Policy in an Age of Uncertainty:
What can Albania Expect **42**
Thomas A. Shannon Jr

"Shqipëria dhe konteksti i saj" **45**
Albania and its context **50**
Daniel Serwer

Fjala e e Ambasadorit të BE **54**
Remarks by EU Ambassador **57**
Luigi Soreca

"Politika e SHBA në Ballkanin Perëndimor - Sfida dhe perspektiva" **60**
US policy in the Western Balkans. Challenges and perspectives **62**
Paskal Milo

"Komisioni i ri Europian - Çfarë pritet për Shqipërinë dhe rajonin **64**
Is the new European Commission bringing
anything new to Albania and the region **66**
Miomir Zuzul

"Roli i SHBA në themelimin dhe finalizimin e shtetësisë së Kosovës" **68**
U.S. role in establishing and consolidating Kosova's statehood **70**
Ahmet Shala

"Historia dyshekullore e marrëdhënieve shqiptaroamerikane." **72**
Two centuries of Albanian- American relations **74**
Ksenofon Krisafi

POLITIKA AMERIKANE NË BALLKANIN PERËNDIMOR. SFIDA DHE PERSPEKTIVA
Paskal Milo **77**

DITA E DYTË E KONFERENCËS
Punimet e Sesioneve Tematike

NGA HISTORIKU DYSHEKULLOR I MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-AMERIKANE
Ksenofon Krisafi **86**

NDIKIMI I SHBA DHE POLITIKAVE TË SAJ NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONINË E VERIUT PAS VITIT 2001
Guximtar Rushani, Senada Laçka **122**

STRENGTHENING DEMOCRACY AND PROMOTING GROWTH AND DEVELOPMENT. THE CASE OF US- GOVERNMENT FOREIGN AID IN ALBANIA
Nevila Xhindi **135**

NDËRHYRJA USHTARAKE E NATO-S NËN UDHËHEQJEN E SHBA NË KOSOVË NË PRANVERËN E VITIT 1999
Skënder Demaliaj, Albana Demaliaj **146**

KONTRIBUTI I SHBA DHE BE-SË NË PROMOVIMIN E DEMOKRACISË DHE SHTETIT LIGJOR NË BALLKANIN PERËNDIMOR
Eriola Hoxha **154**

SHBA: PARTNERË MBËSHTETËS NDAJ SHQIPTARËVE QË PREJ PAVARËSISË DERI SOT
Xhuljeta Krasta **159**

KONTRIBUTI I SHBA NE ZHVILLIMIN E ARSIMIT SHQIPTAR
Nikollaq Pano, Ira Gjika **174**

SIGURIA RAJONALE, (DE)STABILITETI EKONOMIK DHE FLUKSI I MIGRACIONIT NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT – PERIUDHA 2016-2019
Nazmije Merko Zabzun, Genc Merko **186**

POLITIKA E PARTNERIT STRATEGJIK NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK TË VENDIT
Armelina Fushekati Lila, Sonila Nikolla, Rudina Qurku **191**

ROLI I KRIZËS FINANCIARE NË ZHVILLIMET E SEKTORIT BANKAR NË SHQIPËRI
Elia Botka **202**

BASHKËPUNIMI RAJONAL DREJT ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN
Esmeralda Hasani **215**

TEKNIKA TË SJELLJES DHE KOMUNIKIMIT
Holta Heba, Gertjan Veshaj **221**

EDUCATIONAL GOVERNANCE POLICY USA AND ALBANIA
Vebina Resuli, Ferjolt Ozuni, Erdet Lalaj **229**

ROLI I KRIZËS EKONOMIKE NË ZHVILLIMET E FUNDIT NDËRKOMBËTARE. RASTET NGA RAJONI
Drita Avdyli, Rudina Qurku **238**

E DREJTA E INFORMIMIT NË ÇËSHTJET E SIGURISË KOMBËTARE
Prof.As.Dr. Alketa Elezi, Dr. Erisa Kacupi **244**

E DREJTA PENALE DHE PROCEDURIALE NE SHQIPËRI, EVOLUIMI DHE SFIDAT AKTUALE NË SISTEMIN E DREJTËSISË
Prof.Asoc.Dr.Alketa Elezi **256**

The economic diplomacy, of the US and the EU towards Albania, as an instrument for the euroatlantic integration
Emilio Çika **269**



Profesor në fushën e ekonomisë dhe të financës, me një kontribut të shquar, veçanërisht në atë të financave publike dhe të reformave strukturore ekonomike gjatë periudhës së tranzicionit. Prej vitit 1982 e më pas ka kontribuar në profesoratin e Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit të Tiranës e më tej, pas vitit 1990 me angazhimet e tij në politikë. Deputet i Kuvendit të Shqipërisë për disa mandate që nga 1992 në vazhdim, Ministër i Ekonomisë, Ministër i Financave dhe Ministër i Punës dhe të Çështjeve Sociale. Prof. Dr.Angjeli është themeluesi i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve.

RËNDËSIA HISTORIKE E POLITIKËS SË SHBA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Fjala e hapjes së Konferencës

Prof. Dr. Anastas Angjeli
President i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë – SHQIPËRI

KEYWORDS: SHBA, Shqipëri, marrëdhënie, ekonomi, politikë, Ballkani Perëndimor, rajon, stabilitet, bashkëpunim

I nderuar z. Kryeministër i Republikës së Shqipërisë,

E nderuar znj. E Ngarkuara me Punë në Ambasadën e SHBA në Shqipëri,

I nderuar z. Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri,

Të nderuar përfaqësues të lartë të Shtetit shqiptar, si dhe të përfaqësive diplomatike të akredituara në Shqipëri,

Të nderuar kolegë, akademikë, studiues

Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare të organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë,

Nuk po dua ta fsheh, që në këtë fjalë hyrëse, emocionin që kam përpara pranisë së kaq shumë personalitesh të nderuar të jetës publike dhe akademike, shqiptare dhe ndërkombëtare. Së pari, sepse çdo rast që më shtyn të lë mënjanë, qoftë dhe përkohësisht, petkun e politikanit, e më jep mundësinë t'i rikthehem sërish detyrës së studiuesit, më jep një kënaqësi të papërshkueshme. Akoma më e veçantë është kjo ndjesi

në momentin kur selia akademike dhe promovuese e kësaj konference kaq ambicioze është Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Në këtë ditë, pikërisht në vitin e dekadës së parë të jetës së këtij institucioni të rëndësishëm të arsimit të lartë shqiptar, kam nderin e posaçëm të jem ngarkuar nga Senati akademik me hapjen e punimeve për këto dy ditë studimore të kushtuara politikës së Shteteve të Bashkuara në rajonin e Ballkanit perëndimor.

***

Pikënisja jonë për një event të këtyre përmasave është i lidhur, së pari, me një shqetësim të hershëm intelektual që ka të bëjë me aktualitetin dinamik të rajonit ku Shqipëria bën pjesë. Akoma më domethënëse bëhet një përpjekje e tillë kur rrethanave gjeografike të marra në shqyrtim i bashkëngjisim rolin dhe rëndësinë që ka për zhvillimet bashkëkohore në Ballkan politika e jashtme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Një shtet ky i fundit për të cilin rajoni ynë është veç nga shumë vendndodhjet e rëndësisë së veçantë për interesat amerikane të shtrira, prej gati një shekulli, në të gjithë globin. E megjithatë, është po ky Ballkan Perëndimor, si pjesë integrale e gjithë hapësirës mesdhetare dhe evropiane jug-perëndimore, që vazhdon pa rreshtur të tërheqë vëmendjen dhe përkushtimin e arkitektëve të politikës së jashtme amerikane.

Duke u nisur pra nga të tilla premisa, duke dashur që të ofrojmë gjithë kontributin tonë, modest por dhe serioz e të vendosur, e pamë me shumë interes të ishim ne, si Universitet Mesdhetar i Shqipërisë, nxitësit e një tavolinë të rrumbullakët në të cilën, për dy ditë, të mund të ngriheshin për diskutim dhe shtrim të gjitha çështjet që, në këndvështrimin shqiptar e më gjerë, vlerësojnë me vëmendje të veçantë rolin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rajon. Rast ky që na u duk me të vërtetë i vlefshëm për të bërë bashkë personalitete të jetës publike, gazetarë e analistë, studiues të shkencave juridike, politike, ekonomike dhe historike, me synim kryesor zgjerimin e hapesirave debatuese të kësaj konference.

***

Ky vit, plot një shekull pas hapjes solemne të bisedimeve të paqes që u zhvilluan në Versajë, që i dha fund operacioneve të zhvilluara përgjatë konfliktit të parë botëror, bart dhe përkujtimin e angazhimit të parë, vërtetë domethënës, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në planin global. Kanë kaluar më shumë se 100 vite pra që kur Uashingtoni nisi të prodhojë një qasje politike dhe diplomatike që i tejkalonte brigjet gjeografike të dy oqeaneve që e rrethojnë. Rëndësia e një risie të tillë ka lënë shenja të pashlyeshme historike dhe për rajonin në të cilin Shqipëria bën pjesë, duke u kthyer në faktor me impakt të paprecedentë në gjithë zhvillimet e mëpasme. Është i njohur, i kthyer gati në një aksiomë të rëndësisë paradigmatike, ndikimi i asokohshëm që pati veprimtaria e shquar diplomatike e administratës së Presidentit Uillson në fatet e Shqipërisë. Duke

shmangur rrezikun e t'u treguarit tejet fatalistë në lëmin e analizës historike, kemi bindjen e padiskutueshme se gjërat do të kishin rrjedhur krejt ndryshe nëse Uashingtoni nuk do të kishte mbajtur pozicionin që mbajti. Akoma më keq nëse politika e jashtme amerikane nuk do të kishte qenë fare e pranishme për fatet e atëhershme dhe të mëvonshme të Shqipërisë. Megjithatë, pavarësisht evolucionit shpesh herë dramatik dhe të paparashikueshëm të ngjarjeve që rrodhën pas, pavarësisht se ai konflikt i sapombyllur u ndoq, vetëm dy dekada më vonë, nga një tjetër edhe më i ashpër, lidhjet mes Ballkanit dhe Shteteve të Bashkuara nuk u shkëputën.

Nëse sot mund të pohojmë me plot bindje se lidhja politike dhe kulturore mes dy anëve të Atlantikut, duke llogaritur dhe ulje-ngritjet e herëpashershme, vazhdon të jetë e një rëndësie kardinale, për vetë fatet e popujve të përfshirë, kurrsesi rajoni që do të jetë në qendër të kësaj konference nuk mund të përjashtohet nga një ekuacion i tillë gjeopolitik dhe gjeostrategjik. Në këtë kuptim, nëse për gati 45 vite pesha dhe ndikimi amerikan në Ballkan pësoi një ndryshim konceptual jo pak domethënës – çka nuk duhet të intepretohet si zbehje por më tepër si një ndryshim vektorial. Edhe ky i fundit, megjithatë, nuk do të ishte pa pasoja. E në fakt, do të ishte pikërisht kjo prani amerikane në Ballkanin e socializmit real– shpesh e padukshme, shpesh maksimalisht e kujdesshme, por kurrë tërësisht e huaj – që do të vepronte si shtysë kapilare në gjithë zhvillimet që i paraprinë dhe ndoqën rënien e Murit të Berlinit.

Nga ajo kohë e më pas, të thënat dhe të pathënat nuk janë më histori por aktualitet. Megjithëse shumë ujëra kanë kaluar që nga fundi i shekullit që kemi lënë pas, megjithëse shumë ujëra vazhdojnë të ndajnë çastet vendimarrëse të politikave evropiane dhe amerikane, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ende sot, vazhdojnë të luajnë një rol të dorës së parë në gjithë zhvillimet rajonale. Që nga shkëndijat e para të konfliktit etnik në ish-Jugosllavi, tek marrëveshja e Dejtonit, tek ndërhyrja e paprecedentë e NATO-s në Kosovë, tek zhvillimet e pastajme në marrëdhëniet mes Beogradit dhe Prishtinës, Athinës dhe Shkupit, integrimi i Kroacisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në strukturat atlantike e deri tek ngjarjet që janë pjesë e përditshmërisë sonë, fatet rajonale janë ngushtësisht të lidhura me politikëbërjen globale të Uashingtonit.

***

Parë pra në këtë këndvështrim, detyrimisht të gjerë por dhe të kujdesshëm për çdo detaj të aspektit mikro, kjo konferencë ndjek qëllimin parësor të hedhjes së farës së diskutimit. Momenti është mëse unik, siç thashë, edhe për vetë rëndësinë që ndjek 100-vjetori i përfshirjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në historinë dhe zhvillimet, shpesh dramatike, të këtij rajoni. Kësisoj, merr një rëndësi të dorës së parë, së paku parë përmes lentes studimore nxjerrja në pah e atyre aspekteve që kanë të bëjnë me rrjedhën historike të gjithë

angazhimit amerikan në rajon dhe përgjigjen që rajoni, në faza të ndryshme të ecurisë politike, i ka dhënë një interesimi të tillë. Përpos, një vëmëndje e veçantë i është kushtuar sfidave aktuale, ndërkaq që gjithmonë e më tepër gjykohet se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë ulur praninë e tyre fizike në Ballkanin perëndimor. A është i vërtetë një supozim i tillë? Cilat janë, përkundër, pasojat mbi rajonale të një evolucioni të tillë strategjik? Konsiderata të tilla na shtyjnë që të marrim parasysh dhe nevojën për një reflektim të thellë teorik, sa në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare aq dhe në atë të studimeve të sigurisë, për të kuptuar dhe vlerësuar dhe të gjitha pasojat në rrafshin praktik. Në fund, organizatorët e konferencës e kanë parë si të nëvojshme – e do të shtoja, tepër të dobishme – ta qarkojnë debatin dhe analizat përreth gjithë dinamikave që karakterizojnë bashkëpunimin dhe bashkëveprimin SHBA-BE në lidhje me integrimin evropian të Ballkanit perëndimor.

***

Më lejoni pra, të dashur miq, kolegë, të ftuar, t'i konsideroj të hapura punimet e kësaj konference dhe t'i uroj organizatorëve e pjesëmarrësve punë të mbarë në dy ditët solemne të zhvillimit të saj.



Professor in the field of economics and finance, with an outstanding contribution, especially in public finance and structural reforms in economics. From 1982 onwards he has been a Professor at the Faculty of Economics of the University of Tirana. Member of the Albanian Parliament for several terms since 1991, Minister of Economy, Minister of Finance and Minister of Labor and Social Affairs. Prof. Dr. Anastas Angjeli is the founder of the Mediterranean University of Albania, a member of the Academy of Sciences of the Republic of Albania and a member of the European Academy of Sciences and Arts.

The significative role of U.S. policy in Western Balkans

Conference opening remarks

Prof. Dr. Anastas Angjeli
President of Mediterranean University of Albania, ALBANIA

KEYWORDS: USA, Albania, relations, politics, economy, Western Balkans, region, stability, cooperation

Honored Mr. Prime Minister of the Republic of Albania,

Honored Mrs. Chargé d'Affaires, U.S. Embassy in Albania,

Honored Mr. Ambassador of the European Union to Albania,

Honored senior representatives of the Albanian State, as well as of the diplomatic delegations accredited in Albania,

Dear colleagues, academics, researchers,

Dear participants in this international scientific conference organized by the Mediterranean University of Albania,

I do not want to hide the emotion I feel in front of the presence of so many honored Albanian and international personalities of public and academic life. First of all, I want to emphasize that each opportunity that pushes me aside, even temporarily, the cloak of a politician, gives me the opportunity to return to the job of a researcher, gives me an indescribable pleasure. This feeling becomes even more special at the moment when the academic and promotional headquarter of this ambitious conference, is the Mediterranean University of Albania. On this day, exactly in the first decade of the life of this important institution of Albanian higher education, I have the special honor to be charged by the Academic Senate

with the opening of proceedings for these two days of study dedicated to the United States policy in the Western Balkans region.

***

Our starting point for such an event of this size is, first of all, related to an early intellectual concern of the dynamic topicality of the region, to which Albania is a part of. Such an effort becomes even more significant when the given geographical circumstances under consideration, we attach the role and importance of contemporary US foreign policy in the Balkans. The latter is a state for which our region is one of the many sites of special importance for American interests that have been spread around the globe for almost a century. And yet, it is Western Balkans, as an integral part of the entire Mediterranean and European south-western space that continues to attract the attention and dedication of American foreign policy architects.

***

Based on such premises, wanting to offer all our modest but also serious and determined contribution, we consider with great interest that we, as Mediterranean University of Albania, the promoters of a round table on two days could raise for discussion, all issues that, in the Albanian perspective and beyond, assess with special attention the role of the United States of America. This case seemed to us really worthwhile to bring together personalities of public life, journalists and analysts, scholars of legal, political, economic and historical sciences, with the main goal of expanding the debate spaces of this conference.

***

This year, a full century after the solemn opening of the peace talks in Versailles, which ended operations conducted during the First World War, carries with it the commemoration of the first, truly significant, engagement of the United States in a global plan. More than 100 years have passed since Washington began producing a political and diplomatic approach that transcended the geographical boundaries of the two surrounding oceans. The importance of such an innovation has left indelible historical marks for the region in which Albania is part of, becoming a factor with unprecedented impact on all subsequent developments. It is well known, almost an axiom of paradigmatic importance, that the influence of President Wilson's administration on Albania's fate was significant at the time. By avoiding the risk of being overly fatalistic in the realm of historical analysis, we have the indisputable conviction that things would have turned out quite differently if Washington had not maintained its position. Even worse, if American foreign policy had not been present at all for Albania`s past and subsequent fates. However, despite the often dramatic and unpredictable evolution of the events that followed, despite the fact that the newly concluded conflict was followed; only two decades later, by an even harsher one, the bond between the Balkans and the United States were not disconnected.

If today we can say with full conviction that the political and cultural connection

between the two sides of the Atlantic, taking into account the occasional ups and downs, continues to be of cardinal importance, for the fate of the peoples involved, by no means the region that will be at the center of this conference cannot be excluded from such a geopolitical and geostrategic equation. In this sense, if for almost 45 years the American weight and influence in the Balkans underwent a not-so-significant conceptual change - which should not be interpreted as a fading but rather as a vector change. Even the latter, however, would not be without consequences. In fact, it would be this American presence in the Balkans of real socialism - often invisible, often maximally careful, but never entirely foreign - that would act as a capillary impetus to all the developments that preceded and followed the fall of the Berlin Wall.

From that time on, what is said and what is not, is no longer history but actuality. Although many waters have passed since the end of the last century, although many waters continue to share the decisive moments of European and American policies, the United States of America, still today, continues to play a primary role in all regional developments. From the first sparks of ethnic conflict in the former Yugoslavia, to Dayton's agreement, to NATO's unprecedented intervention in Kosovo, to subsequent developments in relations between Belgrade and Pristina, Athens and Skopje, the integration of Croatia, Albania and Northern Macedonia in Atlantic structures to the events that are part of our daily lives, regional destinies are closely linked to Washington's global policy-making.

Seen in this light, necessarily broad but also careful about every detail of the micro aspect, this conference pursues the primary goal of sowing the seeds of discussion. The moment is very unique, as I said, for the importance that the 100th anniversary of the involvement of the United States of America in the history and developments, often dramatic, of this region. Thus, it is of primary importance, at least through the lens of study, to highlight those aspects related to the historical course of all American engagement in the region and the response that the region, at different stages of political progress, has given such interest. In addition, special attention has been paid to the current challenges, while it is increasingly being judged that the United States has reduced its physical presence in the Western Balkans. Is such an assumption true? What are, after all, the regional consequences of such a strategic evolution? Such considerations push us to consider the need for a deep theoretical reflection, both in the field of international relations and in the field of security studies, to understand and evaluate all the consequences in practical level. In the end, the conference organizers saw it as necessary - and I would add, very helpful - to circulate the debate and analysis around all the dynamics that characterize US-EU cooperation and interaction regarding the European integration of the Western Balkans.

***

So allow me, dear friends, colleagues, and guests, to consider the proceedings of this conference open and I would like to wish the organizers and participants, good work in the two solemn days of its development.



Leyla Moses-Ones nisi karrierën e saj diplomatike si Zyrtare e Shërbimit të Jashtëm në Departamentin e Shtetit në korrik të vitit 2001. Që atëherë, ka shërbyer në pozicionin e zyrtares konsullore në San Hose, Kosta Rika; zyrtares politike në Maputo, Mozambik; Zyrtares për Vëzhgimin në Qendrën Operacionale; Zëvendës Zyrtares Kryesore në Adana, Turqi; Zyrtares për Marrëdhëniet me Publikun në Mynih, Gjermani; dhe si Zëvendës Drejtore në Zyrën e Politikave dhe Çështjeve Globale të Byrosë për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike (EUR/PGI) në Uashington, D.C Përveç kësaj, para se t'i bashkohej EUR/PGI në vitin 2015, Leyla përfundoi me rezultate të shkëlqyera Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes duke marrë Diplomën e nivelit Master për Sigurinë Kombëtare dhe Strategjinë për Burimet e Mbrojtjes. Ajo mbërriti në Tiranë në muajin gusht të 2018 për të filluar mandatin tre-vjeçar siZëvendës Ambasadore.

Fjala e të Ngarkuarës me Punë Leyla Moses-Ones

E Ngarkuara me Punë, Ambasada e SHBA në Shqipëri, SHBA

KEYWORDS: SHBA, Shqipëri, marrëdhënie, Ballkani Perëndimor

I dashur Kryeministër Rama, Ambasador Shannon, Ambasador Soreca dhe Ambasador Zuzul, Z. Serwer, Profesor Doktor Angjeli, është vërtet një nder të jem pjesë e kesaj konference. Jam ulur pranë një gjigandi të diplomacisë së Shteteve të Bashkuara dhe është nder i madh për mua që sot të ulem pranë ish NënSekretarit për Çështjet Politike Tom Shannon.

Të gjithë pranojmë se rendi global pas Luftës së Dytë Botërore po evoluon. Ndërsa karakatina e ndryshkur e Luftës së Ftohtë shpërbëhet, vendin e saj e ka zënë një garë globale për ndikim. Shtetet e Bashkuara e mirëpresin këtë mundësi për të garuar për ndikim pozitiv, sepse ne jemi besimplotë në vlerën e ofertave tona.

Është në interesin strategjik të Shteteve të Bashkuara, sigurisht, të promovojmë paqen, begatinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Po, interesi ynë është praktik, pjesërisht. Një gadishull ballkanik në paqe iu mundëson vendeve të rajonit të kontribuojnë për rritjen e sigurisë gjetkë në botë. Një ekonomi e lulëzuar e Ballkanit siguron tregje për bizneset amerikane. Dhe qetësia e brendshme në Ballkan lejon hartuesit e politikave amerikane që të përqëndrojnë kohën dhe burimet e tyre në kriza që ndikojnë rajone të tjera.

Por, politika e Sh.B.A. në Ballkanin Perëndimor parashikon shumë më tepër se sa kaq. Që nga viti 1789, pjesë e interesave tona thelbësore ka qenë të bëjmë avokatin për lirinë dhe barazinë e të tjerëve – siç tha Presidenti Abraham Linkoln, kombi ynë

është krijuar në liri dhe i përkushtohet premisës që të gjithë jemi krijuar të barabartë. Ndjekja e interesit të Sh.B.A. domosdoshmërisht përfshin të përkrahurit dhe të vepruarit në emër të idealeve tona. Ne duam që edhe ju të jeni të lirë dhe të barabartë.

Është e vërtetë – rruga që ne ofrojmë është e vështirë. Është e shtruar me standarde, pritshmëri dhe punë të palodhur, por që do të çojë drejt një Ballkani Perëndimor të lulëzuar, të qëndrueshëm, njerëzit e të cilit janë krenarë për nga vijnë dhe çfarë përfaqësojnë.

Ndërsa shqyrtoj prioritetet e politikës së Shteteve të Bashkuara për rajonin, do të përqendrohem në politikën e Sh.B.A-së ndaj Shqipërisë, një vend me një angazhim të demonstruar ndaj bashkësisë transatlantike. Ajo që bëni dhe zgjedhjet që ndërmerrni kanë pasoja të mëdha për bashkësinë euro-atlantike. Më lejoni t'ju them se si.

Po, deklarata e 18 tetorit e Këshillit të Evropës për zgjerimin ka frymëzuar faqe të tëra komentesh. Ja se çfarë ka rëndësi: Shqipëria është tashmë një vend kandidat – kjo nuk ka ndryshuar. Puna që po tashmë po vazhdon dhe ajo çfarë mbetet për t'u bërë nuk ka ndryshuar. Shqipëria do të fitojë vendin e saj në radhët e shteteve anëtare të BE-së duke dyfishuar përpjekjet për zbatimin e reformave në drejtësi, fshirë korrupsionin dhe fitoren mbi plagën e krimit të organizuar. Kjo ka të bëjë me vlerat; kjo ka të bëjë me sundimin e ligjit; kjo ka të bëjë me begatinë dhe mundësinë për qytetarët shqiptarë.

Shqipëria jo vetëm që po punon shumë për reformën në drejtësi, por tashmë reforma zgjedhore është bërë një projekt kombëtar që qeveria, opozita parlamentare dhe partitë opozitare jashtë tij, po e ndjekin. Drejtuesit e Shqipërisë kanë treguar vullnetin për të bërë kompromis për hir të së mirës të përbashkët.

E mira e përbashkët kërkon një mbrojtje të përbashkët – sigurisht, kjo është premisa e NATO-s. Presim me kënaqësi të mirëpresm Maqedoninë e Veriut së shpejti si aleatja e saj e tridhjetë. Aleanca po evoluon gjithashtu, pasi siguria e mëparshme e Evropës, e subvencionuar nga Sh.B.A., transformohet në një përpjekje të përbashkët për të cilën kontribuojmë të gjithë. Dhe Shqipëria ka përmbushur angazhimin e saj. Shqipëria ka respektuar Premtimin në Samitin e Uellsit. Shqipëria kontribuon më shumë trupa për frymë se pothuajse të gjitha vendet e tjera evropiane. Dhe shqiptarët kanë dhënë jetën e tyre në shërbim të mbrojtjes sonë të përbashkët.

Ekzistojnë vende të tjera që kërkojnë rrugë më të lehta përpara. Në frymën e konferencës së sotme, shqyrtojini ofertat e tyre përpara se t'i pranoni ato. Do të zbuloni që, për Rusinë, Iranin, Kinën, Ballkani Perëndimor është një mjet për një qëllim, një burim nga i cili mund të shfrytëzohet dhe pastaj të flaket tej. Nuk ka asgjë idealiste në qëllimet e tyre. Ata gjithashtu kërkojnë të minojnë modelin perëndimor të vetëqeverisjes që çmon lirinë dhe zgjedhjen me oligarkitë e korruptuara të cilat janë të divorcuara prej interesit të njerëzve të cilëve supozohet t'iu shërbejë qeveria.

Kina ka vënë në zbatim diplomacinë shtrënguese të debitorit për të blerë një ndikim që i pret fuqitë forcës ekonomike dhe gjymton autonominë politike të të ashtuquajturve partnerë të saj. Kremlini këmbëngul të mos eksportojë asgjë tjetër përveç kaosit, ndërsa kërkon të rikuperojë humbjet sovjetike nga Lufta e Ftohtë. Irani ka shfrytëzuar praninë e tij diplomatike në Tiranë për të planifikuar shkatërrimin e

kundërshtarëve të tij politikë, duke kërkuar t'i përgjigjet argumenteve të arsyes me burracakërinë e detonatorëve të fshehur.

Shqipëria ia ka bërë të qartë Kinës se disa gjëra thjesht nuk janë për shitje. Shqipëria ka refuzuar makinacionet ruse.. Dhe, Shqipëria ka treguar që nuk do të tolerojë terroristë iranianë në tokën e saj. Shqipëria ka zgjedhur, sërish dhe përsëri, të mbajë qëndrime parimore.

Vitin tjetër, Shqipëria do të marrë kryesimin e Zyrës së OSBE-së, duke udhëhequr një organizatë që gjithashtu mban qëndrime parimore. Ne do të vazhdojmë mbështetjen tonë besnike ndaj Shqipërisë teksa ajo përdor vlerat frymëzuese dhe zyrën e respektuar të OSBE-së për të trajtuar çështje dhe kriza të mprehta. Shtetet e Bashkuara mirëpresin prioritet e përcaktuara nga Shqipëria – përfshirë luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, përkrahjen e rolit të grave në zgjidhjen e konflikteve, rininë dhe kontrollin e armëve – dhe presim me kënaqësi të punojnë me Shqipërinë gjatë kryesimit të OSBE-së në vitin 2020.

Sigurisht siguria energjetike mbetet thelbësore për suksesin e bashkësisë transatlantike. Që nga hidrocentralet te gazi natyror i lëngshëm, nga nafta deri te energjia diellore, Shqipëria dhe Ballkani Perëndimor mund të formojnë bërthamën e një strategjie energjetike të larmishme për të furnizuar botën perëndimore, ndërsa korrin përfitimet prej vendndodhjes së tyre gjeostrategjike.

Dhe, përsa i përket vendndodhjes gjeostrategjike, ju e dini se revolucioni 5G po vjen: ndërlidhja e rrjeteve 4G të Shqipërisë së shpejti do të përmirësohet; ndërlidhja e vendit të saj gjeostrategjik në hartë është e rëndësishme sepse ka vende si Kina që do të dëshironin të kapnin mënyrën e jetesës dixhitale të Ballkanit Perëndimor për të thithur informacione prej tyre dhe asfiksuar rrjetet e aleatëve të Sh.B.A-së. Shqipëria tashmë po bën gjënë e duhur duke ushtruar vigjilencë në mbrotje të rrjeteve të saj. Edhe një herë, disa gjëra në Shqipëri thjesht nuk janë për shitje.

Shqipëria ka ndërmarrë gjithashtu një qëndrim parimor për një çështje tjetër rajonale me rëndësi të madhe për Shtetet e Bashkuara: dialogu i lehtësuar nga BE ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shtetet e Bashkuara kanë dyfishuar gjithashtu përpjekjet e tyre për t'u siguruar që dialogu të rifillojë, ashtu si u nënvizua edhe nga profesorët, përmes emërimeve të fundit të të Dërguarve të posaçëm në rajon. Vetë Presidenti i Shteteve të Bashkuara ka bërë thirrje që udhëheqësit e të dy vendeve të ecin përpra drejt një të ardhmeje të përbashkët, të begatë dhe të paqtë. Shqipëria gjithashtu e sheh qartë këtë të ardhme dhe bashkohet me Shtetet e Bashkuara në mbështetjen e saj për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë.

Shtetet e Bashkura u angazhuan për sovranitetin shqiptar në vitin 1912 – më shumë se një shekull më parë – dhe angazhimi ynë është i paepur. Rruga amerikane është e vështirë, por ia vlen, pasi ofrojmë një partneritet të bazuar në vlera të qëndrueshme – midis tyre lirinë e fjalës, lirinë e fesë, mundësi të barabartë, baraza, liri individuale dhe liri qytetare.

Kjo është një kohë e jashtëzakonshme për Ballkanin Perëndimor. Jemi me fat që kemi këtë mundësi për të ndihmuar në dhënien formë të ardhmes duke mbështetur udhëheqësit e rajonit në formimin e qeverive të njerëzve, nga njerëzit dhe për njerëzit.

E vlerësoj mundësinë që më dhatë për të folur sot. Shumë faleminderit!



Leyla Moses-Ones began her diplomatic career as a Foreign Service Officer with the Department of State in July 2001. Since then, she has served in the positions of: consular officer in San Jose, Costa Rica; political officer in Maputo, Mozambique; Watch Officer at the Operations Center; Deputy Principal Officer in Adana, Turkey; Public Affairs Officer in Munich, Germany; and Deputy Director of the Bureau for European and Eurasian Affairs' Office of Policy and Global Issues (EUR/PGI) in Washington, D.C. In addition, prior to joining EUR/PGI in 2015, Leyla was a distinguished graduate of the National Defense University, earning a Master's Degree in National Security and Defense Resource Strategy. She arrived in Tirana in August 2018 to begin a three-year assignment as Deputy Chief of Mission.

Remarks by Chargé d'Affaires, a.i. Leyla Moses-Ones

U.S. Embassy in Albania, USA

KEYWORDS: USA, Albania, relations, Western Balkans

Dear Prime Minister Rama, Ambassador Shannon, Ambassador Soreca, and Ambassador Zuzul, Mr. Serwer and Professor Dr. Angjeli, it is truly an honor to take part in this conference. I am sitting next to a giant of U.S. diplomacy and it is a big honor for me today to be sitting next to my former Under Secretary for Political Affairs Tom Shannon.

We all recognize that the post-World War II order is evolving. As the rusting hulk of the Cold War disintegrates, a global competition for influence has taken its place. The United States welcomes this opportunity to compete for positive influence because we are confident in the value of our offerings.

It is in the strategic interest of the United States, of course, to promote peace, prosperity, and stability in the Western Balkans. And yes, our interest is practical, in part. A peaceful Balkan peninsula enables the countries of the region to contribute to enhancing security elsewhere in the world. A thriving Balkan economy provides markets for U.S. businesses. And domestic tranquility in the Balkans allows U.S. policy makers to focus their time and resources on crises affecting other regions.

But U.S. policy in the Western Balkans envisions much more than that. Ever since 1789, our core interests have included advocating for freedom and equality for others – as President Abraham Lincoln said, ours is a nation conceived in liberty and dedicated to the proposition that all were created equal. The pursuit of the U.S. interest necessarily involves advocating for and acting on our ideals. We want you

to be free and equal, too.

It is true – the path we offer is hard. It is paved with standards, expectations, hard work but it will lead to a thriving, stable Western Balkans, whose people are proud of where they come from and what they stand for.

As I survey the policy priorities of the United States for the region, I will focus on U.S. policy towards Albania, a nation with a demonstrated commitment to the transatlantic community. What you do and the choices you make have great consequence for the Euro-Atlantic community. Let me tell you how.

Yes, the EU's October 18 statement on enlargement has inspired pages of mixed commentary. Here is what matters: Albania is a candidate country already – this has not changed. The work that is already underway and the work that must be done have not changed. Albania will its earn place in the ranks of EU member states by redoubling efforts at implementing justice reforms, wiping out corruption, and conquering the scourge of organized crime. This is about values; it is about rule of law; it is about prosperity and opportunity for Albanian citizens.

Not only is Albania working hard on justice reform, electoral reform is now a national project that the government, the parliamentary opposition, and opposition parties outside of office are pursuing. Albania's leaders have shown a willingness to compromise, for the sake of the common good.

The common good requires a common defense – of course, this is the premise of NATO. We look forward to welcome North Macedonia soon as its 30th ally. The Alliance is also evolving, as the previous, U.S.-subsidized security of Europe transforms into a common endeavor to which we all contribute. And Albania has delivered on its commitment. Albania has honored the Wales Summit Pledge. Albania contributes more troops per capita than nearly all other European nations. And Albanians have given their lives in the service of our collective defense.

There are other nations that flaunt easier roads forward. In the spirit of today's conference, scrutinize their offerings before you accept them. You will find that, for Russia, Iran, China, the Western Balkans is a means to an end, a resource from which to extract value and discard. There is nothing idealistic about their goals. They seek to undermine the Western model of self-government that prizes liberty and choice with corrupt oligarchies divorced from the interests of the people whom government is supposed to serve.

China has deployed coercive debtor diplomacy to purchase an influence that saps the economic strength and cripples the political autonomy of its so-called partners. The Kremlin insists on exporting nothing but chaos as it seeks to recover Soviet losses from the Cold War. Iran has exploited its diplomatic presence in Tirana to scheme for the destruction of its political opponents, seeking to answer reasoned arguments with the cowardice of hidden detonators.

Albania has made it clear to China that some things simply are not for sale. Albania has rejected Russian machinations. And Albania has shown it will not tolerate Iranian terrorists on its soil. Albania has chosen, again and again, to make principled stands.

Next year, Albania will assume the Chair in Office of the OSCE, leading an organization that also takes principled stands. We will continue our staunch support of Albania as it deploys the inspirational values and good offices of the OSCE to address thorny issues and crises. The United States welcomes the priorities set forth by Albania – to include combatting terrorism and violent extremism, promoting the role of women in conflict resolution, youth, and arms control – and look forward to working with Albania during its OSCE Chairmanship in 2020.

Energy security remains crucial to the success of the transatlantic community. From hydropower to liquified natural gas, from petroleum to solar power, Albania and the rest of the Western Balkans can form the nucleus of a diversified energy strategy to fuel the Western world while reaping the benefits of their geostrategic location.

And on geostrategic location, you know the 5G revolution is coming: the connectivity of Albania's 4G networks will soon upgraded; the connectivity of its geostrategic position on the map is important because there are nations like China that desire to seize the digital lifeline of the Western Balkans to siphon information from, and choke the networks of, U.S. Allies. Albania is already doing the right thing by exercising vigilance by protecting its networks. Again, some things in Albania are simply not for sale.

Albania has also taken a principled stand on another regional matter of great significance to the United States: the EU-facilitated dialogue between Kosovo and Serbia. The United States has also redoubled its efforts to ensure that the dialogue resumes, through, as noted by the professor, recent appointments of special Envoys to the region. The President of the United States himself has called for leaders in both countries to move toward a joint, prosperous, and peaceful future. Albania also sees this future clearly and joins the United States in its support for the normalization of relations between Kosovo and Serbia.

The United States committed itself to Albanian sovereignty in 1912 – more than a century ago – and our commitment is adamant. The American way is tough, but it is worth it, because we offer a partnership based on enduring values – among them freedom of speech, freedom of religion, equal opportunity, equity, individual liberty and civic participation.

It is a remarkable time for the Western Balkans. We are fortunate to have this opportunity to help shape the future by supporting regional leaders in forming governments of the people, by the people, and for the people.

I appreciate the opportunity to speak today. Thank you Very much!



Edi Rama ka një karrierë të larmishme në arte, sport, mësimdhënie, publicistikë dhe politikë. Edi Rama hyri në politikë si Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në vitin 1998. Në vitin 2000, Edi Rama u zgjodh Kryebashkiak i Tiranës. Edi Rama u rizgjodh sërish Kryetar i Bashkisë Tiranë në vitin 2003 dhe 2007 dhe për 11 vjet drejtoi kryeqytetin e Shqipërisë. Në vitin 2005, Edi Rama u zgjodh Kryetar i Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilën e udhëhoqi gjatë viteve të vështira në opozitë dhe në fitoren plebishitare të 23 qershorit 2013. Nën drejtimin e Ramës si Kryeministër, Shqipëria fitoi statusin e vendit kandidat në vitin 2014.

Shqipëria, marrëdhënie speciale me SHBA

Edi Rama
Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, SHQIPËRI

KEYWORDS: Shqipëri, SHBA, marrëdhënie speciale

Fan Noli tregon se gjatë kthimit nga një takim në Mount Vernon për në Washington u ndesh me Presidentin Willson, të cilit i kërkoi të merrte përsipër të shpëtonte, siç shkruan ai, një racë heroike, por të pambrojtur si shqiptarët, në vigjilje të Konferencës së Paqes ku do të vendosej edhe fati i Shqipërisë. E po sipas tij, Presidenti amerikan iu përgjigj pa ngurrim se do të ishte një zë në Konferencën e Paqes, por ai zë do të mbronte Shqipërinë.

E në fakt ashtu ndodhi dhe qysh prej asaj kohe, marrëdhënia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shqiptarëve dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës së me shqiptarët nisi të plazmohej si një marrëdhënie speciale, e cila sot pa as më të voglin dyshim është në themelin e politikës tonë të jashtme, por me shumë se kaq, është në themelin e vetëdijes së shqiptarëve se jo vetëm nuk janë vetëm, por se janë në shoqërinë më të mirë të mundshme. E nëse sot, në rajonin tonë, shqiptarët janë më mirë se asnjëherë tjetër, krahasuar me të shkuarën e vështirë të kombit tonë dhe të popullit tonë të shpërndarë në të gjitha shtetet e rajonit, kjo në radhë të parë mund të thuhet pa frikë se i dedikohet kësaj marrëdhënie speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe qasjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj shqiptarëve dhe ndaj vetë rajonit.

Me thënë të drejtën i shkojnë më se miri kësaj marrëdhënie dhe përkushtimit të shqiptarëve për këtë marrëdhënie, fjalët e Nolit, i cili thotë për Amerikën, "një

vend kaq i madh, që udhëheq njerëzimin drejt një të ardhme më të mirë dhe paqes universale, drejtësisë, lirisë dhe demokracisë".

Kam vërë re se shumëkush ndër miqtë dhe partnerët tanë europiane në të gjitha nivelet, edhe në nivelin e njerëzve të zakonshëm, edhe në nivelin e njerëzve, le të themi, më pak të zakonshëm, e shikojnë këtë marrëdhënie si një shprehje deri diku naive të kuptimit tonë për botën dhe jo rrallë më ka ndodhur që ndesh një lloj buzëqeshjeje gati-gati të keqardhur për këtë përkushtim që ne kemi si popull, si komb ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në fakt është shumë e vështirë që të mund të kuptohet nga të tjerët Pse-ja e kësaj marrëdhënieje, e cila është e lidhur thelle edhe me atë çka ne kemi jetuar si komb në shumë faza të historisë, por edhe me atë çka ne kemi përjetuar si popull, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë, në periudhën e parë të jetës sonë si bashkëkohës që sot e jetojmë ende historinë dhe hapësirën shqiptare, qoftë çka kemi përjetuar ne në Shqipëri, kur Shqipëria u bë Koreja e Veriut e Europës, qoftë çka kanë përjetuar shqiptarët e Kosovës në periudhën e zymtë të të jetuarit si qytetarë të dorës së dytë, në një kontekst që erdhi duke u rënduar deri në kulmimin me një projekt të vënë në zbatim spastrimi etnik.

Këto kanë ndikuar thelbësisht në vetëdijen tonë, ashtu si sikundër, nëse sot, Ballkani Perëndimor është një vend më i mirë, kjo i dedikohet në radhë të parë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe besoj se Ballkani Perëndimor është pasqyra e ndoshta suksesit më rrezatues të politikës së jashtme amerikane të të gjithë periudhës historike pas përfundimit të luftës së ftohtë. Një pasqyrë, ku historia e përmbledhur e viteve që ne i kemi jetuar si dëshmitarë okularë nisi praktikisht me një konflikt të madh, pastaj u shkua në bomba dhe nga bombat jemi në kushtet kur flasim për intensifikim të bashkëpunimit rajonal, edhe pse padiskutim jemi ende larg zgjidhjes përfundimtare të paqes, për sa kohë nuk ka një zgjidhje përfundimtare të konfliktit të trashëguar mes Serbisë dhe Kosovës.

Po ashtu vlen të theksohet se edhe emërimi në këtë fazë delikate të jetës politike të Ballkanit Perëndimor i dy personaliteteve krejt të ndryshëm, por gjithsesi me zë dhe me një fuqi të mjaftueshme për të ndikuar në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, nga njëra anë, i një miku të hershëm të kësaj zone dhe të shqiptarëve, pa diskutim, Matthew Palmer dhe nga ana tjetër, ambasadorit Grenell, përbëjnë një shenjë kuptimplotë të interesimit dhe të një fokusi që është i domosdoshëm, gjithsesi, nga ana e Shteteve të Bashkuara mbi rajonin dhe mbi këtë konflikt.

Nuk besoj se them një gjë të paditur që, pas vendimit të Këshillit Europian në 18 tetor, pozicioni i Bashkimit Europian në këtë konflikt është dobësuar tej mase dhe kapaciteti i Bashkimit Europian për të ndikuar në procesin e dialogut është tkurrur tej mase, sepse faktikisht, Bashkimi Europian me vendimin e marrë, apo me mosvendimin që rezultoi në fund të një debati të nxehtë mes veti në raport me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ndër të tjera dhe në radhe të parë, mendoj unë, i dha një goditje jo të vogël besueshmërisë së vetë. Do të jetë e vështirë për të dyja palët në procesin e dialogut që të besojnë në mundësinë e incentivave që mund të deklarohen dhe mund të deklarohen sinqerisht, por faktikisht mund të mos mbahen

dhe nuk është hera e parë. Po bëhen disa herë, për hir të së vërtetës, që Bashkimi Europian nuk mban fjalën dhe në rastin e Kosovës besoj se kemi një nga shembujt më flagrantë të mungesës së kapacitetit për të mbajtur fjalën, se në fund të ditës nuk duhet të harrojmë që nuk është një shtet, është një tërësi shtetesh, e cila funksionin në bazë të konsensusit dhe mjafton që një shtet në atë tërësi të kundërvihet dhe e gjithë tërësia e shteteve vendoset në një pozitë të vështirë. E kam fjalën këtu për rastin e kushtëzimit absurd, por, sidoqoftë, një kushtëzim që domosdoshmërisht u mor në konsideratë dhe praktikisht u adresua, të liberalizimit të vizave për Kosovën pas kryerjes së marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi.

Është një rast unikal, ndërkohë që nga viti 2014, Bashkimi Europian ka liberalizuar vizat për 100 milionë njerëz, të cilët jetojnë në territore që nuk kanë asnjë proces negociatash, apo nuk janë në perspektivën e negociatave me Bashkimin Europian. Marrja peng në këtë farë feje e 2 milionë shqiptarëve, – janë më pak, në fakt, që jetojnë në Kosovë, – deri në pikën e transformimit të një vendi të çliruar nga fuqitë e mëdha europiane në aleancë me Shtetet e Bashkuara, tejkalon kufirin e çdo absurdi. Është një pengmarrje që reflekton mungesën e një kohezioni dhe të një kapaciteti për të vepruar në mënyrë të unifikuar dhe rënien e gjithë familjes europiane në vazhdimësi, në grackën e një vendi a një vendi tjetër, që për arsye nga më të ndryshmet imponon moskonsensusin.

Sidoqoftë ajo që sipas meje mbetet e padiskutueshme dhe e palëvizshme është se shqiptarët, në përgjithësi dhe Shqipëria, në veçanti, nuk ka asnjë rrugë tjetër, përveçse të ecim në rrugën e vetme që ka piketuar historia jonë dhe që është e trashëguar si amanet në gjithë vetëdijen e kombit tonë, pavarësisht periudhave të ndryshme historike, herë të zymta e herë me më shumë dritë, që është rruga drejt Perëndimit, drejt Bashkimit Europian, në aleancë strategjike me Shtetet e Bashkuara dhe me Bashkimin Europian.

Në fund të ditës, ajo që të gjithë ne duhet të kuptojmë, është se nuk i bëjmë reformat as për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as për Bashkimin Europian. Nuk i kërkojmë nga vetja të gjitha këto ndryshime të domosdoshme dhe nuk jemi të angazhuar me aleatët tanë në këto procese të ndërlikuara, sepse na kërkohet nga ata, por sepse e kërkon destinacioni i ynë historik, që është krijimi i një hapësire shqiptare dhe në rastin konkret të Shqipërisë, të një shteti modern europian me të gjitha standardet demokratike dhe me të gjitha institucionet funksionale.

Në këtë aspekt, mungesa e dhënies së një vendimi të merituar për Shqipërinë, pa asnjë diskutim, kush e diskuton, bën sikur nuk e kupton në rastin më të mirë, ose pastaj ka nevojë për t'u kuruar, ka goditur psikologjikisht, për një moment, që të gjithë, sepse "PO"-ja e Bashkimit Europian lidhet me një burim energjie për të çuar më tutje reformat, por në pikëpamjen faktike dhe praktike nuk ka ndryshuar asgjë. Sepse të njëjtat gjëra që Shqipëria duhet dhe do të bënte pasi të merrte "PO"-në, të njëjtat gjëra duhet dhe do të bëjë pavarësisht se "PO"-ja nuk erdhi dhe mund të vijë, apo mund të mos vijë në muajt e ardhshëm, apo në vitet e ardhshme, kjo nuk varet nga Shqipëria, kjo nuk varet nga çfarë bëjmë ne, kjo definitivisht varet nga çfarë duan apo nuk duan të bëjnë ata me veten e tyre dhe me perspektivën e Ballkanit

Perëndimor në raport me familjen e Europës së Bashkuar.

Është e pamundur që të flasësh për marrëdhëniet e Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kushtet aktuale dhe të mos prekësh Reformën në Drejtësi, e cila pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ishte një iluzion, siç ka qenë për shumë e shumë vite me radhe në të shkuarën, kur disa herë është ndërmarrë reformë në drejtësi, d.m.th, reformë me këtë emër, por asnjëherë nuk është bërë reformë. Besoj se tek Reforma në Drejtësi, gjithkush që kërkon argumente dhe shembuj për të argumentuar lidhjen e fortë që ekziston dhe investimin që Shtetet e Bashkuara të Amerikës bëjnë bashkësinë tonë në funksion të së ardhmes, gjen një shembull absolutisht kuptimplotë dhe domethënës.

Dua ta mbyll me një falenderim për profesor Angjelin dhe organizatorët, si dhe me një falënderim qoftë për ambasadorin Shannon, qoftë për zotin Serwer dhe gjithë të ftuarit e tjerë nga jashtë në këtë konferencë, duke iu uruar që përveçse të flasim për Shtetet e Bashkuara të Amerikë të marrin maksimumin e kënaqësisë nga qëndrimi në Tiranën dhe Shqipërinë e transformuar thellësisht, sikundër e thanë vete, por që mbetet po ajo që ka qenë, gjithmonë në lartësinë e duhur, kur është fjala tek mikpritja, tek shija e ushqimit dhe e gjithë kënaqësia që mund të merret. Këtë mund t'jua them jo vetëm si banor i Tiranës, por edhe si një njëri që kam patur fatin të shikoj që edhe vetë holandezët mrekullohen kur vijnë në Tiranë dhe thonë që është komplet ndryshe Shqipëria nga çfarë ne e mendojmë dhe pastaj kur kthehen, e shikojnë ashtu siç e mendojnë dhe jo ashtu siç e kanë parë.

Faleminderit!



With a remarkably rich and diverse career path, Edi Rama counts his contribution in arts, sports and teaching, as a publicist and politician. Edi Rama entered politics in the capacity of the Minister of Culture, Youth and Sports, in 1998. In 2000, Edi Rama was elected mayor of Tirana Municipality. Edi Rama was re-elected as Mayor of Tirana in 2003 and 2007 and led the Albanian Capital for 11 years. In 2005, Edi Rama was elected Chair of the Socialist Party of Albania, leading this force through the difficult opposition years and into the overwhelming victory of 23 June 2013.

Albania, special relations with the United States

Edi Rama
Prime Minister, Republic of Albania- Albania, ALBANIA

KEYWORDS: Albania, USA, special relations

Fan Noli recounts that upon his return to Washington from a Mount Vernon meeting he happened to meet President Wilson, who he asked and urged to commit to saving what he described as a heroic yet unprotected race like Albanians ahead of the Peace Conference that was decide over Albania's fate. According to him too, the US President firmly responded he would be a powerful voice at the Peace Conference and it was exactly that voice to defend Albania back then.

And it happened exactly that and since then, the relationship between Albanians and the United States of America started to shape into a special relation, which lies at the foundations of Albania's foreign policy, but more than that, it also lies at the foundation of the Albanians' awareness that they are not only not alone, but instead they enjoy best possible companionship. And if Albanians in our region today find themselves in a better position than ever before if compared to troubled and difficult past of the Albanian nation and people scattered in all countries of the whole region, this is undoubtedly attributed to this special relationship with the United States of America and the US approach to Albanians and the region itself.

Indeed, Monsignor Noli's remarks, describing the United States as 'a great country, leading humanity towards a better future and universal peace, justice, freedom and democracy," fit and best illustrate this relationship and the Albanians' commitment to this relationship.

I have noticed many of our European friends and partners at any level, both at the

level of ordinary people and at the level of those, less ordinary individuals, so to say, see such a relationship as an expression of somehow naïve of our understanding of the world and I have often happened to meet people smiling regretfully at this commitment the Albanian people and nation show to the United States of America. It is actually very difficult for others to figure out and grasp the "Why" of such a relationship, which is deeply connected to what we have gone through as a nation in many eras of the history, but also to what we have experienced as a people, whether in Albania or in Kosovo, in the first period of our life as contemporaries today we still live the Albanian history and space, both in terms of what we in Albania have been through when Albania became Europe's North Korea, and in terms of what Albanians in Kosovo have gone through the dark era of the life like second-hand citizens in a context that kept deteriorating to culminate in an ethnic cleansing project.

These all have had a profound effect on our consciousness. In the meantime, if the whole Western Balkans is a better region today, this is primarily attributed to the US and I believe the Western Balkans is the reflection of perhaps the most radiant success of the United States foreign policy throughout the post-Cold War historic period. A mirror, where the brief history of the years that we have lived as eyewitnesses began with a major conflict, followed with a bombing campaign, which has now been replaced with talks about intensifying regional cooperation, although we are undoubtedly still far from the final peace settlement, as long as there is no ultimate settlement of the inherited conflict between Serbia and Kosovo.

It is also worth noting that the appointment at this delicate stage of Western Balkan political life of two completely different personalities, but nonetheless with a strong voice and sufficient power to influence the process of normalizing relations between Serbia and Kosovo, on one hand, of an early friend of this region and of the Albanians, Matthew Palmer, and Ambassador Grenell, constitute a meaningful signal of the indispensable interest and focus of the United States over the region and this conflict.

I think I won't be announcing something new that after the European Council's decision on October 18, the European Union's position on this conflict has been significantly weakened and the capacity of the European Union to influence the dialogue process has greatly shrunken, because with its decision or non-decision that emerged following a heated debate over Albania and North Macedonia, the EU primarily dealt a considerable blow to its own credibility. It would be really hard for the two sides in the dialogue to believe in real prospect of incentives that are announced perhaps sincerely, but which are never heeded and kept. And this is not the first time, for the sake of truth, when the European Union fails to keep its work and Kosovo case, I believe, represents one of the flagrant examples of the lack of capacity to keep the word, because, at the end of the day, one should not forget that it is not a single state, but a number of countries within the EU, which functions based on consensus and it would take a single member country to reject a proposal and it would send the entire Union into a difficult position. I am speaking about the

absurd condition – which was certainly taken into consideration and practically addressed – to finalize the border agreement with Montenegro in exchange of the visa liberalization for Kosovo.

It is a unique case, because since 2014, the European Union has liberalized its visa regime for over 100 million people from territories that are not negotiating to join the bloc, or aspire no negotiations with the European Union. Taking hostage some 2 million Albanians in Kosovo to the point of transforming a country liberated from the great European powers in alliance with the United States, exceeds the limits of absurdity. It is a hostage taking that reflects lack of cohesion and capacity to act in a unified way, making the entire European family to continuously fall into the trap laid by one country or another, which for various reasons imposes its non-consensus approach within the EU.

However, it is indisputable and undeniable that Albanians in general and Albania in particular have no other alternative, but keep moving forward on the only path our history has designated for us and which we inherit as a legacy in our national awareness, despite the various historic periods, at times gloomy and at times enlightened ones, that is the path towards the West, the European Union and in strategic alliance with the United States and the European Union.

What we should all understand after all is that we are delivering on reforms neither for the sake of the United States, nor for the European Union. We are not asking ourselves to embark on this indispensable changes and we haven't engaged in such complex processes in collaboration with our partners just because our partners ask us to do so, but because this is what our historic destination requires, that is creation of an Albanian space and a modern Albanian state in line with all democratic standards and with its all functioning institutions.

In this aspect, the failure to grant a most deserved decision on Albania's bid to start the negotiations – whoever questions this or pretends as if he or she doesn't understand needs to see a doctor for psychological disorder – because the EU's "YES" is linked with a source of power to push reforms further forward, but nothing changes in factual and practical terms. Because Albania had and will do the same things once it received a "YES' and it will of course do the same things although no decision was made to open the accession talks and although a decision may not be taken in the coming months or even years. This doesn't depend on Albania. This doesn't depend at all on what we do, as it definitely rests on what they want or do not want to do with their own selves or the Western Balkans perspective vis-à-vis the family of the united Europe.

It is impossible to talk about Albania's relations with the United States in the current situation and not to touch upon the justice reform, which would have been just an illusion without the United States of America, as it has been and used to be for many years in the past, when a judiciary reform has been launched several times, but it was never finalized. I believe that whoever would seek arguments and examples of the strong ties and the US investment in benefit of the future would find an absolutely meaningful and significant example.

I would like to conclude my remarks by expressing an appreciation to professor Angjeli and the conference organizers, as well as an appreciation to Ambassador Shannon, Mr. Serwer and every foreign guests to the conference, wishing they enjoy a lot their stay in the profoundly transformed Tirana and Albania, just like they acknowledged themselves, still remaining all the same and living up to its name when it comes to the taste of food and delicacies. I can tell you this not merely as a Tirana resident, but also as someone who has been given the opportunity to see how Dutch visitors are amazed when visiting Tirana and hear them saying it is completely different from the Albania we perceive and think about, but once they go back they see Albania just like they think about it, and not just like they have seen it with their own eyes.

Thank you!



Ambasadori Thomas A. Shannon Jr. mban titullin e Ambasadorit të Karrierës dhe ka shërbyer si Nën Sekretar i Shtetit për Çështjet Politike. Ambasadori Thomas A. Shannon Jr. ka shërbyer për 35 vite në Shërbimin e Jashtëm duke përfaqësuar politikën e 6 Presidentëve të SHBA dhe 11 Sekretarëve të Shtetit. Ka shërbyer nga 2000-2001, si Zëvëndës Përfaqësues i Përhershëm i SHBA në Organizatën e Shteteve Amerikane (OAS) në rangun e Ambasadorit, si Drejtor I çështjeve të Andeve në 2001-2002, si Asistent Sekretar i Shtetit për Çështjet e Hemisferës Perëndimore (2005-2009) gjithashtu edhe si Asistent i Presidentit dhe Drejtor për Çështjet e Hemisferës Perëndimore në Këshillin e Sigurisë Kombëtare (2003-2005), Nën Sekretar i Çështjeve të Hemisferës Perëndimore në Departamentin e Shtetit (2002-2003). Në karrierën e tij Ambasadori Thomas A. Shannon Jr. prej 35 vitesh në Shërbimin e Jashtëm të SHBA-ve ka shërbyer si ambasador në Guatemala, Brazil, Afrikë të Jugut dhe Venezuela.

Politika e jashtme e SHBA në një periudhë pasigurie - Çfarë mund të presë Shqipëria

Thomas A. Shannon Jr
Ambasador Karriere- SHBA, ish nën Sekretar Shteti për Çështje Politike, SHBA

KEYWORDS: SHBA, Shqipëri, marrëdhënie, perspektiva

Zoti President, ju falënderoj shumë! Është një kënaqësi dhe nder të jem pjesë e kësaj koference mbi Politikat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Ballkanin Perëndimor dhe një nder që ndodhem pranë Të Ngarkuarës sonë me Punë, e cila ka bërë një punë të shkëlqyer në këto 15 muaj teksa jemi në pritje të Ambasadores së Shteteve të Bashkuara, dikush që e ka drejtuar misionin amerikan me vizion, qëndrueshmëri dhe kurajo dhe i jemi shume mirënjohës. Jam mirënjohësë për Universitetin Mesdhetar, vecanërisht për Presidentin e tij zotin Angjeli , i cili na ftoi në këtë koferencë. Është një nder të jem pjesë e kësaj koference në një grup panelistesh kaq të shquar që përfshin disa nga mendimtarët dhe aktorët më të rëndësishëm që lidhen me çështje të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor. Është një nder i vecantë të kemi Kryeministrin e Shqipërisë të pranishëm sot, ju falënderoj zoti Kryeministër. Kjo eshte vizita ime e parë në Shqipëri dhe jam shumë mirënjohës për mikpritjen dhe ngrohtësinë. Pata kënaqësinë të bisedoj me ish ministrin dhe ambasadorin e Kroacisë, zotin Zuzul dhe një nga interesat tona të përbashkëta është Ballkani, marrëdhëniet mes Ballkanit dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sic e dini Shqipëria është një partner strategjik i

Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gëzon një vend si anëtar i privilegjuar i NATO-s si dhe një anëtar themelues i Kartës së Adriatikut dhe në përpjekjet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të rritur dhe modernizuar lidhjet Euro-Atlantike, që ka qenë dhe baza e paqes dhe prosperitetit për pjesën më të madhe të botës pas perfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Një pjesë integrale e këtij partneriteti janë reformat e brendshme dhe vazhdimësia e saj per t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian. Përpjekjet e Shqipërisë për të thelluar demokracinë, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien në qeverisje, luftën ndaj korrupsionit, reformimin gjyqësor janë pjesë e përpjekjeve madhore për të treguar se demokracia dhe rendi kushtetues ndikojnë në zhvillimin ekonomiko-social dhe ndryshojnë kontekstin e brendshëm ligjor, institucionalizmit dhe dialogut.

Ka disa gjëra qe dua të nxjerr në pah , një pjesë prej te cilave u përmend dhe nga ana e të Ngarkuarës me Punë në një mënyrë më elokuente dhe elegante se nga se mund ta bëja unë. Ajo që dua të nënvizoj është rëndësia e zotimit dhe angazhimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Shqipërisë, kur Shqipëria u bë pjesë e NATO-s. Rëndësia e zotimit dhe angazhimit sic e përmenda dhe më parë kur fola për përpjekjet e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të modernizuar marrëdhëniet Euro-Atlantike. Shtetet e Bashkuara e kuptuan se pas përfundimit të Luftës së Ftohtë duhet të gjehej rruga e bashkëpunimit për marrëdhënie transatlantike dhe jo vetëm, por si të gjente rrugën për ta kryer një gjë të tillë? Ballkani Perëndimor ishte celësi dhe strategjia e zgjerimit do të përfshinte marrëdhënie që shkojnë përtej partneritetit tradicional dhe si për t'u afruar me vende të cilat gjenden në mes të reformave të rëndësishme të brendshme. Duke pranuar dhe njohur se për të shtyrë përpara këto reforma do të duhet të mos qendrojmë vetëm duke pritur që vendet të mbarojnë procesin e reformimit dhe gjatë kësaj kohe të qendrojmë jashtë, kjo do te ishte nje zgjedhje e gabuar nga ana jonë, ndaj politika jonë ishte ndryshe duke u zotuar, angazhuar për të realizuar një punë të madhe dhe gjithëpërfshirëse në Shqipëri dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor për të ndihmuar dhe cuar përpara nje proces. Proces i cili duhet të ishte kombëtar, institucional me një mbështetje prej partive poilitike dhe shoqerisë civile. Ne jemi të mahnitur nga rezultatet deri tani por kemi ende një rrugë për të bërë sic tha dhe e Ngarkuara me Punë. Pse është e rëndesishme për SHBA? Nëse ju jeni të suksesshëm, NATO është e suksesshme dhe marrëdhënia Trans Atlantike shndërrohet në një pjesë të rëndësishme per t'iu përgjigjur sfidave te shekullit të XXI. Kini parasysh se Shqipëria është shumë më shumë se nje anëtare e NATO-s , një nënshkruese e kartës së Adriatikut, më shumë se nje vend i shumë institucione në të cilat ajo bën pjesë. Eshtë një anëtare shndërruese dhe transformuese, pjesë e një procesi më të madh ndryshimi, për këtë arsye është shumë e rëndësishme për ne. Kjo me sjell në pikën time të dytë, nuk mund t'ju them se cfarë kënaqësie ishte për mua të largohesha nga Ëashingtoni dhe të udhëtoja drejt Tiranës. Polarizimi politik dhe partizania është mjaft intensive dhe nuk do të zbutet. Presidenti po has mundësinë për akte të shkarkimit dhe nëse Dhoma e Përfaqësuesve do të votonte të gjithë nenet e padisë do të dilte para gjygjit dhe Senatit Amerikan ku do të vendoste nëse do të vazhdonte në detyrë apo jo.

Vlen të theksohet se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë në historinë e tyre tre presidentë të cilët kanë kaluar në këtë fazë Lincoln, Richard Nixon dhe Bill Clinton, asnjë prej të cilëve nuk është dënuar në Senatin tonë ndaj dhe nuk po parashikoj rezultate thjesht dua të dini që nuk ka asgjë të pazakontë në këtë që ndodh dhe këta Presidentë e kanë kuptuar qe puna e qeverisë nuk rresht kurrë dhe vazhdon dhe kur ata kanë konflikte kushtetuese. Ashtu si Presidentët tanë e gjetën rrugën për të vazhduar qeverisjen dhe marrëdhëniet me shtetet e tjera ashtu sic jam i bindur se Administrata Trump do të gjejë mënyrën për të vazhduar në ujërat konstitucionale, ujra të cilat parashikoj se do të vazhdojnë të tronditen në zgjedhjet presidenciale, qoftë ato të brendshme apo ato për Presidentin e ardhshëm vitin tjeter. Institucionet amerikane po përgatiten për këtë periudhe dhe do të thoja se caktimi i zotit Palmer dhe i zotit Pompeo të vendosur për të rrënjosur strategjitë tona dhe për të patur institucione të lira. Ajo që dua të them përmes kësaj ju prisni stabilitet dhe qëndrueshmëri në rajon pavarësisht asaj që ndodh brenda në Amerikë. Angazhimi dhe zotimi ndaj Ballkanit Perëndimor, ndaj Shqipërisë është një zotim i dyanshëm i cili do të vazhdojë për një kohë shumë të gjatë. Shqipëria ka mbështetje në Kongres dhe duhet t'u besojë atyre në mënyrë që të ruajë stabilitetin dhe të vazhdojë rrugën e reformimit. Teksa hyjmë në periudhën zgjedhore mendoj se do të kuptojmë marrëdhëniet e jashtme janë një pjesë e rëndësishme e debatit presidencial për arsye se Shtetet e Bashkuara të Amerikës teksa rindërtojnë partitë politike, populli amerikan do të ketë nje dialog më të madh mbi qëllimin e politikës tonë të jashtme dhe ajo që del si rezultat i këtyre sondazheve është pranimi dhe njohja se SHBA ka gjithmonë në krah partnerë, SHBA ka zgjedhur në Ballkanin Perëndimor Shqipërinë. Ne e shohim si partneritet shndërrues duke u rikujtuar se sekretari i Shtetit Truman ka thënë për kolegët e tij se : Burra dhe gratë që hasin këtë sfidë të rindërtimit të botës e bënë me shumë vendosmeri dhe duke injoruar dhe pa dijeni të sfidave pa kuptuar natyrën e Luftes së Dytë Botërore teksa mendojmë për sfidat që kemi para nesh është e rëndësishme të kuptojmë se shndërrimi që ka ndodhur në botë është produkt i suksesit, sukses i përfundimit të Luftës së Ftohtë, duke dhënë fund luftërave ideologjike dhe të përpjekjes për të krijuar procese dialogimi të cilat do të mbajnë në paqe këtë rend. Ne po riformësojmë qasjet tona teksa kthejmë sytë nga e ardhmja besoj se dhe si kolegët ne kemi vendosmërinë, energjinë për të përballuar sfidat, ne jemi në dijeni se duhet të bëjmë dhe gjeneratat në vazhdim do të na gjykojne për vendimet tona. Kam besim te SHBA dhe populli amerikan, kam besim te Shqipëria dhe populli shqiptar dhe popujt e Ballkanit për të gjetur një rrugë për të krijuar paqen dhe prosperitetin që ishte dhe ëndrra e Wilson.



Ambassador Thomas A. Shannon, Jr. served as Under Secretary of State for Political Affairs, the third highest ranking position at the State Department. Holding the personal rank of Career Ambassador, he was the highest ranking member of the United States Foreign Service, the country's professional diplomatic corps. Ambassador Shannon spent nearly 35 years in the Foreign Service, and has served 6 US presidents and 11 secretaries of state. Prior to his 2016 appointment by President Obama as Under Secretary of State for Political Affairs, Ambassador Shannon was the United States Ambassador to Brazil. Prior to this appointment, Ambassador Shannon served as Assistant Secretary of State for Western Hemisphere Affairs from 2005-2009. He served as Special Assistant to the President and Senior Director for Western Hemisphere Affairs at the National Security Council (2003-2005), Deputy Assistant Secretary of Western Hemisphere Affairs at the Department of State (2002-2003), and Director of Andean Affairs (2001-2002). From 2000-2001, he was US Deputy Permanent Representative to the Organization of American States, with the rank of Ambassador. During his career, Ambassador Shannon served in the US Foreign Service at embassies in Guatemala, Brazil, South Africa, and Venezuela.

American Foreign Policy in an Age of Uncertainty: What can Albania Expect

Thomas A. Shannon Jr
Career Ambassador, Former Under Secretary for Political Affairs, USA

KEYWORDS: USA, Albania, future, relations

Mr. President, thank you very much! It is my pleasure and honor to be part of this conference on US Policy in the Western Balkans and also an honor to be with our Charge d'Affaires, who has done an excellent job in these 15 months while we are waiting of the Ambassador of the United States of America, someone who has led the American mission with vision, perseverance and courage, and we are very grateful for that. I am grateful to the Mediterranean University of Albania, especially to the President of this university, Mr. Angjeli, who invited us to this conference. It is an honor to be part of this conference in such a group of panelists that includes some of the most important thinkers and actresses related to issues of Albania and the Western Balkans. It is

also a special honor to have the Prime Minister of Albania present today, thank you Mr. Prime Minister. This is my first visit to Albania and I am very grateful for the hospitality and warmth. I had the pleasure to talk with the former Minister and Ambassador of Croatia, Mr. Zuzul, and one of our common interests is the Balkans, the relations between the Balkans and the United States of America.

As you know, Albania is a strategic partner of the United States of America, enjoys a country as a privileged member of NATO and a founding member of the Adriatic Charter and in the efforts of the United States of America to increase and modernize Euro -Atlantic bond, which has been the basis of peace and prosperity for most of the world since the end of World War II.


An integral part of this partnership is internal reform and its continuation to become part of the European Union. Albania's efforts to deepen democracy, increase transparency and accountability in government, fight corruption, judicial reform are part of major efforts to show that democracy and constitutional order affect socio-economic development and change the internal legal context, institutionalism and dialogue. There are some things I want to point out, some of which were mentioned by the Charge d'Affaires in a more eloquent and elegant way than I could do. What I want to emphasize is the importance of the commitment of the United States of America to Albania, when Albania became part of NATO. The importance of commitment, as I mentioned earlier, when I talked about the ongoing efforts of the United States is to modernize Euro-Atlantic relations. The United States realized that after the end of the Cold War, it needed to find a way to work together for a more Atlantic relationship, and not only that, but how to find a way to do that. The Western Balkans was the key, and the enlargement strategy would include relationships that go beyond traditional partnership and how to approach countries that are in the midst of important domestic reforms. Acknowledging that in order to push forward this reform, we must not just wait for countries to complete the reform process and stay out during this time, this would be a wrong choice on our part, so our policy was different by committing to carrying out a great and comprehensive work in Albania and in the countries of the Western Balkans, in order to help and advance the process. This process should be national, institutional with the support of political parties and civil society. We are amazed by the results so far but we still have a way to go, as the Charge d'Affaires stated. Why is it important for the US?

If you are successful, NATO is successful, and the Trans-Atlantic relationship becomes an important part of responding to the challenges of the 21st century. Keep in mind that Albania is much more than a NATO member, a signatory to the Adriatic Charter, more than a country of many institutions in which it is a part. It is a transducer and transformative member, part of a larger process of change, which is why it is so important to us. This brings me to my second point, I can't tell you what a pleasure it was for me to leave Washington and travel to Tirana. Political polarization and partisanship are quite intense and will not be mitigated. The president is facing the possibility of dismissal acts and if the Chamber of the Representatives would vote all the articles of the lawsuit, would appear before the

court and the US Senate, where it would decide if he will be on duty or not. It is worth emphasizing that the United States has three presidents in its history, who have passed to this stage and they are Lincoln, Richard Nixon and Bill Clinton, and none of whom have been convicted in our Senate and I am not predicting results. What I want you to know is that there is nothing unusual in what is happening and these Presidents have realized that the work of the government never stops and continues even when they have constitutional conflicts.

Just as our Presidents have found a way to continue governing and relations with other states, I am convinced that the Trump Administration will find a way to continue in constitutional waters, waters that I predict will continue to shake in the presidential election, whether internal or those for the next President in the next year. American institutions are preparing for this period and I would say that the appointment of Mr. Palmer and Mr. Pompeu are set to establish our strategies and to have free institutions. What I mean by this is that you expect stability and constancy in the region, regardless of what happens inside America. Commitment to the Western Balkans, to Albania is a mutual commitment that will continue for a very long time. Albania has the support of Congress and must trust them in order to maintain stability and continue the path of reform. As we enter the election period, I think we will find foreign relations as an important part of the presidential debate because as the United States rebuilds political parties, the American people will have a greater dialogue on the purpose of our external policy and what emerges as a result of these polls is the acceptance and recognition that the United States always has a partner on its side, the US has chosen Albania in the Western Balkans.

We see it as a transformative partnership, reminding that the Secretary of State, Truman, told his colleagues that: Men and women facing this challenge of rebuilding the world, have done it with great determination and unaware of the challenges without understanding nature of World War II. As we think about the challenges we face, it is important to understand that the transformation that has taken place in the world is a product of success, the success of the end of the Cold War, ending ideological wars and the struggles to create dialogue processes, which will keep this order at peace. We are reshaping our approaches as we look to the future, I believe that as colleagues, we have the determination, the energy to face the challenges, we are aware of what we need to do and future generations will judge us for our decisions. I have confidence in the US and the American people, I have faith in Albania and the Albanian people and the peoples of the Balkans to find a way to create the peace and prosperity which was Wilson's dream.



Profesori Daniel Serwer (Ph.D., Princeton) drejton Programet e Menaxhimit të Konflikteve dhe Politikës së Jashtme Amerikane në Shkollën e Studimeve Ndërkombëtare të Avancuara John Hopkins. Ai është gjithashtu studiues në Institutin e Lindjes së Mesme. Ish nënkryetar për qendrat e inovacionit ne ndërtimin e paqes në Institutin e Paqes së Shteteve të Bashkuara, nënkryetar për operacionet e paqes dhe stabilitetit në USIP. Serwer ka punuar në parandalimin e konfliktit ndëretnik në Irak dhe ka ndihmuar në dialogun midis serbëve dhe shqiptarëve në Ballkan.

Shqipëria dhe konteksti i saj

Prof. Daniel Serwer
Drejtor i Programit të Menaxhimit të Konflikteve dhe Politikës së Jashtme Amerikane në Shkollën e Studimeve Ndërkombëtare të Avancuara të Universitetit "John Hopkins". SHBA

KEYWORDS: Shqipëri, SHBA, marrëdhënie, konteksti

Është kënaqësi e madhe per mua të kthehem në Tiranë. Falenderoj Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë që më ftoi dhe bëri të mundur këtë kthim. Mendoj se kanë kaluar të paktën 10 vjet që kur isha këtu për here të fundit. Shetita vetem nje orë nëper rrugët e qytetit natën e kaluar dhe pashe sa shume Tirana ka ndryshuar që nga ajo kohë. S'ka rendesi, perderisa vizita ime e pare këtu në 1997 ishte për të vëzhguar një pale zgjedhje të zhvilluara në mes të krismave te armeve. Por më lejoni te kthehem te flas per Shqipërine më vonë. Së pari do të doja të diskutoja mbi botën, siç shihet nga një amerikan, pastaj rajonin e Ballkanit dhe së fundmi per Shqipërine në kontekstin rajonal dhe global.

Bota sot është e trazuar. Iluzioni njepolar, Amerika superfuqia e vetme e botes (periudha mbas kapitullimit te Rusise dhe mbarimit te Luftes se Ftofte) që mundësoi aq shume dhe pranine e Shteteve te Bashkuara në Ballkan në vitet 1990, përfundoi me sulminn daj Qendrës Botërore të Tregtisë në 2001. Ky sulm pasoi me një luftë kundër terrorizmit që fillimisht e përfshiu pjesën më të madhe të botës, si përgjigje: NATO nxiti iniciativen per propozim Nenit 5 te Kushtetutes dhe mbështeti pushtimin e SHBA në Afganistan, por unanimiteti u humb shpejt me pushtimin e Irakut dhe kryengritjes Suni atje, të udhëhequr nga Al Kaeda dhe kundershtaret Ba'athist.

Kriza financiare e vitit 2008 tensionoi më tej konsensusin ndërkombëtar: Rritja

ekonomike evropiane ende nuk eshte rikuperuar ndërs arritja e Kinës u përshpejtua. Cmimet e larta të naftës dhe gazit i dhanë Rusisë mundësi të riafirmojë statusin e saj të fuqisë se madhe, të cilën e realizoi me ndërhyrjet në Ukrainë dhe Siri.

Kriza financiare Greke, Brexit, imigrimi dhe ngritja e levizjes populiste e së drejtës etno-nacionaliste brenda BE dhe SH.B.A. kanë ndryshuar parametrat themelorë të gjeopolitikës sonë.

Sot ne jetojmë në një botë në të cilën konsensusi liberal demokratik, I bazuar në tregjet e lira dhe bindja se të gjithë kanë të drejtë për të drejta dhe mundësi të barabarta, është tensionuar.

Rusia, Kina, Turqia dhe të tjerët po ofrojnë marreveshje me alternative autokratike: në këmbim të një fuqie të pandërprerë afatgjatë ,udhëheqësit e tyre po ofrojnë rritje ekonomike të mbështetur nga shteti dhe stabilitet politik, të paktën për ata udheheqes që identifikohen me grupin etnik me shumicë .

SI NDIKON E GJITHË KJO NË BALLKAN?

Së pari dhe më kryesorja, rritja e ngadaltë ekonomike në Evropë depresionon,ndrydh ekonomitë e Ballkanit; rajoni mund të lulëzojë vetëm kur BE ta bëjë kete. Europesimizmi lidhet ngushtë me ciklin e biznesit. Vetëm me një ringjallje të rritjes ekonomike, Evropa do të tregojë interes të përtërirë për zgjerimin, e cila do t'i sigurojë rinise punë.

Së dyti: Mosmarrëveshja, problematika e Moskës, megjithëse nuk është aq e dukshme në Shqipëri, po pllakos Maqedoninë, Serbinë, Malin e Zi dhe Bosnjën. Fqinjët tuaj po përballen me përpjekje të bashkërenduara për të ngadalësuar ose bllokuar aderimin në NATO dhe BE. Madje Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut janë ende në shënjestër. Moska është ri-futur në vrasjen politike te Ballkanit, dezinformimin dhe propagandën shteterore dhe ne miratimin e teknikave te trazirave, për të cilën të gjithë ne shpresonim se ishin zhdukur me Bashkimin Sovjetik.

Së treti: Kina, gjatë Luftës së Ftohtë miku i vetëm i Enver Hoxhës në botë, po ofron financim per nje infrastructure shume te nevojshme. Ndryshe nga shumë perëndimorë, unë shoh shumë përfitime të mundshme në projektet rajonale dhe rrugore te Pekinit, por kini kujdes (bleres): Kina nuk po jep ndihmë, ajo po financon projekte që I konsideron si të dobishme për Kinën me kushte qe mund te jene te veshtira, te renda nese kthimet e pritshme nuk realizohen.

I would like to begin by thanking Mr. Angjeli for organizing this conference of great importance, the content of which corresponds to the positive response of the Council of Europe. In reference to my experience in this field, I think there's not much left to be added to what the previous speaker has just said about the US policies, which I consider fair enough due to the description by the *Chargé d'Affaires* (charge-D) and Mr. Shannon of the foreign policy of the United States that has served to establish close ties among the six presidents of USA.

I decided to talk about the relations between Brussels and EU based on a similar situation that my country, Croatia, faced. Let me tell you that I am concerned and well informed about the decision made by Brussels, therefore not surprised, and they were aware of that decision as well, and they raised our expectations and made promises to us. Why should they raise expectations and make promises as they did with North Macedonia. Nothing has changed; Albania still remains a dramatic country depending on the future developments that can last for months, years. All we can do is to find out the reasons that really hinder such development.

I think that the first reason is that the Western Balkans is not considered as a priority, there is no new relevant Commission, and the European Parliament refused

three candidates one of which is very important. Another problem is that we are often criticized because Europe is facing procedural problems, since they compile a rule and then replace it with another one.

This is currently a problem that EU will be facing. There is a Commission that has not been formed yet. There is another problem that is getting solved – Brexit. Brussels is extremely concerned about it, and this problem relates to the Western Balkans as well. There have been four important issues that my country, Croatia, has encountered when I was serving as a Minister of Foreign Affairs: bilateral relations, conflicting relations among the Member States, such as France, that consider it a problem and find it difficult to accept and understand a country – issues that will probably become a problem for Albania.

There are also other problematic Member States, such as the Netherlands, that do not consider you, Albania, ready to become a member of EU. The architects of EU think that Europe needs to stop its expansion for a few years, but that has nothing to do with Albania – as was the case with Croatia. When we talk about Brexit, the issue becomes more controversial due to the tendency to go from West to East, and the power of Brussels is moving towards East. The four aforementioned issues should not hinder the new entrants. In other words, there is an analogy of good examples to consider EU either as a family or as a group, the principle of convoy – the first vehicle should not turn to an obstacle to others following it.

I do think that the best thing to be done is that EU accept that each country that fully or partially meets the criteria, becomes part of the EU. Democracy doesn't happen overnight, it is a whole process. If people were asked about NATO, about Germany joining NATO, they would have come to the conclusion that being approached in that way would mean end of the existence of NATO. It is important to have a vision, and I think that all EU countries are aware of the fact that Albania has a clear vision. Let me to draw parallels between them by referring to NATO.

I have been very straightforward, and I think that NATO is one of the most important alliances for unilateral and bilateral relations. I would really like to believe that without NATO we would not have the European Union that we have today. We have faced the same problems, and I had the opportunity to prove that NATO is stronger by admitting new countries. I am extremely happy that history has proved it true – that NATO is stronger now with Montenegro and Albania as its Member States.

NATO has revived its goal, and I think that the same analogy should be applied to the EU as well. Whenever we see what the future holds, it is easy for us to say that Albania, Montenegro and North Macedonia need to be part of EU, and they are on the right path towards Europeanization, which will help them to continue their democratization processes



Ahmet Shala është një ekonomist dhe sipërmarrës i njohur në Kosovë dhe më gjerë. Aktualisht ai është një Profesor në Universitete të ndryshme në SHBA, ku ai po ligjëron, studion dhe këshillon në lëndë dhe fusha të ndryshme të politikave publike, bashkëpunimit rajonal, ndërtimit të paqes dhe udhëheqjes. Para kësaj, ai ka shërbyer si Ambasador i Republikës së Kosovës në Japoni (2012-2015) dhe si Ministër i Parë i Ekonomisë dhe Financave i Republikës së Kosovës nga 2008-2011.

Roli i SHBA në themelimin dhe finalizimin e shtetësisë së Kosovës

Ahmet Shala
Ambasador, Profesor, Ish ministër i Ekonomisë dhe Financave të Kosovës, REPUBLIKA E KOSOVËS

KEYWORDS: Kosova, Shqipëria, SHBA,

Faleminderit Anastas dhe të nderuar miq! Do të doja të bëja prezantimin tim në anglisht. Prezantimi im është i ndarë në 5 module, module pjesë e të cilave janë dhe marrëdhëniet e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës , monitorimi, krijimi i shtetit, marrëdhëniet midis tyre, kthimi i shtetit. Do të fokusohem tek pika e parë dhe e fundit nisur dhe për shkak të kohës kufizuar.

Pyetja që natyrshëm lind për një pjesë të madhe të njerëzve, është përse Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka ndërhyrë në Kosovë. Duke qenë në SHBA këto 5 vitet e fundit kam arritur të kuptoj më së miri arsyen se pse SHBA ka ndërhyrë dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në luftën e Kosovës. Kjo vjen dhe për shkak të vlerave që ajo përfaqëson. SHBA eshte lider në botë për shkak të vlerave, dikush që beson se kushdo meriton të jetë i lirë dhe ka shume deklarata ku shumë njerëz kanë nisur shumë konflikte, pjese e të cilave ka rezultuar që Kosova nuk ka marrë pjesë. Ne menduam se na harruan, sepse Bosnja ishte një gjenocid dhe një tjetër gjenocid ka filluar pavarësisht retorikave dhe pse nuk ka patur nje konflikt tokësor.

Do doja të falenderoja të gjithë të pranishmit për cdo gjë që keni bërë për Kosovën. Ndoshta më duhet të vecoj deklaratën e Tony Blair, i cili u shpreh se ajo ishte një luftë midis së mirës dhe të keqes, civilizimi dhe barbaritetit, demokracisë dhe diktaturës. Rusia është përmendur disa herë dhe sic është shprehur dhe Richard Holbrook në atë kohe se për ato cdo gjë bëhej për respekt. Nuk e di nëse është e njëjta Rusi apo SHBA, apo dhe Bashkim Europian. Mendoj se duhet të gjejmë një mënyrë për t'u marrë me ketë situatë dhe të shpresojmë në gjetjen e çelësit në mënyrë që të mos bllokojmë Këshillin e Sigurisë, temë të cilen e kam trajtuar dhe herë të tjera çështje që besoj se duhet ndryshuar, por kjo I përket një çështje për një ditë tjetër.

Tani më duhet të kaloj në modelin e "ulët" që shkon përtej deklaratës së Kosovës, ku vlen të theksohet se SHBA luajti një rol jetik gjatë vitit 2014 e më tej në 2015, 2016. SHBA mori një pozicion monitorues, ku mund të sillja dhe fakte. Nisur me qëndrimet e SHBA, sekretarëve apo përfaqësuesve të lartë të shtetit e kanë konsideruar të panegociueshëm prekjen e territorit. Kur në një moment vjen një kthesë. Kthesë e cila vjen në 2019, të cilën e kam të ndarë në dy segmente. Politika e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është se nëse dy palët arrijnë të kenë një marrëveshje, atëherë mund të flasim për një ndryshim territori. Sipas meje kjo deklaratë e Bolton është një deklaratë që ndryshon shumë gjëra. Në këtë kontekst sjell dhe në vëmendje deklaratën e komisionerit Han. Këto kanë qenë deklarata të çuditshme nga të gjitha anët. Shpresoj se SHBA do të ketë një kthesë siç pati në luftë dhe do të risjellë vëmendjen në çështjet e rëndësishme për të.

Dua të pyes çdo njërin prej jush sot se pse SHBA është në rolin e vëzhguesit në këto momente dhe çfarë do të ndodhë më tej.

Ju falenderoj dhe me këtë e mbyll deklaratën time!



Ahmet Shala is a well-known economist and entrepreneur in Kosova and wider. Currently he is a Visiting Professor at different Universities in USA, where he is teaching, studying and consulting in different subjects and fields of public policies, regional cooperation, peace building and leadership. Prior to this, he served as the Ambassador of the Republic of Kosovo to Japan (2012-2015). Having served as First Minister of Economy and Finance of the Republic of Kosovo from 2008-2011, he is credited with having built some of the fundamentals of the current economic system in Kosovo

U.S. role in establishing and consolidating Kosova's statehood

Ahmet Shala,
Ambassador, Professor, Former Minister of Economy and Finance of the Republic of Kosova, KOSOVA

KEYWORDS: Kosova, Albania, USA

Thank you Anastas and dear friends! I would like to make my presentation in English. My presentation is divided into 5 modules, modules of which are Kosovo's relations with the United States of America, monitoring, state-building, relations between them, return of the state. I will focus on the first and last point launched and due to limited time. The question that naturally arises for a large part of people is why the United States of America has intervened in Kosovo. Having been in the US for the last 5 years, I have come to understand best why the US has intervened and played an important role in the Kosovo war. This is also due to the values it represents. The US are a leader in the world because of its values, someone who believes that everyone deserves to be free and there are many statements where many people have started many conflicts, part of which has resulted that Kosovo has not participated. We thought we were forgotten because Bosnia was a genocide and another genocide started despite rhetoric and why there was no land conflict. I would like to thank all those present for everything you have done for Kosovo. Perhaps I should single out the statement of Tony Blair, who said that it was a war between good and evil, civilization and barbarism, democracy and dictatorship. Russia has been mentioned several times, and as Richard Holbrook put it at the time, everything was done with respect. I don't know if it's Russia or the

United States, or the European Union. I think we need to find a way to deal with this situation and hope to find the key so as not to block the Security Council, a topic that I have addressed and other times issues that I believe need to be changed, but this belongs to an issue for another day. Now I have to move on to the "low" model that goes beyond Kosovo's statement, where it is worth noting that the US played a vital role during 2014 and beyond in 2015, 2016. The U.S. took a monitoring position, where I could bring and facts. Given the views of the United States, secretaries or high-ranking state officials have considered the touch of territory to be non-negotiable. When at some point a turn comes. The turn which comes in 2019, which I have divided into two segments. The policy of the United States of America is that if the two sides manage to have an agreement, then we can talk about a change of territory. In my opinion, Bolton's statement is a statement that changes many things. In this context, the statement of Commissioner Han brings to attention. These have been strange statements from all sides. I hope the US will have a turnaround as it did in the war and will bring attention back to issues important to it.

I want to ask each of you today why the US is in the role of observer in these moments and what will happen next. Thank you and with that I close my statement!



Prof. Dr. Ksenofon Krisafi ka mbaruar Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike të Universitetit të Tiranës. Ai ka qenë drejtor në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasador në OKB dhe në OBT, në Gjenevë, Sekretar I Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe këshilltar diplomatik i Kryeministrit, anëtar i Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë. Është lektor i së drejtës publike, të drejtës ndërkombëtare, organizatave ndërkombëtare etj.

Historia dyshekullore e marrëdhënieve shqiptaroamerikane.

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi,
Dekan i Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, SHQIPËRI

KEYWORDS: Shqipëri, SHBA, histori

Të identifikuara si marrëdhënie me rëndësi stretegjike dhe me prioritet të veçantë në politikën e jashtme të Shqipërisë, ato kanë njohur progres të vazhdueshëm. Tirana, por edhe Uashingtoni, tregojnë kujdes maksimal për përparimin e tyre të pandalshëm.

Në të vërtetë sot shqiptarët në Shqipëri, Kosovë dhe kudo në Ballkan, në emigracion e në diasporë, janë një nga popujt më proamerikanë të globit. Në këndvështrimin e shqiptarëve ShBA është miku i madh i tyre, partneri kryesor strategjik, një ndër garancitë mbështetëse të zhvillimeve demokratike në vend.

ShBA e kanë bërë të qartë se miqësia midis dy vendeve shtohet me forcimin e demokracisë dhe institucioneve të shtetit, zbatimin e ligjeve, luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e ekonomisë së tregut, me bashkëpunimin e të gjitha forcave politike shqiptare, të cilat duhet të udhëhiqen nga interesat e vendit, nga qëllime të qarta, afat shkurtra dhe afatgjata kombëtare. Ato kanë theksuar se marrëdhëniet popullin shqiptar nuk kushtëzohen as nuk varen nga ndonjë politikan i përkohshëm, as nga ndonjë ideologji, as parti politike, por konsiderohen si marrëdhënie popull me

popull, bazuar në disa vlera, parime dhe të drejta universale të njeriut, pa marrë parasysh se cili person ose cila parti udhëheq qeverinë shqiptare, në një kohë të caktuar.

Mathew Palmer, i dërguar i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, duke analizuar marrëdhëniet shqiptaro-amerikane në zhvillimet politike të fundit të vitit 2019, në Shqipëri, është shprehur në emër të qeverisë amerikane se "populli i Shqipërisë mund të mbështetet tek miqësia dhe partneriteti me Shtetet e Bashkuara. Aleatët tanë, partnerët tanë janë Shqipëria dhe populli shqiptar. Politika është politikë, por marrëdhënia midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë është e fortë dhe e qëndrueshme."

Nuk mund të flitet për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane pa përmendur një falenderim dhe mirënjohje të thellë e të pafundme nga të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen, për ShBA, për kontributin themelor që ajo, krahas forcave të NATO-s dhe shteteve të tjerë, dha në çlirimin e Kosovës nga zgjedha serbe dhe për krijimin e shtetit të saj të pavarur. Meritë të veçantë patën presidentët amerikanë Bill Klinton e Xhorxh Bush si dhe sekretarja e shtetit Madlinë Ollbrajt, ambasadorët Riçard Hollbuk, Kris Hill, Uilliam Uoker dhe shumë personalitete të shquara amerikane, britanike etj. ShBA është dhe mbetet faktori kryesor dhe garanti i palëkundur i Kosovës së sotme, të çliruar e të pavarur.



Prof. Dr. Ksenofon Krisafi is Dean of the Faculty of Law and International Relations at the Mediterranean University of Albania. He has been a director at the Ministry of Foreign Affairs, ambassador to the UN and the WTO, in Geneva, Secretary General of the Council of Ministers and diplomatic adviser to the Prime Minister, a member of the Supervisory Council of the Bank of Albania. He is a lecturer of public law, international law, international organizations etc.

Two centuries of Albanian-American relations

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi,
Dean of Faculty of Law and International Relations at Mediterranean University of Albania, ALBANIA

KEYWORDS: Albania, USA, History

Identified as a relationship of strategic importance and with special priority in the foreign policy of Albania, they have recognized continuous progress. Tirana, but also Washington, show maximum care for their unstoppable progress.

In fact, today Albanians in Albania, Kosovo and everywhere in the Balkans, in emigration and in the diaspora, are one of the most pro-American peoples on the globe. From the point of view of the Albanians, the United States is their great friend, the main strategic partner, one of the guarantees of democratic development in the country. The United States has made it clear that friendship between the two countries is enhanced by the strengthening of democracy and state institutions, law enforcement, the fight against corruption, the development of a market economy, and the co-operation of all Albanian political forces, which must be led by the interests of the country, from clear, short-term and long-term national goals. They stressed that the relations between the Albanian people are not conditioned or dependent on any temporary politician, ideology or political party, but are considered as a people's relationship with the people, based on certain values, principles and universal human rights, without taking given which person or party

leads the Albanian government at a given time.

Mathew Palmer, the United States Special Envoy for the Western Balkans, analyzing Albanian-American relations in the recent political developments of 2019 in Albania, said on behalf of the US government that "the people of Albania can rely on friendship. and partnership with the United States. Our allies, our partners are Albania and the Albanian people. Politics is politics, but the relationship between the United States and Albania is strong and lasting. "

We cannot talk about the Albanian-American relations without mentioning a deep and endless thanks and gratitude from all Albanians, wherever they are, for the USA, for the fundamental contribution that it, along with NATO forces and other states, gave in the liberation of Kosovo from the Serbian yoke and for the creation of its independent state. Special credit went to US Presidents Bill Clinton and George W. Bush, as well as Secretary of State Madeline Albright, Ambassadors Richard Holbrooke, Chris Hill, William Walker, and many prominent American, British, and other personalities. The United States is and remains the main factor and the unwavering guarantor of today's Kosovo, liberated and independent.

DITA E DYTË E KONFERENCËS

PUNIMET E SESIONEVE TEMATIKE

POLITIKA AMERIKANE NË BALLKANIN PERËNDIMOR
SFIDA DHE PERSPEKTIVA

Paskal Milo
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
paskalmilo@outlook.com

ABSTRACT

American politics in the Western Balkans is facing inherited but also new crises and challenges. The main challenge is the revive of nationalism. Others are: 1. Cultivating authorities or institutions of government with great or unlimited powers. 2. Corruption and organized crime. 3. Weaknesses of the European Union in its policy towards the Western Balkans. 4. Increasing role of Russia, China, Turkey, etc. 5. Terrorism, especially the radical Islamic one. 6. Illegal immigration from the Middle East, Asia and Africa. The United States needs a new strategy in the Western Balkans to meet these and other less important challenges. Elements of this new strategy could be: I. The transition from security policy as a central vector of the old strategy, to a focus on the quality of democracy, functional institutions and the rule of law. II. Increasing the level of American policy representation in the region and the longevity of its active engagement. III. Greater US-EU cooperation and synchronization and the establishment of an institutional coordination mechanism for the Western Balkans. IV. Confronting Russia's and China's growing presence and competitiveness in the region, not by Cold War means, but by engaging them in the process of solving problems and challenges. V. A cautious and vigilant policy towards Turkey to keep it at the level of strategic partner from the Western Balkans to the Middle East. VI. A more substantial and direct commitment to Bosnia and Herzegovina to build a functioning institutional state-of-the-art architecture. VII. A strong, forward-looking and intense leadership to mediate a historic and concluding agreement between Kosovo and Serbia without excluding painful compromises between the parties.

KEYWORDS: USA, foreign policy, strategy Western Balkans

Në fillim të vjeshtës 2019 Shtetet e Bashkuara dhanë mesazhe të qarta dhe të shumëpritura për një angazhim të ri e dinamik në Ballkanin Perëndimor.Ato u përcollën përmes tre lëvizjeve të sinkronizuara të administratës së Presidentit Trump në rajon:vizita e Sekretarit të Shtetit Majkëll Pompeu në Podgoricë, Ohër e Athinë, emërimi i zëvëndës ndihmës Sekretarit të Shtetit Metju Palmer si i Dërguar i Posaçëm i Departamentit të Shtetit për Ballkanin Perëndimor si dhe caktimi i ambasadorit Richard Grenell si përfaqësues i posaçëm i Shtëpisë së Bardhë për marrëdhëniet Serbi-Kosovë.

Këto tri lëvizje japin të kuptojnë një ndryshim cilësor të politikës amerikane në rajon jo aq shumë në rimodelimin e objektivave strategjike të saj se sa në përshtatjen dhe akomodimin me zhvillimet dhe tendencat që janë shfaqur në gjeopolitikën ballkanike, në ngecjen e proceseve demokratike e në ndërhyrjen e faktorëve të jashtëm.

Është e njohur se Shtetet e Bashkuara për disa vjetë u tërhoqën nga roli i tyre parësor në Ballkanin Perëndimor për dy arsye kryesore:për shkak se përparësia e interesave strategjike amerikane u ç'vendos në zona të tjera të botës si Azia Lindore, Lindja e Mesme, Afrika Veriore, etj, si edhe për faktin se rajoni si pjesë e Evropës iu besua me të drejtë Bashkimit Evropian që përmes politikave të tij integruese të thellonte proceset demokratike, sundimin e ligjit dhe zbutjen e intolerancës në vatrat potenciale konfliktuale.

Për fat të keq Bashkimi Evropian dështoi përsëri për shkak të mungesës së kohezionit në vendimmarrje dhe të strategjisë joadekuate për kushtet e Ballkanit Perëndimor për të mos folur edhe për influencën negative të krizës së tij të brëndshme.Përçarja e tij për të marrë një vendim për hapjen e negociatave për pranim të Shqipërisë e të Maqedonisë së Veriut e përforcoi bindjen se Brukseli nuk e ka ende aftësinë e administrimit e të parandalimit të krizave për të mos folur për mbylljen e konflikteve të hapura apo ato potenciale.Këto mungesa në aksionin evropian që po lëkundin seriozisht kredibilitetin e BE në sytë e popujve të Ballkanit Perëndimor kanë krijuar e po zgjerojnë hapësirat edhe për depërtimin e thellimin e politikave intervencioniste ruse, kineze, turke apo të tjera e të natyrave të ndryshme në rajon.Pikërisht këto dobësi evropiane janë midis arsyeve që po thirret me urgjencë rivendosja e lidershipit amerikan të paralajmëruar e të kërkuar më kohë nga aktorë politikë rajonalë e analistë strategjistë amerikanë dhe evropianë.

Rikthimi i Shteteve të Bashkuara në Ballkanin Perëndimor nuk duhet të shoqërohet me ç'angazhimin e tërheqjen e Bashkimit Evropian nga rajoni. Pavarësisht nga dobësitë e momentit që po manifeston, Bashkimi Evropian ka një rol të pazëvëndësueshëm në Ballkanin Perëndimor.Përkundrazi, përmes një bashkëpunimi të ri e vizionar midis dy aktorëve më të mëdhenj të demokracisë perëndimore, Ballkani Perëndimor ka shancin që të kapërcej më shpejt krizën aktuale të stanjacionit e të progresoj drejt mbylljes përfundimtare të situatave konfliktuale, të krizave të trashëguara e të ndërtimit të plotë të shoqërive demokratike postnacionaliste, integruese e të shtetit ligjor.

Aktualisht politika amerikane në Ballkanin Perëndimor po ballafaqohet me

kriza e sfida të trashëguara por edhe të reja.Disa prej tyre burojnë nga brënda rajonit, disa të tjera janë rrjedhojë e veprimit të faktorëve të jashtëm, por ka prej tyre ku ndërthuren zhvillimet e brendshme me influencat e ndërhyrjet e huaja.

I.Kryesfida për politikën amerikane në rajon është **rigjallërimi i nacionalizmit** i parë si instrument i luftës së brëndshme për pushtet por edhe si pengesë për të kapërcyer frymën konfliktuale mes etnive në Bosnjë-Hercegovinë dhe bllokimin e arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare mes Serbisë e Kosovës.Tërheqja relative amerikane dhe paaftësia e Bashkimit Evropian për të menaxhuar këto situata krize poskonfliktuale rrezikoi të çimentonte stanjacionin dhe të ushqente tendencën e shndërrimit të tyre në konflikte të ngrira.

II. Ballkani Perëndimor është ende i prapambetur në të gjitha drejtimet por mbi të gjitha për nga kultura politike, nga aftësia për tu shkëputur nga trashëgimia tradicionale negative e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve e konflikteve përmes forcës dhe jo përmes dialogut. Ky terren ballkanik i infektuar ka prodhuar e nxjerr qënie politike që e kanë ngjizur por edhe të ushqyer që në fillim logjikën e moralin e **modeleve historike e të legjendave të bajraktarizmit politik**.Ky fenomen që shpesh herë anashkalohet për arsye dhe interesa kalimtare të momentit pengon shumë zhvillimin dhe emancipimin politik demokratik në sundimin e ligjit në rajon dhe kultivon në vazhdimësi **autoritete dhe institucione qeverisëse me pushtete të mëdha ose të pakufizuara** që nuk e njohin ose e keqpërdorin dialogun e kompromisin.Kjo është **sfida e dytë për politikën amerikane në Ballkanin Perëndimor.**

III.Tashmë është e njohur dhe e provuar që jo vetëm politika por edhe pjesë të shoqërive të vëndeve të rajonit kush më shumë e kush më pak janë të mbërthyera nga **korrupsioni** dhe të lidhura me **krimin e organizuar**.Rrezikshmëria e këtyre fenomeneve ndofta ende nuk perceptohet në dimensionet e tyre reale jashtë rajonit. Nuk është fjala thjeshtë për individë apo grupe të kufizuara njerëzish por për sisteme të mirëorganizuara brënda dhe jashtë institucioneve shtetërore që diktojnë e influencojnë në to.Politika amerikane ka investuar në luftimin e këtyre fenomeneve ekstra negative, veçanërisht në Shqipëri përmes reformimit në proçes të sistemit të drejtësisë por ende mbetet shumë për të bërë.Dhe kjo ka qënë dhe është **një sfidë tjetër për politikën amerikane në rajon**.

IV. Bashkimi Evropian ka shumë vite që po merret me Ballkanin Perëndimor, por pas vitit 2013 u duk se morri udhëheqjen e procesit në këtë rajon evropian në mirëkuptim me Shtetet e Bashkuara që për shkak të angazhimeve prioritare në rajone të tjera të botës bënë hapa prapa në politikën e tyre ballkanike.Pa pretenduar për të bërë një analizë, **BE u ndodh e papërgatitur për të ndërmarrë lidershipin me gjithë nismat, projektet e strategjitë që ka hartuar e shpallur në këto vite të fundit**.Kjo ka ndodhur ndër të tjera për dy arsye kryesore:për shkak të krizës shumëvjeçare jo vetëm ekonomike por edhe politike e strukturore të BE, të mungesës së koherencës në vendimmarrje dhe në dobësinë e tij të manifestuar.Samiti i fundit i Brukselit i vërtetoi këto dobësi edhe për Ballkanin Perëndimor.**Politika amerikane e sheh këtë sfidë që qëndron para saj**.

V.Politika amerikane por edhe evropiane në Ballkanin Perëndimor po sfidohet nga faktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë dhe rajonalë si **Rusia,Kina**, **Turqia**, etj. Rusia ka një avampost tradicional në Ballkanin Perëndimor që është Serbia, shtuar këtu edhe Serbska Republikën dhe në përgjithësi popullsitë sllave në rajon.Rusët kanë disa instrumenta që po i përdorin jo pa sukses si armët, gazin, naftën, kishën ortodokse, diversionin, etj.Synimi i tyre është të pengojë avancimin e mëtejshëm të NATO-s pas dështimit në Mal të Zi e në Maqedoninë e Veriut e sidomos afrimin e Serbisë me bllokun e Atlantikut Verior, ruajtjen e status-quo-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe vonimi ose sabotimi i procesit të integrimit evropian të Ballkanit Perëndimor.**Thelbi i ndërhyrjes ruse aty u favorizua nga tërheqja amerikane dhe nga amullia evropiane**.

Thuajse të njëjtat dobësi u shfrytëzuan edhe nga Kina e cila falë bumit të zhvillimit ekonomik shumëvjeçar e nevojës urgjente që kanë kapitalet e saj të lira për investime, ka ndërmarrë sipërmarje të fuqishme investuese, financiare e tregtare në drejtim të Evropës përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor.Ofertat kineze për investime e tregti janë joshëse për vënde të tilla si rajoni ynë që nuk kanë burime të brëndshme të mjaftueshme dhe që ballafaqohen me vështirësi të mëdha ekonomike.Nismat e mirënjohura kineze, "**një brez, një rrugë**" dhe mekanizmi "**17+1**" ndonëse ende nuk përbëjnë kërcënime serioze për peshën investuese e tregtare që përfaqësojnë, janë një strategji e mirëmenduar ekonomike kineze pa thekse të dukshme gjeopolitike ende.Politika amerikane nuk e ka fshehur shqetësimin për këtë "**marshim të madh**" kinez në Ballkanin Perëndimor.

Politika amerikane vitet e fundit ka shfaqur ndjeshmëri jo të vogël edhe ndaj aleates problematike në NATO, Turqisë jo vetëm për afrimin e saj me Rusinë e për qëndrimet e saj në Lindjen e Mesme por edhe për strategjinë konstante turke për t'u rikthyer në Ballkanin Perëndimor jo thjeshtë e vetëm për shkak të disa lidhjeve tradicionale e influencave gjuhësore, kulturore e fetare.Shqetësimi amerikan për aq sa është bërë i dukshëm e lexohet ka të bëjë me këmbënguljen turke që duke shfrytëzuar realitetet demografike fetare në Bosnjë, Sanxhak, Kosovë, Maqedoninë e Veriut e Shqipëri si dhe potencialet e saj ekonomike e ushtarake **të ndryshoj arkitekturën gjeopolitike të rajonit në funksion të një strategjie rajonale më të gjërë edhe për t'iu bashkuar Evropës jo përmes rrugës institucionale të antarësimit në BE që duket thuajse e pamundur, por përmes imponimit me kufinj virtualë të një perandorie të vogël neootomane.**

VI.Një sfidë tjetër të madhe me të cilën është ballafaquar politika amerikane dhe që është në fokusin e vëmëndjes së saj në shkallë ndërkombëtare por edhe në Ballkanin Perëndimor përfaqëson **terrorizmi**, **veçanërisht ai radikal islamik**.Do të ishte gabim që ai të nënvleftësohej për shkak të rënies së shtetit islamik.Ballkani Perëndimor ka treguar se nuk është i imunizuar nga elementë e forca që e kanë ushqyer terrorizmin islamik e që mundet tani e në të ardhmen të riaktivizohen për të destabilizuar Ballkanin Perëndimor.

VII.Së fundmi, politika amerikane më pak dhe ajo evropiane më shumë janë ndeshur me një fenomen që vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë një rrezik i madh

potencial i minimit të rendit social dhe të sigurisë së rajonit.Ky kërcënim më i ri janë **valët e emigracionit ilegal** nga Lindja e Mesme, Azia dhe Afrika që u përplasën në Ballkanin Perëndimor dhe që ende dhe sot rrjedha relativisht të konsiderueshme filtrojnë në vëndet e rajonit me destinacion final Evropën Perëndimore.

Të gjitha këto sfida të shumta duhen përballuar por do të ishte naive të mendohet se do të jenë Shtetet e Bashkuara që do të duhet të ballafaqohen me to e të japin zgjidhjet e duhura.Në rradhë të parë janë vetë vëndet e Ballkanit Perëndimor që e kanë për detyrë të qëndrojnë në krye të punëve për të siguruar shtëpitë e tyre nga kërcënimet e rreziqet.Së dyti, është Bashkimi Evropian që e ka për objektiv parësor sigurinë dhe progresin e këtij rajoni përmes strategjive realiste integruese.Shtetet e Bashkuara përsa tregojnë mesazhet dhe veprimet më të fundit të tyre po rikthehen në Ballkanin Perëndimor me vullnetin dhe ambicjen për të qëndruar fortë dhe për të zbatur një strategji afatgjatë e të përpunuar mirë jo vetëm në kufinjtë e për objektivat e administratës aktuale të Presidentit Trump por për shumë e shumë më tepër.

Shtetet e Bashkuara kanë nevojë për **një strategji të re në Ballkanin Perëndimor**. Pyetja që shtrohet është: **A e kanë ato këtë strategji të re sot apo e kanë në përpunim e sipër?** Përsa është folur nga zyrtarë të lartë amerikanë të Shtëpisë së Bardhë, Kongresit e Departamentit të Shtetit ende nuk ka një platformë të qartë e të ravijëzuar, të paktën publike. Qëndra të mirënjohura e të specializuara amerikane por edhe think-tanke evropiane kanë bërë studime dhe analiza të dobishme dhe thuajse të gjitha kanë arritur në përfundimin se **Shteteve të Bashkuara u duhet një qasje e re dhe gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor**.

1.Strategjia e vjetër amerikane kryesisht u mbështet **në politikën e sigurisë**. Një strategji e re amerikane duhet të ketë parasysh se tani katër vende të Ballkanit Perëndimor janë anëtare të NATO-s (Kroaci, Shqipëri, Mal i Zi, Maqedonia e Veriut) dhe në Kosovë ndodhet e dislokuar një forcë ushtarake e tij.Pa hequr dorë nga politika e sigurisë, Shtetet e Bashkuara duhet ti japin përparësi ndihmesës për përballimin e sfidave të brëndshme të rajonit e të çdo vëndi në veçanti, ekonomike, sociale, ndërtimit e funksionimit të institucioneve demokratike përfaqësuese, mos kapjes së shtetit nga forca dhe individë që kanë vendosur ose tentojnë të restaurojnë regjime autoritare qeverisjeje.Shtetet e Bashkuara kanë dhënë modele të angazhimit të sukseshëm në këtë drejtim siç është ai i hartimit dhe i zbatimit të reformës në drejtësi në Shqipëri.Kjo frymë dhe ky angazhim duhet të dëshmohet në krijimin e institucioneve reale të demokracisë liberale në të gjitha fushat dhe në sundimin e ligjit për të gjithë e mbi gjithçka.Aktualisht **sfida më e madhe që ka politika amerikane përpara në Ballkanin Perëndimor është ajo e demokracisë**. Me përballimin e kësaj sfide është i lidhur edhe suksesi në zgjidhjen e kënaqëshme të sfidave të tjera.

2.Një qasje e re në politikën amerikane në Ballkanin Perëndimor është e kushtëzuar me **nivelin e përfaqësimit dhe me jetëgjatësinë e angazhimit aktiv të saj**.Do të ishte e pafrytshme nëse ajo konceptohet e përkohshme në formën e një fushate apo me një kohëzgjatje sa çfarë mund të jetë mandati i një administrate në Shtëpinë e Bardhë.Angazhimi i emrave të përveçëm të burokracisë së lartë

diplomatike amerikane apo vizita e Sekretarit amerikan të Shtetit Pompeo në rajon nuk duhet të konsiderohen të jashtëzakonshme e të jenë tepër të rralla.Sigurisht Shtetet e Bashkuara kanë interesa shumë herë më të rëndësishme në zona të tjera të botës sesa në Ballkanin Perëndimor, ku intensiteti i veprimit dhe niveli i përfaqësimit prevalon mbi atë në rajonin tonë.Por Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës dhe kontinenti i vjetër ka qënë e do të mbetet kërthiza e politikës së jashtme amerikane.

3.Një strategji e re amerikane në Ballkanin Perëndimor nuk do të mund të jetë e suksesshme **pa një kordinim të ngushtë me Bashkimin Evropian**. Partneriteti aktiv dhe konkret mes tyre është mëse i domosdoshëm, ai nuk duhet të jetë thjesht deklarativ dhe i përgjithshëm e jo vetëm për çështje të sigurisë.Mirëqeverisja e rajonit përmes institucioneve funksionale demokratike, përmes qarkullimit të elitave dhe jo përmes klaneve politike të qëndërzuara rreth liderëve autokratë e thuajse permanentë në pushtet, duhet të jetë një ndër objektivat parësore të tyre. Për këtë qëllim nevojitet krijimi i strukturave të përbashkëta e të posaçme e në bashkëpunim me ato rajonale për të nxjerrë vëndet e Ballkanit Perëndimor nga harta e "**mbretërive**" ku sundon krimi, korrupsioni, ilegjitimiteti dhe klanet mafioze të drogës.Që këto gjëra këtej e tutje të mos mbeten thjeshtë slogane që përsëriten rast pas rasti, por akse aktive e realizuese të strategjisë së re, do të ishte e dobishme që vëndet e Ballkanit Perëndimor **të kalonin nga niveli aktual i bashkëpunimit në dorëzimin e një pjese të sovranitetit në duart e institucioneve të specializuara amerikane dhe evropiane.**

Një strategji e përbashkët euro-amerikane nuk mund të kuptohet pa **sinkronizimin e politikave për anëtarësimin e vëndeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian**.Sigurisht që Shtetet e Bashkuara nuk janë anëtare dhe nuk kanë votë në vendimmarrjen e institucioneve evropiane.Por tërësia e objektivave dhe e interesave që ato kanë së bashku në këtë rajon do të duhet të diktojë tani e në të ardhmen diçka më shumë se sa një informim apo konsultim midis Brukselit dhe Uashingtonit për këtë çështje.Fakti që mungon ky mekanizëm kordinimi për Ballkanin Perëndimor e dëshmoi edhe reagimi i Departamentit të Shtetit ndaj Këshillit Evropian për vendimin për mos hapjen e negociatave për anëtarësim në BE të Shqipërisë e Maqedonisë së Veriut.

4.Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë ndër të tjera edhe një arsye më shumë e madhore për të qënë së bashku në përballimin e sfidave në Ballkanin Perëndimor.Prania në rritje dhe ambicioze e Rusisë, Kinës, Turqisë dhe aktorëve të tjerë më pak relevantë në rajon, e bën terrenin e veprimit më të komplikuar e më konkurrues.**Kjo konkurencë e këtyre Fuqive nuk mund të përballohet me mjete të Luftës së Ftohtë**.Çdo njëri prej këtyre aktorëve ka veçoritë e synimet e tij, ka lidhje tradicionale ose incentiva të tij të ndryshme që krijojnë hapësira influence të gjithanëshme në rajon.Po kështu vetë Shtetet e Bashkuara kanë marrëdhënie e interesa globale me Rusinë e me Kinën që janë shumë të mëdha, ndonëse zhvillohen në mjedisin e një konkurence të ashpër në paqe.

Në rrethanat e krijuara, ndonëse të padëshiruara ndofta ka ardhur koha të thirren edhe përvojat e së kaluarës së afërt për të angazhuar në çështjet e Ballkanit

Perëndimor institucione të tilla si "**Quint**", pse jo për kriza të zgjatura e shance të pakta për zgjidhje edhe formatin e **Grupit të Kontaktit**.

5.Thëmbra e Akilit në Ballkanin Perëndimor është zhvillimi ekonomik. Shtetet e Bashkuara duhet **të rishikojnë strategjinë e tyre të bashkëpunimit ekonomik** në rajon që të bëhen më të pranishëm me investime, për të sfiduar ekspansionin rus që operon me gazin, naftën, hekurin, etj, në tregun lokal apo Kinën që është në progres përmes investimeve në infrastrukturë dhe energji përmes financimeve me interesa të ulta.SHBA por edhe BE kanë shumë rregulla, standarte e kushtëzime në investime, të cilat nuk plotësohen lehtë dhe e ngadalësojnë ritmin e bashkëpunimit ekonomik me vëndet e rajonit.Kjo i bën ato të mos jenë konkurues me lehtësitë që ofrojnë rusët dhe kinezët në tregun e Ballkanit Perëndimor.Ndërkohë që me Turqinë, këtë aleat të vështirë e problematik të NATO-s, Shtetet e Bashkuara do të duhet që së bashku me BE të bëjnë **kompromise të dhimbshme midis dilemave që lëkunden nga Ballkani Perëndimor në Lindjen e Mesme**.

Ka edhe çështje të tjera që do të duhet të jenë në vëmëndjen e politikbërësve amerikanë për rajonin, por dy angazhime të mëdha duhet të jenë në krye të agjendës së strategjisë së re të Shteteve të Bashkuara nëse flitet për të tillë.Ato janë Bosnja-Hercegovina dhe Kosova, të dy të lidhura me një faktor kryesor rajonal e historik si Serbia.

6.Bosnja-Hercegovina është një rebus tepër i vështirë për t'i gjetur një zgjidhje të përshtatshme e të kënaqëshme.Këtë e dinë të gjithë e veçanërisht në Uashington. Rrëshqitja e saj drejt një konflikti të ngrirë nuk është zgjidhje.Ishte ndërhyrja amerikane dhe e NATO-s që 24 vite më parë e shpëtoi popullsinë myslimane të Bosnjës nga shfarosja përfundimtare e makinës ushtarake kriminale serbe të Millosheviçit, Karaxhiçit e Mlladiçit.Ishin përsëri Shtetet e Bashkuara që nxitën dhe realizuan Marrëveshjen e Dejtonit që sipas Lordit Peter Ashdown ishte një "**super marrëveshje për të përfunduar një luftë, por një marrëveshje shumë e keqe për të bërë një shtet**".Fjalë profetike që i ka vërtetuar koha.

Shtetet e Bashkuara nuk po rikthehen me një formulë të gatshme për zgjidhjen e krizës në Bosnjë-Hercegovinë e për të ndalur rënien e disintegrimin e këtij shteti.Por as edhe janë të gatshëm tani për të kapërcyer formulën e Dejtonit e për të ndërtuar një arkitekturë institucionale funksionale në një kohë kur brënda vëndit ekziston një polarizim i madh etnik e politik.Politikës amerikane do t'i duhet shumë angazhim për të gjetur një formulë të gjithëpranuar për zgjidhje që nga palët vendore, aktorët rajonalë, veçanërisht Serbia e Kroacia por edhe ata ndërkombëtarë, në rradhë të parë Rusia.

7.Le të vijmë së fundmi në Kosovë ku ka sa të panjohura po edhe kaq shanse për të parë dritë në fund të tunelit e për të arritur një marrëveshje përfundimtare me Serbinë në termat e njohura e të diskutuara.Dy emisarë të lartë amerikanë, Palmer dhe Grenell së bashku me ekipet diplomatike në Prishtinë e në Beograd nuk është vështirë të kuptohet se janë në kulmin e punëve të tyre për të hartuar projekt propozimet dhe projekt kompromiset e një marrëveshjeje të mundshme historike midis dy vëndeve.Padyshim që do të ketë shumë rëndësi për fatin e një projekt

marrëveshjeje nëse pjesë e saj do të jetë ose jo **idea e korrigjimit apo e shkëmbimit të territoreve mes Kosovës e Serbisë**. Mbetet për të parë nëse kjo ide e lidhur dhe e mbështetur nga ish këshilltari për sigurinë kombëtare i Presidentit Trump, Xhon Bolton, ka ikur bashkë me të apo do të jetë gur themeli në një marrëveshje të supozuar.Një gjë është e sigurt: presidenti Trump do ta dëshironte një marrëveshje të tillë historike në Ballkanin Perëndimor në prag të zgjedhjeve presidenciale të nëntorit 2020 dhe nënshkrimin e saj ceremonial në prani të tij në Uashington apo në Kemp Dejvid.Nëse ai do të vazhdoj t'i qëndroj këtij objektivi është e shpjegueshme edhe pse caktoi si negociator midis Kosovës e Serbisë, njeriun e tij të besuar, ambasadorin Richard Grenell.

Për momentin zgjidhja e këtij ekuacioni ka disa të panjohura që duhen marrë në analizë.E para, është qëndrimi i palëve të angazhuara, Serbisë dhe Kosovës në negociatat që mund të fillojnë.**Çfarë platforme negocimi do t'u ofrohet, cila do të jetë përqindja e karrotave dhe e shkopinjve që ajo do të përmbaj**? Kombinimi i këtyre elementëve për të kapërcyer një armiqësi e krizë shekullore do të ketë nevojë për miratimin dhe firmën e presidentit, të qeverisë së Serbisë si dhe të Kuvëndit të saj, në mos të të gjithë popullit serb, në një kohë kur pas disa muajsh aty do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare.A është gati presidenti serb Vuçiç t'i hedh zaret pa i bërë mirë llogaritë se çfarë fiton e çfarë humbet? Është ende shpejt të thuhet.

Në Prishtinë sapo kanë mbaruar zgjedhjet parlamentare dhe ish opozita (Vetëvendosja dhe LDK) krijuan një qeveri të përbashkët pavarësisht diferencave të njohura programore dhe qasjeve të ndryshme të të bërit politikë.LDK ka qënë më e lakuar ndaj idesë së një marrëveshjeje dhe kryetari i saj Mustafa është ulur në Bruksel si kryeministër përballë Vuçiçit.Vetëvendosja për vite me rradhë ndërtoi profilin e një partie radikale dhe nacionaliste me aksione jo shumë tradicionale e të gjithëpranuara brënda dhe jashtë Kuvendit të Kosovës.Ajo kundërshtoi me forcë platformën dhe bisedimet shqiptaro-serbe në Bruksel dhe çdo ide të shkëmbimeve territoriale me terma thellësisht të ashpra.

Cila do të jetë tani qasja e Vetëvendosjes dhe Albin Kurtit në pozitën e kryeministrit ndaj negociatave me Serbinë me ndërmjetësinë amerikane? Çfarë ndryshimesh nëse do të ketë, do të shfaqen në pozitën e kryeqeveritarit në krahasim me pozitën e ish kryeopozitarit? Normalisht, përvoja ka dëshmuar se në qeveri gjuha zbutet e rrumbullakoset, bëhet më diplomatike dhe veprimet më të kujdesshme.Albin Kurti ka dhënë shenja në këtë drejtim.Ka filluar të shfaqet përgjegjshmëria e qeverisjes.**A do ta gjej ai mesin e artë mes saj dhe platformës nacionaliste të partisë së tij që e solli në pushtet?** Nuk do të vonojë të provohet.

Politika dhe ndërmjetësimi amerikan për një marrëveshje të mundshme mes Kosovës dhe Serbisë patjetër që do të ketë në konsideratë dy faktorë të rëndësishëm të jashtëm: Rusinë dhe Bashkimin Evropian.Të parin si mentorin dhe mbështetësin paekuivok të Serbisë.**Roli i Rusisë do të lëkundet midis mbrojtjes së interesave serbe dhe frikës se mos përfundimi i konfliktit dhe marrëveshja përfundimtare shqiptaro-serbe i heq gurë themeli nevojës ruse dhe pranisë së gjithanshme të saj në Serbi**.Aq më keq që kjo marrëveshje siç edhe është deklaruar do t'i hapte

rrugën Serbisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe do të krijonte rrethana për një afrim me NATO-n në formën e një partneriteti strategjik.Për të gjitha këto dilema e për ta bërë Rusinë bashkëpunuese në arritjen e marrëveshjes ndofta do të mendohet që të gjëndet një mekanizëm për ta konsideruar si pjesë të proçesit.

Shtetet e Bashkuara në sipërmarrjen e tyre negociuese mes Kosovës dhe Serbisë do të duhet ta kenë përkrah **Bashkimin Evropian si partnerin kryesor me të cilin po ndajnë të gjitha sfidat në Ballkanin Perëndimor**. Për më tepër se Bashkimi Evropian që nga viti 2013 ka ndërmjetësuar për arritjen e marrëveshjes Kosovë-Serbi dhe ka një përvojë të vlefshme që mund të shërbej.Mënyra e ndërveprimit mbetet për t'u parë.

NGA HISTORIKU DYSHEKULLOR I MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-AMERIKANE

Ksenofon Krisafi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
krisafi2002@yahoo.com

ABSTRACT

According to one point of view, based on the description of Virginia Carmichael, author of the biographical book "Mary Ball Washington," the origin of Albanian-American relations goes back to the first quarter of the eighteenth century. George Washington's mother, named Mary Ball, was of Albanian descent. The initial name Marie (Bala) was given by her Albanian parents, who arrived in the US in 1706, from the outskirts of Peja. Given this, let's call it a "blood relation", various authors try to argue the American descent of the American president considering it to be one of the cornerstones upon which the structure and origin of Albanian-American relations would be built. The most plausible episode of the first Albanian-American contact is that which occurred on April 8, 1819, when a sailing ship docked in the modest Sayyadah Chameria landed two American journalists, J. Humber and K. Rooth, who were heading to Ali Pasha Tepelena's yard. In 1873 Scanderbeg would "arrive" on the American continent, as one of the characters in the third volume of Henry Wadsworth Longfellow's work. The event that would attract US attention was the Prizren League, 1878-1881, whose developments would be widely reflected in the American press. Correspondents of *The New York Times*, in the capitals of the "old" continent, recognized in the League the traits of a politico-administrative creature as a product of the Albanian National Movement. The chronicle of Albanian-American relations would later be enriched with interesting episodes, highlighting two main lines, on the one hand it was the interest or at least the American discovery of Albanians and their lands, on the other hand the landing of Albanians on the American continent and in the US. In 1908 the couple of Violet and Fines (Phineas) Kennedy arrive in Korça and at the same time the distinguished personality Charles Telford Erickson, director of the American Board of Foreign Missions in Albania, to be followed by the arrival of the American Red Cross on April 3, 1919. In 1886 Koli Christopher,

from Katund village of Korça, arrived in America as the "the first swallow"of other mass migrations in later decades, which would lead to the creation of associations of Albanian communities. Their number would increase rapidly, as there were about 30,000 Albanians in the United States on the eve of World War I. Subsequently, Albanian-American contacts and relations intensified, institutionalized, and developed to express Albanians' sincere feelings for the United States. Excluding the communist period in Albania, they have consistently been characterized by positive developments.

KEYWORDS: Albania, America, USA, Tirana, Washington, Vatra, World War I, World War II, international recognition, UN, Peace Conference, relations, president, ambassador, prime minister, minister.

Shumëkujt, kur dëgjon të flitet për zanafillën e lidhjeve shqiptaro-amerikane, mund t'i shkojë mëndja te viti 1922, kur u vendosën marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve. Dikush tjetër mund ta çojë atë te 1908, kur në tokën shqiptare mbërriti Charles Telford Erickson, drejtori i Bordit amerikan të misioneve të huaja dhe çifti Kenedi, si misionarë të tij. Të tjerë mund të hamendësojnë 1886, kur në Amerikë zbriti shqiptari i pare, Koli Kristofori nga Korça. Në fakt origjina e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane zbret shumë më thellë në histori.[1]

GEORGE WASHINGTONI ME ORIGJINË SHQIPTARE?

Sipas një pikëpamjeje që bazohet në librin biografik "Mary Ball Washington", të autores Virginia Carmichael, botuar për herë të parë në 1850,[2] rezulton se e ëma e George Washingtonit, ishte fëmija e dy prindërve shqiptarë, me origjinë nga rrethinat e Pejës, që kishin emigruar në kontinentin amerikan në vitin 1706. Ajo lindi në Lively të Virxhinias dhe e quajtën Maria Bala, emër të cilin do ta ndryshonte më vonë në Mary Ball. Në vitin 1731 u bë gruaja e dytë e Augustine Uashingtonit dhe më 22 shkurt 1732 solli në jetë George Uashingtonin, një prej etërve themelues të ShBA. Mbështetur në këtë, le ta quajmë "lidhje gjaku", autorë të ndryshëm përpiqen të argumentojnë prejardhjen shqiptare të presidentit amerikan. Por shumica e cilësojnë atë si legjendë. Dikush insiston për vërtetësinë e saj.[3]Sidoqë të jetë, e vërtetë apo e stisur,

1 Për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane janë shkruar libra dhe artikuj të shumtë. Midis tyre duhet të përmendim librat e Haris Silajxhiç "*Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit*", Ndriçim Kullës, *Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: një historik gjithëpërfshirës*, Ilir Ikonomit, *Faik Konica - Jeta në Uashington* dhe *Pushtimi,* Agron Alibalit, *Faik Konica, dritëhijet e një diplomati,* Nasho Jorgaqit, *Jeta e Fan S.Nolit*, Mal Berisha,- *Charles Telford Erickson, Një jetë e jashtëzakonshme kushtuar Shqipërisë*, Peter Lucas,- *Misioni amerikan në Shqipëri, Operacionet sekrete të Oss-it dhe bashkëpunimi me partizanët komunistë gjatë Luftës së dytë Botërore* etj, si dhe disa shkrime interesante të studiuesve Irakli Koçollari, Auron Tare etj. Për këtë arsye autori i këtij referati mendoi të ndalej vetëm në disa momente që, sipas gjykimit të tij, përfaqësojnë zhvillime me interes të veçantë në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.

2 *Mary Ball Washington* by Virginia Carmichael, Mary Washington Branch, Association for the Preservation of Virginia, Antiquities (1967).

3 Carl Woodward, gazetar, reporter amerikan, që ka fituar katër çmime Pulitzer, autor i dhjetëra librave dokumentarë për presidentët amerikanë dhe historive nga Shtëpia e Bardhë, thotë se kishte gjetur nëpër arkiva

ajo tingëllon interesante si pikënisje origjinale, unikale e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane. Në themel të tyre vendoset figura e presidentit të parë të ShBA.

AMERIKANËT NË SHQIPËRI

Kronika e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane duket se ka ndjekur dy linja bazë. E para interesimi i amerikanëve për shqiptarët dhe trojet e tyre dhe nismat për zbarkim në Shqipëri, e dyta lundrimi i shqiptarëve drejt kontinentit amerikan dhe ShBA.

Akti i parë i skenarit të kontakteve shqiptaro-amerikane ka ndodhur më 8 prill të vitit 1819, kur nga një anije e ankoruar në molin e Sajadhës së Çamërisë, zbritën dy gazetarë amerikanë. Ata do të shkonin te Ali Pashë Tepelena. Përshtypjet nga takimi si dhe nga vizitat në vend, i pasqyruan në një reportazh, që e botuan në vitin 1820, në revistën Amerikane *The North-American Review and Miscellaneous Journal*, nën titullin: "*Visit to Joannina and Ali Pasha*". Autorët thonë se "Janina është qyteti më i madh, më i pasur dhe njëkohësisht më i begatë në krahasim me tërë qytetet e tjera të Greqisë. Njerëzit e ditur dhe të mësuar këtu janë të shumtë, ndërsa njerëzit e pasur janë më mirë të mbrojtur dhe të sigurt."[4] Ata sjellin edhe një detaj shumë interesant për çështjen për të cilën po flasim. Ata shkruajnë se Aliu iu kërkoi ndihmë për të vendosur raporte diplomatike dhe lidhje tregtare me kontinentin e largët, madje edhe dërgimin e një konsulli amerikan në Janinë. Në atë kohë në kryeqendrën e pashallëkut të tij vepronin konsullatat e Francës, Anglisë dhe të Rusisë.

Kjo dëshmi, përveç se sjell një këndvështrim shumë interesant mbi politikën e jashtme të Ali Pashës, tregon gjithashtu se marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, nuk janë aq të vona sa mendohet ngandonjëherë. Këtë histori e përshkruan studiuesi Irakli Koçollari. Auron Tare, i cili gjithashtu ka rëmuar jo pak nëpër arkivat e ShBA, duke iu referuar të njëjtës kohë dhe dhe të njëjtit vend, e përshkruan pak më ndryshe ngjarjen.[5] Ai pohon se disponon "një dokument shumë interesant të botuar për herë të parë në prill të 1820-ës në një revistë të New England *The North-American Review and Miscellaneous Journal*. Revista në fjalë, e para revistë letrare e botuar në Amerikë që me 1815... ka botuar një dokument pa autor... (i cili) është një përshkrim i mrekullueshëm i udhëtimit të një grupi të vogël udhëtarësh amerikanë në viset shqiptare në prillin e 1818-ës."[6]

Se ç'ndodhi në vijim nuk dihet, por vështirë të mendohet që zhvillimet e asaj kohe

---

një letër të George Washington, ku fliste për shqiptarët. Woodward shkruan se "mbaj mend që, kur mora letrën për t'ia treguar Bill Klintonit në një nga shumë intervistat dhe i thashë: "Ja, Bill, kjo është ajo që kam zbuluar nga arkivat e Uashingtonit", ai tha: "E kam parë Carl, e kam parë. Nëse nuk do ta kisha parë, Zoti e di nëse do të kishim ndërhyrë në Kosovë". Sipas John McCallum, gazetar i Reuters, duket se ka edhe një provë tjetër që vjen nga Instituti i Biokimisë dhe Gjenetikës, me seli në Schafhausen, Zvicër. Instituti ka publikuar rezultatet e hulumtimit më të fundit gjenetik të liderëve botërorë, midis të cilëve dhe mostrat gjenetike të ish-presidentit amerikan George Washington dhe i rezulton se ai ishte 50 përqind shqiptar, që do të thotë se njëri nga prindërit e tij ishte 100 përqind shqiptar. Autori thotë gjithashtu se ekspertë të fushave të tjera kanë kërkuar ta konfirmojnë këtë pohim, duke përmendur edhe prova të tjera, gjenealogjinë dhe prova gjuhësore. John McCallum, - Sipas Reuters/ George Washington, shqiptari që krijoi Amerikën, Citohet sipas Prizrenpress, 12/30/2019.

4 Irakli Koçollari, *1819 / Dy gazetarët amerikanë që intervistuan Ali Pashën, Java News*, 15/02/2016.

5 *Auron Tare,- Eduard Everet, një amerikan në oborrin e Ali Pashë Tepelenës, Gazeta Shqiptare,* 20/01/2012

6 Po aty.

jepnin shanse për ndonjë rezultat konkret. Sepse jo më larg se pas tre vjetësh koka e Aliut do të udhëtonte drejt Stambollit në tepsinë e mjaltit, kurse trupi do t'i varrosej në Janinë. Nga ana tjetër duhet patur parasysh se shërbimi diplomatik amerikan, sapo kishte mbushur 40 vjetorin e krijimit të tij.[7] Nuk besohet se do të kishte arritur të krijonte përfytyrimet e duhura rreth pashallëkut të Janinës, një strukturë politiko-administrative *sui generis*, që ekzistonte disa mijëra milje larg Uashingtonit, që ta vendoste kërkesën e Pashait në rendin e ditës së veprimtarisë së vet. Edhe nëse e pranojmë atë të kapërcyer e të zgjidhur pozitivisht, mund të shfaqej si faktor tjetër pengues statusi dhe personaliteti i themeluesit të tij, të cilat rrethoheshin nga pikëpyetje të shumta.

Kjo dëshmi, përveç se sjell një këndvështrim interesant mbi politikën e jashtme të Ali Pashës, tregon gjithashtu se marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, e kanë zanafillën në dekadën e dytë të shekullit të XIX.

Rreth 40 vjet më pas, në 1863 poeti Longfellow "do të çonte" në kontinentin amerikan heroin e shqiptarëve, Skënderbeun, të shndërruar në një nga personazhet e vëllimit të tretë të veprës së tij me poezi *Rrëfenja të një hani ndanë udhës*. Duke bërë të njohura trimëritë, fitoret, cilësitë dhe vlerat e udhëheqësit shqiptar, ai përshkruan gati me hollësi kthimin e Skënderbeut në Krujë dhe ua prezantonte amerikanëve si një legjendë me vokacion të rëndësishëm kombëtar e europian.[8]

Lidhja e Prizrenit, 1878-188, ngjarje madhore për shqiptarët, e ndodhur rreth 15 vjet më pas, tërhoqi vëmendjen e ShBA së largët. Të dhënat e deritanishme nuk ofrojnë ndonjë lajm për raporte të drejtpërdrejta ndërmjet Liidhjes dhe ndonjë organi amerikan. Edhe pse ShBA që kishin gati një shekull jetë shtetërore, nuk e kishin marrë ende formën dhe rolin e një fuqie me ndikime direkte në politikën botërore, në territorin e saj mbërrinte jehona e zhvillimeve që ndodhnin në kontinentin europian. Në atë kohë një pjesë e Europës, Ballkani dhe veçanërisht Perandoria Osmane ishin përfshirë në atë që quhej *Kriza Lindore*. Shqiptarët dhe territoret e tyre u gjendën në vorbullën e saj. Në ato vite shtypi amerikan ka përcjellë njoftime dhe opinione për Lidhjen e Prizrenit. Fjala vjen gazeta *The New York Times* ka shkruar për karakterin, qëllimet, frymëzimet politike të Lidhjes, për drejtuesit e saj etj.

Në prillin e vitit 1878, pa u formuar ende Lidhja, kur ishte nënshkruar Traktati i Shën Stefanit (3 mars 1878), korrespondenti i gazetës njujorkeze në Paris, duke komentuar ambicjet ekspansioniste të Malit të Zi, në kurriz të tokave shqiptare, njoftonte se zgjerimi i "Malit të Zi nuk mbështetet as mbi parimin *uti possidetis* dhe as mbi parimin e kombësisë, duke qenë se provincat e aneksuara prej tij janë të banuara krejtësisht nga shqiptarë katolikë dhe myslimanë, pa më të voglën përzierje

7 Daniela Grrica, *Frank Shkreli,- Marrëdhëniet Diplomatike Shqiptaro-Amerikane, Gazeta Shekulli,* 01.08.2019.

8 Në poemthin *"Kthimi i Skënderbeut në Krujë,* kushtuar Skënderbeut, shqipëruar me mjeshtëri nga Fan Noli dhe botuar në Boston, më 1916, Henry Wadsworth Longfellow thotë, ndër të tjera: "Nga kështjella shpejt ka rënë, Flamuri me gjysmë-hënë, Edhe populli shikon, Që në vënt të tij valon, Flamur' i Skënderit n'erë, Shkab' e zezë me dy krerë. Dhe një thirrje lart-u-ngrit, Se çdo zëmër e çdo shpirt, U-mërzit nga Turku i lik, Q'e kish bërë atë Krujë, Zi, murtajë dhe rrëmujë. Ay zë me gas me bujë, Q'oshëtin nga brek në brek, Është: "Rrofsh, o Skanderbeg!" LONGFELLOW, Henry Wadsworth,- Skanderbeg, Tales of a Wayside Inn, Sudbury, Massachusetts, 1863, shqipëruar e botuar nga At Fan S. Noli, Libraria Popullore, Boston Mass. 1916.

me gjak sllav, sikurse krenohen ata.[9]

Në një shkrim të 26 dhjetorit 1879, ku përshkruhen tentativat për plotësimin e kërkesave malazeze, vihet në dukje se "Plava me Gucinë nuk pranojnë ende t'i dorëzohen Malit të Zi, në përputhje me urdhërat dhe lutjet e Sulltanit, i cili shpreh padurimin e tij për përmbushjen e zotimeve që kishte marrë në Berlin... Katolikët, skizmatikët grekë dhe myslimanët e konsiderojnë veten se i përkasin një familjeje dhe do të lenë mënjanë armiqësitë e brendshme për t'u bashkuar në një qëndresë të përgjithshme ndaj copëtimit të vendit të tyre... Ata nuk duan t'ia dinë për Kongresin dhe të plotfuqishmit, për kajzerët dhe padishahët."[10]

Tashmë administrata dhe opinioni amerikan furnizoheshin me ide, në themel të të cilave qëndronte e vërteta që mbizotëronte kudo nëpër Europë, se "Lidhja Shqiptare është shtrirë kudo ku ka popullsi me gjak shqiptar, ajo është i vetmi autoritet, të cilit i binden dhe në asnjë vend ajo nuk ndesh në kundërshtim ndaj zbatimit *të ligjeve* që lëshon." Në pasazhin e sipërcituar vihet re se faktori ndërkombëtar ishte në dijeni për karakterin, organizimin, synimet, funksionet dhe veprimtarinë e zakonshme të Lidhjes. Siç shihet ata kishin dalluar se ajo përfaqësonte një strukturë komplekse, me tipare të qarta shtetërore, e cila ushtronte ndër të tjera edhe funksionet legjislative. Tepër interesant është pohimi tjetër që vjen nëpërmjet shkrimit me titull *Çështja shqiptare*, botuar në numrin e 30 majit 1880, i cili thotë se "Ne nuk kemi dëgjuar për asnjë lloj teprimi dhe çdo gjë është bërë me një pamje të ligjshme, me qëllimin e bërë publik për sigurimin e një ekzistence autonome, të ngjashme me atë që gëzojnë fqinjët e tyre në siujdhesën ballkanike."[11] Korrespondenti i saj në Londër, në korrik të vitit 1880 gjykonte se "Mendimi i përgjithshëm në Stamboll është se ata (shqiptarët) nuk do të luftojnë për Sulltanin, por për pavarësinë dhe rezultati përfundimtar do të jetë humbja e Shqipërisë (për Turqinë)."[12] Gazeta amerikane e rithekson këtë nëpërmjet të njëjtit korrespondent të saj,i cili në prillin e vitit 1881, shkruante nga Londra se "duket që ndërmjet krerëve shqiptarë ka mbizotëruar bindja, e inkurajuar edhe nga ndërmjetësa të Pallatit (Portës së Lartë, shënim i autorit), që Sulltani do ta njohë pavarësinë e Shqipërisë dhe do ta kënaqë veten me një suzerenitet sa për të thënë, në shkëmbim të ndihmës shqiptare kundër Fuqive, e cila u ofrua pa rezerva, për të penguar malazezët dhe grekët të jetësojnë aneksimet territoriale të premtuara."[13]

Ndërkohë një pjesë e shtypit amerikan nuk i kishte shpëtuar një opinioni që qarkullonte gjerësisht në atë kohë dhe që e konsideronte atë si krijesë dhe instrument të politikës së Portës së Lartë. Ky qëndrim ishte jehonë e pikëpamjes se Ballkani dhe në përgjithësi Lindja, ishin hapësira gjeopolitike të pandryshueshme, me karakter statik, të banuara nga popullsi të prirura nga ndjenjat e fanatizmit

9 *The New York Times*, *Traktati i Shën Stefanit*, 7 prill 1878, Citohet nga Artan R.Hoxha, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në faqet e The New York Times,* në *Studime Historike*, Nr.1-2/2012, f.227

10 *Çështjet shtetërore jashtë*, *The New York Times*, 26 dhjetor 1879, cit nga Artan R.Hoxha, shkrim i cit.

11 *Çështja shqiptare*, *The New York Times*, 30 maj 1880, cit nga Artan R.Hoxha, shkrim i cit.

12 *Problemet shtetërore europiane, The New York Times*, *13 korrik 1880*, cit nga Artan R.Hoxha, shkrim i cit.

13 *Lajme aktuale nga jashtë*, *The New York Times*, 30 prill 1881, cit nga Artan R.Hoxha, shkrim i cit.

dhe konservatorizmit. Më pas korrespondentët e saj në kryeqendrat e kontinentit "të vjetër", dallojnë te Lidhja tipare të një krijese politiko-administrative dhe të një produkti të natyrshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Ndërkohë një pjesë e shtypit amerikan nuk i kishte shpëtuar një opinioni që qarkullonte gjerësisht në atë kohë dhe që e konsideronte atë si krijesë dhe instrument të politikës së Portës së Lartë. Ky qëndrim ishte jehonë e pikëpamjes se Ballkani dhe në përgjithësi Lindja, ishin hapësira gjeopolitike të pandryshueshme, me karakter statik, të banuara nga popullsi të prirura nga ndjenjat e fanatizmit dhe konservatorizmit. Më pas korrespondentët e saj në kryeqendrat e kontinentit "të vjetër", dallojnë te Lidhja tipare të një krijese politiko-administrative dhe të një produkti të natyrshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Në vijim kronika e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane do të pasurohej me episode të tjera.

Ndër amerikanët e parë që shkelën në Shqipëri pas gazetarëve që takuan Ali Pashë Tepelenën, ishin çifti Violetë dhe Fines (Phineas) Kennedy, që udhëtuan për në Korçë, në 1908, si përfaqësues të *Bordit Amerikan të Misioneve të Huaja*. Drejtor i tij u bë Charles Telford Erickson, i mbërritur po atë vit. Ata kishin mësuar për Shqipërinë nëpërmjet Sevasti Qiriazit, që kishte qenë shoqja e fëmijërisë dhe e shkollës (klasës) e Violetës.Nga shoqëria me të i lindi dëshira për të mësuar gjuhën shqipe dhe më pas për të ardhur në Shqipëri. Misionarët Kennedy mbërritën në qytetin e Korçës me 26 Mars 1908, nëpërmjet Manastirit.[14] Aty, me gjithë pengesat e shumta nga administrata osmane, hapën një shkollë. Iu desh të përjetonin pushtimin grek, të provonin presione deri edhe arrestimin e Kennedit në Kolonjë, që do të pasohej nga kufizimi i misionit deri ikjen nga Korça drejt në Selanikut. Në vijim "aventura e tyre shqiptare" vazhdon me vendimin për t'u rikthyer në Amerikë, qëndrimin e detyruar në portin e Vlorës, heqja dorë nga udhëtimi drejt Amerikës, bashkimi me refugjatët e luftës, bamirësia në shërbim të muhaxhirëve dhe udhëtimi drejt Dibrës etj.[15]

Ndërsa Çarls Telford Erikson (Charles Telford Erickson), si drejtor i *American Board of Foreign Missions* në Shqipëri, shërbeu zyrtarisht për dymbëdhjetë vjet dhe në vijim, për katërmbëdhjetë vjet të tjera, qëndroi e punoi si individ i pavarur. Për përkushtimin, kontributet dhe dashurinë e dëshmuar ndaj Shqipërisë Federata e Shqiptarëve të Amerikës dhe qeveria e përkohshme e Durrësit e zgjodhën delegat ndër në Konferencën e Paqës në Paris.[16] Tre vjet më vonë erdhi Çarls Riçard Krein (Charles Richard Crane), për të cilin do të flitet në vijim.[17] Në vitin 1914 një tjetër amerikan, Uilliam Houard (William Howard), vizitoi vise të Shqipërisë për të mësuar gjendjen vajtuese të të dëmtuarëve prej luftës dhe për të ndihmuar në ndarjen e ushqimeve të dërguara prej Amerike.

Edith Stikney përmend Shoqërinë Anglo-Amerikane, të themeluar para

14 Kristo Dako,- *Shqipëria çelësi kryesor i Lindjes së Afërme*, Shtëpia botuese *Arbëria*, Tiranë, 2003, f. 186.

15 Dalip Greca,- *Çifti Amerikan Kennedy, tri dekada të dashuruar mes shqiptareve*, Gazeta *Dita*,- April 11, 2018.

16 Mal Berisha,- *Charles Telford Erickson, Një jetë e jashtëzakonshme kushtuar Shqipërisë*, Biografi, Botuar nga Edualba, Tiranë 2012, f. 151-152, .

17 Kristo Dako,- vep.cit, f. 186.

mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Nëpërmjet lidhjeve që kishte në Europë e ShBA, ajo përpiqej për riafirmimin e njohjes së pavarësisë së Shqipërisë.[18]Po në atë kohë, duke pasur edhe mbështetjen e Nolit, Konicës dhe individëve të tjerë nga Shqipëria dhe diaspora, përgatiti një memorandum drejtuar presidentit Uillson ku kërkohej protektorati amerikan për Shqipërinë.

Çarls Telford Erikson në vitet 1922-1923, i gjëndur në Shqipëri, si pjesë e stafit të Legatës Amerikane në Tiranë, i mbështetur edhe nga qeveria shqiptare, themeloi një shkollë bujqësore për djemtë dhe një shkollë të arteve shtëpiake për vajzat. Vazhdoi lidhjet me Shqipërinë për shumë vjet. Në vitin 1945 rishfaqet si pjesë e grupit të vëzhguesve të Vatrës, që ndiqte punimet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara, në San Françisko.[19]

SHQIPTARËT NË AMERIKË

Në raportet shqiptaro-amerikane kanë rëndësinë e vet edhe migrimet e shqiptarëve drejt Amerikës, sado modeste që mund të përfytyrohet. Shqiptari i parë në Amerikë, nëse vazhdojmë ta shohim me rezervë udhëtimin e nënës së Xhorxh Uashingtonit, në vitin 1706, ishte Koli Kristofori, nga fshati Katund i Korçës. Ai mbërriti në 1886 dhe u bë pararendësi i migrimeve të tjera më të shumta e më masive në dekadat e mëvonshme.

Në vitin 1906 numri i shqiptarëve kishte arritur në 5 mijë, kurse në pragun e Luftës së Parë Botërore, ishin rreth 30 mijë vetë. Kjo çoi në krijimin e shoqatave të komuniteteve shqiptare, të cilat për kontributet që dhanë, si për ndihmën ndaj shqiptarëve të porsaarritur në tokën amerikane ashtu edhe për forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, meritojnë mirënjohje. Tregues i rolit, statusit dhe vendit që shqiptarët e Amerikës kishin zënë në jetën e vendit ku jetonin, është edhe numri i tyre si dhe kontributet që dhanë për të. Në të dy luftrat botërore numri i shqiptarëve që u rreshtuan në ushtritë amerikane ishte 8414 vetë.[20]

Historia e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane gjatë gjithë kohës dëshmon se amerikanët nuk do ta humbisnin asnjëherë interesin ndaj Shqipërisë, natyrisht pa pretenduar që ajo do të ishte në qendrën e vëmendjes së tyre. Për filozofinë dhe objektivat strategjike të politikës së shtetit të tyre do të vazhdonin veprimtarinë shoqatat bamirëse, gazetarë e udhëtarë amerikanë, të cilët së bashku me suveniret nga toka shqiptare, do të çonin në atdheun e vet edhe rrefenja, mbresa, histori, kuriozitete për vendin nga vinin. Ka jo pak artikuj gazetash e revistash, madje edhe libra, që i referohen Shqipërisë, herë si vend ekzotik në qendër të Europës e herë si popull me vyrtyte të larta e të çmuara. Një prej tyre, që i takon vitit 1903, është artikulli i botuar në *New York Daily Tribune*, i datës 20 prill 1903 dhe që mban titullin *Rajon i*

18 Edith Pierpont Stickney, - Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet Europiane Ndërkombëtare 1912-1913, Koha, Tiranë, 1998, f. 156.

19 Mal Berisha,- vep.cit, f. 321-324.

20 Viron Prodani, Kontributi i emigranteve shqiptare ne ShBA, ne Luften e Pare dhe te Dyte Boterore. Në libër tregohet se gjatë Luftës së Parë Botërore në ushtrinë amerikane morën pjesë 4973 shqiptarë, kurse në Luftën e Dytë Botërore ishin 3441 shqiptarë. Citohet nga gazeta Dita, 11, 12, 13 Janar, 2018.

egër, por me hukuri magjepsëse, Malazezët: Plava dhe Gucia, kafshatë që s´kapërdihet.[21]

Një tjetër shkrim me titullin domethënës *Shqiptarët, një racë e rrallë; miq dhe armiq të turqve!*, i takon një viti më vonë. Eshtë botuar në gazetën amerikane *The Seattle Star*, të datës 29 prill 1904. Ai flet me nota pozitive për shqiptarët, duke i vlerësuar për virtytet, si; besnikëria, krenaria, mikpritja etj.[22] Duke iu kundërvënë opinioneve denigruese që i paraqesnin ata si njerëz të egër, shkrimi përbënte një reklamë të mirë për shqiptarët dhe vendin e tyre, në ato kohë aq shumë të turbullta.

"Qytetet e ndaluara të Plavës dhe Gucisë, të cilat nuk mund t´i shkelë dot askush përveç shqiptarëve të klanit të Guciajve (gusinjotët) apo vëllezërve të tyre të gjakut, akoma mund të ndajnë të njëjtin fat thuajse si i Lhasës (kryeqyteti i Tibetit) dhe misteret e tyre janë material i denjë për t´u përfshirë në guidat turistike si destinacione të paeksploruara. Kjo do të përbënte njëkohësisht edhe përfundimin e zënkave territoriale mes Malit të Zi dhe Shqipërisë, një çështje e ndjeshme në rajonin e Europës Juglindore, me të cilën diplomatët po merren prej vitesh". Kështu niste një artikull në të përditshmen amerikane *The Sun*, i datës 28 korrik 1907. Ai i kushtohej në mënyrë ekskluzive historisë, zakoneve dhe traditave të njërës prej zonave më të bukura, më atdhetare e më të famshme të Shqipërisë së Veriut. Shkrimi është zbuluar dhe ka ardhur në shqip nga gjurmuesi pasionant Armand Plaka.[23]

SHBA DHE PAVARËSIA E SHQIPËRISË

Personalitete të shquara amerikane përshëndetën shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në 1912 dhe bashkuan përpjekjet për mbrojtjen e saj. Studiuesi dhe shkrimtari i shquar Nasho Jorgaqi sjell një të dhënë me interes të veçantë, e cila tregon tërthorazi qëndrimin e SHBA. Ai bën fjalë për përpjekjet e delegacionit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, në Londër, si dhe të Nolit dhe shqiptarëve të tjerë mërgimtarë, të ndodhur atje apo që kishin marrë rrugën për këtë qëllim. Ata u interesuan të ndikonin në punimet e Konferencës së Ambasadorëve nëpërmjet mikut të tyre Çarls Krein. I njohur si specialist i çështjeve ballkanike, Krein e njihte nga afër realitetin shqiptar, sepse e kishte vizituar disa herë Shqipërinë.[24] Meqënëse kishte miqësi me Eduard Grei-n, kryetarin e Konferencës së Ambasadorëve, i mbërrinin vazhdimisht telegrame nga Noli dhe patriotë të tjerë shqiptarë. Ata i kërkonin ta përdorte miqësinë me E. Grein për të ndikuar në Konferencë për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare. Në përgjigje të tyre, Grei i tha Krein-it: "U thuaj shqiptarëve të mos harxhojnë aq shumë dollarë për telegrame, se ne e dimë që ato vende janë të Shqipërisë."[25] Megjithatë, Grei nuk bëri, nuk donte ose nuk mundi të bënte pothuajse asgjë për ato vende, që, siç thoshte, e dinte se ishin të Shqipërisë.

21 Citohet sipas **Armand Plaka, i cili thotë se artikulli është botuar në** New York Daily Tribune, 20 prill 1903.

22 Citohet sipas **Armand Plaka,** Amerikanët në 1904: Shqiptarët, miq dhe armiq të turqve! Gazeta Dita,March 11, 2019.

23 Shkrimi është botuar në të përditshmen amerikane "The Sun", i datës 28 korrik 1907 dhe është sjellë në shqip nga Armand Plaka, në revistën Klan, e merkure, 20 Qershor 2012, nën titullin: Dy qytetet e shenjta shqiptare.

24 Nasho Jorgaqi, Jeta e Fan S.Nolit, vëllimi i parë, 1882-1924, OMBRA GVG, Tiranë 2005, f. 277-278, si dhe Albert Bushnell Hart, Europe's "Autonomous Albania" Absurd, Says Hart; Gazeta New York Times, 19.10.1913.

25 Sipas Nasho Jorgaqi, vep.cit, f. 277-278.

Ngjarjet që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë u ndoqën jo pa kuriozitet në ShBA. Departamenti i Shtetit nuk mund të mos tregonte interes për shfaqjen e këtij subjekti të ri juridiko-ndërkombëtar në Ballkan. Ai mblidhte informacione për t'u njohur në thelb me zhvillimet konkrete në Shqipëri, perspektivën e tyre të mëtejshme, njerëzit që ndodheshin në krye të vendit etj. me qëllim që të procedonte ose jo me njohjen ndërkombëtare. Kishte jo pak burime që furnizonin me njoftime kancelerinë e Departamentit të Shtetit. Të tilla ishin njoftimet e shtypit amerikan dhe të huaj që pasqyronin ngjarjet në Shqipëri, raportet që dërgonin përfaqësuesit e shoqatave bamirëse amerikanë në Shqipëri, si dhe përfaqësuesit diplomatikë e konsullorë amerikanë në vendet fqinjë, agjentët e shërbimeve inteligjente etj.

Të parët që dhanë lajmet ishin organet e shtypit. Gazeta *New York Times*, e datës 28 nëntor 1912, shkruante se *Daily Telegraph* ka marrë një varg njoftimesh nga Durrësi, të cilat kanë kulmuar me lajmin se flamuri kombëtar shqiptar, i cili përbëhet nga një shqiponjë e zezë mbi një sfond të kuq, u ngrit dje mbasdite (të premten) pa ceremoni mbi ndërtesat qeveritare. Nëpunësit u bindën në mënyrë paqësore të pranonin regjimin e ri ose përndryshe do të flakeshin... Në port është hequr çdo flamur turk.[26] Gazeta tjetër *Los Angeles Times,* e datës 1 dhjetor 1912, shkruante se kishte lindur shteti më i ri i Europës, i quajtur Albania, e cila sapo u shkëput nga dominimi Osman duke u përpjekur të zinte vend në radhën e vendeve të civilizuara të botës.[27]

Shtypi jepte gjithashtu njoftime edhe për protagonistin e kësaj ngjarjeje, Ismail Qemalin, për të cilin vinin në dukje mbështetjen që kishte nga Austro-Hungaria. Bënin fjalë edhe për telegramet që ai, me cilësinë e kryeministrit të qeverisë shqiptare, iu kishte nisur qeverive austriake, franceze dhe italiane, duke iu kërkuar njohjen e shtetit të ri shqiptar dhe mbrojtjen e tij nga copëtimi.[28]

Janë me shumë interes dhe të argumentuara bukur pikëpamjet e shfaqura dhe qëndrimet që mbaheshin si reagim ndaj kësaj ngjarjeje. Duke i quajtur njohje të shtetit shqiptar veprimet, diskutimet dhe komunikimet e deriatëhershme të Fuqive të Mëdha, në kuadrin e Konferencës së Ambasadorëve dhe jashtë saj, ata theksonin me shumë të drejtë se njohjen e shtetit shqiptar e solli nevoja e ruajtjes së ekuilibrave të shteteve europiane. Më saktë këtë mendim e përçonte gazeta *New York Times*. Analiza e saj e botuar në numrin e 13 prillit 1913, spikaste për sensin e fortë realist dhe objektiv në trajtimin e faktorëve ndikues, qëllimet e tyre, rreziqet e përplasjeve etj. Për shkak se ky shkrim që vinte fare pak kohë pas ngjarjeve që përshkonin forumin diplomatik të Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe mjediset jashtë saj, kemi preferuar të citojmë disa prej ideve të tij. Autori thoshte se "Trajtimi i çështjes shqiptare nga Fuqitë e Mëdha i afrohet shumë traditës së vjetër të politikës europiane... Motivi i krijimit të një Shqipërie autonome është pikërisht i njëjtë me atë

26 Serbia abandons Albanians claims, në New York Times, 28 nëntor 1912. Citohet nga Valentina Duka,- Jehona tejatlantike e pavarësisë shqiptare: në gjurmë të komenteve të shtypit amerikan (1912-1914), në botimin Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX, Përmbledhje studimesh të Konferencës shkencore, kushtuar 95 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Tiranë 2008, f. 112-113.

27 Po aty.

28 Envoys will sign Armistice today, New York Times, 30 nëntor 1912. Citohet nga Valentina Duka,- vep.cit.

të copëtimit të Maqedonisë. Në të dy rastet qëllimi ka qenë bashkëjetesa e Europës dhe asgjë tjetër. Shqipëria është duke u bërë autonome jo sepse është e drejta e shqiptarëve për të qenë të lirë, por vetëm sepse shteti shqiptar i nevojitet Austrisë si kundërbalancë ndaj Serbisë..., Gjermanisë, sepse një Serbi e fuqishme do të paralizonte Austrinë, që ishte pjesëtare e Aleancës Tripalëshe; Italisë sepse ajo nuk mund të lejonte që Austria të gëzonte monopolin e mirëdashjes së shqiptarëve, si dhe Antantës sepse çdo qëndrim tjetër do t'i hapte telashe të pafundme për politikat e saj të jashtme dhe madje mund të çonte në luftë."[29]

Vëmendjes së shtypit amerikan nuk i shpëtoi as edhe çështja mjaft e mprehtë e caktimit të kufijve të shtetit shqiptar, për çka pati raportime, analiza e komente interesante.

VIDI KËRKON NJOHJEN NGA AMERIKA

Përçapja e parë nga pala shqiptare për njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur prej Uashingtonit u ndërmorr nga Princ Vidi. Komunikimi zyrtar daton në 8 maj 1914, kur ai, i caktuar në krye të shtetit shqiptar me vendimin e Konferencës së Ambasadorëve, i dërgoi nga Pallati i Durrësit presidentit amerikan Uillson, njoftimin për ardhjen e tij në fronin e Shqipërisë. Duke iu referuar "lidhjeve ekzistuese ndërmjet popullit shqiptar dhe kombit amerikan", siç shkruante ai, i kërkonte njohjen ndërkombëtare. "Interesi që keni treguar gjithmonë ndaj vendit tim, – shkruante Vidi, – më bën të shpresoj se do të më akordoni miqësinë tuaj dashamirëse për të forcuar pozitën ndërkombëtare të shtetit të ri, i cili është i destinuar të luajë një rol të rëndësishëm në ekuilibrin e Ballkanit". Vështruar në optikën juridiko-ndërkombëtare përmbajtja e komunikimit të Vidit ishte jo vetëm kërkesë për njohje, por edhe propozim për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe marrëdhenieve në fushat e tjera. Nuk kemi gjetur ndonjë të dhënë rreth qëndrimit amerikan ndaj propozimit shqiptar, por duket se shpërthimi i Luftës së Parë Botërore, largimi i Vidit nga Shqipëria dhe pezullimi i ekzistencës së shtetit shqiptar si subjekt i së drejtës ndërkombëtare gjatë Luftës, nuk i lanë kohë administratës amerikane për ta trajtuar.

Megjithatë, duket se Uashingtoni nuk qëndroi refraktar ndaj kësaj kërkese dhe në përgjithësi zhvillimeve në Shqipërinë e asaj kohe. Një muaj pas njoftimit të Vidit, Departamenti i Shtetit komunikoi me ministrin e vet fuqiplotë në Greqi, Xhorxh Fred Uilliams. Ai ishte i akreditуar në Greqi dhe në Mal të Zi, mbulonte edhe Shqipërinë, ishte gjithashtu vëzhgues i ShBA në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit në Durrës.[30] E porositi që të ndërmerrte një tur vizitash në Shqipëri e në Mal të Zi, në një kohë të përshtatshme, gjatë muajve qershor-korrik të atij viti.

Uilliams mbërriti në Shqipëri në dhjetëditshin e dytë të qershorit 1914, duke hyrë nga kufiri tokësor me Greqinë. Udhëtoi nga jugu në veri me kuaj, me qëllim

29 Now distuts "liberators", New York Times, 13 prill 1913. Citohet nga Valentina Duka, vep. cit. f. 113.

30 Ndriçim Kulla, Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: një historik gjithëpërfshirës, Plejad, Tiranë 2017, f. 84.

që ta njihte sa më mirë situatën në vend.[31] Në 18 qershor 1914 arriti në Durrës, ku u takua me autoritetet si dhe anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit.[32] Ato çka pa nëpër Shqipëri e shokuan dhe e tronditën. Në përfundim të vizitës njëjavore, i prekur dhe i ngarkuar me dhimbje të mëdha njerëzore nga skenat e rënda që pa, pas kthimit në Athinë, më 7 korrik 1914dërgoi në Uashington raportin dhe paraqiti menjëherë dorëheqjen nga posti diplomatic që mbante.[33] E motivoi me indinjatën ndaj qëndrimit mizor të Fuqive të Mëdha, sipas tij, shkaktare të kësaj gjëndjeje tepër të rëndë në Shqipëri. Ai kishte parë ngjarje të tmerrshme, të cilat, i shtoheshin therorive të Traktatit të Londrës, siç u shpreh vetë, në një konferencë shtypi që mbajti në Athinë, më 11 korrik 1914.[34]Prandaj lëshoi alarmin për mjerimin e papërshkrueshëm të shqiptarëve, shkaktuar nga genocidi, mizoritë, masakrat e ushtrive të fqinjëve dhe padrejtësitë ndaj tyre në periudhën e luftrave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Përjetimet e përftuara gjatë vizitave në Shqipëri i denoncoi fuqimisht dhe me kurajo në çdo tribunë politike e diplomatike dhe i hodhi në libërthin "Shqiptarët". Në faqen që inaguron fillimin e tij, gjendet një pjesë nga fjala që kishte mbajtur në mitingun e organizuar në Boston, më 7 nëntor 1915, në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar. Aty thuhet se "Vij si mik dhe adhuronjës i racës shqiptare. Dashuroj Shqipërinë... siç dashuroj Amerikën... E lashë Shqipërinë në vuajtje dhe të mbytur në gjak nga faji i Europës...Unë protestova kundër paudhësisë së Europës kundrejt Shqipërisë, lashë vendin tim zyrtar dhe ju siguroj se ajo ditë që unë protestova për Shqipërinë është dita më e lumtur e jetës sime... Unë jam gati për çdo shërbim për lirinë dhe shpëtimin e Shqipërisë edhe me jetën time."[35] "Shqiptarët nuk kërkojnë mëshirë, por drejtësi."[36]

Të dhënat e raportit të Xhorxh Fred Uilliamsit Departamenti i Shtetit nuk mund të mos i merrte në konsideratë, sepse raporti përshkohej nga tone realiste, të cilat e pikturonin vendin ashtu siç ishte, për fat të keq pa shtet, pa rend, pa rregull, me një situatë, konfuze, kaotike, ku mbizotëronin përplasjet, dhuna dhe ku nuk dukej asgjë premtuese në horizont. Kjo tablo e zymtë nuk linte aspak hapësirë për njohjen e Shqipërisë. Ajo kishte emrin shtet, por në krye ndodhej një "princ, i cili vetquhej mbret, pa fuqi, pa territor dhe pa shtetas, me përjashtim të gruas dhe fëmijëve të tij", siç shprehej Uilliamsi.[37]

Administrata amerikane u rezervua dhe e la në heshtje kërkesën e Vidit, në pritje të informacioneve të tjera në ardhmen që të tregonin nëse në vend kishin ndodhur ose jo ndryshime pozitive. Megjithatë ajo inkurajoi nismat e humanistëve, personaliteteve të politikës, kulturës dhe të shoqatave të ndryshme me karakter humanitar për të ndihmuar popullin shqiptar me ushqime, veshje, çadra, medikamente, vajguri etj

31 Po aty, f. 79.

32 Po aty.

33 Now distuts "liberators",New York Times, 13 prill 1913. Citohet nga Valentina Duka, vep.cit. f. 113.

34 Citohet sipas Valentina Duka, vep.cit.f. 117.

35 Shqiptarët, Xhorxh F. Williams, Argeta - LMG, Tiranë 2003, f. 4.

36 Po aty, f. 56.

37 Citohet sipas Valentina Duka, vep.cit. f. 117.

për të përballuar krizën e rëndë humanitare të shkaktuar nga luftrat e paprera që zhvilloheshin në territorin e tij. Midis tyre meritë të veçantë kishte *Albanian Relief Fund* (ARF), i krijuar në vitin 1913. Në drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tij u shquan Çarls Riçard Krein dhe Uilliam Houard.[38] I pari ishte edhe mik i ngushtë dhe njëkohësisht bashkëpuntor i besuar i Udrow Uillsonit. Kur ai mori postin e presidentit të ShBA Krein ishte këshilltar i tij.

ARF i drejtohej publikut amerikan duke i treguar se në brigjet e Adriatikut rreth 500 mijë njerëz, të zhveshur e të zbathur, të uritur, të paushqyer e të sëmurë janë duke vdekur.[39] Amerika bëri në Shqipëri atë që nuk e kishte bërë askush më parë. Ngriti në këmbë gjithë strukturat organizative të shoqërisë civile, grumbulloi ndihma humanitare dhe i erdhi në ndihmë popullit të raskapitur e të uritur shqiptar.[40]

Me princin do të ndodhte një histori kurioze. Atij iu gjend në krah një amerikan me origjinë britanike. Ishte Harold Sherud Spencer (Harold Sherwood Spencer), i cili do t'i ofronte atij shërbimet e veta si amerikan. Rrethanat e jetës së tij heraherë aventurore deri në skandale, e kishin hedhur në ato mote në Shqipëri. William W. Howard, bashkëpunëtor i filantropit të madh Josef Pulitzer, më 1914 ishte ngarkuar të drejtonte një Fondacion për të ndihmuar Shqipërinë. Në një nga raportet e tij, siç shkruan Edwin Jacques, Spencer përmendet shprehimisht.Aty lexohet: "Qinami, 5 kilometra larg Ersekës, u sulmua nga ushtarët grekë më 2 maj 1914. Të gjitha shtëpitë, përveç njërës, u shkatërruan me zjarr e dinamit. Ditën e tretë të majit një trupë e vogël vullnetarësh shqiptarë, e kryesuar nga Harold Sherud Spencer, një vullnetar amerikan në shtabin e Princ Vidit, rrethuan fshatin dhe u përleshën me forcat greke. Në fund të ditës së tretë të betejës, Spenseri me njerëzit e vet mundën të futeshin me forcë në fshat dhe i dëbuan trupat greke. Në të vetmen shtëpi, që ishte ende në këmbë, ai gjeti trupat lakuriq të pesë grave të reja, që ishin përdhunuar dhe mbytur nga ushtarët grekë. Një grua rreth të gjashtëdhjetave doli nga shtëpia në kohën që Spenseri po hynte brenda. Ajo i tha atij se grekët e kishin përdhunuar 27 herë! Gratë e reja kishin luftuar për të mbrojtur nderin, derisa më në fund i kishin mbytur. Pastaj ushtarët grekë kishin përdhunuar kufomat e tyre..."[41]

KONTRIBUTI I *VATRËS* DHE SHOQATAVE TË TJERA

Episode të shumta të zhvilluara në Shqipëri ose ShBA, madje edhe në shtete të tjerë dëshmojnë se amerikanët dhe shqiptarët do të ndërtonin dhe zhvillonin marrëdhënie reciproke në interes të të dy vendeve dhe do të kultivonin ndjenja miqësore, dashuri, respekt dhe vlerësim. Shtjellimi i kujdesshëm i tyre duke i vendosur në kontekstin e duhur kronologjik e tematik, nxjerrja në pah e ndikimit që kanë luajtur direkt ose në prapaskenë disa nga personazhet e spikatura politike

38 Ndriçim Kulla, vep.cit, f. 90-91.

39 National Archives of the USA, Washington D.C., Decimal File 1910-1939, 875 48/20. Citohet nga Ndriçim Kulla, vep, cit, f. 92.

40 Ndriçim Kulla, vep.cit, f. 93-94.

41 Edwin Jacques,- Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, Shtëpia botuese Kartë e Pendë, Tiranë 1996, Citohet sipas Ben Andoni,- Një 'pervers' amerikan në mbrojtje të Shqipërisë së Vidit, Revista Java, 21 mars 2012.

ose të shoqërisë civile nga të dy vendet, plotësojnë dhe sqarojnë rrjedhën e shumë ndodhive në këto marrëdhënie.

Shqiptarët e vendosur në ShBA, veçanërisht pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, jetonin me ankth të madh për fatet e atdheut dhe familjeve të tyre. Për organizimin e përpjekjeve rol të dorës së parë luajti Federata *Vatra*, e cila gjatë gjithë kohës ka kontribuar fuqimisht për të ndihmuar çështjen kombëtare të shqiptarëve. "Kolonia shqiptare në Shtetet e Bashkuara, thoshte Kostë Çekrezi në 1919, është shumë më interesante nga gjithë të tjerat, sepse pikërisht shqiptarët e Amerikës kanë dhënë kontributin më të madh për rritjen e nacionalizmit dhe të zhvillimit intelektual të vendit amë."[42]

Duket se *Vatra* kishte përcaktuar si orientim strategjik të politikës dhe veprimtarisë së saj edukimin e shqiptarëve me idetë, mentalitetin dhe kulturën amerikane të shtetformimit, zhvillimit ekonomik, politik, social e kulturor të Shqipërisë së ardhshme. Noli, një ndër drejtuesit e saj, shprehte bindjen se shumë shqiptarë që ishin detyruar të emigronin në Amerikë kishin dëshirë të ktheheshin në atdhe dhe të jepnin ndihmesën në zhvillimin e tij dhe, "me futjen e koncepteve amerikane të lirisë, ekonomisë dhe zhvillimit politik", ta futin Shqipërinë në rrugën e rilindjes ekonomike dhe kulturore. Institucionet arsimore amerikane, sipas mendimit të Nolit, do të ishin "shpëtim për Shqipërinë, duke patur parasysh se kultura anglosaksone i përshtatet më mirë shpirtit puritan të racës shqiptare".[43]

Janë të panumërta përpjekjet e *Vatrës*, klubeve dhe shoqatave të tjera të shqiptarëve në Amerikë si dhe të gazetave e revistave që ata publikonin, për sensibilizimin e qarqeve politike amerikane në dobi të çështjes shqiptare.[44] Përmendet ndërhyrja e saj në fundin e vitit 1917, kur doli në shesh përmbajtja e Traktatit të fshehtë të Londrës, të 26 prillit 1915. Fan Noli, me cilësinë e kryetarit të *Vatrës*, i dërgoi Sekretarit të Departamentit të Shtetit, R. Lansing, një telegram, ku denonconte Traktatin dhe i drejtohej Presidentit Uillson "të përdorte gjithë ndikimin e tij moral për të penguar copëtimin e Shqipërisë nga".[45] Në vazhdën e përpjekjeve të pareshtura gjatë viteve 1917-1918, përfaqësuesit e *Vatrës*, morën nga ish presidenti, T. Ruzvelt deklarimin se "Shqiptarët i dua dhe i admiroj se janë një racë e vjetër dhe trima që meritojnë të shpëtohen dhe të vetqeverisen... dhe se independenca e Shqipërisë duhet restauruar dhe garantuar nga fuqitë aleate."[46]

Në memorien e shqiptarëve ka mbetur i skalitur takimi i Fan Nolit me presidentin Uillson në 4 korrik 1918, në jahtin presidencial *Myflower*, në lumin Potomac. Ai u ndodh si delegat i *Vatrës* në kongresin e kombeve të shtypur. Noli, i cili e ka bërë të

42 Kostë Çekrezi,- Shqipëria: e shkuara dhe e tashmja, Shtëpia botuese Naimi, Tiranë, 2012, f. 266.

43 Mal Berisha,- Roli i federatës pan-shqiptare Vatra në mbrojtjen e kufijve dhe pavaresinë e Shqipërisë para dhe gjatë Konferencës së Paqes në Paris, Kumtesë në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit të daljes së gazetës Dielli, Nju Jork, 30 Tetor 1999.

44 Për Vatrën shih edhe Mal Berisha,- Roli i federatës pan-shqiptare Vatra në mbrojtjen e kufijve dhe pavaresinë e Shqipërisë para dhe gjatë Konferencës së Paqes në Paris, Kumtesë në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit të daljes së gazetës Dielli, Nju Jork, 30 Tetor 1999.

45 Nasho Jorgaqi,- vep. cit, f. 344-345.

46 Nasho Jorgaqi,- vep.cit, f. 353.

njohur ngjarjen, thotë ndër të tjera se i shpjegoi Presidentit situatën e rëndë në të cilën gjendej Shqipëria në fundin e Luftës së Parë Botërore dhe i kërkoi ndihmë për refuzimin e pretendimeve territoriale të fqinjëve në Konferencën e Paqes në Versajë. Kur Uillsoni i tha se çështja "është me të vërtetë shumë e koklavitur," ai ia ktheu se "e vetmja shpresë për shqiptarët është Amerika dhe ju, z. President."[47] Në vijim erdhi përgjigja e famshme, e njohur gjerësisht nga shqiptarët, e formuluar me shprehjen: "unë do të kem vetëm një zë në kongresin e paqes dhe atë zë do ta përdor dhe për të drejtat e Shqipërisë", çka e entusiazmoi tej mase Nolin, i cili i tha se "ai zë është i mjaftë për shqiptarët dhe ata do të jenë vdekërisht të gëzuar dhe fare të sigurtë për të drejtat e tyre."[48]

Shqiptarët u inkurajuan sidomos kur lexuan daklaratën e presidentit Uillson, botuar në *Paris Press*, 23 prill 1919, ku hidheshin poshtë pretendimet e Italisë ndaj Fiumes, si të bazuara thjesht në interesa dhe jo në parime. Ai thoshte se "jo vetëm që ju nuk do të keni tërë territoret shtesë që lakmoni, por unë kundërshtoj që t'ju jap edhe atë që ju është garantuar prej traktateve tuaja të fshehta. Unë refuzoj të pranoj se, meqë qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk ka qenë palë në këtë traktat, të ketë qenë në fakt edhe tërësisht e panjohur me ato që janë vendosur aty. Rrethanat e reja e kanë transformuar atë në një copë letër pa vlerë."[49] Ky deklarim u mor si ritheksim i parimeve të tij për mbrojtjen e të drejtave të popujve të vegjël (ku bënte pjesë edhe populli shqiptar), të nëpërkëmbura nga Fuqitë e Mëdha, nëpërmjet traktateve të fshehta.

Por ekzaltimi i shqiptarëve dhe veçanërisht i Nolit do të kthehej në zhgënjim, kur mori vesh se presidenti Uillson, për një varg arsyesh, nuk "e mbajti fjalën", sepse në diskutimet e para gjatë punimeve të Konferencës së Paqes, ra dakord që Italisë t'i jepej Vlora. Presidenti Uillson, tha Noli gjithë dhimbje, "provoi të jetë dëshpërimi i tërë botës."[50] Ai duhet "të çlirohet nga frika e traktateve sekrete". Dhe meqënëse tani shpresa e tij kishte mbetur te populli amerikan dhe te Senati, thoshte se është detyrë e Senatit që ta korigjojë atë.Përfundonte me shprehjen: "SOS-i i Shqipërisë janë ShBA."[51]

Fakti është që presidenti Uillson nuk e harroi Shqipërinë në Konferencën e Paqës. Ai dha porosi që konsulli amerikan i akredituar në Torino, Josef Haven, të bënte një vizitë në Shqipëri. Gjatë muajve shkurt-gusht 1919, konsulli përshkoi vendin nga jugu në veri. Sipas udhëzimeve të delegacionit amerikan në Paris, duhet të verifikonte nga afër realitetet, ndjenjat e vërteta të njerëzve rreth përkatësisë së tyre kombëtare etj. Fjala ishte sidomos për banorët e zonave pranë kufirit, për të cilët përfaqësues të shteteve fqinjë në forumet e Konferencës deklaronin se ata donin bashkimin me Greqinë, Serbinë ose Malin e Zi. Haven, përveç përshtypjeve shumë pozitive për vendin, për shqiptarët, për dashurinë e tyre për atdheun, dëshirën për

47 Nasho Jorgaqi,- vep. cit, f. 353.

48 Nasho Jorgaqi,- vep. cit, f. 353.

49 Mal Berisha,- vep. cit, f. 164.

50 Nasho Jorgaqi,- vep. cit, f. 380.

51 Nasho Jorgaqi,- vep. cit, f. 380.

progres ekonomik, social e kulturor, dalloi edhe falsitetin e propagandës së shteteve fqinjë, të cilët synonin që me dhunë, kërcënime, intimidime, mashtrime e falsifikime të manipulonin opinionin publik, veçanërisht protagonistët në Konferencën e Paqes.[52] Raportin e tij të gjatë ia përcolli delegacionit amerikan. Opinionet e tij objektive kthjelluan shumë të vërteta rreth Shqipërisë. Argumentet dhe faktet e sjella duhet të kenë ndikuar deri diku edhe në qëndrimin e presidentit Uillson dhe delegacionit amerikan për të kundërshtuar planin për copëtimin e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Traktatit të fshehtë të Londrës. Iu hap rruga ruajtjes së Shqipërisë së mbetur sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve dhe bllokimit të zbatimit të Traktatit të fshehtë të Londrës. Qarqet politike të shqiptarëve të etura për korigjimin e padrejtësive që i bëri Shqpërisë Konferenca e Ambasadorëve, kërkonin rikthimin e të gjitha trojeve brenda shtetit kombëtar, pa marrë në konsideratë faktin që Konferenca e Paqes ishte gjithë rreziqe e të papritura për zhdukjen edhe të asaj Shqipërie që la pas Londra e 1912-1913, për të kënaqur lakmitë e pafundme të fqinjëve.

Si jehonë e këtij qëndrimi të paqortueshëm, *Ylli i mëngjesit*, në një nga numrat e vitit 1920 shkruante: "Kuptohet që shqiptarët nuk u kënaqën, sepse me të drejtë prisnin që, duke u mbështetur në parimet e presidentit Uillson, në këtë konferencë do të fitonin bashkimin kombëtar duke marrë përbrenda kufijve të Shqipërisë Kosovën dhe Çamërinë dhe të siguronin përgjithnjë indipendencën e vendit të tyre".[53]

Qëndrimi i ShBA dhe Presidentit Uillson në Konferencën e Paqes, i parë në tërësi dhe i vendosur në kontekstin e të gjithë faktorëve që ndikonin në vendimmarrjet e mëdha të asaj kohe, në njëfarë kuptimi, e shpëtoi Shqipërinë. Nuk u zbatuan as Memorandumi i 9 dhjetorit 1919 as ai i 13-14 janarit 1920, që parashikonin ndarjen e saj midis fqinjëve. Prandaj Noli, që, me sa duket kishte reflekuar dhe e kishte kuptuar raportin midis dëshirave, mundësive dhe realiteteve, në fjalimin e mbajtur në parlamentin shqiptar, më 11 shkurt 1924, për të nderuar kujtimin e presidentit Uillson, solli ndërmend fjalët që ai i kishte thënë në vitin 1918 gjatë takimit në Malin Vernon. Me respektin që meritonte ky mik i madh i shqiptarëve tha se ai "e mbajti fjalën. Në janar 1920, një erë zie dhe dëshpërimi kish rënë më të gjitha anët e vendit tonë, i cili qe si i vdekur në agoni. Projektet e copëtimit të Shqipërisë redaktuar prej Aliatëve, ishin njohur dhe pritej vetëm një firmë që të bëhej një fakt definitiv. Firma që mungonte ishte ajo e Presidentit Wilson, firmë që nuk u vu në atë projekt aq të padrejtë. Presidenti Wilson, jo vetëm që nuk vuri firmën, por u përgjegj me dy nota, në të cilat mpronte të drejtën e Shqipërisë së vogël për vetqeverim, dy nota që janë dy nga xhevairët më të ndritshëm të karrierës së tij të shkëlqyer. Ato nota ndaluan copëtimin e Shqipërisë që gëzojmë sot."[54]Prof. Nasho Jorgaqi pohon se ai e quajti Uillsonin "amerikani i madh, idealist bujar, diell i vegjëlisë, mbrojtës i Shqipërisë". Sipas tij Amerika u bë për shqiptarët fushë pune, se një e katërta e Shqipërisë së jugut

52 Për vizitën e J. Haven flet me hollësi edhe Sejfi Vllamasi, Ballafaqime politike në Shqipëri: 1897-1942, Shtëpia botuese Nereida, Tiranë, 2000, f. 166-169.

53 Konferenca e Paqes dhe Shqipëria, në Ylli i mëngjesit, Viti 1920, f. 321-327.

54 Fan Noli, Vepra, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1996, vëllimi 6, f. 155.

ushqeheshin me kurbetin e Amerikës, po dhe shkollë, ku mësuan të respektojnë ligjet, disiplinën, vlerën e organizimit, detyrat ndaj atdheut.[55]Më saktë, më qartë, më mirë dhe më bukur nuk mund të përkufizohej kontributi i ShBA dhe presidentit të saj Uillson për shpëtimin e Shqipërisë në vitin 1920. Këtë e bënte një njeri i madh, siç ishte Fan Noli, që i ndodhur në role protagonisti në shumë nga zhvillimet politike shqiptare, dinte dhe vlerësonte me objektivitet gjithëçka kishte ndodhur. Madje, përpara të vërtetës, pati kurajon të bënte një "prapa-ktheu" nga deklarimi i tij katër vjet më parë. Ishte kjo arsyeja pse Noli, kur erdhi në krye të qeverisë shqiptare në 1924, më 21 gusht 1924, mori vendimin për t'i dhënë Shëngjinit emrin e Uillsonit.[56]

Lufta e Parë Botërore e ktheu Shqipërinë në *place d'armes* dhe e rrënoi edhe më keq. Mjerimi, uria, sëmundjet, vdekjet e përditshme po e shkretonin vendin. Sërish Amerika e largët iu gjend pranë shqiptarëve. Më 3 prill 1919, me kërkesën e qeverisë shqiptare, mbërriti në Shqipëri Kryqi i Kuq amerikan (KKA). Ekipi u vendos në Tiranë dhe ngriti zyra në Durrës, Shkodër dhe Elbasan, të cilat u pajisën me mjekë, infermiere, dentistë dhe personel tjetër ndihmës. Hapi spitale, dispanseri anti-TBC, kundër malaries, ndërmori nisma për edukimin e nënave me normat higjienike, mblodhi nga rruga fëmijë jetimë dhe i grumbulloi në qendra të veçanta, të cilat më vonë u kthyen në streha vorfnore shtetërore. U angazhua gjithashtu në arsimin shqiptar,[57] duke çelur së bashku me autoritetet shqiptare shkolla fillore që i pajisi me libra, fletore dhe mjete të tjera mësimi, si dhe u punësuan arsimtarë shqiptarë.[58]

Sensibilizimi i politikës dhe popullit amerikan për gjendjen e mjerueshme në Shqipëri kishte filluar herët, së paku që në verën e vitit 1914, kur trupat greke kishin plaçkitur dhe vrarë dhjetra njerëz në jug të vendit. Burime historike flasin për një përpjekje të fondacionit "Rokfeler" që të dërgonte njerëzit e tij në nëntor të vitit 1916, por pa sukses. Vetëm në fund të shkurtit 1919 u bë e mundur që njerëzit e KKA të fillonin veprimtarinë e tyre në Shqipëri.[59] Asistenca e tij ishte një rreze drite që vinte nga larg, por sillte ngrohtësi e shpresë për ditë më të mira. Tregonte së shqiptarët kishin fituar zemrat e amerikanëve, çka pasqyrohej edhe në artikuj të ndryshëm në shtypin amerikan të kohës. Ai vazhdonte të shkruante për Shqipërinë, për gjëndjen e saj dhe perspektivat e të ardhmes. Në një shkrim të titulluar "*Shqipëria, një komb i ri në një hotë të vjetër*", i publikuar në *Scribner's Magazine*, në vitin 1922, me rastin e 10 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, përshkruhet realiteti i një shteti-foshnje, siç e cilësonte autori. Tregoheshin problematikat me të cilat ndeshej si dhe ëndrrat e

55 Zani i Malsisë, January 8, 2018 - Comments Off on Prof. Dr. Nasho Jorgaqi tregon për rolin e Fan Nolit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.

56 Poaty.Noli, një ndër figurat qendrore të bashkësisë shqiptare të Amerikës, por edhe një ndër shqiptarët e mëdhenj, është përpjekur të kontribuonte maksimalisht për forcimin e marrëdhënieve shqiptaro-amerikane, të cilat pas Luftës së Dytë Botërore, deri nga fundi i viteve '90 të shekullit të kaluar, ishin tej mase të stresuara. Këtë e ka bërë nëpërmjet ndërhyrjeve në personalitete të larta të politikës, kulturës, artit, fesë etj të shoqërisë amerikane, deri edhe te disa prej presidentëve amerikanë siç ishin T. Ruzvelti, U. Uillsoni, F. Ruzvelti, H. Trumani, D. Ajzenhaueri e Xh. Kenedi, me të cilët ai ishte takuar ose kishte pasur lidhje.

57 Spiro Mëhilli,- Si dhe kur lindi shërbimi shëndetsor, Gazeta Telegraf 8 janar 2015

58 Ndihma e Kryqit të Kuq amerikan (KKA) në Shqipëri Nga Abedin Kaja, Revista e Kryqit të Kuq shqiptar, 2016|NR. 67, f. 7

59 Po aty.

popullit të tij për një jetë më të mire. Denoncoheshin makinacionet e fqinjëve për të kompromentuar zhvillimet normale dhe për të aneksuar pjesë nga territoret e tij.[60]

MANDATI AMERIKAN MBI SHQIPËRINË

Propaganda e madhe e bërë në Shqipëri, por edhe nga Federata *Vatra* në ShBA si dhe në gjithë mjediset shqiptare, brenda e jashtë Shqipërisë, kishte krijuar një mit për Amerikën dhe presidentin e asaj kohe. Rrjedhoje e kësaj klime ishte propozimi i avancuar në qarqe të caktuara për t'ia besuar ShBA të ardhmen e Shqipërisë. Më 9 janar të vitit 1920, pikërisht në ato ditë gjithë tension për çështjen shqiptare kur në Konferencën e Paqes në Paris, diskutohej për copëtimin e Shqipërisë, përfaqësues të parisë së Tiranës, gjykuan t'i transmetonin Uashingtonit, propozimin e dhënies Amerikës të mandatit për mbikqyrjen e Shqipërisë, mandat i cili në bazë të Traktatit të fshehtë të Londrës, 1915, i ishte caktuar Italisë. Për këtë arsye, në kërkim të rrugëdaljeve për shpëtimin e atdheut, ata morën takim me dy zyrtarë të Kryqit të Kuq amerikan në Tiranë dhe iu lutën që këtë kërkesë t'ia transmetonin qeverisë së tyre.[61]

Çështja e mandatit amerikan mbi Shqipërinë, e rikthyer në bisedimet e qarqeve politike shqiptare, në fundin e Luftës së Parë Botërore, mori përmasa serioze. Ajo tërhoqi edhe vëmendjen e presidentit Uillson, Departamentit të Shtetit dhe strukturave të tjera të administratës amerikane. Rezulton që të jetë diskutuar seriozisht, në detaje duke marrë në konsideratë gjithë faktorët influentë të brendshëm e ndërkombëtarë, ndikimin që mund të kishte në raportet e ShBA me aleatët e vet etj. Kishte mendime pro dhe kundër dhe secila palë paraqeste argumentet e veta. Deri afër kohës kur do të merrej vendimi në Konferencën e Paqes në Paris, alternoheshin herë varinati pro dhe herë ai kundër. Në prillin e vitit 1919 delegacioni shqiptar, në Konferencë i përcjell asaj një letër, të nënshkruar nga Mehmet Konica, Mihal Turtulli dhe Mithat Frashëri, në të cilën kundërshtohet mandati italian, i parashikuar nga Traktati i fshehtë i Londrës i 1915 dhe propozohej mandati amerikan. Në letër thuhej se vetëm Amerika disponon autoritetin e nevojshëm moral për realizimin e një mandati mbi Shqipërinë.[62] Memorandumi dërguar Konferencës, përgatitur kryesisht nga Mehmet Konica dhe amerikani Carls Telford Erikson, mbante titullin "Gjashtë arsye për të cilat Amerika duhet të bëhet mandatore ndaj Shqipërisë".[63] Midis tyre përmendej fjala vjen se Amerika duhet të bëhej mandatore e Shqipërisë sepse ajo hyri në luftë për synime morale dhe mandati mbështetej mbi parimin e mbrojtjes së popujve dhe kombeve të vegjël, që ishte shpallur nga Presidenti Uillson. Amerika me mandatin mbi Shqipërinë do të përmbushte një nga angazhimet e

60 Viola I. Paradise and Helen Campbell, - Albania – a new nation in an old world, Scribner´s Magazine, London, 1922, p. 566-580, Citohet nga Armand Plaka, - Kombi i ri i botës së vjetër, Revista Klan, e mërkurë, 20 Qershor 2012.

61 Ilir Ikonomi: 1920, kur paria e Tiranës i kërkonte amerikanëve të merrnin 'në dorë' Shqipërinë, Gazeta Shqiptarja.com,19 Prill 2018,

62 Haris Silajxhiç, Shqipëria dhe ShBA në arkivat e Uashingtonit, Dituria, Tiranë 1999, f. 93.

63 C.T.Erikson, Six Reasons Why America Should Became Mandatoty for Albania, Paris, May 1919, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep. cit, f. 91.

Konferencës për mbrojtjen e të drejtave të kombeve dhe për vendosjen e kufijve mbi baza etnike. Detyra e Amerikës është të mbetet në Europë që të ndihmojë në çlirimin e popullit shqiptar dhe t'i ndihmojë atij të ngrihet dhe "me bekimin e gjithë botës, të vendosë harmoninë dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në Ballkan."[64] "Detyra e Amerikës është që këtë "popull të varfër mes të varfërve" ta pranojë me një dashuri prindërore, sepse bëhet fjalë "për një racë të përcaktuar qartë, jashtëzakonisht të fortë dhe të bashkuar."[65]Në mbështetje të këtij propozimi Chares Telford Erikson tha në Senatin Amerikan më 2 shtator 1919 se: "Te shqiptarët gjen virtyte, të cilat do ishin të dëshirueshme për shumë popuj të përparuar. Propaganda sistematike i ka paraqitur ata si armiq të qytetërimit dhe plaçkitës, por kjo është një gënjeshtër... Ata janë inteligjentë, fisnikë, punëtorë, mikpritës... besnikë deri në vdekje. Të tillë popull kam njohur unë dhe jam krenar që sot po e përfaqësoj këtu"[66]

Ia vlen të përmendet edhe argumentimi që bën një nga përfaqësuesit e shqiptarëve të asaj kohe, Gjergj (Gaqo) Adhamidhi bej Frashëri, i prezantuar me disa ofiqe, si ish-përfaqësues diplomatik i Shqipërisë në Romë, delegat i Republikës së Korçës, Kryetar i Komitetit Kombëtar shqiptar dhe kryetar i shoqërisë "Bashkimi" në Egjipt dhe delegat i "Vatrës". Ai thoshte se "shqiptarët për nga natyra janë krenarë dhe të pavarur dhe etnikisht kanë rrënjë të përbashkëta me skocezët, prandaj kanë dëshirë të pranojnë t'i drejtojnë funksionarët anglezë dhe amerikanë, pasi janë të bindur në sinqeritetin e tyre, sepse e dinë që janë superiorë në raport me kombet e tjera dhe se amerikanët nuk kërkojnë të dominojnë."[67] Në favor të kësaj ideje lobonte edhe misionari Çarls Telford Erikson, si dhe Shoqëria Anglo-Amerikane, e themeluar para mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Ato iu drejtuan presidentit Uillson, për vendosjen e Shqipërisë nën mandatin amerikan.

Propozimi për mandatin amerikan kishte nisur në një formë tjetër, kërkohej për një periudhë 1-2 vjeçare, ndoshta edhe më gjatë, por për ato territore shqiptare, në jug e në veri që rivendikoheshin nga fqinjët. Në vijim ai u përvijua si një mandat i mirëfilltë, i diskutuar krahas mandatit zviceran, atij britanik dhe francez.[68]Ai italian përjashtohej nga shqiptarët për shkak të frikës së shndërrimit të tij në një mburojë juridiko-ndërkombëtare për aneksim. Në dokumentacionin e prodhuar në Departamentin e shtetit dhe në institucione të tjera, janë gjetur edhe skicë-ide konkrete se si mund të ishte ky mandat ndaj Shqipërisë,[69] por në fund të fundit, triumfoi mendimi që e kundërshtonte. Dëshira e shqiptarëve dhe njëfarë tundimi në ndonjë nga hallkat e administratës amerikane mbetën një utopi kurioze.

TEODOR RUZVELT KANDIDAT PËR MBRET I SHQIPTARËVE!

64 Po aty, f. 91.

65 Po aty, f. 92.

66 U.S.Senate, 66 Congress, I-st session, Hearing before the Committee on Foreign Relations, Sen, doc, no 106 Washington, 1919, f. 971-1011.

67 Po aty, f. 91.

68 Haris Silajxhiç, vep. cit, f. 93, 98.

69 Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 89-102.

Nuk ishte e para herë që shqiptarët i drejtonin sytë me shpresë për shpëtim te ShBA. Shtatë vjet më parë, kur Konferenca e Ambasadorëve vendosi që në krye të shtetit të pavarur shqiptar të caktohej një princ i huaj, midis kandidaturave që u përfolën ishte edhe ajo e ish presidentit amerikan ,Teodor Ruzvelt (Theodore Roosvelt).[70] Në komentet që bëheshin nga ata që e konsideronin të papërshtatshme kandidaturën e ish presidentit amerikan thuhej ndër të tjera se "shqiptarët duhet ta nisin me një njeri më të vogël dhe të jenë të gatshëm që ta lenë atë të rritet bashkë me vendin. Kolonel Ruzvelti është rritur në një komb prej 100 milionësh dhe është shumë i ndërgjegjshëm që të mos çmendet dhe të mos pranojë të tkurrë personalitetin e tij duke pranuar pushtetin mbretëror shqiptar."[71]

KËRKESË TJETËR PËR NJOHJE

Ndërkohë shqiptarët duke e ditur mirë peshën dhe potencialin e jashtëzakonshëm politik të ShBA në skenën botërore, nuk i reshtën përpjekjet për të tërhequr përkrahjen dhe mbështetjen e tyre. Në fillimin e vitit 1920 qeveria shqiptare kërkoi zyrtarisht njohjen e ShBA për pavarësinë e Shqipërisë, shtetit dhe qeverisë së saj.[72] Ajo u nis nga një episod i ndodhur në fundin e vitit 1919, shpallja e Memorandumit anglo-franko-amerikan të 9 dhjetorit 1919 për statusin dhe shtrirjen e Shqipërisë. Në tekstin e Memorandumit thuhej shprehimisht se Italia "merr mandat mbi *shtetin e pavarur shqiptar*."[73] Kjo ritheksohej edhe në një akt tjetër, ku shtetet e mësipërm përcaktonin kushtet e mandatit Italian mbi Shqipërinë dhe deklaronin se ShBA, Anglia dhe Franca dëshirojnë të nënvizojnë "*pavarësinë e Shqipërisë*". Edhe pse këta dy dokumente përfaqësonin akte të copëtimit të mëtejshëm të shtetit shqiptar të shpallur më 28 nëntor 1912 dhe të njohur në 29 korrik 1913, nga një pikëpamje strikte juridike, pranimi i "shtetit të pavarur shqiptar" dhe "pavarësisë së Shqipërisë", nëpërmjet fjalëve të shkruara shprehimisht në tekstin e tyre, përfaqësojnë një njohje të tërthortë nga të tre shtetet autore të Memorandumit.

Amerikanët do të avanconin edhe më tej, do të ndërmerrnin një hap praktik. Departamenti i Shtetit njohu me cilësinë e komisionerit në mënyrë gjysmëzyrtare Konstandin (Kostë) Çekrezin si përfaqësues të Shqipërisë, të cilën Amerika nuk e kishte njohur ende zyartarisht. Çekrezi, më 27.03.1920 kreu madje edhe ritin klasik të fillimit të detyrës si përfaqësues i shtetit shqiptar në ShBA, dorëzoi letrat kredenciale (!) që ishin nënshkruar nga kryeministri, Sulejman Delvina dhe ministri i Punëve të Jashtme, Mehmet Konica. Por, iu sugjerua që kontaktet do t'i mbante me Seksionin për Lindjen e Afërt në Departamentin e Shtetit, i cili ishte ngarkuar edhe me ndjekjen e çështjeve për Shqipërinë.[74] Ai hapi edhe përfaqësinë shqiptare në Uashington, e cila pas pak kohe u mbyll për aryse financiare. Më 14.04.1922, u hap

70 Valentina Duka,- vep. cit f. 115.

71 *King of Albania*, New York Times, 12 maj 1913, Citohet nga Valentina Duka, vep. cit., f. 116.

72 Haris Silajxhiç, vep. cit, f. 126.

73 Haris Silajxhiç, vep. cit, f. 127.

74 National Archives of the USA, Uashington D.C, Decimal File, 1910-1939 (në vijim N.A.) 87501B11/2.(Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.)

në Nju Jork nënkonsullata shqiptare, në krye të së cilës u vendos Konstandin (Koço) Tashko, me rangun e nënkonsullit.[75] Qëndrimi i administratës amerikane, i gjykuar nga pikëpaja juridiko-ndërkombëtare është disi i veçantë, përfaqëson një precedent në mos të panjohur, së paku tepër të rrallë, në praktikën ndërkombëtare.

Gjithë këto veprime, të interpretuara në optikën juridiko-ndërkombëtare mund të konsiderohen si njohje e shtetit dhe e qeverisë shqiptare. Por autoritetet amerikane duket se, pavarësisht se kishin pranuar kryerjen e procedurave të mësipërme, tregoheshin tej mase prudentë, që ato të mos identifikoheshin me njohjen ndërkombëtare të Shqipërisë nga ShBA. Justifikimi i përdorur ishte që edhe pse parimisht ishin "për ekzistencën e shtetit shqiptar", "nuk ishin ende të bindur për efikasitetin dhe stabilitetin e tij."[76] Kujdesi shkonte deri në ekstrem, sa që shmangeshin sistematikisht përpjekjet e Çekrezit për kontakte direkte me nivele përfaqësuese në Departamentin e Shtetit. Madje edhe shkresat e dërguara prej tij përcilleshin e merreshin në dorëzim në forma të tërthorta që atij të mos i krijohej përshtypja se po trajtohej si përfaqësues i një shteti të njohur ndërkombëtarisht.[77]

Autoritetet amerikane kishin përdorur këtë mënyrë veprimi edhe me përfaqësuesit e nja 20 shteteve të tjerë, të cilët endeshin nëpër mjediset sekondare qeveritare amerikane, me synimin për të tërhequr vëmendjen e Departamentit të Shtetit, me shpresë që një ditë të siguronin njohjen e vendit të tyre.[78] Bëhej shumë përpjekje nga zyrtarët e Uashingtoni që në raportet me këta "përfaqësues" të mos toleronin asnjë pakujdesi që mund të jepte përshtypjen se ishin njohur zyrtarisht dhe se kishin siguruar njohjen ndërkombëtare të shtetit të tyre. Zyrtarët e Departamentit i përsëritën Çekrezit se kishin nevojë të krijonin bindje për qëndrueshmërinë e shtetit shqiptar, seriozitetin, shtrirjen territoriale, efikasitetin e veprimtarisë së qeverisë dhe individëve që ishin në krye të vendit. Për këtë arsye kërkuan informacione plotësuese nga përfaqësitë e tyre diplomatike dhe konsullore në Athinë, Beograd, Romë, Trieste etj. Morën gjithashtu edhe informacionin e Komisionit hetimor të Lidhjes së Kombeve që ishte dërgur në Shqipëri.[79]

Ndërkaq, edhe pse Kostë Çekrezi vazhdonte të punonte dhe të kryente detyrën e përfaqësuesit të akredituar *sui generis* të Shqipërisë, Tirana kërkoi dhe mori përlqimin që me këtë mision të ngarkohej amerikani Charles Telford Erickson.[80] Ai mbërriti në Uashington për të marrë në dorëzim zyrën dhe detyrën, por u njoftua se në Shqipëri kishte patur ndryshime qeveritare. Ky zhvillim si dhe problemet financiare

75 N.A. 875.1b11/3, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.

76 N.A. 875,01/122, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.

77 N.A. 875.01/184 dhe 875.01/188, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 127.

78 Ilir Ikonomi, *Faik Konica - Jeta në Uashington*, Shtëpia botuese: *UET Press*, Tiranë 2017, f. 18.

79 N.A. 875.01/65; N.A. 875.01/77; N.A. *Raport on the Albanian situation, October-November, 1921*, by John F. Carter; N.A. 875.00/75; N.A. 875.01/212; N.A. 875.01/255; N.A. 875.01/ 191; N.A. 875.01/162a, 172a. , Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 128-129.

80 Ilir Ikonomi, *Faik Konica - Jeta në Uashington*, Shtëpia botuese: *UET Press*, Tiranë 2017, f.19. Ndërkaq Mal Berisha, duke iu referuar edhe burimeve arkivore shqiptare konstaton se Ericksoni nuk mori as pëlqimin e autoriteteve shqiptare. Vendimi nr. 1160, i 28 dhjetorit 1920, firmosur nga kryeministri Vrioni, përcakton se "U vendos qi Z.Erickson, me që nuk asht nënshtetas shqiptar e me qenë se nuk ka dekret prej Këshillës së Naltë, të mos njihet si përfaqësues i shtetit t'onë." Arkivi i MPJ, Dosja Nr. 4, Viti 1921, faqe 3.

krijuan paqartësi se kush realisht ishte "përfaqësuesi" i Shqipërisë në Uashington. Të dy punonin paralel, duke mos i kursyer akuzat ndaj njëri tjetrit për paaftësi dhe gabime në veprimtari. Edhe Departamenti i Shtetit, pa e njohur në mënyrë eksplicite qeverinë e Tiranës, vazhdonte komunikimet me Kostë Çekrezin, nëpërmjet të cilit merrte hera-herës informacionet që i lypseshin. Kur Konferenca e Ambasadorëve në Paris miratoi vendimin e 9 nëntorit 1921 për Shqipërinë ishte Çekrezi ai që njoftoi Departamentin e Shtetit se Anglia dhe Franca e njohën Shqipërinë.[81]

Dukej se gjithëçka shkonte në favor të njohjes, por Uashingtoni kësaj here nuk donte të ngutej, kishte ende çështje që donte t'i sqaronte deri në thellësi. Të tilla ishin paqartësitë dhe incidentet në kufijtë e Shqipërisë me fqinjët, statusi i të ashtuquajturës Republikë e Mirditës etj. Por në informacionet që mbërrinin në Uashington për Shqipërinë kishte edhe të dhëna me interes të posaçëm, siç ishin fjala vjen perspektivat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë mbështetur mbi pasuritë minerale që ishin zbuluar në vend, veçanërisht nafta dhe mineralet e tjera, ndër të cilat platini, siç iu thoshte Çekrezi amerikanëve, burimet ujore, pyjet etj.[82]

Por, qëndrimet reticente vazhdonin mbështetur kryesisht mbi pretekste të improvizuara, si problemet e brendshme shqiptare, ndërhyrjet dashakeqe të fqinjëve që përhapnin opinione negative për shqiptarët etj.[83] Në vazhdim interesimi i grupeve të fuqishme amerikane, veçanërisht atyre të industrisë së nxjerrjes dhe shfrytëzimit të naftës, siç ishin Sinkler Exploration Company- Sinkler, Standard Oil Company dhe të tjera[84] bëri që në Departamentin e Shtetit dosja e njohjes së Shqipërisë të shihej me tjetër sy. Në këtë atmosferë ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë, Fan Noli, më 28.01.1922, me anën e një letre drejtuar Departamentit të Shtetit, përsëriti kërkesën zyrtare për njohje.[85]

Çështja do të lëvizte pas vizitës që bëri në vend konsulli amerikan i Tanzherit, Makswell Bllejk, të cilin qeveria amerikane e caktoi njëkohësisht edhe si përfaqësuesin e saj në Shqipëri. Në realitetin shqiptar ai konstatoi elemente pozitivë në favor të njohjes. Në raportin e përcjellë në Uashington, krahas mundësive për bashkëpunim ekonomik me përfitime interesante, reshtonte edhe frymën e proamerikane të shqiptarëve, të cilët, siç shkruante ai, janë të bindur në desinteresimin e amerikanëve nga pikëpamja politike, si dhe në atë që kapitali amerikan mund të ndihmojë në zhvillimin e vendit.[86] Më 25 korrik 1922 Bllejkut i mbërriti njoftimi i shumëpritur nga Departamenti i Shtetit, në të cilin porositej që në datën 28 gusht 1922 duhet t'i dorëzonte Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë një notë me tekstin e përgatitur paraprakisht nga desk oficeri përkatës i Departamentit në Uashington. Argumentimi që përdorej ishte si vijon: qeveria e

81 N.A. 875.01/255, Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 129.

82 N.A. 875.01/189. Citohet nga Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 130.

83 N.A. 875.01/88,

84 N.A. 875.6363/11; N.A. 875.6363/22.

85 N.A. 875, *Letër e Fan Nolit drejtuar Departamentit të Shtetit, më 28.01.1922.*

86 Papers Relating to the Foreign Relations of the United States of America, 1915-1939, (Washington D.C.;Government Printing Office) – Papers, 1922, vol.I, f.603.

ShBA "e udhëhequr nga qëndrimi i suksessheëm i qeverisë kombëtare shqiptare" e njeh *de jure* qeverinë e Shqipërisë.[87]

MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE, 1922

Më 28 gusht 1922, pas shumë ngurrimesh, Shtetet e Bashkuara e njohën *de jure* Shqipërinë[88] dhe shpallën vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.Përfaqësuesi i parë i ShBA i akredituar në Tiranë ishte Ulysses Grant-Smith, i cili i paraqiti, letër kredencialet më 4 dhjetor 1922. Në vijim, deri në prillin e vitit 1939, u emëruan në postin e titullarit të përfaqësisë amerikane në Shqipëri edhe pesë të tjerë.[89] Në prill 1939, kur u bë e qartë se Italia po e pushtonte Shqipërinë, ambasadori i fundit amerikan i periudhës së paraluftës së Dytë Botërore Hugh Grant, i ofroi strehim Zogut dhe familjes së tij, ofertë që u refuzua.

Kandidatura e përzgjedhur për përfaqësuesin e parë diplomatik të Shqipërisë në ShBA, ishte ajo e Mithat Frashërit.[90] Por ai nuk i kapërceu dot të gjitha fazat që parashikonte e drejta diplomatike për t'u emëruar dhe për të dorëzuar letërkredencialet si i tillë. Shkak u bë Faik Konica, i cili nëpërmjet një letre drejtuar Departamentit të Shtetit ngrinte probleme ndaj personalitetit të Mithatit. Midis tyre ai përmendte faktin se atë nuk e kishin pranuar as Franca dhe as Italia, kur qeveria shqiptare e kishte propozuar për të njëjtin post disa kohë më parë.[91]

Përfundimisht Zogu, që ishte autoriteti kompetent kushtetues për të përzgjedhur kandidatin që do t'i propozohej qeverisë amerikane, vendosi që ai të ishte një nga ish armiqtë e tij të dikurshëm, Faik Konica, me të cilin kishte "shpallur armëpushim". Ai do të mbante rangun e ministrit fuqiplotë dhe i takoi privilegji që të themelonte legatën shqiptare në Uashington. Më 16 korrik 1926, sipas rregullave të protokollit dhe ceremonialit diplomatik, u prit në Departamentin e Shtetit, nga Frank Kellogg.[92] Po atë ditë i shkroi Ministrisë së Jashtme në Tiranë "sot u poqa zyrtarisht me

87 N.A. 875.01/233.a. Silajxhiç, f. 138.

88 Ilir Ikonomi, "*Faik Konica, Jeta në Uashington*", vep. cit. f. 20.

89 Presidenti Warren Harding, emëroi 22 shtator, 1922 si të Dërguar të Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Ulysses Grant Smith, i cili e nisi misionin diplomatik më 4 dhjetor 1922, me paraqitjen e letërkredencialeve. Përshtypjet e para të Smith për Shqipërinë dhe shqiptarët përmblidhen në pak rrjeshta, në të cilat lexohet ndër të tjera: "vend është shumë i varfër, njerëz të pashkolluar e të paushqyer, por çuditërisht përpara meje ndodhet kryeministri Fan Noli, i cili flet një anglishte harvardiane shumë më të mirë nga mua. Dhe unë ndjehem keq përpara tij". Me përfundimin e misionit të tij më 8 Shkurt 1925, u zëvendësua nga Charles C. Hart, i emëruar më 27 Maj, 1925, duke paraqitur letërkredencialet më 1 gusht, 1925, i riakredituar sërish kur Shqipëria u shpall mbretëri dhe paraqiti letërkredencialet e tjera më 13 dhjetor, 1928. Me mbarimin e misionit të tij u caktua më 17 shkurt, 1930, Herman Bernstein, që i paraqiti letërkredencialet më 28 Prill, 1930. Vendin e tij, pas largimit më 24 shtator, 1933, do ta zinte Post Wheeler, i emëruar më 26 gusht, 1933. Leterkredencialet i dorëzoi më 28 nëntor, 1933. Ai u largua më 1 nëntor, 1934, duke u zëvendësuar nga Hugh G. Grant, i emëruar më 9 gusht, 1935. Dorëzimin e letërkredencialeve e bëri më 8 nëntor, 1935. Përfundimi i Misionit të tij u imponua nga pushtimi fashist Italian i Shqipërisë, çka bëri që Legata amerikane në Tiranë të mbyllej zyrtarisht në 16 shtator, 1939 dhe Granti të largohej më 27 shtator, 1939. *Ambasada e SHBA në Shqipëri,- Ambasadorët Amerikanë në Shqipëri*. Faqja zyrtare e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri.

90 Uran Butka, *Gjeniu i Kombit*, Drier, Tiranë 2000, f. 221.

91 F.Konica to Secretary of State, letër pa datë, pranuar më 19 shtator 1922, National Archives at College Park, Maryland, në vijim NACP 701.7511/3, Citohet nga Ilir Ikonomi, "*Faik Konica, Jeta në Uashington*", vep. cit. f. 22.

92 Takimi është fiksuar në një foto, në të cilën Konica ka shkruar "Ja një foto e paharruar: Faik Konica (majtas) me Sekretarin amerikan të Shtetit, Frank Kellogg, 17 korrik 1926." - Citohet nga gazeta *Standard,* 3 September, 2017, - Foto e rrallë/ Zbardhet telegrami i Faik Konicës me sekretarin amerikan.

sekretarin e shtetit, domethënë Ministrin e P. Jashtme hon. F. B. Kellogg i cili më bëri një pritje kordiale. Qëndruam bashkë dhe për një fotografi. Presidenti Coolidge ndodhet larg me vakancë dhe kthehet në Washington pas pesë javësh..."[93] Më 8 tetor 1926, kur presidenti Calvin Coolidge ishte kthyer nga pushimet, Konica i paraqiti atij letrat kredenciale. Ceremonia dhe dorëzimi i tyre u bë në Dhomën Blu në formë ovale të Shtëpisë së Bardhë.[94] Ishte hapi i parë i mbërritjes zyrtare të Shqipërisë në ShBA. Ai finalizoi inagurimin e aktit të shumëpritur të shkëmbimit të përfaqësive diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe ShBA dhe njëkohësisht startin e historisë së përfaqësimit diplomatik të Shqipërisë në SHBA. Sipas protokollit diplomatik Konica mbajti një fjalë të shkurtër, ku, ndër të tjera vuri në dukje se "misioni im, që është forcimi i mëtejshëm i miqësisë mes kombit tuaj të madh dhe Shqipërisë, bëhet për mua një detyrë tërheqëse. Do të kujdesem për këtë mission me sa fuqi që kam, nën hijen dhe me dëshirën e mirë të qeverisë së Shkëlqesisë Tuaj."[95]

Gjatë shërbimit të tij në krye të legatës shqiptare në Uashington, publicisti, shkrimtari, kritiku Faik Konica, një nga mendjet e mëdha që ka nxjerrë Shqipëria, njëkohësisht përfaqësuesi i një vendi të vogël në një nga shtetet më të mëdhenj të globit, që tashmë ishte bërë kryeqendra e politikës dhe diplomacisë botërore, arriti të zinte një vend të respektuar. Një erudit i gjithanshëm, me kulturë të gjerë, me zhdërvjelltësi dhe elegancë të shprehuri, forcë të madhe argumentuese etj, shkëlqeu edhe në diplomaci. Konsiderohej si një ndër diplomatët më të shquar në kryeqytetin amerikan, i cili, siç shprehet një nga studiuesit e tij, Agron Alibali, hodhi gurët e themelit për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. Me ndikimin e tij Shqipëria dhe ShBA lidhën disa traktate shumë të rëndësishme.[96] Ai ishte ambasador i kulturës shqiptare, i cili nuk linte rast pa folur me admirim për vendin e vet, pak të njohur, për t'ia shpjeguar atë publikut amerikan.[97]

Gjatë shërbimit në ShBA, Konica arriti edhe një sukses që për çdo diplomat të rangut të tij do të ishte i lakmueshëm. Në vitin 1936, pas përpjekjesh të shumta mori miratimin e zyrës së presidentit amerikan Ruzvelt për ta ftuar mbretin e shqiptarëve, Ahmet Zogun, për të kryer një vizitë zyrtare në ShBA. Por, Zogu në çastin e fundit hoqi dorë dhe jo vetëm që humbi një rast që rrallë herë mund t'i jepet kryetarit të një shteti të vogël, siç ishte Shqipëria, të ishte i ftuari i presidentit të shtetit më të

93 Po aty.

94 Po aty.

95 *Z. Konitza çmon përkrahjen amerikane për indipendencën e Shqipërisë pas Luftës së Madhe*, Gazeta *Dielli*, 15 tetor 19126.

96 Disa nga marrëveshjet më të rëndësishme ishin: Marrëveshja për dhënien e klauzolës së kombit më të favorizuar në tregti, e negociuar midis Bllejkut dhe Xhaferr Ypit, gjatë qershorit 1922 dhe e nënshkruar po në qershor 1922 (Papers, 1923, Vol.I, f. 386, Siljxhiç, f.146); Marrëveshja për arbitrazhin, Marrëveshja për zgjidhjen e konflikteve (22.101928), të cilat u ratifikuan nga pala shqiptare më 27.12.1928, kurse nga pala amerikane, më 04.01.1929. Hynë në fuqi pas shkëmbimit të notave, më 12.02.1929. N.A. 875.00/ 273; Marrëveshja për natyralizimin, e cila u nënshkrua në Tiranë, më 21.01. 1931, ndryshuar dhe nënshkruar më 05.04.1932. Ajo u ratifikua nga pala amerikane më 13.3.1935 dhe nga pala shqiptare më 12.04.1935; Marrëveshja monetare" (1 Korrik 1933); Marrëveshja për ekstradimin, u nënshkrua më 1.03.1933. ShBA e ratifikoi më 21.02.1935, kurse Shqipëria më 20. 04. 1935 dhe hyri në fuqi pas shkëmbimit të notave, më 14.11.1935. (Shih Floreta Luli Faber,- *Marrëveshjet me Amerikën: Shqipëria, kombi më i favorizuar më 1922*, Revista,-*Monitor*, 29/03/2014.)

97 *Botohet "Faik Konica, dritëhijet e një diplomati"*, Intervistë e Agron Alibali, për VOA, 16 janar 2017. Për më gjerë mund të lexohet libri i autorit Agron Alibali, "Faik Konica, dritëhijet e një diplomati", Argeta LMG, Tiranë, 2016.

rëndësishëm të botës së asaj kohe, por rrezikoi të shkaktonte edhe një incident të rëndë diplomatik ndërmjet dy vendeve. Fatmirësisht nuk pati reagim të shprehur pakënaqësie nga pala amerikane.[98]

Edhe pse u vendosën marrëdhëniet diplomatike ndikimi i politikës amerikane në Shqipëri do të vazhdonte të ishte pothuajse periferik.

Megjithatë, disa nga amerikanët që shkelnin në Evropë gjatë e pas Luftës së Parë Botërore me misione të ndryshme, kanë hyrë edhe në Shqipëri për të ofruar ndihmë mjekësore, teknike e arsimore etj. Interesant është fakti që makina e parë me flamur amerikan në territorin shqiptar është dokumentuar në Drashovicë dhe Kotë, më 28 korrik 1920, gjatë Luftës së Vlorës, të vitit 1920 (4 qershor deri 3 shtator 1920).[99] Më pas shtetas amerikanë përmenden të angazhuar në fushën ekonomike, sociale, kulturore, arsimore etj. Në vitet 20-30-të u hapën disa shkolla amerikane. Në shtimin e marrëdhënieve ndikoi pozitivisht një marrëveshje e përfunduar midis përfaqësuesve të të dyja palëve, nëpërmjet të cilës Shqipëria dhe ShBA, i kishin akorduar reciprokisht, njëra tjetrës statusin e kombit më të favorizuar në tregti. Klima e krijuar prej saj iu hapi dyert e Shqipërisë dhjetëra biznesmenëve, sipërmarrësve, eksploruesve të nëntokës, shkencëtarëve të ekspeditave, themeluesve të shkollave, përfaqësuesve të kryqit të kuq amerikan etj.

Konkluzioni i përgjithshëm është se nuk u realizuan pritshmëritë optimiste amerikane në fushën e marrëdhënieve ekonomiko-tregtare, për marrjen e koncensioneve për shfrytëzimin e pasurive natyrore, minerale etj. Shkaku kishte të bënte me sa duket me faktin se një varg rrethanash politike, gjeostrategjike, historike etj. e kishin përcaktuar atë si domen të Italisë. Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të Parisit, i 9 nëntorit 1921, e kishte lënë atë gati nën varësinë e Italisë, çka do të sanksionohej në vijim edhe në dy akte juridiko-ndërkombëtare, në ato që njihen me emrin *Paktet e Tiranës*, të viteve 1926 dhe 1927, si dhe në një numër marreveshjesh koncensionare, huash, kredish etj. Shkaku lidhej gjithashtu edhe me politikat konkuruese angleze. Për interesat amerikane nuk qe e mundur të gjendej vend.[100]

QEVERIA E NOLIT, QERSHOR-DHJETOR 1924

Ndryshimi i rëndësishëm jo kushtetues që ndodhi në Shqipëri në fundin e pranverës së vitit 1924, që rrëzoi qeverinë e kryesuar nga A. Zogu dhe solli në krye të vendit Fan Nolin, u bë gjithashtu një pjesë tjetër e dosje së marrëdhënieve shqiptaro-amerikane. Ai tërhoqi vëmendjen e politikës dhe diplomacisë në Tiranë e Uashington. U parapri nga një ngjarje që traumatizoi specifikisht raportet ndërmjet dy vendeve, ishte fjala për vrasjen e dy shtetasve amerikanë në Mamuras në fillim të prillit 1924, ngjarje e cila, siç u shpreh ministri i ShBA, Grant-Smith "e hodhi Shqipërinë 1000

98 Ndriçim Kulla, - vep. cit, f. 167-170.

99 AQSH, Fondi i Fototekës AQSH, Dosja 400, Viti 1920.

100 Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 177.

vjet prapa në sytë e botës."[101] Koincidenca e shpërthimit të *Revolucionit të qershorit*, bëri që Amerika të sillte në Durrës dy destrojerë, të cilët u shndërruan në pretekst që të vinin të tillë edhe nga shtetet e tjerë, si Franca, Italia etj, çka acaroi situatën në Shqipëri. Më pas kur gjëndja u duk se u kthjellua dhe destrojerët u larguan, ministri amerikan Grant-Smith, mendoi se mund ta shfrytëzonte ndryshimin qeveritar në dobi të vendit të vet. Prandaj në fillim e vlerësoi pozitivisht ardhjen e Nolit në krye të qeverisë, duke njoftuar Departamentin e Shtetit se interesat e Amerikës gjenden në mbështetjen e një regjimi që është proamerikan dhe që i kundërvihet Anglisë.[102] Nën entusiazmin e këtyre përshtypjeve propozoi "njohjen e qeverisë së re sa më shpejt të jetë e mundur në përputhje me praktikën tonë."[103] Tre ditë përpara nisjes së propozimit të lartpërmendur, më 22 qershor 1924, në selinë e legatës amerikane kishte qenë për vizitë vetë kryeministri Noli, i cili i kishte lënë në dorë ambasadorit kërkesën për njohjen e qeverisë së tij.[104] Në legatë shkuan më pas edhe politikanë të tjerë, me shpresë se mund të ndikonin për marrjen e njohjes nga Uashingtoni. Përçapjet do të vazhdonin. Në korrik 1924, konsulli i Shqipërisë në Nju Jork, Abdul Sula, u interesua në Departamentin e Shtetit nëse qeveria amerikane ishte e gatshme të miratonte kërkesën e qeverisë shqiptare për të hapur legatën e Shqipërisë në Uashington. Precipitimi i shpejtë i ngjarjeve në Shqipëri bëri që edhe pse në krye të qeverisë ishte një proamerikan i deklaruar, ShBA të mbante qëndrime të rezervuara. Ndikuan me siguri edhe rezervat e shfaqura ndaj saj nga vende të tjera. Në përgjigjen që iu dha qeverisë shqiptare për kërkesën për njohje thuhej ndër të tjera se "Departamenti i Shtetit nuk dëshiron të deklarojë nëse në vendimin e njohjes apo të mosnjohjes së regjimit të ri ka ndikuar çështja e kushtetutshmërisë së tij".[105] E mbetur në një terren opinionesh të kundërta nga ana e diplomatëve amerikanë njohja nuk erdhi. Një pjesë e tyre, fjala vjen konsulli amerikan në Firence, Xhozef Hejvn (Josef Haven),[106] e shihnin pozitivisht qeverinë e Nolit, një pjesë tjetër, si i ngarkuari me punë Koding dhe të tjerë përreth tij, shfaqnin hapur rezerva, madje antipati, për shkak edhe të nismës së Nolit për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ish-Bashkimin Sovjetik.[107]

AMERIKA ME SELI DIPLOMATIKE NË TIRANË

Shqipëria u bë vendi ku Amerika pati legatën e saj të parë të ngritur jashtë shtetit. Ndërtimi filloi pas vitit 1927, kur Kongresi i ShBA vendosi që të mos lejonte që diplomatët amerikanë të jetonin në ndërtesa me qira me qëllim që të ruhej prestigji i Amerikës edhe në përfaqësimin e saj diplomatik jashtë vendit. Ministri amerikan në Shqipëri, Charles Hart, zgjodhi vendin ku do të niste ndërtimi i selisë dhe rezidencës

101 N.A. 875.00/148.

102 Papers, 1924, vol.I,f. 309. Citohet nga H. Silajxhiç, vep.cit. f. 155.

103 N.A. *Letër e ambasadorit amerikan Nr.222, datë 25.06.1924*. Sipas H. Silajxhiç, vep. Cit. f. 156.

104 Papers, 1924, vol. I, f. 311, Sipas H. Silajxhiç, f. 156 dhe N.A. 875.00/150, H. Silajxhiç, f. 156.

105 N.A. 875.00/157. Sipas H. Silajxhiç, f.157-158.

106 N.A. *Informacion i Xhozef Hejvn, i datës 4.10.1924*, Sipas H. Silajxhiç, f. 158

107 N.A. 875.01/253, Sipas H. Silaxhiç, f. 159.

në një zonë gati të shkretë, por piktoreske, në rrugën e Elbasanit, me sipërfaqe prej 15 mijë metrash katrore, nga ku dukej Mali i Dajtit dhe kodrat e Saukut.[108]

Kur ndërtimi mbaroi në vitin 1930 u shfaq një kompleks i bukur, më i madhi dhe më moderni i Tiranës, që ia kalonte edhe pallatit mbretëror. Mbreti Zog e ndihmoi Hartin duke ia dhënë tokën me një çmim prej gjysmë frangu ari për metër katror. E gjithë sipërfaqja kushtoi rreth 2 mijë dollarë. Vlera e përgjithshme e kompleksit arriti në 112 mijë dollarë, ose rreth 1.6 milionë dollarë me kursin e sotëm.[109] Me atë rast edhe gjithë zona përreth saj mori rëndësi të veçantë.

Përurimi u bë në "Ditën e Falenderimeve", më 27 nëntor 1930, me një banket dhe një ballo. Në ceremoni ishte i pranishëm vetë kryetari i shtetit, veshur me uniformë ushtarake. Ishte e para herë që ai vizitonte një legatë. Merrnin pjesë ministrat, personalitete të tjera si dhe diplomatët e huaj të akreditуar në Tiranë. Përurimi u kthye në një nga ngjarjet më të mëdha sociale në kryeqytetin shqiptar. Bernsteini, që kishte marrë tashmë drejtimin e legatës, mbajti një fjalim të shkurtër, ku ndër tëtjera vuri në dukje se ndërtimi i legatës fliste për besimin, simpatinë dhe interesimin e Amerikës ndaj pavarësisë së Shqipërisë. "Shumë pak dihet për Shqipërinë, tha ai, dhe për fat të keq, jashtë qarkullojnë plot informacione të shtrembëruara dhe jomiqësore."[110] Sipas traditës diplomatike, por edhe në zbatim të politikës amerikane të kohës, nuk harroi të fliste edhe për "udhëheqjen e mençur të Mbretit Zog, që i ka hapur rrugën zhvillimit dhe përparimit të vendit".[111] Pas tij e mori fjalën mbreti, i cili theksoi se "kënaqësinë time e shton fakti që kjo është e para legatë e ndërtuar jashtë vendit nga qeveria amerikane, e cila e ka treguar simpatinë dhe miqësinë ndaj popullit shqiptar në raste të ndryshme."[112] Dita pas inagurimit të legatës amerikane ishte 28 nëntori, festa e Pavarësisë së Shqipërisë. Me atë rast presidenti amerikan Herbert Hoover i dërgoi Mbretit, telegram me të cilin uronte popullin shqiptar për festën.[113]

Shqipëria nuk e kishte luksin që të blinte truall dhe të ndërtonte selinë e ambasadës së saj në Uashington. Megjithatë, ministri që kryesonte legatën shqiptare atje, Faik Konica, ishte vendosur në një apartament në hotelin *Mayflower* në Uashington. Aty kishte selinë dhe rezidencën, jetonte dhe punonte për kryerjen e detyrave si diplomat i vendit të vet. *Mayflower*konsiderohej si hoteli më luksoz i Amerikës së asaj kohe, njihej madje edhe si adresa e dytë më prestigjoze e kryeqytetit, pas Shtëpisë së Bardhë.[114]

Në vitin 1928 në Shqipëri ndryshoi forma e regjimit. A. Zogu nga president i republikës shqiptare u bë mbret i shqiptarëve, ngjarje kjo që shtroi edhe çështjen e rinjohjes ndërkombëtare. Në përgjithësi, me ndonjë përjashtim të vogël, pothuajse të

108 Ilir Ikonomi,- *Pushtimi, UETPress*, Tiranë, 2014, f. 10.

109 Ilir Ikonomi,- *Pushtimi*, vep. cit, f. 11.

110 Po aty.

111 Po aty.

112 Po aty.

113 Po aty.

114 Ilir Ikonomi, *Faik Konica - Jeta në Uashington*, vep. cit, f. 16.

gjithë shtetet e njohën Zogun si mbret. E njohu edhe ShBA. Pa u mbushur as dy javë, më 13 shtator 1928, mbërriti në Tiranë telegrami i Departamentit të Shtetit, ku thuhej se qeveria e ShBA kishte marrë parasysh ndryshimin e "formës së qeverisjes".[115] Po atë ditë presidenti amerikan Kulixh i uroi Zogut ardhjen në fronin e Mbretërisë shqiptare dhe, në emrin e popullit amerikan dhe në emrin e tij personal, i dëshiroi "shëndet të mirë", begati dhe lumturi popullit shqiptar.[116] Mbreti, në përgjigjen e vet fliste për "ndihmën humane të ShBA dhënë popullit shqiptar nëpërmjet Kryqit të Kuq Amerikan dhe mikpritjen zemërgjerë" që gëzojnë shqiptarët në Amerikë.[117] Njohja nga ana e Amerikës kishte rëndësi të veçantë për Zogun, për arsyet që tashmë dihen dhe që lidhen me rolin e veçantë që ajo kishte marrë në politikën botërore.

ALEATË NË LUFTË ARMIQ NË PAQE

Kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1939, kur si rezultat i pushtimit fashist italian të vendit (1939-1943) dhe atij nazist të Gjermanisë hitleriane (1943-1944) gjatë Luftës së Dytë Botërore, marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-amerikane, u *ndërprenë,*[118] term i përdorur saktësisht edhe nga pala amerikane.

Më 5 qershor 1939 Xhemil Dino, i instaluar nga italianët në postin e Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë së pushtuar, njoftoi Grant-in se Ministria e Punëve të Jashtme shqiptare ishte suprimuar, në përputhje me marrëveshjen e bërë me qeverinë italiane, e cila ia kishte kaluar këtë funksion Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë.[119] Për rrjedhojë Grant, pasi njoftoi Uashingtonin, u porosit që të mbyllte legatën amerikane nëTiranë. Shefi i Departamentit amerikan të Shtetit, Cordell Hull, njoftoi Faik Konicën se marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy vendeve ndërpriteshin. Vazhdoi ta njihte atë si përfaqësues të Shqipërisë në Uashington, deri më 24 qershor 1939. ShBA vendosi të mbyllte zyrtarisht më 16 shtator 1939 legatën e vet në Tiranë. Grant u largua më 27 shtator të vitit 1939.[120] Përfaqësitë zyrtare u mbyllën dhe personeli i tyre u tërhoq reciprokisht.[121]

Disa muaj më pas do të shpallej fillimi i Luftës së Dytë, Botërore, ku Shqipëria u gjend e përfshirë, si shteti i parë pas Etiopisë, i pushtuar nga një prej fuqive të boshtit fashist. Ajo filloi rezistencën e armatosur ndaj okupatorëve italianë dhe më pas nazistëve gjermanë, duke u bërë kështu pjesë e Koalicionit Antifashist të popujve. Uashingtoni nxiste popujt e shtypur të Europës, përfshirë edhe popullin shqiptar, që

115 Papers, 1928, Vol.I, f. 848. Citohet sipas H. Silajxhiç, f. 191.

116 Papers, 1928, Vol.I, f. 848. Citohet sipas H. Silajxhiç, f. 191.

117 Po aty, f. 849. Citohet sipas Silajxhiç, f. 191.

118 Sipas vlerësimeve të mëvonshme të Departamentit Amerikan të Shtetit, marrëdhëniet diplomatike të ShBA-së me Shqipërinë, më 7 prill 1939 nuk ishin *prerë*, por *ndërprerë,* në kuptimin që ishin pezulluar, për shkak të pushtimit.

119 Haris Silajxhiç, vep.cit. f. 217.

120 Ilir Ikonomi,- *Pushtimi*, vep. cit, f. 137.

121 Intervista e Faik Konicës, ministrit fuqiplotë të Shqipërisë në Uashington, dhënë Hilmar Baukhage, komentator i radios amerikane *NBC*, në apartamentin e tij në Hotelin *Mayflower* të Uashingtonit, më 8 prill 1939, një ditë pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia. Ai e quan agresionin e Italisë kundër Shqipërisë së pambrojtur "një thikë pas shpine". Citohet nga *Lapsi.al*, 07/04/2019.

të rrëmbenin armët kundër fashistëve italianë, më vonë kundër nazistëve gjermanë. Aleatët e Mëdhenj deklaronin se në mbarim të Luftës popujt e shtypur do të fitonin pavarësinë kombëtare. Këtë zotim presidenti i ShBA-së Franklin Ruzvelt (Roosvelt) dhe kryeministri britanik Uinston Çërçill (Winston Churchill) e shpallën me "Kartën e Atlantikut", nënshkruar më 14 gusht 1941, me të cilën u solidarizua edhe Bashkimi Sovjetik. Karta u bë frymëzim për Deklaratën e Kombeve të Bashkuara, nënshkruar më 1 janar 1942 nga ShBA-ja, Britania e Madhe dhe Bashkimi Sovjetik, e cila shërbeu për themelimin më 1945 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-ja).

U duk se lufta në frontin e përbashkët të Koalicionit Antifashist të Popujve, do të hapte horizonte të reja për marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, pas mbarimit të saj.

Aleatët në vitin 1942 e njohën luftën e shqiptarëve kundër fashizmit dhe si rrjedhojë në Shqipëri mbërritën misionet aleate amerikan, anglez e rus. Ata mbështetën sipas mundësive luftën e shqiptarëve. Anglezët kishin misionet më të shumta dhe dhanë kontribut më të madh. Amerikanët kishin caktuar shqiptaro-amerikanin Thomas Stefan si shef të misionit të tyre në Shqipëri.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri ranë dëshmorë njëmbëdhjetë amerikanë.[122]Fluturonin me një avion ushtarak amerikan, i cili u rrëzua në malet e Sheperit të Zagorisë. [123]

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, rifitimit të lirisë së humbur nga pushtimi dhe krijimit të një qeverie të pavarur, pritej të riaktivizoheshin marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve. Por qeveria shqiptare e ardhur në krye të vendit, nuk e mori njohjen ndërkombëtare as nga anglezët dhe as nga amerikanët. Asaj i krijoheshin vazhdimisht vështirësi për të qenë pjesëmarrëse në konferencat që u organizuan pas lufte dhe që do të çonin në themelimin e OKB. Udhëheqja komuniste e konsideroi veçanërisht lëndues faktin që në Konferencën e San Franciskos u thirrën vende të tilla si Haiti, Hondurasi, Kosta Rika, El Salvadori, Bolivia, Paraguaji, Meksiko etj, me një kontribut të papërfillshëm, në një kohë që Shqipëria kishte bërë shumë më tepër se ç'i takonte.[124]Ndonëse i plotësonte kushtet politike, ajo nuk u ftua të merrte pjesë në radhët e Kombeve të Bashkuara, pasi, siç u tha, nuk kishte një organizatë antifashiste shqiptare (qeveri apo komitet) që ta përfaqësonte në arenën ndërkombëtare.

Amerikanët, nëpërmjet një note që mbante datën 11 nëntor 1945, në të njëjtën kohë dhe pothuajse me të njëjtin qëndrim me Britaninë e Madhe dhe Bashkimin Sovjetik, i kthyen përgjigje kërkesës së kryeministrit shqiptar, Enver Hoxha, për njohjen e qeverisë së kryesuar prej tij. Tre Fuqitë e Mëdha aprovonin regjimin në Shqipëri. Shtetet e Bashkuara njoftuan zyrtarisht qeverinë e përkohshme të Shqipërisë për gatishmërinë mbi dhënien e njohjes sipas disa kushteve që iu njoftuan autoriteteve në Tiranë. Veprimi u mor pas konsultimeve me qeveritë e fuqive të mëdha aleate, në përgjigje të kërkesës së Shqipërisë.

122 AQFA, Fondi i Shtabit të Përgjithshëm, dosja 299, Viti 1945.

123 Po aty.

124 Peter Lucas,- *Misioni amerikan në Shqipëri, Operacionet secrete të Oss-it dhe bashkëpunimi me partizanët komunistë gjatë Luftës së dytë Botërore*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2007, f. 279.

Në njoftimin e departamentit të Shtetit thuhej se që prej pushtimit fashist të Shqipërisë në vitin 1939, qeveria e SHBA megjithëse nuk ka ruajtur lidhjet zyrtare me qeveritë shqiptare, ka shprehur vazhdimisht mbështetjen e saj për pavarësinë e vendit. Populli amerikan ka admiruar përpjekjen e gjatë e të guximshme të Shqipërisë për liri nga tirania e forcave të Aksit. Kjo përpjekje, e ndihmuar nga rritja e prezencës së forcave Aleate në vend, sollën mbylljen e suksesshme të përpjekjes në fund të 1944 me dëbimin e forcave pushtuese gjermane dhe krijimin e qeverisë së Tiranës që tashmë ushtron kontroll në të gjithë vendin.

Më 8 maj 1945 një mision informal amerikan i drejtuar nga Joseph E. Jacobs erdhi në Shqipëri për të studiuar kushtet dhe zhvillimet para dhënies së njohjes[125] dhe pas informacioneve të tyre dhe konsultimit me fuqitë e tjera aleate Shtetet e Bashkuara kanë vendosur sot që me anë të përfaqësuesit të tyre të komunikojnë qëndrimin e tyre. Në vijim ishte teksti i deklaratës së SHBA i formuluar si më poshtë:

"Pas marrjes në konsideratë të kërkesës së autoriteteve shqiptare qeveria e SHBA shprehet e gatshme të hyjë në marrëdhënie diplomatike dhe njeh regjimin aktual në Shqipëri si Qeveria e Përkohshme e Shqipërisë. Për vendosjen e marrëdhënieve zyrtare diplomatike qeveria e SHBA dëshiron të veprojë sipas detyrimeve dhe parimeve të Deklaratës së Krimesë për Evropën e Çliruar dhe sipas garancive se në vend do të mbahen zgjedhje të lira e të drejta, për të gjithë individët dhe grupet etnike, si dhe gazetarët e huaj të lejohen të hyjnë në Shqipëri për të ndjekur zgjedhjet dhe punën e parlamentit. Qeveria e SHBA dëshiron të konfirmojë gjithashtu se traktatet dhe marrëveshjet mes Shqipërisë dhe SHBA para pushtimit të 7 prillit 1939, mbeten të vlefshme. SHBA nga ana e saj e konfirmon vlefshmërinë e akordeve. Pas marrjes së sigurive të kërkuara SHBA është e gatshme të vijojë me këmbimin e diplomatëve zyrtarë. Pasi mbaronte njoftimi i qeverisë amerikane, Jacobs vazhdonte duke sqaruar "se propozimi aktual i SHBA nuk duhet të konsiderohet si paragjykues dhe jam i lumtur t'i kaloj qeverisë sime përgjigjen tuaj ndaj propozimeve të mësipërme."[126]

Por rrjedha e zhvillimeve në vijim nuk eci në favor të rifillimit tëlidhjeve miqësore, aq shumë të dëshiruara nga populli shqiptar dhe ai amerikan, por krejt në të kundërtën. Ato përshkuan një periudhë 45 vjeçare pa asnjë lloj marrëdhënieje. Ndikuan një varg faktorësh, ndër të cilët ishin edhe orientimi i udhëheqjes shqiptare drejt bllokut komunist dhe adoptimi prej saj i një politike vetizoluese nga Perendimi.

E çara e madhe që u krijua ndërmjet Shqipërisë dhe ShBA pas LDB pati si shkaqe formalisht të shprehura çështjen e vlefshmërisë juridike të traktateve ndërkombëtare të lidhura ndërmjet dy vendeve gjatë periudhës së sundimit zogist dhe kërkesën

125 Lidhur me këtë çështje Peter Lucas, thotë se "Xhejkobsi dhe Fulci mbërritën në Tiranë më 8 maj 1945, për t'u takuar me Hoxhën, tashmë shef i Republikës Popullore të Shqipërisë. Nëse qeveria e Shteteve të Bashkuara do të zgjaste lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, kjo kishte të bënte me plotësimin e dy kushteve nga shqiptarët. I pari lidhej me mbajtjen e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme në Shqipëri. Kushti i dytë ishte që Shqipëria të njihte vlefshmërinë e traktateve të nënshkruara midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë para prillit 1939. Kushti i zgjedhjeve të lira ishte një nga parimet e artikuluara nga Tre të Mëdhenjtë në Jaltë. Kushti i traktateve ishte një parim i Shteteve të Bashkuara që datonte nga fundi i shekullit të 18-të." Peter Lucas,- vep. cit, f. 302.

126 *Detajet, ja reagimi i DASH për situatën në Shqipëri pas çlirimit nga nazistët, kërkesë Enver Hoxhës për të zhvilluar zgjedhje demokratike*, Gazeta *SOT*: 06/10/2019

e zhvillimit të zgjedhjeve demokratike.Në fakt për të dyja palët ato ishin më tepër çështje parimi se sa çështje të karakterit juridik.SHBA insistonin për vlefshmërinë e traktateve për t'i bërë të qartë qeverisë shqiptare të pasluftës domosdoshmërinë e respektimit të parimit të rëndësishëm të detyrimeve juridiko-ndërkombëtare të pranuara nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, i fiksuar jo vetëm te parimi *pacta sunt servanda*, por edhe te parimi tjetër i suksedimit të angazhimeve juridiko-ndërkombëtare. Kurse qeveria shqiptare invokonte si pengesë vështirësinë e karakterit juridiko-kushtetues, që buronte nga vendimi i Kongresit të Përmetit. Ai stipulonte shprehimisht rishikimin e të gjitha marrëveshjeve që regjimi zogist kishte nënshkruar me shtetet e tjerë, anullimin e marrëveshjeve skllavëruese dhe zëvendësimin e tyre me të tjera, sipas parimit *rebus sic stantibus*. Qëllimi i këtij vendimi, siç thuhej në atë kohë, nuk drejtohej kundër SHBA, të cilën udhëheqja e LANÇ-it e konsideronte aleate, por kryesisht ndaj Italisë, e cila gjatë kohës së Zogut, me pushtimin faktik politik dhe ekonomik të vendit, i kishte imponuar atij edhe marrëveshje skllavëruese siç ishin psh dy paktet e Tiranës, marrëveshjet koncensionare, të huave etj. Kongresi i Përmetit shprehu parimisht vullnetin e hedhjes poshtë të këtij sistemi marrëveshjesh skllavëruese në tërësi me synimin rivendosjen juridike dhe garantimin e sovranitetit kombëtar. Në fakt marrëveshjet midis Shqipërisë dhe ShBA, siç u tha më sipër, trajtonin çështje në dobi të të dyja palëve dhe në njëfarë kuptimi nuk i cenonin interesat e Shqipërisë. Insistimi i të dyja palëve e shdërroi këtë çështje në një pengesë të pakapërcyeshme, në një *conditio sine quoi non* që hodhi në erë dëshirën reale të pakontestueshme të të dy popujve për marrëdhënie miqësore në të gjitha fushat.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për kushtin e dytë. Për ShBA zgjedhjet e lira dhe demokratike ishin dhe janë gur prove i karakterit të regjimit politik dhe i natyrës pluraliste të qeverisë. Ato parimisht nuk vendosin e nuk mbajnë marrëdhënie me shtete dhe qeveri diktatoriale, antidemokratike që ngrihen mbi politika që mohojnë liritë demokratike, ekonominë e tregut, ndarjen e pushteteve etj.

Kështu u prodhua situata e viteve 1945-1946 që çoi në ndërprerjen e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve dhe mosnjohjen ndërkombëtare të qeverisë shqiptare.

Nuk mund të mohohet se në periudhën e gjatë të ngricës së madhe politike, Uashingtoni ka dëshmuar interes dhe mbështetje për Shqipërinë dhe për shqiptarët, doemos jo për regjimin e asaj kohe. Edhe te shqiptarët mbeti e pashuar dashuria dhe respekti ndaj ShBA. Disa qindra, ndoshta mijëra vetë, kaluan ilegalisht kufirin për të mbërritur në tokën amerikane duke rrezikuar ose humbur jetën, shumë të tjerë përfunduan nëpër burgjet komuniste, për shkak të shprehjes së simpatisë ndaj SHBA.

Konkluzionin e saktë e ka nxjerrë studiuesi Ndriçim Kulla, i cili shprehet se "shqiptarët sfiduan antiamerikanizmin e Enver Hoxhës duke dëgjuar çdo ditë *Zërin e Amerikës*. Fakti që *Zëri i Amerikës* vazhdoi të transmetonte gjatë gjithë kohës së Luftës së Ftohtë në gjuhën e një vendi të vogël si Shqipëria, është tregues i bindjes së thellë që Amerika kishte se shqiptarët e izoluar do të mbeteshin proamerikanë, gjë

që u vërtetua plotësisht kur sekretari i shtetit Xhejms Bejker (James Baker) vizitoi Tiranën, në qershor 1991. Antiamerikanizmi në Shqipëri ka qenë vetëm ideologjik komunist, ose fetar ekstremist islamik dhe në të dy rastet i ka përkitur një pakice, e cila ka kërkuar ta imponojë me dhunë atë."[127]

Akti i zyrtarizimit të marrëdhënieve diplomatike erdhi më 15 mars, 1991, pas një ndërprerjeje prej 52 vjetësh dhe pas përfundimit të një odiseje gati dhjetëvjeçare negociatash me Britaninë e Madhe, e cila përfaqësonte edhe interesat e SHBA për çështjen e arit shqiptar. Ambasada e ShBA në Tiranë u hap më 1 tetor 1991, me diplomatin Kristofer Hill si i ngarkuar me punë a.i (ad interim), i pasuar nga ambasadori Uilliam Rajerson, i cili i paraqiti letër kredencialet më 21 dhjetor 1991. Edhe Shqipëria nuk vonoi në hapjen e ambasadës në ShBA. Pas nënshkrimit në Uashington, më 15 mars 1991, të Memorandumit të Mirëkuptimit për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Shqipërisë dhe ShBA, Tirana caktoi menjëherë dy diplomatët e parë, (Sazan Bejo dhe Ben Teta), të cilët fillimisht u sistemuan në Misionin e Përhershëm të Shqipërisë në OKB, në Nju Jork, deri sa u zhvendosën në Uashington, kur u gjet selia e ambasadës.[128] Rivendosja e marrëdhënieve në marsin e vitit 1991 dhe vizita e Bejker, i shtendosi përfundimisht raportet shqiptaro-amerikane, krijoi kushte për zhvillime të përshpejtuara, duke i siguruar Shqipërisë përkrahjen e superfuqisë më të madhe dhe më me peshë në jetën ndërkombëtare.

Të identifikuara si marrëdhënie me rëndësi stretegjike dhe me prioritet të veçantë në politikën e jashtme të Shqipërisë, ato kanë njohur progres të vazhdueshëm. Tirana, por edhe Uashingtoni, tregojnë kujdes maksimal për përparimin e tyre të pandalshëm.

Në të vërtetë sot shqiptarët në Shqipëri, Kosovë dhe kudo në Ballkan, në emigracion e në diasporë, janë një nga popujt më proamerikanë të globit. Në këndvështrimin e shqiptarëve ShBA është miku i madh i tyre, partneri kryesor strategjik, një ndër garancitë mbështetëse të zhvillimeve demokratike në vend.

ShBA e kanë bërë të qartë se miqësia midis dy vendeve shtohet me forcimin e demokracisë dhe institucioneve të shtetit, zbatimin e ligjeve, luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e ekonomisë së tregut, me bashkëpunimin e të gjitha forcave politike shqiptare, të cilat duhet të udhëhiqen nga interesat e vendit, nga qëllime të qarta, afat shkurtra dhe afatgjata kombëtare. Ato kanë theksuar se marrëdhëniet popullin shqiptar nuk kushtëzohen as nuk varen nga ndonjë politikan i përkohshëm, as nga ndonjë ideologji, as parti politike, por konsiderohen si marrëdhënie popull me popull, bazuar në disa vlera, parime dhe të drejta universale të njeriut, pa marrë parasysh se cili person ose cila parti udhëheq qeverinë shqiptare, në një kohë të caktuar.[129]

Mathew Palmer, i dërguar i posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin

127 Ndriçim Kulla, - vep.cit, f. 22.

128 *Genc Mlloja: Prapaskenat e rivendosjes së marrëdhënieve mes SHBA-së dhe Shqipërisë*, Altin Sinani, ALBDREAMS.NET, March 16, 2011

129 Marrëdhëniet Diplomatike Shqiptaro-Amerikane, Publikuar më 01.08.2019 nga Daniela Grrica, Frank Shkreli

Perëndimor, duke analizuar marrëdhëniet shqiptaro-amerikane në zhvillimet politike të fundit të vitit 2019, në Shqipëri, është shprehur në emër të qeverisë amerikane se "populli i Shqipërisë mund të mbështetet tek miqësia dhe partneriteti me Shtetet e Bashkuara. Aleatët tanë, partnerët tanë janë Shqipëria dhe populli shqiptar. Politika është politikë, por marrëdhënia midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë është e fortë dhe e qëndrueshme."[130]

Nuk mund të flitet për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane pa përmendur një falenderim dhe mirënjohje të thellë e të pafundme nga të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen, për ShBA, për kontributin themelor që ajo, krahas forcave të NATO-s dhe shteteve të tjerë, dha në çlirimin e Kosovës nga zgjedha serbe dhe për krijimin e shtetit të saj të pavarur. Meritë të veçantë patën presidentët amerikanë Bill Klinton e Xhorxh Bush si dhe sekretarja e shtetit Madlinë Ollbrajt, ambasadorët Riçard Hollbuk, Kris Hill, Uilliam Uoker dhe shumë personalitete të shquara amerikane, britanike etj. ShBA është dhe mbetet faktori kryesor dhe garanti i palëkundur i Kosovës së sotme, të çliruar e të pavarur.

BIBLIOGRAFIA

- Alibali, Agron - *Faik Konica, dritëhijet e një diplomati,* Argeta LMG, Tiranë, 2016.
- Andoni, Ben - *Një 'pervers' amerikan në mbrojtje të Shqipërisë së Vidit*, Revista *Java*, 21 mars 2012.
- Berisha, Mal - *Charles Telford Erickson, Një jetë e jashtëzakonshme kushtuar Shqipërisë*, Biografi, Botuar nga Edualba, Tiranë 2012.
- Berisha, Mal - *Roli i federatës pan-shqiptare Vatra në mbrojtjen e kufijve dhe pavaresinë e Shqipërisë para dhe gjatë Konferencës së Paqes në Paris*, Kumtesë në Simpoziumin e mbajtur për nder të 90 vjetorit të daljes së gazetës *Dielli,* Nju Jork, 30 Tetor 1999.
- Butka, Uran - *Gjeniu i Kombit*, Drier, Tiranë 2000.
- Carmichael,Virginia - *Mary Ball Washington* by Virginia Carmichael, Mary Washington Branch, Association for the Preservation of Virginia, Antiquities (1967).
- Comments Off on Prof. Dr. Nasho Jorgaqi tregon për rolin e Fan Nolit në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane. *Zani i Malsisë*, January 8, 2018.
- Çekrezi, Kostë - *Shqipëria: e shkuara dhe e tashmja*, Shtëpia botuese *Naimi*, Tiranë, 2012.
- *Çështja shqiptare*, Gazeta *The New York Times*, 30 maj 1880, cit nga Artan R.Hoxha, shkrim i cit.

130 *Palmer tregon ç'do bëjë SHBA për Shqipërinë dhe Kosovën*, Gazeta *Dita*, September 18, 2019.

- *Çështjet shtetërore jashtë,*- Gazeta *The New York Times*, , 26 dhjetor 1879, cit nga Artan R.Hoxha.
- Dako, Kristo - *Shqipëria çelësi kryesor i Lindjes së Afërme*, Shtëpia botuese *Arbëria*, Tiranë, 2003.
- Duka, Valentina - *Jehona tejatlantike e pavarësisë shqiptare: në gjurmë të komenteve të shtypit amerikan (1912-1914),* në botimin *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX, Përmbledhje studimesh të Konferencës shkencore, kushtuar 95 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë,* Tiranë 2008,
- *Dy qytetet e shenjta shqiptare - The Sun*, i datës 28 korrik 1907,sjellë në shqip nga Armand Plaka, në revistën *Klan*, e merkure, 20 Qershor 2012.
- *Envoys will sign Armistice today*, *New York Times*, 30 nëntor 1912.
- Erikson, C.T.- *Six Reasons Why America Should Became Mandatoty for Albania*, Paris, May 1919.
- *Fan Noli, Vepra*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1996, vëllimi 6.
- Greca, Dalip - *Çifti Amerikan Kennedy, tri dekada të dashuruar mes shqiptareve*, Gazeta *Dita*,- April 11, 2018.
- Grrica, Daniela & Frank Shkreli,- *Marrëdhëniet Diplomatike Shqiptaro-Amerikane*, Gazeta *Shekulli*, 01.08. 2019
- Hart, Albert Bushnell - *Europe's "Autonomous Albania" Absurd, Says Hart*; Gazeta *New York Times*, 19.10.1913.
- *Serbia abandons Albanians claims*, në *New York Times*, 28 nëntor 1912.
- *Ikonomi, Ilir - 1920, kur paria e Tiranës i kërkonte amerikanëve të merrnin 'në dorë' Shqipërinë*, Gazeta *Shqiptarja.com*,19 Prill 2018,
- Ikonomi, Ilir - *Faik Konica - Jeta në Uashington*, Shtëpia botuese: UET Press, Tiranë 2017.
- Ikonomi, Ilir - *Pushtimi*, UETPress, Tiranë, 2014.
- Jacques, Edwin - *Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, Shtëpia botuese Kartë e Pendë, Tiranë 1996,
- Jorgaqi, Nasho - *Jeta e Fan S.Nolit*, vëllimi i parë, 1882-1924, OMBRA GVG, Tiranë 2005,
- Kaja, Abedin - *Ndihma e Kryqit të Kuq amerikan (KKA) në Shqipëri* gazeta *Tema*
- *King of Albania*, New York Times, 12 maj 1913.
- Koçollari, Irakli -*1819 / Dy gazetarët amerikanë që intervistuan Ali Pashën*, *Java News*, 15/02/2016.

- *Konferenca e Paqes dhe Shqipëria*, në *Ylli i mëngjesit*, Viti 1920.
- Kulla, Ndriçim - *Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane: një historik gjithëpërfshirës*, Plejad, Tiranë 2017.
- *Lajme aktuale nga jashtë*, Gazeta *The New York Times*, 30 prill 1881, cit nga Artan R.Hoxha, shkrim i cit.
- **Armand Plaka, i cili thotë se artikulli është botuar në** *New York Daily Tribune*, 20 prill 1903.
- *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në faqet e The New York Times,* në *Studime Historike*, Nr.1-2/2012, f.227
- Longfellow, Henry Wadsworth - *Skanderbeg, Tales of a Wayside Inn*, Sudbury, Massachusetts, 1863, shqipëruar e botuar nga At Fan S. Noli, Libraria Populllore, Boston Mass. 1916
- Lucas, Peter - *Misioni amerikan në Shqipëri, Operacionet secrete të Oss-it dhe bashkëpunimi me partizanët komunistë gjatë Luftës së dytë Botërore*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2007.
- Luli Faber, Floreta - Marrëveshjet me Amerikën: Shqipëria, kombi më i favorizuar më 1922, Revista,- Monitor, 29/03/2014.)
- McCallum, John - Sipas *Reuters/ George Washington, shqiptari që krijoi Amerikën*, Citohet sipas *Prizrenpress,* 12/30/2019.
- Mëhilli, Spiro - *Si dhe kur lindi shërbimi shëndetsor*, Gazeta *Telegraf* 8 janar 2015
- *Mlloja, Genc - Prapaskenat e rivendosjes së marrëdhënieve mes SHBA-së dhe Shqipërisë*, Altin Sinani, ALBDREAMS.NET, March 16, 2011
- *Now distuts "liberators"*, *New York Times*, 13 prill 1913.
- *Palmer tregon ç'do bëjë SHBA për Shqipërinë dhe Kosovën*, Gazeta *Dita*, September 18, 2019.
- Paradise, Viola I. & Campbell, Helen - *Albania – a new nation in an old world*, *Scribner's Magazine*, London, 1922, Citohet nga Armand Plaka, - *Kombi i ri i hotës së vjetër*, Revista *Klan,* e mërkurë, 20 Qershor 2012.
- *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek.XX, Përmbledhje studimesh të Konferencës shkencore, kushtuar 95 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë,* Tiranë 2008.
- **Plaka, Armand** - *Amerikanët në 1904: Shqiptarët, miq dhe armiq të turqve*! Gazeta *Dita,* March 11, 2019.
- *Problemet shtetërore europiane* , Gazeta *The New York Times*, *13 korrik 1880*, cit nga Artan R.Hoxha

- Prodani, Viron - *Kontributi i emigranteve shqiptare ne ShBA, ne Luften e Pare dhe te Dyte Boterore, 2017*. Citohet nga gazeta *Dita*, 11, 12, 13 Janar, 2018.
- Silajxhiç, Haris - *Shqipëria dhe ShBA në arkivat e Uashingtonit*, Dituria, Tiranë 1999.
- Stickney, Edith Pierpont - *Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet Europiane Ndërkombëtare 1912-1913*, *Koha*, Tiranë, 1998.
- Tare, Auron - *Eduard Everet, një amerikan në oborrin e Ali Pashë Tepelenës*, *Gazeta Shqiptare*, 20/01/2012
- *Traktati i Shën Stefanit*, Gazeta *The New York Times*,7 prill 1878, Citohet nga Artan R.Hoxha,
- Vllamasi, Sejfi - *Ballafaqime politike në Shqipëri: 1897-1942*, Shtëpia botuese *Nereida*, Tiranë, 2000.
- Williams, Xhorxh F. - *Shqiptarët*, Argeta - LMG, Tiranë 2003.
- Woodward, Carl - gazetar, reporter amerikan.

GAZETA

- Gazeta *Dielli*, 15 tetor 1926.
- *Dita*, January 11, 2018, April 11, 2018, September 18, 2019.
- *Shekulli*, 01.08. 2019
- Gazeta *Shqiptarja.com*, 19 Prill 2018,
- *Gazeta Shqiptare*, 20/01/2012
- Gazeta *SOT*: 06/10/2019
- Gazeta *Standard,* 3 September, 2017,
- Gazeta *Telegraf* 8 janar 2015
- *The New York Times*, 7 prill 1878, 26 dhjetor 1879, 30 maj 1880, *13 korrik 1880,* 30 prill 1881, 28 nëntor 1912, 30 nëntor 1912, 13 prill 1913, 12 maj 1913, 19.10.1913.
- *The Sun*, i datës 28 korrik 1907.
- *New York Daily Tribune*, 20 prill 1903.

REVISTA ETJ.

- *Java*, 21 mars 2012.
- *Java News*, 15/02/2016
- Revista *Klan,* e mërkurë, 20 Qershor 2012
- Revista e Kryqit të Kuq shqiptar, 2016| NR. 67.
- Revista Monitor, 29/03/2014.
- *Ylli i mëngjesit*, Viti 1920.
- VOA, 16 janar 2017.
- *Zani i Malsisë*, January 8, 2018.
- ALBDREAMS.NET, March 16, 2011
- *Lapsi.al*, 07/04/2019.
- *Prizrenpress,* 12/30/2019.

FONDE ARKIVORE

- *Ambasada e SHBA në Shqipëri,- Ambasadorët Amerikanë në Shqipëri*. Faqja zyrtare e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri.
- Arkivi i MPJ, Dosja Nr. 4, Viti 1921.
- AQFA, Fondi i Shtabit të Përgjithshëm, dosja 299, Viti 1945.
- AQSH, Fondi i Fototekës AQSH, Dosja 400, Viti 1920.
- National Archives at College Park, Maryland, - NACP 701.7511/3,
- National Archives of the USA, Uashington D.C, Decimal File, 1910-1939 (në vijim N.A.) 87501B11/2.
- Papers Relating to the Foreign Relations of the United States of America, 1915-1939, (Washington D.C.;Government Printing Office) – Papers, 1922, vol.I.
- U.S.Senate, 66 Congress, I-st session, Hearing before the Committee on Foreign Relations, Sen, doc, no 106 Washington, 1919.

NDIKIMI I SHBA-ve DHE POLITIKAVE TË SAJ NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE MAQEDONINË E VERIUT PAS VITIT 2001

-Një vështrim i shkurtër i simpatisë/antipatisë së shqiptarëve ndaj SHBA-ve

Guximtar Rushani
International University of Struga
g.rushani@eust.edu.mk

Senada Laçka
International University of Struga

ABSTRACT

Political and diplomatic relations between Albania and the United States of America have always been at a high level, given the friendship between the two nations and the continued support and assistance that the United States has always shown to Albania and the Albanian people in the Western Balkans. The United States as a world power and one of the key factors of peace and stability in the world have given their contribution to the Albanian people in Kosovo in the late 90s, and this has significantly enhanced the American image in the eyes and hearts of Albanians, all over their lands or even to Albanians living outside their lands. However, after the events of 9, September 2001, a lot of things have changed in world geopolitics, wars between the United States and some Muslim states have begun, and the current political situation of the countries of near east (in countries with Muslim population) is not good at all. The relationship between the USA and other Muslim countries in Europe and the world (one of them Turkey) is not as they have the same coordination after Donald Trump's victory as US president, this is also a result of Erdogan's dominant policy and Turkey is witnessing the last decade. All this current state of geopolitics in the world, when one of the main factors of stability and peace in the world is surely the US, makes us reflect on whether the initial sympathy of Albanians towards the USA and the American people still exists, considering the fact that the majority of the Albanian population in the Western Balkans is exactly Muslim Albanian.

All these theses or antitheses whether there is a Turkish and Muslim lobby among the Albanian population in Albania, Kosovo, North Macedonia or other countries where Albanians live, or do we have a new idea or a new national conviction regarding the former "Platonic love" of Albanians towards the USA and the American people, or does the same sympathy for the American people and the USA in general continue? These questions that arise naturally are part of the discussions among ordinary citizens as well as in the tables of state or nongovernmental institutions with lobbying power in our region. So the discussion will continue, but it is up to us as a scientist to do the right analysis for a more coherent and serious answer.

KEYWORDS: Albania, Kosovo, North Macedonia, USA, policy, international relations

HYRJE

Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjithmon kanë qënë forca me e madhe politike, ushtarake, socio-ekonomike dhe kulturore në aspektin global. Ata ndër të tjerash janë edhe pjesë e rëndësishme e proceseve historike aq me shumë gjatë shekullit që lam pas. Kanë qënë faktor determinat në dy luftërat botërore (edhe si pjesëmarrës aktiv të tyre) duke qënë forca vendimtare për ndalimin dhe përfundimin e këtyre dy luftërave, ndërkohe kanë qënë edhe pjesëmarrës në shumë konflikte ushtarake pas luftës së dytë botërore. Luftërat në Vietnam, Afganistan, Irak etj., janë vetëm disa nga pjesëmarrjet aktive të SHBA-ve si forca më e madhe ushtarake në botë.

Megjithatë pikërisht për shkak të pjesëmarrjes së tyre në disa prej konfliketeve të dekadës së parë të shekullit XXI, SHBA-të u ndodhën përballë disa sfidave shumë të vështira që historia e Amerikës i ka njohur deri më atëherë. Pas sulmeve të avioacionit Japonez në ***Pearl Harbour*** (Havai) në mëngjesin e së dielës (07.12.1941) SHBA-të nuk njihnin sulme te reja të ngjashme , por u deshën që të kalonin rreth 50 vite që mëngjesin e së martës të datës 11.09.2001 Kullat binjake të ***World Trade Center*** të sulmoheshin nga dy aeroplan të cilët u përplasën në kullat që konsideroheshin si pjesë e krenarisë së New York-ut dhe të SHBA-ve. Sulmuesit ishin pjesëtar të Grupit terrorist ***"Al Qaida"*** , me këtë filloj një faqe e re e historisë bashkëkohore. SHBA-të nisën politikë ofanzive në lindjen e afërt dhe fushëbeteja të reja ndaj vendeve muslimane të cilët "mbanin" në territorin e tyre terroristët dhe pjesëtarët e organizatës "Al Qaida". Vrasja e Osama Bin Laden në 2 Maj të vitit 2011 dhe së fundmi vrasja e Abu Bakër Al-Baghdadi, (Liderit të shtetit Islamik) , bashkë me eliminimin e grupeve ushtarake të ndryshme islamike, janë disa nga sukseset e SHBA-ve në aspektin e eliminit të rrezikut potencial nga forcat terroriste bashkëkohore.

Megjithatë, e gjithë kjo sjell edhe ne viktima të panevojshme të qytetarëve

të pafajshëm dhe shkatërrime të panevojshme të pronave private apo edhe vendbanimeve muslimane në këto vende. Levizje nga njëri vend në tjetrin, refugjatë, kërkime për azil apo procese të ngjashme janë karakteristikat e çdo konflikti të armatosur, e me këtë krijohet edhe kaosi dhe mos menaxhimi dhe prishja e rendit juridik në këta shtete. Si rezultat edhe Muslimanët në mbarë botën kanë ndryshuar opinionin në raport me SHBA-të si edhe simpatia e popullatës mbarë botërore muslimane dhe jo muslimane ndaj SHBA-ve është ka marrë tatëpjetën duke shënuar një rënie drastike. Sipas një hulumtimi të realizuar në 37 shtete nga "PEW Institute", qëndrimet ndaj Amerikës shënojnë një rënie dramatike drejt negatives (te rreth gjysma rënie dyshifrore), në veçanti në Europën Perëndimore dhe në Amerikën Latine. Në Gjermani, për shembull, shkalla e antipatisë ndaj Amerikës është 62 %, në Spanjë 60%, në Holandë 59%, Greqi 53%. Mesatarja globale është 49%, që paraqet një rënie të konsiderueshme nga mesatarja 64 % në vitet pëfundimtare të presidencës së Obamës. Nga Obama te Trump-i simpatia ndaj SHBA-ve shënon rënie drastike (Meksikë – 36%, Spanjë – 28%, Holandë – 26%, Kanadë – 22%) (Wyke, et.al., 2017)[131]

Miqësia shqiptaro-amerikane ndërlidhet me Bostonin e fundit të shekullit XIX, me komunitetin e emigrantëve shqiptarë, kryesisht ortodoksë, rrjedhim i të cilit është edhe i diplomuari në Harvard, Fan S. Noli. Sipas Frida Ghittis, nga CNN, dashuria shqiptare për Amerikën, besimi i tyre në "demokracinë e madhe që shpërndan liri dhe demokraci në katër anët e botës" buron që nga presidenti Woodrow Wilson, i cili pas Luftës së Parë Botërore ka ngulmuar se shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër të Europës, një komb i vërtetë, kufijtë e të cilit duhet të ruhen. Pra, buron nga dyshimi tek "bushtra Europë" ose antieuropianizmi, ngase "Fuqitë e Mëdha, Britania, Franca dhe Italia, kishin dashur ta copëtonin Shqipërinë, këtë vend të vogël, të varfër dhe të pambrojtur, në favor të fqinjëve si shpërblim për luftimin dhe mundjen e koalicionit gjerman/austriak". Në periudhën e komunizmit relacioni i shqiptarëve me "tokën e ëndrrave" shpërfaq lobin shqiptar në Amerikë, që ka luajtur një rol të veçantë në mbështetjen e Kosovës në rrugën me ferra, së pari të qëndrimit në këmbë dhe, më pas, drejt pavarësisë. Ky lob i ka mbajtur gjallë shpresat se dhuna serbe do të përfundojë dhe se do të vijnë ditë më të mira se ato të pas vitit 1980-të, rrugë kjo që u kurorëzua me ndërmarrjen e "presidentit legjendar", mikut shqiptar Bill Clinton, i cili nisi bombardimin e caqeve ushtarake serbe dhe *de facto*, bashkë me faktorin politik vendas dhe UÇK-në, solli pavarësinë. Në Shqipëri, në vitin 1991, 300 mijë shqiptarë në një zë brohorisnin "USA, USA". Ndërkohë, pas rënies së komunizmit shqiptarët i janë falënderues George W. Bush-it, të cilin S. Berisha e ka quajtur "miku më i madh dhe më i veçantë që shqiptarët kanë pasur", trasues i rrugës për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. Kryeministri aktual Rama para do kohe pati pohuar se Shqipëria është një nga vendet më proamerikane në Europë, madje edhe në botë!" (Vendet më proamerikane: Izraeli 84%, Koreja e Jugut 82%, Kenia 80%)... Rruga Wilson, shtatorja e Clinton-it, grafitti në stadium:

131 Ali Pajaziti- Shqiptarët dhe Amerika:Dashuri Platonike apo Utilitarizëm. https://shenja.tv/shqiptaret-dhe-amerika-dashuri-platonike-apo-utilitarizem/

"Obama... I love you!" dhe shumë pika urbane me ngjyrime amerikane gjithandej trojeve shqiptare. Dhe, kulmi, gazeta *Korrieri*, duke aluduar në SHBA-të publikoi një titull sarkastik: "Ju lusim na okuponi!"[132]

Megjithatë edhepse shqiptarët janë komb me shumicë muslimane, në raport me gjendjen aktuale botërore respektivisht atmosfera e islamoffobisë globale që është një trend në rritje kohëve të fundit, të bën të mendosh se a ka ndër shqiptarët amerikanofobi ose antiamerikanizëm?! Nga ana tjetër kemi një frymë të re që vjen nga shteti me i madh musliman në Europë - Turqia. Erdogani dhe rryma erdoganiste që ka krijuar gjatë viteve të fundit , ka bërë që tek një pjesë e madhe si e popullatës turke ashtu edhe tek turqit në Europë apo me gjërë, respektivisht tek muslimanët e tjerë në Europë e gjetiu, e në veçanti tek Shqiptarët musliman të krijoj një simpati dhe të lindi një frymë e re potenciale që na bën të mendojmë se mbase aleati më i mirë dhe më i madh i shqiptarëve mbase nuk janë SHBA-të , por është pikërisht Turqia.

Është e vërtetë se antiamerikanizëm ndër shqiptarë ka, por e tëra është një ishull i vogël, ndërsa perceptimi gjeneral është proamerikan, gjë që edhe etikisht është e pritur duke e marrë parasysh politikën amerikane në favor të shqiptarisë, në veçanti të dekadave të fundit. Pa Amerikën ose me një Amerikë të dobët konteksti shqiptar me siguri se do të ishte shumë më i ndryshëm. Edhe Shqipëria, edhe Maqedonia (shqiptare), por në veçanti Kosova, do të ishin nën një konstelacion tjetër të ekzistimit politik, ekonomik dhe kulturor. Andaj, nuk është humane që e mira të harrohet. Ajo duhet të bëhet pjesë e kujtesës kombëtare, pa marrë parasysh tezën për pragmatizmin klasik amerikan. (Henry Kissingeri një herë ka thënë: "Amerika *nuk* ka *miq* dhe armiq *të përhershëm*, *por* vetëm *interesa të përhershme*".) Me një shënim, proamerikanizmi nuk duhet të shndërrohet në psikologji të skllavit. Është mirë kur në një lidhje ose transaksion të dyja palët janë të kënaqura. Relacionet shqiptare janë edhe pragmatiste edhe utilitariste. Në politikë, edhe në atë vendore edhe në atë ndërkombëtare, interesat janë determinante.[133]

1. ISLAMI DHE IDENTITETI KOMBËTAR TEK SHQIPTARËT NË BALLKANIN PERËNDIMOR-

PARAQITJA E VEHABISTËVE

Shqiptarët janë një ndër popujt e rrallë që edhe pse kanë gjuhën, traditat, zakonet dhe foklorin e përbashkët , ndërkohë na karakterizon edhe fakti se ne shqiptarët jemi komb me katër bashkësi fetare (muslimanë, muslimanë bektashi, katolikë dhe ortodoksë).

Megjithatë pas viteve 2000 në vendet e banuara me shqiptarë (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni), paraqiten aktorë të ri fetar islam, të cilët marrin epitetin "vehabistë" e me

132 Ali Pajaziti- Shqiptarët dhe Amerika:Dashuri Platonike apo Utilitarizë. https://shenja.tv/shqiptaret-dhe-amerika-dashuri-platonike-apo-utilitarizem/

133 Ali Pajaziti- Shqiptarët dhe Amerika:Dashuri Platonike apo Utilitarizëm. https://shenja.tv/shqiptaret-dhe-amerika-dashuri-platonike-apo-utilitarizem/

këtë kemi paraqitjen e rrymave neosafiste në vendbanimet shqiptare në Ballkanin Perëndimor. Dukuria e tyre është e pazakonshme për rajonin dhe karakterizohet me mjekra të gjata ose pantallona tre çerek.

Gjithashtu ata dallohen edhe sipas mënyrës së prakticizmit të lutjeve, të cilat kryhen sipas ritualeve të ndryshme nga ato të zakonshmet të besimtarëve tradicional. Përveç kësaj, fitojnë sjellje të vetmitarëve, funksionojnë në rreth të mbyllur dhe veçanërisht solidarizohen mes vete. Karakteristikë që habit për ata është fakti se këta aktorë mbajnë fjalime ku predikojnë prakticizmin e islamit jotolerant.

Këto fjalime janë pak të pazakonshme për rajonin, pasi që predikojnë prakticizmin e rreptë të një islami, i cili është pastruar nga tradita lokale. Këta aktorë fetar i takojnë kategorisë neosalafistë të tipit të devotshëm të cilët i përshkruam në hyrjen e tekstit. Ata përhapin version të shtrembëruar për shoqërinë dhe nxisin kuptimin të fjalëpërfjalshme të Kuranit.[134]

Me këtë nënkuptojmë që një rrymë e re e fesë islame është aktivizuar dhe kjo nuk ka ndodhur rastësisht. Që të ndodhi një Reaksion është dashur që të ketë nj aksion, e kjo rrymë është dëshmia më e mirë.

Natyrisht që qytetarët janë ata të cilët vihen në vështirësi më të mëdha, nga vet fakti që kjo rrymë e re nxit edhe pakënaqësitë tek qytetarët shqiptar pamarr parasysh se kujt religjioni i takon, për shkak të imponimit të ri të besimit apo predikimit fetar që ata imponojnë nëpër xhamitë, bisedat apo mënyrën se si ata transmetojnë bindjet e tyre lidhur me fenë, problemet socialo-ekonomike apo kulturore. E që nuk diskutohet që SHBA-të janë një ndër fajtorët më të mëdhenjë për situatën gjeopolitike botërore tek kjp rryma e re neosafiste tek shqiptarët.

Tre vëllezërit Duka nga Dibra (që jetojnë në SHBA) u dënuan për përpjekjen e tyre për të organizuar akte terroriste në SHBA. Ata së bashku me me dy shtetas të tjerë (njëri jordanez , e tjetri Turk) u dënuan nga gjykata amerikane.

Më parë në Bosnjë e Kosovë, e tani në Maqedoni e Shqipëri, një numër në rritje myslimanësh po paguhet në mënyrë informale me shuma që shkojnë nga 50-200 euro në muaj për ushtrimin e besimit në formën që përcaktohet nga disa parime si ai i lartpërmenduri. Pjesa më e madhe e besimtarëve që marrin këto pagesa "nën dorë" i përket shtresave të varfra: njerëz të papunë, me probleme personale dhe familjare të pazgjidhura. Në mes njëri-tjetrit ata thirren vëllezër dhe përgjithësisht janë tipa të pakomunikueshëm, periferikë dhe me formim të mangët, kryesisht vetëm me arsimin bazë.

Thuajse të gjithë kanë hequr dorë nga emrat që u kanë vënë prindërit dhe janë vetëquajtur me emra tipikë myslimanë, kryesisht të pjesëtarëve të familjes, apo të miqve të profetit. Në KMSH nuk besohet, por "ata paguhen për me ndejtë tanë ditën në xhami", thotë një teolog në veri të vendit, duke iu referuar papunësisë, e gjithashtu edhe shpërfilljes që ky kontingjent besimtarësh ka për ummetin, apo për krejt shoqërinë. Nëpërmjet lëvizjeve, kryesisht në muzg ose para agimit, këta

134 Islami dhe Politika në Ballkanin Perëndimor (Mes nacionalizmit laik dhe instrumenalizmit të institucioneve fetare islame)fq. 25 - Bashkim Iseni

besimtarë shpeshherë e kalojnë kufirin politik, duke realizuar me vëllezërit e tyre në anën tjetër takime, qëllimi i të cilave mbetet mister, në mos për të shkëmbyer libra fetarë. Në shumë qytete shqiptare, por sidomos në Tetovë, Shkodër, Prizren, por edhe në Tiranë, Elbasan etj., kanë shkaktuar probleme të rënda sociale, ndarje brenda familjeve që nuk kanë rënë dakord me praktikat e reja të besimit, dhunime prone apo personi familjar, por edhe dhunime të organizuara ndaj personave ose objekteve të kultit.

Raste si ai i rrahjes së imamit të një xhamie tradicionaliste në Shkodër, përpjekja për dhunimin e varrezave të vjetra në një qytet në Kosovë etj., nuk janë të vetmet. (Të shumtë ishin edhe misionarët bamirës e fetarë të rimartuar gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri me vajza të zgjedhura, të cilat me fëmijë apo shtatzëna i braktisën kur u kthyen në vendet e tyre). Ky tip i ri besimtari, për qëllimet dhe aspiratat e të cilit mungon krejtësisht informacioni, shihet jo pa frikë nga myslimanët e tjerë. Më shumë se për haxh, të gjithë ëndërrojnë dhe përpiqen të mbledhin para për të jetuar një orë e më parë në vendet e shenjta, por ata nuk flasin me kënd për këto gjëra. Drejtues të xhamive në disa qytete të vendit nuk janë fort të shqetësuar për këta besimtarë, "pasi ata i falin rregullisht të pesë vaktet" edhe pse "në një mënyrë të ndryshme". Në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, edhe pse e njohin dukurinë, pranojnë se nuk ka asnjë masë mbrojtëse ndaj tyre, por mjaftohen duke i quajtur "jashtë rrethit shumë të gjerë të islamit" besimtarët e çuditshëm që nuk pranojnë të nderojnë të vdekurit. KMSH i konsideron protagonistët e rasteve të dhunës ndaj funksionarëve apo besimtarëve të vet, si objekt i punës së policisë, duke hequr dorë kështu jo vetëm nga çdo përgjegjësi për njerëzit e vet, por edhe nga të qenit zotërues realë të "territorit" aspak në kuptimin gjeografik të fjalës. [135]

2. SHQIPTARËT DHE ERDOGANI

Pas gjithë proceseve të ndryshme socio-politike në Ballkanin Perëndimor, e si rezultat i politikave agresive të SHBA-ve në raport ndaj vendeve muslimane, shqiptarët sikur po gjen një ndjenjë sigurie tek Erdogani dhe Turqia që ai udhëheq e që kjo gjë sjell një raport të ri mes shqiptarëve në raport me Turqinë dhe një emocion i ri që nuk është se ka qënë diçka e pritur. E gjithë kjo vjen nga fakti që Erdogani me anë të deklaratave të tij interesante si: "Shqiptarët dhe Turqit janë një Popull. Ja çfarë dua nga ju. Le të mos e harrojmë Rabia'rim. Përmbajtja e kësaj Rabia është shumë e rëndësishme. Nuk ka ndarje këtu. Këtu ka vetëm unitet. Këtu ekziston vetëm një komb. Ne jemi 80 milionë turq, kurd, laz, çerkez, gjeorgjian, romë, boshnjak dhe shqiptarë"" (e thënë kjo në qytetin e Bursas), apo se "Turqia është aleati më i madh i Shqiptarëve" si edhe deklarata të tjera të ngjashme, e ndërkohë edhe aktivitetet e politikës së jashtme të Turqisë në raport me investimet që bëjnë në vendet e banuara me shqiptarë (si ndërtimi i shkollave, xhamive, parqeve për

135 A janë shqiptarët kamikazët e ardhshëm. https://www.gazetaexpress.com/shkurt-e-shqip-a-jane-vehabistet-shqiptare-kamikazet-e-ardhshem-102204/

fëmijë, apo rikonstruktime të objekteve të ndryshme publike), bën që një pjesë e konsiderueshme e popullatës shqiptare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut të krijojnë simpati ndaj Erdoganit dhe Turqisë në të njëjtën kohë.

Profesori amerikan Alon Ben Meir ka akuzuar presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan se po tenton t'i kthejë shtetet e Ballkanit Perëndimor në shtete islamike.

Alon Ben Meir është një ekspert amerikan në politikat dhe çështjet e Lindjes së Mesme, i specializuar në negociatat e paqes midis Izraelit dhe Emirateve të Bashkuara Arabe.

Ai këtë e ka thënë nëpërmjet një statusi në Facebook ku i referohet një deklarate të presidentit të Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan.

"Paqja, stabiliteti, qetësia dhe prosperiteti i shteteve të Ballkanit janë ekstremist me rëndësi për ne", tha Erdogani dje. Po, zotëri Erdogan, ju nuk mund ta fshihni sa "me rëndësi", është për juve ta merrni këtë regjion nën kontroll dhe t'i shndërroni këto shtete në shtete islamike", ka shkruar në Facebookun e tij, Meir.

Ben-Meir i cili shërben si bashkëpunëtor i lartë në Qendrën e Çështjeve Globale të Universitetit të Nju Jorkut kohëve të fundit është marrë edhe me çështjen e Turqisë.

Ai gjithashtu ka marrë në fokus edhe çështjen e shteteve të Ballkanit dhe problemet në këtë pjesë të Evropës.

Një status tjetër i tij, gjithashtu tregon se si askush në Kosovë nuk ka marrë përgjegjësi për indoktrinimin e të rinjve që kanë marrë pjesë në luftën e Sirisë.

"Kosova ka tani mbi 900 xhami – 240 prej tyre të ndërtuara që nga lufta kundër Serbisë – dhe janë të fajësuara për ndihmë ndaj indoktrinimit të gjeneratës së re në Vehabizëm, dhe askush deri tani nuk ka mbajtur përgjegjësi për indoktrinimin e qindra burrave dhe grave nëpër xhami", ka shkruar Ben-Meir. [136]

Nga ana tjetër analistë ,politikanë dhe personalitete shqiptare të sferave të ndryshme kanë potencuar në mënyrë direkte apo edhe indirekte simpatinë që kanë për Erdoganit dhe suportin që i japin Turqisë në raport me ndikimin e tyre në Ballkanin perëndimor e me këtë edhe tek shqiptarët. Ne vazhdim po postojmë disa pjesë nga shkrime të ndryshme të autorëve shqiptar lidhur me suportin që kanë ndaj Erdoganit dhe Turqisë:

Serbët ankohen pse futbollisti shqiptar nga Kosova , Shaqiri, ka në këpucë Flamurin e Kosovës kurse Presidenti i Turqisë Erdogan e mban atë rreth qafës. A mos vallë edhe kjo i shqetëson turkofobët e Kosovës?!

Këta hipokritë dhe mercenarë bëjnë sikur shqetësohen për standartet dhe liritë demokratike në Turqi, por në të vërtetë këta i shqetëson dhe i verbon fakti pse Shqipëria dhe Kosova kanë marrëdhënie të mira me Turqinë; i shqetëson fakti dhe i gërryen urrejtja për Turqinë pse ajo është bërë nën drejtimin e Erdoganit superfuqia rajonale dhe supershtet ekonomik, politik, strategjik dhe ushtarak në rang global.

Që prej 15 vitesh kur u bë Kryeministër i Turqisë , Erdogan, ky burrë i madh shteti e ka përkrahur e ndihmuar shtetndërtimin e Kosovës, ka kërkuar dhe promovon e

136 https://www.gazeta-shqip.com/2019/07/11/alarmi-nga-shba-erdogan-po-merr-ne-kontroll-ballkanin-kosova-ka-900-xhami/

kërkon ndërkomëtarisht gjithmonë në organizmat dhe institucionet ndërkomëtare njohjen e Kosovës nga shtetet e ndryshme të botës, ua kërkon këtë edhe shteteve të Organizatës Islamike që se kanë njohur akoma, Erdogan kërkon në OKB antarësimin e Kosovës në OKB, në BE dhe e mbron Kosovën në NATO.

Këto veprime, sjellje dhe kërkesa, këto janë ashtu dhe të tilla siç i bën edhe Shteti Shqiptar i Shqipërisë për Kosovën, pra këto i bën një Shtet aleat dhe një President turk i cili i konsideron dhe i respekton shumë shqiptarët, si vëllezër , siç e ka deklaruar vetë Erdogani, ashtu siç dëshirojnë dhe veprojnë për shqiptarët e Kosovës edhe shqiptarët e Shqipërisë, të cilët janë vëllezër gjaku me shqiptarët Kosovës.

Prandaj me të drejtë politika në Shqipëri dhe në Kosovë i është Turqisë mirënjohëse për atë se çfarë ka bërë Turqia, Erdogan ashtu sikuse kanë bërë dhe të gjithë parardhësit e tij të shtetit moderrn turk për shqiptarët.

Turqia , Erdogan ashtu si edhe paraardhësit e tij gjithnjë dhe konstasnt kanë përkrahur gjithmone shqiptarët.

Erdogan ka respektuar njëlloj si Berishën, si Nanon, si Nishanin, si Metën dhe Ramën, pra respekton dhe gjithnjë e ka treguar me vepra respektin për shqiptarët dhe Shqipërinë pa marrë parasysh se cila forcë politike ka qeverisur, qeveris dhe do ta qeveris në të ardhmen Shqipërinë ashtu si gjithnjë siç bën e vepron populli dhe shteti turk në marrëdhëniet miqësore e vëllazërore me shqiptarët . Prandaj Erdogan është mik i sinqertë i Shqipërisë dhe Kosovës, mik i të gjithë shqiptarëve.

Dhe bënë shumë mirë që Kryeministri i Shqipërisë dhe Presidenti i Kosovës i uruan ndër të parët fitoren Erdoganit në Zgjedhjet e 24 Qershorit 2018, ashtu sikurse do ta uronin këdo që do ta kishte zgjedhur dhe votuar populli turk.

Edhe Papa Francesku e ka bërë me duar simbolin e shqiptarëve në respekt të kombit shqiptar, pavarësisht se Vatikani nuk e ka njohur akoma Kosovën ashtu si aleatët e Serbisë Rusia, Kina, India, Brazili etj. Por Papa respekton njerëzinë dhe kombet e saj dhe nuk pyet as serbët dhe askënd që ta bëjë apo jo me duar simbolin e shqiptarëve.

Dy personat më të besuar të Erdoganit, shefi i kabinetit të Presidentit të Turqisë dhe këshilltari i parë i Erdoganit bëjnë shqiponjën me duar, simbolin e shqiptarëve, dhe askush nuk u ka thënë në Turqi, pse?

Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët kudo të parën kanë kombin shqiptar, Shqipërinë e trojeve gjithshqiptare dhe shqiptarët duhet, janë dhe do të jenë me të gjithë ata të cilët respektojnë, janë dhe do të jenë me shqiptarët pa dallim vëndndodhje, gjuhe, kulture e besimi që ata kanë.[137]

Ndërkohë pas gjithë kësaj simpatie ndaj Turqisë dhe Erdoganit, vijojnë takimet e fundit mes Erdoganit dhe Presidentit Serb Vuçiç dhe Presidentit Amerikan Donald Trump. Me këtë lindin dhe dilemat e reja tek popullata shqiptare që simpatizon dhe suporton Erdoganin dhe Turqinë, se a në të vërtetë ky lider Turk mban dhe ruan interesat e Shqiptarëve si vëllezër të Turqisë apo të gjitha janë thjeshtë një farsë e

137 http://shekulliagency.com/opinionanaliza/turqia-aleat-i-madh-dhe-erdogan-mik-i-sinqerte-i-shqiperise-dhe-kosoves/

politikave të një politikani i cili dëshiron që të zgjeroj interesat e tij në Ballkan dhe me këtë edhe në Ballkanin Perëndimor duke ndikuar tek shqiptarët tek pjesa që ata e vlerësojnë goxha edhe ajo është Besimi dhe religjioni.

3. POLITIKA AMERIKA DHE SHQIPTARËT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

SHBA-të në mënyrë tradicionale kanë patur një politikë të jashtme të unifikuar dhe nuk është se ka patur ndryshime radike në politikën e jashtme edhe pas ndryshimit të administratës amerikane (përpara mandatit të presidentit Obama, apo edhe pas mandatit të presidentit Obama), e me këtë nënkuptohet që qëndrimet amerikane në raport me shtetet e tjera nuk është se dallojnë shumë pas njërës apo tjetrës administratë presidenciale. Ata vazhdimisht qëndrojnë stoik në raport me interesat e tyre gjeostrategjike në Europë , apo edhe kontinente të tjera.

Shqiptarët gjithmon kanë gëzuar suportin amerikan, posaçërisht në kohën e luftës në Kosovë, (1998-1999) asaj në Maqedoni (2001) dhe problemet e ndryshme që shqiptarët i kanë patur gjatë dekadave të fundit.

Po cila ka qenë kapja amerikane dhe si ka ecur politika shqiptarë në Ballkanin Perëndimor?

3.2 INTERESAT E SHBA NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Interesat e SHBA në Ballkanin Perëndimor janë interesa për çështje të sigurisë, çështje diplomatike, ushtarake, dhe ekonomike. “Ne u mblodhëm bashkë sepse arritëm në përfundimin se në Ballkanin perëndimor janë duke ndodhur tri gjëra, që nuk janë në interes të SHBA”, thotë Ambasadori Frank Wisner. Situata e brendshme në vendet e rajonit, ndikimet e huaja atje dhe fundamentalizmi.

ÇFARË PO ECËN KEQ?

Situata e brendshme në çdo vend të Ballkanit Perëndimor nuk ka pasur progres, dhe në disa raste ka pasur zhvillime që e kanë përkeqësuar situatën. Institucionet nuk janë duke konsoliduar, ekonomia nuk është bërë tërheqëse, papunësia është në rritje, të rinjtë po largohen nga rajoni. Dinamikat e brendshme nuk janë të shëndetshme. Marrëdhëniet midis vendeve të Ballkanit nuk janë përmirësuar, jo vetëm midis Kosovës dhe Serbisë, por edhe në raste të tjera. Po nö Ballkan vihet re dhe ndërhyrja e vendeve të huaja, pjesa më e madhe e të cilave nuk janë konstruktive si: Rusia, Kina dhe Turqia.

RUSIA

Rusia ka vendosur ta përdorë Ballkanin Perëndimor si vegël për të mbrojtur interesat e veta me Europën. Rusia po e përdor Kosovën për të detyruar pjesëmarrjen e saj në arkitekturën e të ardhmes së Evropës. Duke përdorur propogandën, për shembull me radion Sputnik ajo punon për destabilizimin e gjithë rajonit. “Rusia

ka të drejtë të bëhet pjesë e zhvillimit dhe të vrasë mendjen si mund të zhvillohet rajoni, por Rusia nuk ka të të drejtë të ketë veton për të ardhmen e rajonit dhe ta përdorë atë për të balancuar marrëdhënet e veta me vendet e tjera të Evropës," thotë ambasadori Wisner.

Në lidhje me rolin e OKB në Ballkan vihet re se SHBA kërkon të reduktojë aktivizimin e Këshillit të Sigurimit me Kosovën, të reduktojë UNMIK dhe ideja është më pak OKB dhe më shumë BE dhe NATO në Ballkan.

Shefi i Misionit të Finlandës në OKB, Kai Sauer, ish-asistent i Marti Artihsarit me angazhim shumë aktiv për rajonin, shpjegon se OKB aktualisht nuk ka rol në Ballkan. "Operacionet e OKB, UNMIK kushton 35 milionë në vit, për një punë që nuk ka fakte politike. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, e ka quajtur Ballkanin si një nga prioritetet e angazhimit të tij. Synimi është nxjerrja e OKB-së nga Ballkani dhe jo futja e saj në të", tha Kai Sauer.

TURQIA DHE ÇFARË THOTË AJO

Janë parë rizgjime të interesave turke në rajon. Shumë prej tyre janë konstruktive. Turqia është investitore, Turqia është arkitekte e modernizimit të rrugëve, Turqia është pjesëmarrëse në forcat paqeruajtëse. Por, politika turke është duke ndërhyrë në rajon. Kryeministri turk bën fushatë në Sarajevë për zgjedhjet që zhvillohen në Turqi. Dhe ka edhe raste të tjera, si përshembull konflikti me gylenistët.

Një e dërguar e misionit turk pranë OKB, kundërshton mënyrën se si prezantohet vendi i saj. "Nuk jemi dakord si prezantohet vendi im në raport dhe në diskutim. Kur flisni për Turqinë, ju flisni sikur Turqia të ishte një aktor i jashtëm. Turqia është prej vitesh vend aleat i NATO-s, dhe ka qenë zëri më i lartë në NATO për perspektivën euro-atlantike të Ballkanit. Ne nuk e konsiderojmë veten tonë si aktor të jashtëm."

Ambasadori Wisner i shpjegon asaj: "Ne shprehim shqetësimin që Turqia kërkon të zgjidhë problemet e politikës së brendshme, duke bërë politikë të jashtme. Dhe këtu mund të haset me të tjerë në rrugë."

KOSOVA DHE SERBIA

Ambasadori Cameron Munter, drejtor i Institit EastWest merr fjalën kur flitet për Serbinë dhe Kosovën. Në Kosovë situata ka mbetur në vend dhe nuk po ecën përpara me rezolutën, siç u mendua 10 vjet më parë, kur Kosova deklaroi pavarësinë dhe duke dashur zgjidhje të shpejtë u rekomandua që të dy vendet të njohin njëri-tjetrin dhe të bëhen anëtare të BE dhe NATO-s.

"Ajo që po ndodh në Serbi, është që ju shihni zotin Vuçiç, një njeri të sinqertë në angazhimin e tij për t'u futur në BE, por edhe si dikush që ka probleme me plotësimin e vlerave demokratike, si liria e shtypit, liria e sistemit të drejtësisë, etj. Kjo e bën të vështirë për ne ta imagjinojmë Serbinë në BE. Ne kemi të bëjmë me dikë që ka forcën për t'i kryer punët, por nuk vepron gjithnjë siç do të donte BE," tha Cameron i cili ka qenë dy vjet ambasador në Serbi, gjatë kohës që Kosova shpalli pavarësinë.

"Nga ana tjetër ne kemi Kosovën, e cila që prej pavarësisë nuk ka qenë në gjendje të krijojë një lloj qeverie koherente, të cilën kërkojmë ne. Një nga vështirësitë është se

edhe nëse Serbia dhe Kosova do të arrijnë në një marrëveshje për statusin, do të jetë e vështirë të gjesh konsensus për të në Kosovë. Njerëzit në Kosovë kanë mentalitetin që të shohin kush po vjen nga jashtë të zgjidhë problemet e tyre," thotë ai.

Lidhur me idetë e ndarjes së Kosovës, sipas të cilave Kosova të japë 5-10 përqind të territorit në veri të Mitrovicës si këmbim për njohjen e statusit, Munter tha: "Ne e kemi parë seriozisht këtë sugjerim. Është interesante të shohësh se si dikush ka guximin të bëjë sugjerime të tilla. Ne kemi arritur në përfundimin se nuk është koha për këtë. Nuk është zgjidhje e qëndrueshme të bësh këmbime territoresh midis Kosovës dhe Serbisë. Për shumë arsye, jo vetëm për njerëzit në rajon, por edhe në nivel ndërkombëtar shumë njerëz janë skeptikë."

SHQIPËRIA NË RRUGË TË MBARË

Për Shqipërinë, përshtypja është shumë e mirë. Shqipëria është fokusuar në forcimin e institucioneve të veta, kryesisht institucionet e gjyqësorit. "Shqipëria është në "rrugë të mbarë", thotë Ambasador Wisner. Ka shumë për të bërë në çështjet e kriminalitetit, jo vetëm kjo qeveri por edhe e ardhshmja, edhe tjetra pas saj.

Mali i Zi ka qenë një histori e mirë. Vendi është në NATO, pati zgjedhje demokratike. Maqedonia, është "work in progress", puna vazhdon.[138]

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

SHBA-të duhet të kenë strategji të ardhshme kombëtare ku duhet që t'i kushtojë vëmendje të veçantë problemve të mëdha ekonomike me të cilat ballafaqohen. Gjendja momentale me deficitin masiv si dhe me borxhet në rritje për tu mbajtur një standard i jetesës, nuk është edhe aq e përballueshme. Në qoftë se këto tendenca vazhdojnë, roli i SHBA-ve në marrëdhniet ndërkombëtare do të zbehet, gjë që do të lë hapësirë për një botë multipolare edhe më herët nga koha që parashikojnë skeptikët amerikan. SHBA-të duhet të ndërmarrin hapa të guximshëm për parandalimin e tendencave negative ekonomike. Deficiti i pakontrolluar duhet të vihet nën kontroll me hapa të guximshëm ekonomik drejt një sistemi të pranueshëm rregullator dhe tatimor dhe gjithashtu me zbatimin e politikave të mirëfillta monetare dhe fiskale. Këto masa duhet të ndikojnë në mbrojtjen e tregut vendor dhe njëkohësisht tregun ndërkombëtar ta bëjnë edhe më konkurent. Dominimi i SHBA-ve si një "superfuqi e vetme" vëhet në pikëpyetje serioze në të ardhmen e ndikuar nën barrën e problemeve ekonomike (borxh të jashtëm, deficit të lartë), luftërat e gjata dhe terrorizmi ndërkombëtar. Kriza ekonomike është pasojë e efekteve negtive të tregtisë së jashtme të ekonomisl amerikane, rritja e ulët ekonomike dhe niveli i lartë i papunësisë. Luftërat e vazhdueshme konsumojnë shumë para, humbet besimi tek

138 Aida Cama - Interesat e SHBA-së në Ballkanin Perëndimor

https://www.dw.com/sq/interesat-e-shba-s%C3%AB-n%C3%AB-ballkanin-per%C3%ABndimor/a-44127859

aletatët, ndërlikohen raportet me fenë islame dhe në botë inicohet dhe i jepet shtysë shtesë terrorizmit ndërkombëtar.

Këto janë kushte të jashtëzakonshme ku forcat konkurente rajonale kanl ndikim dhe sfidojnë dominin global të SHBA-ve. Fuqia në rritje e Kinës, Indisë, Brazilit dhe Rusisë, u kanoset seriozisht SHBA-ve në vendimet që ndërmerr si lider ndaj vendeve tjera dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Strategjia kineze e '"forcës së madhe dashamirëse" është ekonomikisht shumë e suksseshme, sepse ajo nuk është sfidë ushtarake ndaj SHBA-ve. Kina nuk e ka ndërmend që t'i kundervihet ushtrisë së SHBA-ve për shkak të fokusit të saj ndaj zhvillimit të brendshëm ekonomik si dhe strategjisë afatgjate për të qënë e njohur si fuqi e made. Kur flitet për teori të kolapsit të një vendi, ekonomia gjithmonë është në pikln fillestare.

Ekonomia e SHBA-ve dhe më tutje është ekonomia më e madhe dhe më e fortë me buxhet në vlerë prej rreth 3.654 trilion dollar për vitin 2018. Pritet që SHBA-të edhe gjatë këtij viti të kenë rolin dominant në botë dhe të kenë një forcë stabile ushtarake dhe ekonomike, kur forcat e reja globale do ta riorganizojnë skenën botërore dhe do të vendoset një rend i ri botëror. Historia ka treguar se secila fuqi globale ka ngritjen dhe uljen e saj dhe se dominimi nuk mund të qëndrojë në një kohë afatgjate. Nga perspektiva e sotme një periudhë më e gjatë kohore është punë relative. Globalizimi, industrializimi si dhe teknologjitë e reja bënë që 10 vjet të jenë një periudhë e gjatë kohore, ndërsa 100 vjet të jenë një periudhë shumë e shkurtër.

Megjithatë Shqiptarët duhet të vazhdojnë që të besojnë në politikën e jashtme të SHBA-ve dhe të jenë akoma "simpatizantë" të amerikanizmit dhe të gjithë asaj se çfar SHBA-të bëjnë për paqen dhe rendin botëror në përgjithësi dhe për atë se çfar kanë bërë dhe kontributin e pashoq që kanë dhënë për shqiptarët në veçanti, e posaçërisht gjatë dekadave të fundit.

Gjithmon duhet të kemi parasysh se perspektivat euro-atlantike janë një proces relativisht i gjatë por që gjithmon do të na duhet suporti i një fuqie të madhe dhe një miku të veçantë, e që kjo fuqi dhe ky mik quhet SHBA.

BBIBLIOGRAFIA

- 1. http://fon.edu.mk/files/NazmiMaliqi1.pdf
- 2. https://www.sobranie.mk/republika-maqedonis-n-rrug-n-p-r-n-be.nspx
- 3. http://www.mod.gov.mk/?shtit=%D1%81%D0%B0%D0%B4-%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D1%83%D0%BF%D0%B5%D1%80%D1%81%D0%B8%-D0%BB%D0%B0-%D0%B8%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D0%BD%D0%B0&lang=sq

- 4. https://flaka.com.mk/ish-ambasadori-i-nato-s-ivanov-faktor-i-destabilizimit-ne-maqedoni/
- 5. https://shenja.tv/shqiptaret-dhe-amerika-dashuri-platonike-apo-utilitarizem/
- 6. https://xk.usembassy.gov/sq/fjala-e-ambasadorit-delawie-ne-konferencen-nato-ne-ballkanin-perendimor-sot-dhe-neser/
- 7. https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=1bbd607e-45a9-8c0b-f8fe-3d4ed95eb27a&groupId=252038
- 8.https://www.gazeta-shqip.com/2018/09/26/politika-amerikane-dhe-bota-shqiptare-ne-gadishullin-ilirik/
- 9.https://www.mcms.mk/sq/per-punen-tone/hulumtime-dhe-publikime/lista-e-hulumtimeve-dhe-publikimeve/595-islamot-i-politikata-na-zapaden-balkan.html
- 10.https://www.mcms.mk/images/docs/2009/islami-dhe-politika-ne-ballkanin-perendimor-2009.pdf
- 11.https://www.dw.com/sq/interesat-e-shba-s%C3%AB-n%C3%AB-ballkanin-per%C3%ABndimor/a-44127859
- 12.https://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/01/Strengthening-the-Rule-of-Law.pdf
- 13.https://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/08/Leadership-Adrift_fin-2.pdf
- 14. http://shekulliagency.com/opinionanaliza/turqia-aleat-i-madh-dhe-erdoganmik-i-sinqerte-i-shqiperise-dhe-kosoves/

STRENGTHENING DEMOCRACY AND PROMOTING GROWTH AND DEVELOPMENT

THE CASE OF US- GOVERNMENT FOREIGN AID IN ALBANIA

Nevila Xhindi
Mediterranean University of Albania
nevila.xhindi@umsh.edu.al

ABSTRACT

Foreign aid is one of the few topics in the development discourse with such a constant, yet volatile history in terms of interest and attention from academics, policymakers, and practitioners alike. The current debates on poverty reduction, debt relief and, more broadly, the efficacy of development assistance have shed renewed light on foreign aid. Is the actual aid promoting democracy, development and reducing poverty in the developing countries? Do we have some lessons to be learnt? These are important questions in outlook of the developing a new landscape in foreign aid and recent world developments, for both donors and recipients in this area.This paper builds on this discussion and provides an updated answer to the above question based on case study, a recent evidence of foreign aid of US Government in Albania, by looking to the wider and long-term impact of this aid at the sectorial and country level. Promoting growth, democracy and foreign aid are moving to the vanguard of the international economic agenda, and are able to exert real influence on political events internationally. Exploring the problems and dilemmas posed by the giving and receiving of financial and technical assistance, this paper brings an interdisciplinary approach to a range of relevant issues. It includes cross-national examples, and provides an extensive chronology of events marking the historical progress of socio-economic development and aid of US government in Albania.

KEYWORDS: foreign aid; donors and recipients; development discourse

INTRODUCTION

More than sixty years after the end of the Cold War, the world seems self-reliant to fall into another deep placed polarization: the one between the developed and the developing world. The rupture is not only economic and social, linked to the persisting gaps in standards of living and opportunities, but above all political, with the risk of becoming "ideological" and providing support to radicalism, extremism and civilization clashes. We see this new bi-polarism at play in the delayed Doha negotiations, in the aborted reforms of global institutions, in the confrontations concerning human rights, and even in the different approaches to fighting terrorism and building peace and security (Van Bilzen, 2015).

Development assistance is at the heart of this new polarization. The growing distrust and antagonism in the developing world against the rich countries is fed by the widespread persuasion that the developed countries are not doing what they should do, and are not even living up to what they promised to do: sharing opportunities with the less fortunate, supporting development and fighting poverty (Mahembe, Admore & Odhiambo.M Nicholas, 2019). Never before have economics figured so obviously in the politics between nations; never before have individuals and non governmental organizations had such an opportunity to impact the success of politics in the international arena.

In this paper I am bringing an interdisciplinary approach to the dilemmas posed by the giving and receiving of financial and technical assistance from the USA government to countries in development like Albania.

Foreign aid is provided by three main types of donors: rich country governments, Non-Governmental Organizations (NGOs) and private foundations. But why is it given? Aid is provided in the belief either directly or indirectly that it will help improve the lives of those who really need it: the extremely poor; those hit by emergencies with nowhere else to turn; and those on the margins of survival at risk of falling into a cute poverty and destitution (Alvi, A., & Senbeta, A, 2012).

As discussed below while the distribution of official aid is still influenced by short term political, security and commercial interests of donor governments (Boone, 1996), almost all aid is given to developing countries on the assumption that it will help those most in need, contributing to their development in a sustainable way.

Vendet anëtare të BE-së gjithashtu përballen me këtë fenomen. Dallimi është se klientelizmi është më shumë normë sesa përjashtim në shoqëritë ballkanike, dhe rrënjët e saj qëndrojnë në shpërndarjen e vetë pushtetit. Trashëgimia komuniste e vendeve në rajon mund të ketë vendosur shkallët e hapjes së klientelizmit, por marrëdhëniet klienteliste jane përshtatur me kontekstin e ri demokratik pas ndarjes të Jugosllavisë. As krijimi i institucioneve demokratike dhe as kushtëzimi gjithnjë e më i rreptë i anëtarësimit ne BE ndaj vendeve aspirante të Ballkanit nuk ka penguar përjetësimin e klientelizmit.

PËRFUNDIME

Jo të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor janë të barabartë dhe tiparet e demokracisë ndryshojnë. Disa vuajnë nga institucione komplekse destruktive, si Bosnja, të cilat stimulojnë sjellje destruktive nga elitat në pushtet, të tjerët nga nivele të larta të polarizimit ndër-partiak, siç është Shqipëria.

Shkalla në të cilën ushtruesit e detyrave ndaj institucioneve dhe rregullave demokratike ndryshojnë gjithashtu, nga Maqedonia, ku partia mbizotëruese midis 2006 dhe 2016, VMRO-DPMNE është angazhuar në manipulime të qarta elektorale dhe patronazh të gjerë për Shqipërinë, ku alternimi i pushtetit ka qenë i mundur dhe i shpeshtë .Transformimi i peizazhit mediatik në Ballkanin Perëndimor është një proces i hapur që kurrë nuk mund të konsolidohet plotësisht, i ngjashëm me vetë demokratizimin. Në peizazhet shumë komplekse të mediave me marrëdhënie simbiotike midis mediave, politikës dhe bizneseve, dobësitë e fundit të mediave në rajon janë pasiguria financiare dhe frikësimi politik - duke penguar lirinë e medias dhe cilësinë. Gjatë dekadës së kaluar, të gjithë indekset kryesore të demokracisë tregojnë se Ballkani Perëndimor është larguar nga shndërrimi ne demokraci të konsoliduar. Kjo rënie është pjesë e trendit global, e dukshme edhe midis vendeve anëtare të BE-së.

Për pjesën më të madhe të dy dekadave të kaluara, politikat e ndjekura nga SHBA dhe BE ndaj Ballkanit Perëndimor kanë vepruar në një mënyrë të koordinuar. Të dy palët kanë përdorur mjete të ndryshme për të zbatuar politikat e tyre: nga ana e SHBA kanë qenë më të shtrënguara dhe të orientuara drejt sigurisë, ndërsa BE ka përdorur mjete më të orientuara drejt angazhimit ekonomik dhe integrimit evropian. Pavarësisht strategjive të ndryshme , qëllimet dhe qasjet kanë qenë në sinkron.

Nga rezultatet e analizës u përforcua ideja që Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian duhet të thellojnë angazhimin e tyre me Ballkanin Perëndimor, një rajon ku Rusia, Turqia dhe shtetet e pasura të Gjirit Arab kanë zgjeruar ndikimin e tyre. Edhe pse shtron sfida të mëdha për partnerët e saj kryesorë në Evropë, administrata Trump ka treguar një gatishmëri për ti dhënë përparësi marrëdhënieve të saj me Ballkanin.

BIBLIOGRAFIA

- Bertelsmann Stiftung ,Transformation Index BTI 2018. Aksesuar nga : https://www.bertelsmann-stiftung.de/fileadmin/files/BSt/Publikationen/imported/leseprobe/LP_978-3-86793-797-9_1.pdf
- Bieber, F (2019) Leadership Adrift: American Policy in the Western Balkans. Aksesuar nga https://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/08/Leadership-Adrift_fin-2.pdf
- Cama. A (2018) Interesat e SHBA-së në Ballkanin Perëndimor. Aksesuar nga : https://www.dw.com/sq/interesat-e-shba-s%C3%AB-n%C3%AB-ballkanin-per%C3%ABndimor/a-44127859

SHBA: PARTNERË MBËSHTETËS NDAJ SHQIPTARËVE QË PREJ PAVARËSISË DERI SOT

Xhuljeta Krasta
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
xhuljetakrasta@yahoo.com

ABSTRACT

Considering the actual political situation of Albania, especially the rejection of specific European Union veto to open negotiations, my reflection is on the enforcement and progressing of the relations between Albania and United States of America. The United States has contributed greatly to the post-war reconstruction of the Western Balkans and remains a key player. While the region is not as high on the U.S. foreign policy agenda as in the 1990s, the USA has consistently shown commitment to its Euro-Atlantic integration. US engagement is seen as crucial in this historically volatile region, weakened by unresolved past and emerging challenges. The U.S. is perceived in the region, in general terms, as a supporter of the democratic reforms with significant leverage and credibility. Its influence and presence varies in the individual countries: from 'unparalleled' in Kosovo, to strong in Albania.
This paper aims to take a historic-political journey to the loyal relationship of U.S. with Albanian nation in the last century until present. Even though Albanians are the nation that has demonstrated enormously true friendship towards United States, in recent years, it seems that there has been a tendency at times for snobbery, at times for good-willed politics, and at times inspired by some anti-Albanian circles that some journalists, politicians, and even state officials in Albania and in the region have been sometimes doubtful and even hostile towards the actual U.S. Department of State.

KEYWORDS: Strategic partners, Euro-Atlantic integration, Albania, Western Balkans, regional security, foreign policy.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Metodat e përdorura në këtë studim janë universale apo të përgjithshme; janë përdorur gjthashtu metoda analitike, sintetike dhe logjike. Metoda e hulumtimit në këtë studim është kualitative. Përmes metodës kuantitative ose cilësore ne sigurojmë kuptimin dhe sqarimin e rasteve studimore, objekteve të hulumtimit nga prizmi historik e filozofik. Nëpërmjet *Metodave Kualitative*, pra cilësore, janë siguruar, grumbulluar të dhëna e informacione me qëllim verifikimin e pohimeve të bëra. Duke grumbulluar të dhënat e informacione me qëllim duke u bazuar në një rast të vetëm studimor, atë të marëdhënieve SHBA – Shqipëri. **Dizajni apo tipi i studimit** që ju paraqitet është përshkrues dhe shqyrtues.

Qëllimi i studimit: Ky studim ka qëllim të eksplorojë momente-fakte historike dhe karakteristika specifike të ndërhyrjes së diplomacisë amerikane në krijimin dhe forcimin e shtetit shqiptar si një formë e realizimit të bashkëpunimit mes dy shteteve e kombeve.Ky punim ka dy **Objektiva:** 1.Të shpjegojë përpjekjet politike të diplomacisë amerikane të bëra në kuadër të përmirësimit të bashkëpunimit mes dy kombeve partnerë strategjikë në vazhdimësi. 2.Të analizojë kohërat dhe ngjarjet specifike të ndërhyrjes amerikane në mbrojtje të mbijetësës së popullit e shtetit shqiptar dhe demokracisë. **Rezultate të pritshme:** Nën syrin e vëzhgimit shkencor punimi synon të konstatojëekzistencën e faktevekyçe të cilat provojnë parteritetin dhe mbështetjen e madhe dhe shpesh pa kushte të SHBA-së ndaj popullit dhe shtetit shqiptar.

Burimet e përdorura në këtë studim janë burime dytësore ose kritike. Objekti i studimit bëhet edhe në varësi të mundësisë për të gjetur burime referencash dhe bibliografike, prandaj ky studim është bazuar në burime dytësore informacioni. Analiza dhe gjetjet e këtij studimi bazohen në konsultimin e literaturës akademike dhe kërkimore për politikën e jashtme e të dyja kombeve si dhe në intervista nga politikanë e përfaqësues të lartë, ligjërimi dominant politik, analiza e ligjërimit apo analiza dokumentare.

HYRJE:

Në të gjitha hulumtimet që bëjnë ekspertët e kompanisë me renome ndërkombëtare për hulumtime Gallup International[142] shqiptarët, si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë, me vite të tëra, dalin populli më pro-amerikan në këtë pjesë të Evropës, ndërsa përkrahja për politikën e jashtme amerikane kapërcen shifrën 90% pro. Në kohën kur në botë mbizotëron një formë e kriticizmit të çdo gjëje amerikane, posaçërisht në Amerikën Latine, por edhe disa pjesë të Evropës, shtrohet pyetja nëse kjo përkrahje është vazhdimësi e përkrahjes që Shqipëria e dikurshme e kishte për

142 Gallup International. http://www.gallup-international.com (16.03.2013)

BRSS-në e Kinën si superfuqi apo tashmë ekziston një sentiment tjetër gjykuar edhe nga fakti se rezultatet janë gati identike edhe në Kosovë, ku elementet nacionaliste anti-jugosllave dhe anti-komuniste kanë ekzistuar edhe në kohëra të represionit të madh serb.

Një gjë është e vërtetë, ndonëse në shikim të parë duket konstatim i vrazhdë se shqiptarët kanë shumë arsye të mos u besojnë fuqive evropiane dhe Rusisë për shkak të historisë që e ka përcjellur krijimin e shteteve të dominuara nga shqiptarët, Shqipërisë dhe Kosovës. Të dy këto entitete shtetërore janë krijuar dhe njohur pas luftërave të përgjakshme me fqinjët pa ndihmën evropiane, madje në raste ka pasur ndihmë për palët e tjera që i dëshironin tokat shqiptare, por pa shqiptarë.

SHBA-të në fillim dhe fund të shekullit XX, në dy rastet vendimtare, ishin faktori themelor për ngritjen e shtetësisë së Shqipërisë dhe çlirimin e Kosovës, të cilën në shekullin e XXI shtetin e Kosovës e drejtuan drejt pavarësisë që gëzon sot.

Edhe në periudhën pas Luftës së Ftohtë, ishin shqiptarët të parët që përqafuan, qoftë deklarativisht, qoftë në vepër, sentimentin pro-amerikan në organizimin shtetëror dhe promovimin e demokracisë në Shqipëri, si dhe në krijim e partive të para demokratike në bllokun e Lindjes, siç ishte rasti edhe me Partinë Demokratike të Shqipërisë, edhe me Lidhjen Demokratike të Kosovës, të krijuar në dhjetor 1991[143]. Pas zhytjes së Ballkanit në luftëra të reja, të cilat motivet i kishin të vjetra dhe të njohura për popujt e Ballkanit, dhe përkushtimit diplomatik dhe ushtarak amerikan për përfundimin e tyre, rezultati final i nxori fitimtarë shqiptarët, dhe prej atëherë, sentimenti pro-amerikan nuk ka pasur rënie, ndërsa kredibiliteti i politikës së jashtme ka pasur ngritje edhe më të madhe në sytë e shqiptarëve. Pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 populli shqiptar reagoi me empati ndaj humbjeve amerikane. Republika e Shqipërisë, pa mëdyshje, u shpreh se do të bashkëpunojë me SHBA-të në koalicionin kundër terrorizmit, duke dërguar forca që edhe sot shërbejnë në fushëbetejat e Irakut dhe Afganistanit. Së fundi, edhe Kosova dhe Shqipëria janë zotuar se do të përbëjnë koalicionin e ndërtuar për të parandaluar rritjen dhe në fazën tjetër eliminimin e Shtetit Islamik që është shpallur në territorin e Irakut dhe të Sirisë.

Marrëdhëniet Shqipëri-SHBA fillojnë në vitet e hershme të shekullit të XX, kur Presidenti amerikan Uillson i ofroi mbështetjen e nevojshme dhe të domosdoshme shtetit të ri shqiptar, për njohjen e tij. Marrëdhëniet diplomatike midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë u rivendosën më 15 mars 1991, pas një ndërprerjeje prej 52 vjetësh. Fillimisht marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve ishin vendosur më 28 korrik 1922.

Ka rreth 27 traktate dhe marrëveshje të nënshkruara midis Shqipërisë dhe SHBA-ve në fusha të ndryshme ku veçohet fusha e drejtësisë dhe policisë, atë të ekonomisë, transportit, të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe fushën e kulturës[144]. Të dy

143 Jusuf Buxhovi, Kthesa historike-Vitet e Gjermanisë dhe Epoka e LDK-së, (Prishtinë: Faik Konica 2008), f. 226.

144 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. http://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-me-shtetet-e-bashkuara-te-amerikes.

vendet, SHBA dhe Shqipëria, si aleate në NATO, kontribuojnë për rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në botë. Shqipëria ishte ndër vendet e para që iu bashkua koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit dhe ISIL, nën lidershipin e SHBA-ve[145]. Deklarata e Përbashkët për Partneritet Strategjik Shqipëri-SHBA, nënshkruar më 20 prill 2015 pasqyron më së miri marrëdhëniet e partneritetit mes dy vendeve. Ky dokument fokusohet në partneritetin mes dy vendeve në tre plane: partneritet për çështjet globale; partneritet për çështjet rajonale dhe partneritet për agjendën dypalëshe – dialogu politik, siguria, forcimi i shtetit të së drejtës në Shqipëri, zhvillimi ekonomik, siguria energjetike dhe shkëmbimet arsimore-kulturore.

Marrëdhëniet me SHBA janë të rëndësisë parësore dhe strategjike për Shqipërinë. SHBA janë aleati dhe partneri ynë strategjik, ndëra niveli i marrëdhënieve dypalëshe vlerësohet i shkëlqyer. Këto marrëdhënie kanë hyrë në fazën e partneritetit. Partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara përbën një nga themelet e politikës së jashtme të RSH. Qeveria shqiptare është e angazhuar maksimalisht për të qenë partner i vendosur përkrah SHBA në drejtim të zhvillimeve demokratike, të ruajtjes së stabilitetit, paqes e prosperitetit në rajonin tonë e më gjerë, të konsolidimit të ekonomisë së tregut, të luftës kundër terrorizmit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Mbështetja e SHBA-ve ndaj kombit shqiptar në këtë punim është ndarë në dhjetë momente dhe pikëvështrime të ndryshme, bërë sipas një renditje kronologjike dhe mbështetur në të dhëna e fakte historike. Pasqyrimi i rolit të SHBA-ve starton me fillimin e shekullit të XX-të e deri në ditët tona me përkrahjen e institucioneve demokratike në Shqipëri.

Pjesët përbërëse të këtij punimi janë si vijon: I. Pavarësia më 28 Nëntor 1912; II.Konferenca e Paqes në Paris 1919; III. Diplomacia Amerikane pro Shqipërisë në vitet 20-të; IV. Qëndrimi i SHBA-së gjatë Luftës së Dytë Botërore; V. Mbështetje për rrëzimin e Komunizmit; VI. Përkrahje e Shqipërisë kundër armiqve të saj; VII.Nxitje e shteteve Perëndimore për të mbështetur Shqipërinë; VIII. Pavarësia e Kosovës; IX. Konsolidimi I Demokracisë dhe Reforma në Drejtësi.

PAVARËSIA MË 28 NËNTOR 1912

Kombi shqiptar duhet ti jetë mirënjohës Amerikës prej një burri të quajur *Charles TelfordEricson* që erdhi në Shqipëri në 1908 dhe pasi njohu mirë Shqipërinë dhe shqiptarët duke i quajtur "zambaku i Ballkanit" u bë i huaji i parë flamurtar që punoi për pavarësinë e Shqipërisë nga Turqia. Në shumë shkrime në gazetat amerikane dhe angleze që nga mbërritja në Shqipëri deri në 1913, Ericson i bëri jehonë e asaj që po bëntë Evropa ndaj Shqipërisë por dhe masakrat e Serbisë dhe Greqisë ndaj popullisë shqiptare.

Përkrahja e shqiptarëve ndaj SHBA-ve daton me përpjekjet e tyre për të krijuar shtetin shqiptar me rënien e Perandorisë Otomane në Ballkan. Shqipëria u shpall

145 Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.. http://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-me-shtetet-e-bashkuara-te-amerikes/.

shtet nga shqiptarët në vitin 1912, por, në të vërtetë, u deshën edhe tëtë vite të tjera dhe një Konferencë Ndërkombëtare që ajo të ketë të gjitha garancitë dhe kufijtë e saj të jenë të paprekur. Pasi dolën nga Lufta e Parë Botërore si vendi me prodhimin më të lartë në botë, larg shkatërrimeve që kishin goditur kontinentin dhe e udhëhequr nga Presidenti Udro Uillson, SHBA-të hynë në skenën ndërkombëtare si element i pakalueshëm në vendimmarrje. Gjatë Konferencës së Parisit, Presidenti Uillson promovonte parimet e lirisë dhe të vetëvendosjes për popujt që kishin dalë nga rënia e tri Perandorive: Otomane, Austro-Hungareze, Rusisë-Cariste. Edhe më parë, ai kishte shprehur idetë e tij për lirinë, duke kritikuar imperializmin evropian që gjithë Luftën e Parë Botërore e kishte bërë për interesa të Monarkive. Presidenti Uillson paraqiti në Kongres, më 22 janar 1917, në fjalimin e tij, konceptin paqe pa fitues[146], dhe një vit më vonë, më 8 janar 1918, në të cilin renditi 14 pika bazë që duhej të respektoheshin për të mos pasur më konflikte ndërkombëtare. Tezat kryesore ishin: Lidhja e Kombeve, liria dhe vetëvendosja për popujt dhe vendet e vogla që nuk kanë nevojë më për patronat të një superfuqie, por bëhen pjesë e konceptit të sigurisë kolektive ndërkombëtare duke flakur marrëveshjet bilaterale dhe aleancat e fshehta që kishin mbizotëruar në Evropë për gati dy shekuj. Ky plan ishte në favor të Shqipërisë, por më e rëndësishmja ishte në disfavor të fqinjëve të saj që donin ta copëtonin territorialisht.

KONFERENCA E PAQES NË PARIS 1919

Kombi shqiptar duhet t'i jetë përsëri mirënjohës presidentit të 28-të të SHBA-ve Thomas Woodrow Wilson, i cili në Konferencën e Paqes në Paris 1919, mbështetur në doktrinën e vetëvendosjes së popujve mbështeti fuqimisht rinkonfirmimin e pavarësisë së Shqipërisë që në realitet, në ato momente ishte një pavarësi e humbur. Ishte vetoja e Wilson ndaj Shqipërisë që shkatërroi planet e Evropës dhe sidmos të Serbisë, Greqisë dhe Italisë për të eleminuar dhe fshirë nga harta shtetin shqiptar. Sa kuptimplotë është të lexosh sot pas 99 vjetësh atë që Wilson tha ato ditë në Paris: "Amerika e ka për detyrë të pranojë thirrjet e shqiptarëve, të cilët kërkojnë ndihmë, njëlloj sikurse kapiteni i anijes e ka për detyrë ti përgjigjet sinjalit SOS dhe ti afrojë ndihmë anijes që po mbytet"[147].

Në janar të vitit 1920, në Konferencën e Parisit, fuqitë evropiane, në mungesë të negociatorëve amerikanë, vendosën ta ndajnë Shqipërinë mes Jugosllavisë, Greqisë dhe Italisë. Shqiptarët u organizuan për të mos pranuar asesi një ndarje të tillë dhe krijuan Asamblenë Kombëtare Shqiptare, në *Kongresin e Lushnjës*, ku përpos ndarjes proporcionale të përfaqësimit, u caktua edhe një vend deputeti për komunitetin Shqiptaro-Amerikan që ishte mjaft i konsiderueshëm në SHBA. Presidenti Uillson vendosi që në mars të vitit 1920 ta pranojë Shqipërinë në kufijtë ekzistues duke

146 Për më shumë, Knock, Thomas To end all wars: Woodrow Wilson and the Quest for a New World Order,(Princeton: University Press. Reprint 1995).

147 Dokumenti i Sekretarit Hoover për Departmentin e Shtetit, Nr. 875.6363/21 26 Prill 1922 Foreign Relations ofthe United States, 1922 Vol 1 f. 596.

sfiduar Marrëveshjen e Parisit dhe evropianët. Të njëjtën gjë bëri edhe Lidhja e Kombeve në dhjetor1920 dhe me këtë filloi një epokë e re e raporteve Shqipëri-SHBA. Ato u jetësuan në formë diplomatike në vitin 1921, kur delegacioni shqiptar u takua me Ambasadorin e SHBA-ve në Romë, ku përpos të tjerash, kompanive amerikane u mundësohej hulumtimi dhe e drejta e koncesionit për rezervat e naftës në Shqipëri. Sekretari i Tregtisë, Hoover udhëzoi Sekretarin e Shtetit të marrë parasysh këto zhvillime dhe të merret në mbrojtje preferenciale Shqipëria pikërisht për shkak të bashkëpunimit ekonomik.[148]

DIPLOMACIA AMERIKANE PRO SHQIPËRISË NË VITET 20-TË

Më 22 korrik 1922, Diplomacia Amerikane arriti të vendosë marrëdhënie zyrtare diplomatike me Shqipërinë duke i dhënë prioritet këtyre marrëdhënieve nëpërmjet një sërë vendimesh. Jo vetëm statusi i kombit të favorizuar më 28 dhjetor 1925, jo vetëm heqja e vizave me Shqipërinë, por ndërtimi i godinës së ambasdës amerikane në Tiranë me vendimin e 21 Gushtit 1926 për 60 mijë dollarë, e para godinë që Departamenti i Shtetit ndërtoi jashtë SHBA-ve, tregoi për vizionin e qartë të marrëdhënieve të SHBA-së me Shqipërinë.

Si vitrinë e këtyre marrdhënieve qendron marrëveshja unikale e ekstradimit mes presidentit Franklin Delano Rosevelt me mbretin Ahmet Zogu në vitin 1937, që tregon shkallën e nivelit të këtyre marrëdhënieve.

Më 28 korrik 1922, SHBA-të e pranuan edhe de-jure Shqipërinë duke dërguar emisarin U. Grant-Smith në Tiranë duke filluar marrëdhëniet bilaterale në mes të dyja vendeve. Në të njëjtën kohë, Ahmet Zogu u caktua Kryeministër i Shqipërisë. Por, këto nuk ishin edhe kohëra të stabilitetit politik. P,sh. prej korrikut e deri në dhjetor 1921, Shqipëria kishte ndërruar pesë kryeministra. Një seri rrethanash negative, vrasja e dy turistëve amerikanë, më 6 prill 1924, në pjesën veriore të Shqipërisë, vrasja e Avni Rrustemit, politikan prominent, më 5 maj të po atij viti, krijoi kushtet e një revolucioni, i cili e solli Fan S. Nolin, Peshkopin Ortodoks të shkolluar në Harvard, në krye të Shqipërisë, ndërsa Zogun e dërgoi në ekzil. Por, qeveria e tij llogaritej kuazi-e majtë dhe apeli i tij drejtuar Rusisë Sovjetike nuk ishte i mirëseardhur as i mirëpritur për SHBA-të. Ato mbajtën raportet me Shqipërinë, por sipas qëndrimeve të Sekretarit të Shtetit Hughes [illegible]nëse nuk ndërrohet kreu i Qeverisë, çështja e njohjes së Shqipërisë mbetet e hapur.[7] Para Krishtlindjeve, Zogu u kthye nga ekzili së bashku me përkrahësit e tij dhe me mbi 1000 forca të rregullta jugosllave dhe ruse e rrëzoi Qeverinë e Nolit. Më 1 shkurt 1925, Zogu u bë President i Shqipërisë dhe duke e ditur rëndësinë e SHBA-ve e dërgoi emisar në SHBA Faik Konicën, një lider prominent të Lëvizjes Kombëtare. Konica ishte zyrtari i parë shtetëror në SHBA dhe ndonëse ende pa përfaqësi të fiksuar diplomatike zhvillonte aktivitetet e tij pa ndaluar.

148 Ibid.

QËNDRIMI I SHBA-SË GJATË LUFTËS SË II-TË BOTËRORE

Më 1 shtator 1928, Zogu e proklamoi Shqipërinë Monarki dhe nën instruksionet dhe presionet italiane u kurorëzua Mbret i Shqipërisë. Këtë ndërrim e njohën SHBA-të si vullnet të vetë shqiptarëve duke hequr mëdyshjet e fqinjëve të Shqipërisë. Përfaqësuesi i SHBA-ve në Shqipëri, Hart, e dërgoi këtë mesazh për Mbretin, por edhe e njoftoi Departmentin e Shtetit për përkrahjen e madhe që gëzojnë SHBA-të në Tiranë[149]. Në këtë periudhë Shqipëria nënshkroi disa marrëveshje tregtare bilaterale me SHBA-të [150]. Në të njëjtën kohë fashizmi në Itali ishte në kulminacionin e zhvillimit dhe Shqipëria kishte qenë gjithëerë në planet e Musolinit si tokë që duhej pushtuar. Ai e realizoi këtë në prill të vitit 1939. Një ditë para invazionit italian, Mbreti Zog, së bashku me familjen braktisën Shqipërinë dhe shqiptarët [151].

Sulmi italian u denoncua nga Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, Cordell Hull përmes një deklarate për shtyp[152]. Pas pushtimit italian në Tiranë u instalua një qeveri kukull fashiste, Monarkia shqiptare u shpërnda ndërsa froni i Shqipërisë iu ofrua Mbretit Italian Victor Emmanuelit për të realizuar edhe formalisht Bashkimin Itali-Shqipëri më 16 prill 1939. Si reagim, SHBA-të më 12 qershor 1939 mbyllën përfaqësinë diplomatike në Tiranë dhe si rezultat u mbyll edhe ajo e Shqipërisë në SHBA. SHBA-të nuk i shkëputën anjëherë marrëdhëniet me Mbretin Zog, por edhe nuk e njohën Qeverinë në ekzil. Italia e përdori Shqipërinë për ta sulmuar Greqinë dhe së bashku me Gjermaninë naziste korrën fitore në Greqi dhe në Jugosllavi. Në maj 1941, Gjermania ia dorëzoi kontrollin mbi Kosovën Italisë dhe pjesët e Greqisë Veriore me popullatë shumicë shqiptare. Është ironike se ëndrra e shqiptarëve për bashkimin e trojeve të tyre u realizua përmes Fuqive të Boshtit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore raportet SHBA-Shqipëri morën një dimension tjetër me kryengritjen e shqiptarëve të armatosur, nën udhëheqjen e Lëvizjes Nacional-çlirimtare. SHBA-të ishin pro lëvizjeve të armatosura kundër forcave të Boshtit dhe prapë e shpëtuan Shqipërinë nga një kërkesë e çuditshme që erdhi nga Qeveria Greke për aneksimin e Shqipërisë Jugore (për grekët Vorio Epiri) të cilën Nën-Sekretari i Shtetit, Sumner Wells e refuzoi menjëherë si të pabazë[153]. Në Shqipëri kishte dy fraksione të armatosura që kishin dallime ideologjike: Balli Kombëtar - nacionalist dhe Lëvizja Nacionalçlirimtare - komuniste. Dallimet e tyre ideologjike ishin në plan të dytë për SHBA-të dhe aleatët e tjerë që ishin të interesuar për ta mposhtur Boshtin. SHBA-të në Shqipëri dërguan agjentët e OSS, organizatës paraardhëse të CIA-s, për të ndihmuar luftën kundër forcave fashiste dhe naziste. Kryesisht edhe agjentët anglezë kishin hyrë në Shqipëri me të njëjtin qëllim, por ata iu afruan më shumë partizanëve të LNÇ-së, sepse këta ishin më konkretë. Gjatë

149 Letra e diplomatit Hart për Departmentin e Shtetit, Shtator 27, 1928. The Foreign Relations of the UnitedStates 1928, 1943.

150 Marrëveshjen e Arbirtaritetit, 1928 Marrëveshjen e Mirëkuptimit 1928, Marrëveshjen e Naturalizimit 1932, Marrëveshjen e Ekstradimit 1933.

151 Stanley G. Payne, A History of Fasscism 1914-194.

152 New York Times, 9 prill, 1939.

153 US Foreign Relations, 194, Vol II, f. 828-82.

viteve 1943 dhe 1944 mbi 50 oficerë britanikë dhe disa amerikanë operonin në Shqipëri në ndihmë forcave që luftonin forcat e Boshtit[154].

Pasi u bindën që Balli Kombëtar nuk ishte kooperativ, në verën e vitit 1943, SHBA-të ndërprenë programin e furnizimit me armë, ndërsa oficerët anglezë u tërhoqën nga Shtabi i Ballit Kombëtar. Britanikët, në mes të vitit 1944 e inkurajuan udhëheqësin e partizanëve, Enver Hoxhën që të fillojë së krijuari Këshillin Çlirimtar Kombëtar dhe të bëhet gati për qeverisjen e Shqipërisë pas Luftës. Në tetor 1944, nga ky Këshill, pas intervenimit të Titos nga Jugosllavia, u emërua Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Hoxha kërkoi nga aleatët ta njohin qeverinë e tij dhe në nëntor 1944, Shqipëria kërkoi njohje formale edhe nga SHBA-të. SHBA-të kishin shpresuar se edhe me këto zhvillime do të arrihej pajtimi mes forcave nacionaliste dhe atyre komuniste, por ajo nuk ndodhi. Udhëheqësit e Ballit Kombëtar dhe Legalitetit braktisën Shqipërinë dhe fillimisht u vendosën afër portit të Brindisit në Itali. Hoxha kërkonte t'i dorëzoheshin atij, sepse i quante kriminelë lufte, por forcat amerikane në Itali nuk morën parasysh një kërkesë të tillë me arsyetimin se çështja e kriminelëve të luftës duhej të vërtetohej e mëpastaj të rregullohej ekstradimi me marrëveshje të posaçme[155].

Shtetet e Bashkuara të Amerikës përmenden të jenë i vetmi shtet në botë që denoncoi pushtimin e Shqipërisë nga Italia më 7 prill 1939. Ndërsa Evropa nuk e quajti as lajm këtë pushtim, SHBA ende asnjanëse në atë kohë ndaj luftës, bëri çmos që ta ekspozonte dhe dënonte aktin e pushtimit. Vlen të përmendet se mbasadori amerikan në Tiranë në atë kohë Hugh Grant, më 6 prill i afroi mbretit Zog tre pasaporta, për të, për mbretëreshën Geraldinë dhe për Lekën 1-ditësh për t'u strehuar në ambasadën amerikane në Tiranë duke i marrë në mbrojtje. Zogu nuk pranoi, por, nëse do ta bënte këtë, historia do të shkruhej ndryshe...

MBËSHTETJE PËR RRËZIMIN E KOMUNIZMIT

Ndonëse pati një indiferencë nga shtetet e Evropës Perëndimore ndaj Shqipërisë pas konferencës së Jaltës, SHBA-të kanë qenë të vëmendshme që vendi ynë të ishte jashtë orbitës komuniste. Në fund të viteve 80-të angazhimi dhe impenjimi i SHBA-ve ndaj Shqipërisë ka qenë në atë shkallë që asnjë shtet amerikan nuk e ka patur. Vetëm radioja shtetërore e Departamentit të Shtetit, "Zëri i Amerikës" ka luajtur nj rol të jashtëzakonshëm në rrëzimin e komunizmit, dhe jo vetëm.

Marrëdhëniet me regjimin e Hoxhës gjithmonë kanë qenë të ndieshme për amerikanët dhe gjithnjë ka ekzistuar një atmosferë e mosbesimit të ndërsjellë. Megjithatë, SHBA-të ishin më të kujdeshme se Britania e Madhe dhe nuk donin të krijonin mendim për forcën qeverisëse të Hoxhës pa e parë në vepër. Për dallim prej tyre, britanikët që kishin qenë më afër Hoxhës i kishin parë ndikimet sovjetike dhe jugosllave në pikëvështrimet e tij dhe ishin tani pro largimit të tij nga pushteti edhe me mjete dhune.

154 Që në vitin 1940 anglezët kishin krijuar ekipin —Special Operation Executivell me qëllim që të inkurajojnë forcat anti-Bosht në Shqipëri. Për më shumë Julian Amery Sons of the Eagle: A study in Guerilla War. (London: MacMillan 1948).

155 US Foreign Relations, 1945, Vol IV, f. 42.

Më 4 tetor 1945 u mbajt një takim konsultativ në Londër në Foreign Office, ndërmjet përfaqësuesve të Britanisë së Madhe dhe SHBA-ve për të vendosur rreth pranimit të Shqipërisë dhe Qeverisë së Hoxhës. Ata u dakorduan që ta pranojnë Shqipërinë pas mbajtjes së zgjedhjeve të lira në vend. Mirëpo, veprim të kundërt bëri Bashkimi Sovjetik, i cili njohu Shqipërinë në krye me Hoxhën më 10 nëntor 1945. SHBA-të kishin edhe kushte të tjera përpos zgjedhjeve: që Shqipëria të respektojë marrëveshjet që kishte arritur Mbreti Zog me SHBA-të si dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike të varej nga hapat e parë të Hoxhës. Hoxha pranoi kushtin për zgjedhjet, të cilat do të monitoroheshin nga shtypi i lirë, por pas fitores në zgjdhje në Shqipëri me rreth 93% të përkrahjes ai nuk pranoi të zbatonte marrëveshjet e Mbretit Zog.

Kështu, dalngadalë, Shqipëria rrëshqiti në Bllokun Sovjetik. Sepse vetë Britania e Madhe ishte më e përqëndruar të jetë e pranishme në Greqi, ndërsa SHBA-të, në politikën e jashtme të pasluftës, fare apo aspak nuk mendonin për Ballkanin sepse kishin zotime në Gjermani dhe në Japoni, që për ta ato ishin të rëndësisë vitale. Edhe ekonomikisht Shqipëria nuk ishte e vlefshme, sepse SHBA-të kishin më shumë tregti me Jugosllavinë, Bullgarinë dhe Rumaninë[156].

Në vitet në vijim, Shqipëria më shumë mori kursin e Jugosllavisë dhe të Bashkimit Sovjetik kundrejt SHBA-ve. Gabime janë bërë edhe nga ana e SHBA-ve me neglizhimin e zhvillimeve në Shqipëri. Periudha 1945-1947 u tregua të jetë kruciale për Shqipërinë, sepse e vendosi në sferën sovjetike të influencës dhe automatikisht raportet me SHBA-të u ngrinë. Ato do të mbesin të tilla për dyzet vjet deri në rënien e komunizmit në vitet 1991-1992.

PËRKRAHJA E SHQIPËRISË KUNDËR ARMIQVE TË SAJ

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një kontribut të jashtëzakonshëm për përkrahjen që i kanë dhënë Shqipërisë në shumë momente deçisive kur fqinjët tanë kanë synuar ose t'i marrin toka dhe territore ose t'a dobësojnë si shtet. Janë një sërë situatash në këto 107 vjet shtet shqiptar që Serbia, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut kanë treguar deri agresione ushtarake ndaj Shqipërisë, por SHBA në çdo rast u kanë thënë "ndal". Ky pretendim është faktuar me të dhëna historike në argumentat e paraqitura më sipër.

NXITJE E SHTETEVE PERËNDIMORE PËR TË MBËSHTETUR SHQIPËRINË

Nëse pas rrëzimit të komunizmit Evropa Perëndimore ka treguar mbështetje ndaj Shqipërisë, kjo ka qenë e inspiruar dhe nxitur padyshim nga SHBA. Është vepra e diplomacisë dhe shtetit amerikan që Evropa t'a tërhiqte në gjirin e vet Shqipërinë, e cila gjeografikisht gjithsesi është pjesë e kontinentit. Tashmë Shqipwria është në një proces pa kthim për t'u bërë një ditë pjesë e Bashkimit Evropian. Kordinimi i diplomacisë amerikane me atë evropiane, ka qenë i pandërprerë dhe vazhdon me të njëjtin temp edhe sot.

156 Bilanci tregtar me Shqipërinë në vitin 1939 ishte 280.000 USD, me Jugosllavinë 9 milionë USD, me Rumaninë 12 milionë USD sipas kartës së tregtisë së kohës Geir Lundestad US Trade Assets in Eastern Europebefore the war, f. 478-479.

PAVARËSIA E KOSOVËS

Shpallja e pavarësisë së shtetit të Kosovës më 17 shkurt 2008 është rezultat i pragmatizmit amerikan në afirmimin e vlerave liridashëse dhe promovimit të demokracisë në botë nga ky vend. Kjo është ngjarja më e madhe dhe më e rëndësishme në historinë e shtetit shqiptar pas 28 nëntorit 1912 të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Pas afro 100 vjet që Serbia e kishte bërë pjesë të saj Kosovën, SHBA arriti t'a shkëpusë prej saj dhe t'i japë pavarësinë e humbur prej një shekulli.

Shkatërrimi i përgjakshëm i ish Jugosllavisë ishte një shtytje për një kujdes më të shtuar nga bashkësia ndërkombëtare, e sidomos nga SHBA-t, në moslejimin e edhe të një tragjedie njerëzore, e cila do të rëndonte ndërgjegjen e politikbërësve të kohës. Shqiptarët për dhjetë vite rezistuan paqësisht kundër nacionalizmit ekspansionist serb, por zëri i tyre, përkundër simpative, nuk mjaftoi për të tërhequr kujdesin e duhur ndërkombëtar pa hyrë në ciklin e dhunës ndëretnike. Dukej se një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare kishte iluzion vazhdimin e qëndrimit të ish federatës, ashtu siç do të konsideronte edhe mundësinë e gjetjes së zgjidhjes së çështjes së Kosovës brenda një mbetjeje serbo-malazeze, apo më vonë brenda Serbisë. Pavarësinë e tyre, kombet e ish Federatës Jugosllave, e paguan me humbjen e qindra mijëra jetëve, si pasojë e të udhëhequrit nga mitet e besëtytnitë e trilluara mesjetare, mbi të cilat u formësua ideologjia serbomadhe, pararojë e së cilës do të qëndrojë Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë[157].

Përkrahja amerikane për Kosovën duhet shikuar si përkrahje globalizimit të demokracisë dhe respektimit të identitetit individual e kolektiv e si përpjekje për t'i ndalë tiranitë e autokratëve në vendet me deficit demokratik. Ajo kishte nisur me nxjerrjen në pah të sjelljeve përbuzëse të regjimit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, me përkrahjen humanitare e ekspertizë, me kontributin e saj gjatë ndërhyrjes ushtarake për ta ndalur eksodin e popullsisë, e pas luftës duke e ndihmuar atë në ngritjen e institucioneve demokratike, në zhvillimin ekonomik e asistim në tejkalimin e ngërçeve politike të paraqitura si pasojë e brishtësisë së institucioneve të Kosovës së pasluftës. Politika e ShBA-ve ndaj Kosovës përfshinë përkrahjen në respektimin e të drejtave të njeriut deri te vetëvendosja për popullin e Kosovës.

Sot kombi shqiptar ka dy shtete shqiptare, një konsekuencë që njihet si produkt ekskluziv i SHBA-së, pasi nuk do të kishte ndodhur nëse NATO nuk do të kishte ndërhyrë.

ANËTARËSIMI I SHQIPËRISË NË NATO DHE POLITIKA E JASHTME AMERIKANE NË VENDET ISH-KOMUNISTE

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO më 1 prill 2009 është një ngjarje e madhe politike. Mbështetja që diplomacia dhe shteti amerikan i ka dhënë Shqipërisë në këtë anëtarësim ishte dhe mbetet një punë e përhershme dhe ekskluzive e shtetit

157 Samet Dalipi, *SHBA dhe Kosova: Nga të Drejtat e Njeriut te Pavarësia*, (Universiteti AAB, Prishtinë), Thesis, nr.1, 2013) , f.39.

amerikan. Që nga ai moment Shqipëria jo vetëm është një vend më i sigurtë, por është pjesë e Aleancës më të madhe që ka njohur njerëzimi.

Pas fitores së forcave demokratike, 22 marsit 1992 në krye me Partinë Demokratike të Shqipërisë, raportet SHBA-Shqipëri filluan të ndryshonin dhe bashkëpunimi u rrit dukshëm. Administrata e Presidentit Bush, pas përfundimit të Luftës së ftohtë, ishte treguar e gatshme të bashkëpunonte me të gjitha qeveritë e shteteve të Evropës Lindore që pasuan regjimet komuniste. Megjithatë, në rastin e Shqipërisë, interesimi ishte edhe më i shtuar dhe më i veçantë për shkak të konfliktit në Jugosllavi dhe pozitës së shqiptarëve të Kosovës. Në fakt, SHBA-të dhe NATO ishin mjaft të brengosura për skenarin e destabilizimit të përgjithshëm të Ballkanit, që e kishin paraparë në studimet gjeostrategjike, që do të mund të ndodhte lehtë nëse Shqipëria nuk përkrahej edhe në sferën e sigurisë dhe nëse shqiptarët e Kosovës liheshin të pambrojtur para forcave serbe të sigurisë. Kështu, përkrahjen e forcave demokratike, të udhëhequra nga Partia Demokratike, disa analistë e shpjegonin jo vetëm në prizmin e shpërndarjes së demokracisë në vendet ish-komuniste, por si përpjekje të planifikuar seriozisht për t'iu kundërvënë ndikimit politik të Serbisë, që mbështetej në lidhjet e ngushta me Rusinë[158].

Për këtë arsye, Aleanca Veriatlantike e shpejtoi planin për integrimin e Shqipërisë në strukturat e sigurisë. Shqipëria edhe zyrtarisht paraqiti kërkesën për anëtarësim në NATO, ndërsa më vonë, në qershor 1992 edhe do të pranohej në Këshillin e Bashkëpunimit Veriatlantik. NATO kishte themeluar Këshillin e Bashkëpunimit Veriatlantik me qëllim të ofrimit të ndihmës shteteve dikur anëtare të Paktit të Varshavës në proceset e tyre demokratike si dhe në pranimin e ekonomisë së tregut.

Presidenti Bush, në dhjetor 1992, përmes Ambasadës së SHBA-ve në Beograd, u dërgoi një porosi të qartë autoriteteve në Beograd se në rast të eskalimit të konflikteve në Kosovë, SHBA-të janë të gatshme të intervenojnë ushtarakisht edhe pa aleatët evropianë.

Po të njëjtën porosi do ta përsërisin zyrtarët e administratës së Presidentit Bill Clinton vetëm disa javë pas inaugurimit të tij[159]. Sipas parimeve të politikës së jashtme të Presidentit Clinton, SHBA-të u bënë lideri kryesor në botë në promovimin e dinjitetit njerëzor dhe demokracisë si dhe të Drejtave elementare të Njeriut, dhe për të arritur këtë qëllim, SHBA-të asnjëherë nuk duhet të veprojnë si forcë e vetme, dhe asnjëherë nuk duhet të veprojnë duke tejkaluar mundësitë e veta politike dhe ushtarake[160].

Bazuar në këto parime, SHBA-të intensifikuan ndihmën dhe përkrahjen për Shqipërinë pas zgjedhjeve të vitit 1992, posaçërisht në planin e sigurisë kombëtare dhe të përafrimit me aleancën veriatlantike.

Fillimet e bashkëpunimit të institucionalizuar të Shqipërisë me NATO-n fillojnë me Aantarësimin e vendit tonë në Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut

158 Miranda Vickers dhe James Pettifer, *Nga anarkia te një identitet Ballkanik*, (Tiranë: Toena 1998), f. 89.

159 Për më shumë për Kërcënimin e Krishtlindjeve *The New York Times,* Shkurt 1993.

160 Ibid.

(NACC) në Qershor 1992. Shqipëria ishte vendi i parë ndërmjet vendeve të ish-bllokut komunist që nënshkroi Dokumentin Themelor te PfP, më 23 shkurt 1994 dhe që kërkoi zyrtarisht anëtarësimin në NATO.

Në Maj të vitit 2003, Shqipëria, Kroacia e Maqedonia, nën kujdesin dhe praninë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nënshkruan "Kartën e Partneritetit të Adriatikut" ose A-3. Kjo nismë shprehte një pranim dhe angazhim të përbashkët për paqen dhe stabilitetin e Evropës Jug-Lindore duke i shërbyer bashkëpunimit për të motivuar e shtyrë progresivisht vendet e rajonit më pranë strukturave Euro-Atlantike, me synim të fundit anëtarësimin e plotë në NATO.

Samiti i Stambollit, në qershor 2004, krahas agjërimit të Aleancës, konfirmoi "Politikën e Dyerve të Hapura" të Aleancës. Pavarësisht se anëtarët e A-3 nuk morën ftesë për anëtarësim, Samiti njohu dhe vlerësoi progresin e tyre dhe posaçërisht të Shqipërisë në zbatimin e Programeve Kombëtare Vjetore në kuadër të MAP, si dhe rolin konstruktiv të politikës së jashtme shqiptare për stabilitetin rajonal.

Në Samitin e Aleancës në Riga, Letoni në nëntor 2006, Aleanca ofroi për Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë statusin e kandidatit, si dhe mundësinë e marrjes së ftesës për anëtarësim në Samitin e ardhshëm të saj.

Në Samitin e Bukureshtit, që zhvilloi punimet në datat 2-4 prill 2008, NATO ftoi Shqipërinë dhe Kroacinë për anëtarësim në Aleancë[161]. Pas dy raundesh bisedimi midis Shqipërisë dhe Aleancës, Protokollet e Anëtarësimit të Shqipërisë në NATO u nënshkruan në Bruksel më 9 korrik 2008.

Me depozitimin e instrumentit të aderimit në NATO, më datë 1 prill 2009, Republika e Shqipërisë u bë Palë e Traktatit të Uashingtonit dhe shtet anëtar i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Pas anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë, Misioni i Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s u shndërrua në Përfaqësi të Përhershme të Shqipërisë në NATO, ndërsa Ambasadori i Shqipërisë pranë NATO-s u akreditua si Përfaqësues i Përhershëm i Shqipërisë në Këshillin e Atlantikut të Veriut[162].

Qeveria e re e dalë nga zgjedhjet e 23 Qershorit 2013, i rishpallën edhe një herë në mënyrë më të fokusuara synimet e Shqipërisë dhe angazhimin përkatës për të përshpejtuar zbatimin e detyrimeve. Përmbushja e angazhimeve si vend anëtar i NATO-s dhe procesi i anëtarësimit në BE përbën për ne një objektiv kombëtar përcaktues për të ardhmen e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Partneritetet strategjike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian përbëjnë dy themelet kryesorë të politikës sonë të jashtme.

Përmbushja e angazhimeve që burojnë nga anëtarësimi i Shqipërisë në NATO përbën për ne një prioritet. Ndërkohë që kontributin ushtarak në misionet ndërkombëtare paqeruajtëse apo ndërtimin e paqes, do ta shoqërojmë me një kontribut civil e diplomatik në përputhje me mundësitë tona. Marrëdhëniet me SHBA do të thellohen në të gjitha aspektet e politikës së jashtme, duke filluar që nga proceset informative të analizës dhe ato të parashikueshmërisë strategjike, deri tek diplomacia publike.

161 Maqedonia nuk u ftua jo për shkak standardesh, por për problemet e vetos Greke lidhur me çështjen e emrit.

162 Shih faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.

KONSOLIDIMI I DEMOKRACISË DHE REFORMA NË DREJTËSI

Angazhimi i SHBA-së për vendosjen e demokracisë në Shqipëri është i jashtëzakonshëm. Nuk ka asnjë situatë, rrethanë apo ngjarje e madhe politike që SHBA të mos mbështesë dhe inkurajojë politikën shqiptare për të zhvilluar demokracinë. Vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit James Becker më 6 qershor 1991 dhe vizita historike më 10 qershor 2007 e presidentit George W. Bush dhe më vonë edhe të Sekretarëve Hillary Clinton dhe Madaleine Allbright janë shembuj të kësaj mbështetejeje.

Sipas ish Ambasadorit amerikan Donald Lu reforma në Drejtësi është "reforma më e rëndësishme në 25 vite që nga rënia e komunizmit"[163]. Reforma në Drejtësi sipas Ambasadorit "Ka mundësinë të çlirojë sistemin gjyqësor shqiptar nga gjyqtarët e korruptuar dhe prokurorët që vjedhin paratë e qytetarëve të zakonshëm dhe lejojnë figurat e krimit të organizuar, vrasësit dhe politikanët e korruptuar të blejnë drejtësinë" [164]. Ky është një udhëzim direkt nga zyrtarë të lartë në Shtëpinë e Bardhë dhe në Departamentin e Shtetit. Ambasadori konfirmon se prioriteti numër një i Qeverisë Amerikane në Shqipëri është të mbështesë reformat e nevojshme për pranimin e Shqipërisë në BE. Synimi i reformës në Drejtësi është një sistem gjyqësor i çliruar nga korrupsioni dhe inkompetenca. "Do të jetë një sistem ku gjyqtarët dhe prokurorët do të japin llogari. Edhe zyrtarët e lartë të qeverisë, parlamentarët dhe zyrtarët lokalë do të japin llogari gjithashtu". SHBA-ja, këmbënguli Lu, "nuk do të gjejë qetësi" derisa procesi të përfundojë.

Sipas Kryetarit të Kuvendit Z. Gramoz Ruçi, vlerësohet fakti që SHBA vazhdojnë ta kenë me prioritet në fokus rajonin e Ballkanit Perëndimor, çka e konfirmoi edhe emërimi nga sekretari Pompeo i Matthew Palmer si i dërguar special për rajonin. Drejtori Kostelancik nënvizoi mbështetjen e SHBA-ve për reformën në drejtësi. Institucionet e reja të sistemit do t'u shërbejnë qytetarëve sot e në të ardhmen dhe do të mundësojnë që shqiptarët të jetojnë në paqe e mirëqenie. "Vettingu është mbështetur dhe do të vazhdojë të mbështetet fort nga SHBA", vuri në dukje Kastelancik[165].

Për implementimin e kësaj reforme do të mbetet për t'u parë në vazhdimësi. Ende nevojitet të mësojmë dhe të aplikojmë gjithashtu rekomandimet e GRECO, dhe të Komisionit të Venecias dhe Këshillit Europian lidhur me reformën në Drejtësi. Më në fund shpresojmë edhe ne Shqiptarët një drejtësi me standarde europiane.

163 Marrë nga: Qëndra për Çështjet e Informimit Publik: http://www.infocip.org/al/?p=11583.

164 Ibid.

165 Agjencia Telegrafike Shqiptare. https://ata.gov.al/2019/09/04/kostelancik-reforma-ne-drejtesi-dhe-vettingu-mbeshteten-fort-nga-shba/

PËRFUNDIM

Ndërsa rajoni i Evropës Juglindore nuk duket të jetë më aq lartë në axhendën e politikës së jashtme amerikane ashtu si në vitet 1990, SHBA vazhdimisht ka treguar përkushtim për integrimin e saj euro-atlantik. Angazhimi amerikan shihet si vendimtar në këtë rajon historikisht të paqëndrueshëm, i dobësuar nga e kaluara e pazgjidhur dhe sfidat në zhvillim. Shtetet e Bashkuara kanë kontribuar shumë në rindërtimin e pas luftës së Ballkanit Perëndimor dhe mbeten padyshim një nga aktorët dhe faktorët kryesorë. ShBA perceptohet në rajon, në terma të përgjithshëm, si një mbështetës i reformave demokratike me një levë dhe besueshmëri të konsiderueshme. Ndikimi dhe prania e tij sa i përket kombit shqiptar sikurse pasqyrohet në këtë punim, rezulton nga 'i paprecedentë' në Kosovë, në i fortë në Shqipëri.

Ky punim ndërmori një rrugëtim kronologjik të angazhimit të SHBA-së në momentet më kyçe të instancave hitorike, politike të kombit shqiptar që nga shekulli i kaluar e deri më sot. Si konkluzion, shqiptarët duket se kanë të drejtë të jenë kombi i cili demonstron përzemërsi dhe miqësi jashtëzakonisht të vërtetë ndaj Shteteve të Bashkuara! Sot kombi shqiptar ka dy shtete shqiptare, një konsekuencë që njihet si produkt ekskluziv i SHBA-së, pasi nuk do të kishte ndodhur nëse NATO nuk do të kishte ndërhyrë.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, nuk kapatur asnjë proces të rëndësishëm në Shqipëri për konsolidimin e institucioneve dhe demokracisë që të mos ketë patur deri më sot mbështetjen e SHBA-së. Angazhimi më i rëndësishëm i SHBA-së ndaj prosperimit të Shqipërisë qëndron edhe mbështetja e saj për Reformën në Drejtësi. Shqipëria ka tmerrësisht dhe urgjentisht nevojë për aplikimin e sa më parë të jetë e mundur të kësaj reforme. Vendi ka vuajtur gjithmonë e më tepër nga moszbatimi i ligjeve, prandaj vetëm një zbatim rigoroz i Reformës në Drejtësi do të bënte të mundur ndër të tjera edhe çlirimin e vendit nga korrupsioni megalopant dhe krimi i organizuar që kanë mbërthyer vendin në vitet e sërzgjatura të tranzicionit. Të shohim...

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia Telegrafike Shqiptare. https://ata.gov.al/2019/09/04/kostelancik-reforma-ne-drejtesi-dhe-vettingu-mbeshteten-fort-nga-shba/
- Bilanci tregtar me Shqipërinë në vitin 1939 ishte 280.000 USD, me Jugosllavinë 9 milionë USD, me Rumaninë 12 milionë USD sipas kartës së tregtisë së kohës Geir Lundestad *US Trade Assets in Eastern Europebefore the war, f. 478-479.*
- Dokumenti i Sekretarit Hoover për Departmentin e Shtetit, Nr. 875.6363/21 26 Prill 1922 *Foreign Relations ofthe United States, 1922 Vol 1 f. 596.*

- Gallup International. http://www.gallup-international.com (16.03.2013).
- Julian Amery *Sons of the Eagle: A study in Guerilla War.* (London: MacMillan 1948).
- Jusuf Buxhovi, *Kthesa historike-Vitet e Gjermanisë dhe Epoka e LDK-së,* (Prishtinë: Faik Konica 2008), f. 226.
- Letra e diplomatit Hart për Departmentin e Shtetit, Shtator 27, 1928. *The Foreign Relations of the UnitedStates 1928, 1943.*
- Maqedonia nuk u ftua jo për shkak standardesh, por për problemet e vetos Greke lidhur me çështjen e emrit.
- Marrëveshjen e Arbirtaritetit, 1928.
- Marrëveshjen e Mirëkuptimit 192.
- Marrëveshjen e Naturalizimit 1932.
- Marrëveshjen e Ekstradimit 1933.
- Ministria e Mbrojtjes.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.http://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-me-shtetet-e-bashkuara-te-amerikes.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. http://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-me-shtetet-e-bashkuara-te-amerikes/.
- Miranda Vickers dhe James Pettifer, *Nga anarkia te një identitet Ballkanik*, (Tiranë: Toena 1998), 89.
- New York Times, 9 prill, 1939.
- Për Kërcënimin e Krishtlindjeve *The New York Times,* Shkurt 1993.
- Knock, Thomas *To end all wars: Woodrow Wilson and the Quest for a New World Order,*(Princeton: University Press. Reprint 1995).
- Qëndra për Çështjet e Informimit Publik: http://www.infocip.org/al/?p=11583.
- Stanley G. Payne, *A History of Fasscism 1914-194.*
- Samet Dalipi. SHBA dhe Kosova: Nga të Drejtat e Njeriut te Pavarësia. (Universiteti AAB, Prishtinë. Thesis, nr.1, 2013) ,39.
- *US Foreign Relations, 194, Vol II, fq828-82.*
- US Foreign Relations, 1945, Vol IV, f. 42.

KONTRIBUTI I SHBA NE ZHVILLIMIN E ARSIMIT SHQIPTAR

Nikollaq Pano
Mediterranean University of Albania
npano@umsh.edu.al

Ira Gjika
Mediterranean University of Albania
ira.gjika@umsh.edu.al

ABSTRACT

Education as the main engine for human capital development has been and remains one of the areas in which the US role for Albania has been prominent in the last 100 years. American pragmatic orientation in vocational training stimulated the creation of the secondary education system at the beginning of the last century. American expertise and consultancy was a crucial factor in restructuring higher education after the 1990s. It promoted and facilitated the development of study programs and curricula suitable for business and the labor market and paved the way for the transfer of new technologies. Preparing generations of managers, executives and entrepreneurs capable of responding to the demands of a market economy is a challenge for any society. For Albania, as well as other transition and developing countries, this challenge was overcharged by the need to create a tradition of private sector education that was lacking in these countries until the end of the Cold War. The American contribution to orient and reorganize Albanian higher education within a broad educational market was the fruit of a long-standing pragmatic tradition. This has led to Albania's educational product being valued and re-evaluated nationally, mostly in terms of employment and self-employment. The historical perspective of this process is the subject of our study and is addressed at the institutional and individual level. From this approach the paper aims to highlight the achievements of the Albanian higher education system in the short and long term, as a result of American influence and funding.

KEYWORDS: higher education, economic development, business, study program, innovation, management.

1. HYRJE

Amerikanët e parë që kanë ardhur në Evropë (gjatë e pas Luftës së Parë Botërore), kanë depërtuar dhe në Shqipëri me misione të ndihmës mjekësore, teknike, arsimore etj. Diplomatë, themelues shkollash, sipërmarrës, shkencëtarë ekspeditash, eksplorues të nëntokës, përfaqësues të institucioneve bamirëse e fetare që erdhën në Shqipëri ne fillimet e viteve 1900 kanë qenë ndër kontribuesit e parë amerikanë që vendosën urat lidhëse ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA (Golemi Z., Golemi A. 2012). Në nivel institucional marrëdhëniet Shqipëri-SHBA fillojnë në vitet e hershme të shekullit të XX, kur Presidenti amerikan Uillson i ofroi mbështetjen e nevojshme dhe të domosdoshme shtetit të ri shqiptar, për njohjen e tij. Marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve u vendosën në korrik 1922, u ndërprenë gjatë Luftës së dytë botërore dhe u rivendosën në mars 1991 (www.MEPJ).

Gjatë gjithë shekullit të kaluar, dhe në vazhdim, investimi në arsim dhe kulturë ka qenë një nga burimet që Amerika ka vënë në dispozicion të vendeve në rajonin e Ballkanit perëndimor për të mbështetur zhvillimin e tyre dhe njëkohësisht ka rritur prezencën në rajon.

Objektivi i këtij punimi është paraqitja në kontekst historik e rolit të individëve dhe institucioneve amerikane në mbështetje të shoqërisë shqiptare, me fokus në zhvillimin e arsimit. Në aspektin metodologjik, punimi e trajton këtë kontribut në dy periudha kohore, përkatësisht në fillimin e shekullit të XX-të dhe në dhjetëvjeçarin e fundit, që përkojnë me faza të rëndësishme të zhvillimit të arsimit. Punimi ndërthur paraqitjen e fakteve historike me analizën e faktorëve dhe elementëve që kanë përcaktuar rrugën e avancimit të arsimit shqiptar, fillimisht të mesëm dhe më pas atij të lartë, nën ndikimin dhe me mbështetjen amerikane.

2. EDUKIM TEORIK DHE PRAKTIK PËR TË NXITUR ZHVILLIMIN E NJË VENDI TË VOGËL NË FILLIM SHEKULLIN E XX-TË

Zhvillimi i gjithanshëm i një vendi ndikohet nga faktorë të natyrës ekonomike dhe jo-ekonomike. Kombinimi i faktorëve të brendshëm të zhvillimit të një vendi me proceset gjeopolitike përgjithësisht kanë përcaktuar rrugën e progresit për vende të vogla si Shqipëria. Në fundin e shekullit te XIX-të SHBA zunë vendin e liderit në zhvillimin ekonomik botëror duke kaluar Anglinë dhe në përgjithësi vendet europiane në termat e rritjes ekonomike (Bakker et al., 2015). Ndikimi i SHBA në sistemet ekonomike dhe politike botërore u rrit gradualisht duke përfshirë edhe rajonin ballkanik.

Pavarësisht distancës gjeografike ndermjet dy vendeve, një vështrim retrospektiv në historinë e marrëdhënieve ndërmjet SHBA dhe Shqipërisë evidenton raporte interesante, sidomos në fushën e arsimit.

2.1. FILLIMET E INVESTIMIT AMERIKAN NË ARSIMIMIN E SHQIPTARËVE

Njohja e parë e amerikanëve me shqiptarët daton në periudhën e vendosjes së Misioneve Evangjeliste Amerikane në territorin e Perandorisë Osmane, pas zhvillimit të Reformave të Tanzimatit (Asllani, 2011). Përshkrimet e asaj kohe, të dokumentuara më pas nga studjuesit, përmendin kontaktet e para të misionarëve amerikanë me rilindasit shqiptarë dhe fëmijët e tyre. Nga këto kontakte misionarët amerikanë vlerësuan dëshirën dhe etjen e madhe të shqiptarëve për arsim, dije dhe kulturë dhe mundësuan kontributet e para, në nivel individual, për shkollimin e të rinjve shqiptarë. Me bursat amerikane në fundin e shekullit XIX, shumë të rinj shqiptarë studiuan në kolegjet dhe institutet amerikane në Prinston, Boston e Filadelfia, por edhe në ato që funksiononin në vende të tjera, gjeografikisht më pranë, si në Bullgari e Turqi.

Në Shqipëri, kontributi i parë ishte hapja në vitin 1908 e Shkollës Amerikane të Vajzave nga çifti misionar Pinears dhe Violete Kennedy. Pavaresisht vështirësive të mëdha, puna e tyre vazhdoi deri në prill të vitit 1912, kur Korçën e pushtuan grekët dhe mbyllën të gjithë shkollat ku mësohej në gjuhën shqipe. Më pas shkolla u ri-hap dhe misionarët e vazhduan punën e tyre deri në vitin 1933, kur në Shqipëri u mbyllën të gjitha shkollat private.

Një tjetër amerikan, që në ato vite e nisi punën e tij pedagogjike në Elbasan, ishte dr. Charles Telford Erickson, por shkollën e tij e mbyllën autoritetet turke që sundonin në Shqipëri në verën e vitit 1910.

Përpjekjet individuale të amerikanëve në vitet e para të shekullit të XX-të u pasuan nga aktivitete më të organizuara në nivel institucional, pas përfundimit të Luftës I Botërore. Në shkurt të vitit 1919, erdhi në Shqipëri një ekip i Kryqit të Kuq i të Rinjve Amerikanë (KKRA) i përbërë nga 60 persona. Ky ekip, në Tiranë, Shkodër, Elbasan, Durrës e gjetkë, hapi dhe rihapi spitale, dispanseri anti-TBC, kundra malaries, edukoi nënat shqiptare me normat higjienike, mblodhi nga rruga fëmijë jetimë dhe i grumbulloi në qendra të veçanta, të cilat më vonë u kthyen në streha vorfnore shtetërore. Por mbi te gjitha spikat roli i vecantë që organizata KKRA ka luajtur në arsimin shqiptar.

Në shtator të vitit 1919, qendra e KKRA në Uashington, dërgoi në Shqipëri përfaqësuesin e saj O. M. Salisbury për të vëzhguar në vend nevojat urgjente të vendit. Pasi e vizitoi Shqipërinë, Salisbury pa me sytë e tij mungesën e plotë të shkollave dhe dëshirën e madhe të shqiptarëve për shkollim, prandaj ai rekomandoi dhënien e bursave për të rinjtë që donin të studionin nëpër kolegjet amerikane të Stambollit, si edhe sugjeroi hapjen në Shqipëri të shkollave të mesme profesionale bujqësore.

Për rrjedhoje, me ndihmën financiare të KKRA dhe nën përkujdesjen e Ministrisë së Arsimit të asaj kohe, në korrik 1921 përfaqësuesi amerikan John Chappel Crawley hapi dyert e të parës shkollë profesionale, Shkollës Teknike Amerikane (Asllani, 2011). Kjo ngjarje shënoi një pikënisje të zhvillimit të arsimit profesional në Shqipëri dhe njëkohësisht hapi rrugën për krijimin dhe përshtatjen e sistemit të arsimit të mesëm në një vend ku shumica e popullsisë ishte analfabete.

2.2. PARIMET E TË MËSUARIT NGA TRADITA AMERIKANE E PERIUDHËS SË PARË TË SHEKULLIT TË KALUAR.

Kalimi i shumë fuqive të huaja në territoret shqiptare ka lënë gjurmë në themelimin e institucioneve arsimore me ndikime të ndryshme, të cilat dallonin jo vetëm nga gjuha në të cilën zhvillonin aktivitetin, por edhe nga aspektet didaktike, orientimi ndaj të mësuarit dhe të vepruarit.

Institucionet shkollore me bazë amerikane të ngritura në Shqipëri dallonin nga disa karakteristika, të cilat sollën ndikim në arsimin shqiptar në përgjithësi, kryesisht në periudhën ndërmjet dy luftrave botërore.

1- Karakteristika e parë e ndikimit të kulturës amerikane në sistemin arsimor shqiptar ishte lidhja e edukimit me nivelin e zhvillimit ekonomik të tregut.

Historia e zhvillimit të sistemit ekonomik në Shqipërinë e viteve 1925-1935 dëshmon futjen e kapitaleve të huaja sidomos nga vendet fqinje por edhe krijimin e një sërë bizneseve të vogla dhe të mesme me kapitale vendase. Në tregun shqiptar hyri për herë të parë shoqëria General Electric me një hidrocentral në Vithkuq, SITA&SESA në Tiranë, Fabrika e duhan cigareve në Durrës, Fabrika e cimentos në Shkodër, etj. Para krizës së madhe te '29-'33 dinamika e rritjes së bizneseve në Shqipëri ishte e ndjeshme dhe u realizua kryesisht ose në infrastrukturën e vendit ose në funksion të zejtarisë dhe bujqësisë. Hartimi i kodit tregëtar dhe i një baze ligjore perëndimore shënoi krijmin e sistemit të menaxhimit të shoqërive aksionere me kapital të huaj shqiptar dhe mix. Ndërsa në vitet 1921-1924 ishin themeluar në tregun shqiptar vetëm dy shoqëri aksionere me kapital 300 mijë franga ari, në periudhën 1925-1928 u krijuan 14 shoqëri aksionere me kapital mbi 7.620 mijë franga (Banja, 2012).

Deri në këto vite industria ishte pothuajse inegzistente dhe ekonomia e vendit mbështetej në sektorin e bujqësisë. Personeli me kualifikim professional vinte nga shkollat e huaja, ndërkohë që në vend mungonte arsimi professional. Për më tepër zhvillimi i arsimit do të duhej të lidhej domosdoshmërisht me zhvillimin dhe modernizimin e bujqësisë dhe blegtorisë, si edhe me fillimin e industrisë. Ishte pikërisht ky orientim i shkollimit nga nevojat e tregut që erdhi si kontribut amerikan, me Shkollën Teknike Amerikane më 1921. Në shkollën e sapohapur, dega më kryesore ishte agronomia dhe, pas asaj dega teknike (mekanikë, elektrikë, ndërtim) si edhe dega e mësuesisë. Nga viti 1922 e derisa ajo shkollë u shtetëzua në vitin 1933, atë e drejtoi me talent e profesionalizëm, miku i shqiptarëve Harry Fulltz, emrin e te cilit e mori me pas dhe e mban edhe aktualisht. Kryqi i Kuq i të Rinjve Amerikanë ndërtoi një program model për asistencën teknike, duke synuar ngritjen e një instituti si "Robert College" edhe në Shqipëri (www.IHF)

Ndryshimet në strukturën e tregut kerkonin dije të reja që lidheshin me elementë të zhvillimit industrial. Tashmë kërkoheshin specialistë sidomos me njohuri të elektricitetit, mekanikës, hidraulikës etj. Kjo situatë do të evidentojë jo vetëm ndryshimet e programeve shkollore të kohës por dhe ndërtimin e profileve të ndryshme në shkollat ekzistuese në Shqipëri. Shkolla Teknike u jepte nxënësve

njohuri të posaçme teorike dhe praktike me një gamë të gjerë programesh profesionale. Shkolla teknike zhvillonte veprimtari të shumta sportive e kulturore dhe publikonte gazetën e njohur "Laboremus". Cilësia e programeve ishte e tillë që të diplomuarit e shkollës pranoheshin në universitetet më të njohura të SHBA-së dhe Europës. (www. IHF)

Përveç Shkollës Teknike të Tiranës, një rol shumë të madh në zhvillimin e arsimit profesional të orientuar nga tregu dhe në zhvillimin e bujqësisë shqiptare ka luajtur Instituti Shqiptaro-Amerikan, që ka qenë njohur në Shqipëri me emrin Shkolla Amerikane Bujqësore e Kavajës**.** Veprimtarinë e saj e nisi në vitin 1926 e themeluar dhe e drejtuar nga specialistë amerikanë (Dr. Telford Erikson)dhe të diplomuarit e parë të saj kanë qenë 10 studentë të vitit 1930. (Uran Asllani, 2011). Qëllimi i kësaj shkolle ishte që nëpërmjet një teknike të zhvilluar në bujqësi e blegtori, të tregohej konkretisht epërsia e fermerit të kualifikuar. Drejtuesit e shkollës synonin që nëpërmjet kuadrove të përgatitur të mbushnin një boshllëk në tregun e punës që lidhej me mekanikën bujqësore, edukimin kontabël dhe disa profesione të zejtarisë. Zgjedhja e pozicionit gjeografik ishte e tillë që tërhiqte të interesuarit për këto profesione nga Myzeqeja deri në Durrës.

2. Një tjetër karakteristikë e ndikimit amerikan në sistemin arsimor shqiptar ishte ndërtimi i raporteve funksionale të praktikës profesionale me edukimin teorik. Motoja kryesore ishte: "vepro duke menduar dhe mos mendo pa vepruar".

Në këtë fazë përvec ndryshimeve sasiore që po pësonte tregu arsimor në Shqipëri filluan të evidentohen dhe ndryshime të rëndësishme cilësore, që kishin në bazë metodikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sistemi amerikan i të mësuarit mbështetej në paradigmën e dijeve të nevojshme dhe të përdorshme në cdo kontekst. Ndryshe nga arsimi i mesëm i organizuar në qytete të tjera si Shkodra dhe Korca kryesisht me konceptet europiane të të mësuarit nën ndikimin austriak, italian e grek (të japim kulturën e gjuhën e vendit që e ka themeluar), e mësuara në stilin amerikan ishte praktike, e prekshme dhe konkrete. Ajo jepte të gjithë elementët teorike të nevojshme për zbatimin praktik të proceseve, procedurave dhe mbi të gjitha të zgjidhjeve konkrete të problemeve. Në këtë mënyrë, me përjashtim të shkollës Normale të Vlorës që përgatiste specialistë me profil llogaritar i mesëm, nga vitet 1920-1944 në sistemin arsimor shqiptar u pervijuan dy drejtime kryesore: ai i të mësuarit teorik mbështetur në shkollën europiane dhe ai i të mësuarit praktik, mbështetur në traditën amerikane. Ndërsa i pari synonte të përgatiste nxënës që mund të vazhdonin më tej studimet jashtë vendit dhe të krijonte brezin e intelektualëve të rinj shqiptarë, i dyti përgatiste nxënës që mund të punonin dhe të drejtonin në të gjitha llojet e bizneseve që funksiononin në Shqipëri. Sigurisht edhe mësimnxënia e 'stilit amerikan' nuk pengonte vazhdimin e studimeve të mëtejshme, por në thelb i bënte nxënësit të hynin sa më shpejt në tregun e punës dhe mbi të gjitha të përshtateshin më lehtësisht në profesionet përkatëse.

Në aspektin e mësimnxënies në shkollat e profilit bujqësor e blegtoral përveç

lëndëve të shkencave natyrore si botanikë, zoologji, anatomi, kimi inorganike dhe atë organike, nxënësit mësonin lëndët specifike të specialiteteve agronomi të përgjithshme, drithërat, hortikulturë, vitikulturë, fitoteknikë, zooteknikë, patologji të kafshëve, planifikimi bujqësor, administrimi dhe kontabiliteti bujqësor. Për sa i përket pjesës praktike të programit mësimor, sipas kurrikulave të asaj periudhe, nga 50 orë mësimore, tri orë ishin mekanikë bujqësore, teori dhe praktikë, 10 orë traktorë dhe motorë, përveç punës së përhershme në fermën e shkollës. Për të nxjerrë specialistë të aftë, për t'i ardhur në ndihmë sa më shpejt ekonomisë shqiptare, specialistët amerikanë përdorën me shumë efektivitet fermën komplekse bujqësore.

Nga viti në vit, gradualisht dega zooteknikë po zinte vendin kryesor në specializimin e nxënësve. Pjesa më e rëndësishme e veprimtarisë zooteknike në atë shkollë ishte të mësuarit me regjimin e ushqimit e të higjienës në stallat moderne të tipit amerikan me moton: «Më e mira dhe më e bukura në Shqipëri», duke stimuluar shtimin e pasurisë bujqësore e blegtorale të vendit.

Në Shkollën Bujqësore të Kavajës, qe kishte si objektiv përgatitjen e administratorëve dhe specialistëve per bujqësine, për 14 vite pune u përgatitën 177 agronomë të mesëm, nga të cilët 65 u morën me punë bujqësie dhe u punësuan si agjentë bujqësorë në administratën lokale, 48 u morën me administrimin e tokës dhe pronës së tyre, 19 u bënë mësues edhe 21 vazhduan studimet e tyre nëpër universitetet e Evropës dhe SHBA. Shkollat amerikane në tërësi, por veçanërisht ajo e Kavajës me mësuesit amerikanë, specialistë dhe mësues të aftë e të talentuar, kanë dhënë një kontribut shumë të madh në krijimin e një plejade bujqish modernë, që më vonë u bënë elita intelektuale e bujqësisë shqiptare.

3. Karakteristika e tretë e ndikimit amerikan në sistemin arsimor shqiptar ishte mësimi dhe futja në treg e teknologjive të reja, nën moton "Shiko si veprojnë ata që janë më të zhvilluar, nëse do të zhvillohesh edhe ti".

Kjo metodë kishte filluar në shkollat bujqësore me ciklin e bimëve të mbjella ku rradha nuk ishte më e rastësishme por sipas nevojave të tokës, në blegtori me futjen e racave të reja dhe zbatimin e regjimeve ushqimore, në përpunimin e produkteve blegtorale sipas teknologjive ushqimore të asaj periudhe, etj. Në vitin 1929 shkolla bujqesore e Kavajes kishte dy traktorë, disa makina mbjellëse e shirëse dhe pajisje të tjera të mekanikës bujqësore (Asllani, 2011).

Shumë më i dukshëm ishte ky proces në fushën elektrike, mekanike dhe të profesioneve të tilla si hidraulik dhe mekanik makinerish. Në shkollën teknike të Tiranës nxënësit përdornin vegla që ende nuk kishin hyrë në tregun shqiptar dhe materiale që njiheshin shumë pak. Ajo kishte një central elektrik që i jepte dritë qytetit, shtypshkronjën e vet dhe ndërmerte projekte ndërtimi (www. IHF). Promovuesit e parë të këtyre elementëve ishin pikërisht nxënësit e kësaj shkolle. Në këtë mënyrë në tregun shqiptar nuk hynë vetëm metodat e reja të punës por mbi të gjitha teknologjitë e reja. Filloi kështu një process i transferimit të teknologjive që, megjithëse në një treg të vogël, u bë element i rëndësishëm zhvillimi.

3. ETAPA E DYTË E NDIKIMIT DHE MBËSHTETJES AMERIKANE PËR SHQIPËRINË DHE VENDET E RAJONIT BALLKANIK. ZHVILLIMI I EKONOMISË SË TREGUT PËRMES EDUKIMIT.

Ndihma e huaj e SHBA për vendet e tjera tradicionalisht ka patur një focus strategic dhe ideologjik. Sipas Prud'homme (2007) pas Luftës së Dytë Botërore dhe pasojave të saj, SHBA krijoi një numër agjencish të ndihmës për të rindërtuar Evropën përmes Planit të Rindërtimit Marshall. Sikurse është historikisht e njohur, kjo nuk mundi të funksiononte për Shqipërinë në atë periudhë, për shkak të regjimit në fuqi që shumë shpejt mbylli rrugën për mbështetjen amerikane dhe u orientua nga Lindja.

Mundësia u krijua përsëri pas rënies së murit të Berlinit dhe përfundimit të "Luftës së ftohtë". Gjatë fillimeve të 1990-s, qeveria amerikane ndërmori programe ndihme e zhvillimi për vendet e rajonit të Europës Qendrore e Lindore (EQL), të konsideruara si Newly Independent States (NIS). Agjencia e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar me Trainime në Menaxhim dhe Projekte të Edukimit Ekonomik (USAID MTEEP) vuri në dispozicion fonde për partneritet ndërmjet 10 universiteteve amerikane dhe 9 universiteteve në vende të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL): përkatësisht nga Shqipëria, Bullgaria, Republika Ceke, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania dhe Slovakia (McIntyre et al., 2005).

Në këndvështrimin teorik sipas studimeve të fushës (McIntyre, Alon, 2005) një sistem unik i arsimit të biznesit profesional, i përshtatur me nevojat e vendit dhe i bazuar në praktikat dhe mësimet më të mira, do të bënte të mundur të përgatiten profesionistë të talentuar, me kualifikim të lartë dhe të motivuar. Një gjeneratë e punonjësve vendas, të përgatitur për të menaxhuar në mjedisin kombëtar dhe ndërkombëtar të biznesit është parakusht për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Nga ana e tyre IHD-të ndikojnë në krijimin e vendeve të punës, në zvogëlimin e ikjes së trurit, krijojnë mundësi për shtrirjen në tregjet ndërkombëtare si pjesë e zinxhirit të furnizimit dhe për sigurimin e fitimeve të vazhdueshme nga rritja e produktivitetit (Bakker et al., 2015). Me efekt zinxhir, të gjitha përfitimet e pritshme të sipërpërmendura mund të gjenerojnë sektorë të fuqishëm eksporti për rritje dhe diversifikim.

Përkundrejt këtyre nevojave, specialistë amerikanë të fushës së biznesit dhe arsimit në fillimet e 1990-s e kanë përshkruar nivelin e ekspertizës në vendet e EQL në këtë mënyrë: "Këto vende përgjithësisht kanë forca pune të arsimuara dhe inteligjente. Megjithatë, ekziston një mungesë në njohuritë praktike dhe aftësitë e menaxhimit, të nevojshme për të drejtuar ndërmarrjet private në një ekonomi të drejtuar nga tregu" (Lee, Luthans, Hodgetts, 1992). Sipas tyre, ndërmarrjet në Europën Qendrore dhe Lindore kanë nevojë për një ndihmë të madhe nga Perëndimi. Për shkak të rëndësisë së njohur të mallrave dhe shërbimeve cilësore, menaxhimi i përgjithshëm i cilësisë (TQM) duhet të jetë në krye të listës së metodave e qasjeve të menaxhimit dhe teknologjive moderne që duhet të zotërojnë firmat në vendet e EQL.

Këto konstatime dhe sugjerime përbënin bazën që nxiti SHBA dhe vende të tjera perëndimore të ofrojnë grante të ndihmës teknike për arsimin në fushën e ekonomisë në Shqipëri pas 1990-s. Me mbështetjen e USAID në 1992 një grup pedagogësh dhe sipërmarrësish kryesisht nga Universiteti i Nebraskës filluan në

Shqipëri projektin për të trajnuar zyrtarë qeveritarë, mësimdhënës dhe njerëz të biznesit në stilin perëndimor të menaxhimit dhe ekonomisë së tregut. Motoja ishte "E ardhmja e shqiptarëve varet nga përdorimi efektiv i kapitalit të pasur njerëzor që ka ky vend, sidomos studentët e rinj të biznesit dhe sipërmarrësit" (Lee, 2001).

Përvoja e dhjetëvjeçarëve të fundit për vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion tregon se ato i kanë krijuar elitat e tyre drejtuese me modele të ndryshme (Alon et al., 2013). Modelet kanë përfshirë dërgimin e menaxherëve të ardhshëm në shkollat e biznesit të vendeve të industrializuara ose "importimin" e programeve të gatshme të biznesit të stilit perëndimor për të përmbushur kërkesën për trajnime në nivelin lokal. Duke patur parasysh rolin e kapitalit njerëzor dhe të arsimimit në avancimin e ekonomive, gjykohet se reforma që ka ndikimin më të madh në një vend në proces zhvillimi apo në tranzicion është ri-organizimi i sistemit arsimor në funksion të zhvillimit ekonomik. Në SHBA programet e ekonomisë janë zakonisht ose pjesë e një shkolle biznesi ose pjesë e shkencave sociale, ose në disa raste të dyja se bashku. Në vendet e lindjes, shkollat e biznesit dhe/ose menaxhimit me shpesh janë pjesë e një shkolle të ekonomisë (jo e kundërta). Që nga fillimi i ndryshimeve thelbësore politike dhe ekonomike, nën ndikimin e shkollës amerikane, një pjesë e tyre u riorganizuan dhe u riemëruan si shkolla të ekonomisë dhe menaxhimit, ose gjithnjë e më shumë si shkolla të biznesit. Ky evolucion mund të ketë qenë për shkak të faktit se sistemi arsimor para-reformës apo tranzicionit kishte primare ekonominë politike dhe tregtinë (ndërkombëtare), kështu që përfshirja e degës së biznesit në shkollat ekzistuese ekonomike ishte një hap logjik (Alon et al., 2013).

Kontributi amerikan në ri-organizimin e arsimit universitar të fushës ekonomike është përcjellë në formën e investimeve konkrete në strukturën dhe infrastrukturën e arsimit të lartë në Shqipëri. Disa nga pikat kyce të këtij kontributi evidentohen në vijim, duke theksuar fort faktin që ato trajtohen në kontekstin e sfondit shoqëror dhe të kohës së realizimit të tyre. Pavarësisht kësaj dhe faktit që aktualisht, rreth 3 dekada më pas, avancimi i shkollës shqiptare të biznesit e ka bërë atë të krahasueshme me arsimin e lartë në vendet e tjera të botës, pa themelet e hedhura në fillimet e '90-s nuk mund të kuptohet vlera e tyre aktuale. Sado të vogla e të parëndësishme për tu marrë në konsideratë të mund të duken sot.

Lidhja sa më e ngushtë e arsimit universitar me tregun e punës, në Shqipëri, si edhe në vendet e tjera të EQL, është elementi bazë prej të cilit u orientua organizimi ose reforma në studimet e fushës së biznesit.

Në gjykimin e specialistëve amerikanë të fushës së biznesit në fillimet e viteve '90 "Në përgjithësi, sistemi shkollor shqiptar është i zhvilluar mirë dhe ekziston një traditë e arsimit të shëndoshë. Sidoqoftë, institucionet shqiptare të arsimit të lartë janë të papërgatitur qe të ofrojnë arsim modern të biznesit për drejtuesit e ardhshëm (Lee & Trimi, 2004). Për rrjedhojë, nevoja për një arsim të shëndoshë në fushën e biznësit është thelbësore për suksesin e një vendi të vogël me burime dhe investime të huaja të kufizuara. Shqipëria do të mund të zhvillonte një ekonomi të bazuar në treg përmes arsimimit të biznesmenëve të ardhshëm (https://www.unl.edu/).

Sipas Lee, 2004, projekti i filluar në mars 1992 kishte dy sfida kryesore. E para ishte të ofronte një program edukimi të përgjithshëm për punonjësit në institucionet shtetërore, stafin e fakultetit të Ekonomisë dhe një numër sipërmarrësish.

Programet e trajnimit, të mirë-organizuara, masive dhe të qarta përfshinin njohuri mbi parimet e ekonomisë së tregut, menaxhimin, sipërmarrjen dhe agrobiznesin, të cilat mungonin në atë periudhë. Programi i parë i trajnimit përfshiu rreth 450 persona për një program pesë-ditor në Tiranë. Që atëherë deri në fillimet e viteve 2000, u trajnuan mbi 6,000 persona nëpërmjet programeve bazë dhe/ ose të avancuara, të fokusuara dhe on-site (USAID, 1998). Shumica e programeve të trajnimit u përqëndruan në qytetet kryesore – Tirana, Korca, Shkodra, dhe Vlora.

Sfida e dytë ishte konsulenca dhe ndihma për ristrukturimin e plotë të kurrikulës së shkollës së biznesit në Shqipëri, në atë kohë Fakulteti i Ekonomisë. Objektivi ishte fuqizimi i infrastrukturës akademike shqiptare në disiplinat e ekonomisë dhe biznesit.

Për të gjithë stafin e angazhuar në arsimin e lartë të fushës ekonomike të asaj periudhe janë evidente ndryshimet e ndodhura me emërtimet dhe përmbajtjen e lëndëve, përgatitjen e leksioneve dhe më pas të teksteve. Modeli i kurrikulës amerikane përcaktoi gradualisht, dhe pothuajse tërësisht strukturën e lëndëve në diplomat e viteve të para. Ky ndikim kulmoi me organizimin dhe hapjen në Universitetin e Tiranës të programit të parë dhe të vetëm Master në Administrim Biznesi në Shqipëri më 1996. Klasa e parë përbëhej nga 30 studentë të zgjedhur nga një grup prej 80 aplikantësh. Ai ishte programi i parë MBA në të gjithë EQL që u ngrit sipas standardeve ndërkombëtare dhe i licensuar nga qeveria (Lee & Trimi, 2004).

Ky model shkollimi mbështetej në parimin e kalimit nga mësimi i menjëhershëm në mësimin e vazhdueshëm. Ai u zbatua pothuajse njëkohësisht në disa vende të EQL. Në fund të vitit 1997, të diplomuarit e parë të programeve më të hershme dolën në tregun e punes, duke përdorur aftësitë dhe njohuritë e tyre për të përmirësuar operacionet për firmat e tyre. Ishin shtatë programe master të administrimit të biznesit (MBA) që vepronin në pesë vende (Shqipëri, Hungari, Letoni, Poloni dhe Republika Sllovake) me rreth 1.000 studentë të regjistruar. Rreth 200 studentë kishin marrë gradën e tyre në MBA, dhe 200 të tjerë pritej të përfundonin studimet deri në pranverën e vitit 1998. Sipas Hull, 1999, edhe pse pak nga programet kishin arritur njohjen zyrtare, të diplomuarit në MBA po arrinin sukses në tregun e punës, ne firma të mëdha të huaja, dhe në një mori start-ups që po zhvilloheshin duke dalë nga sektori informal.

Përmbajtja e kurrikulës si dhe procesi i realizimit janë paralelisht faktorë përcaktues të arritjeve të pritshme nga sistemi i arsimit të biznesit.

Një konceptim i tillë i sistemit të reformuar të arsimit u përcoll nëpërmjet përvojës amerikane në sistemin katërvjecar dhe sidomos në atë master në fakultetin e ekonomisë, ku mësimdhënia realizohej fillimisht nga stafi amerikan. Leksionet tradicionale dhe metodat e të mësuarit rutine ishin karakteristikë e mësimdhënies në shumë prej vendeve në tranzicion, si rrjedhojë e traditës së mëparshme të shkollimit. Së bashku me kurrikulën e re u nxit ndryshimi në metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ato u orientuan drejt përdorimit të modeleve interaktive, praktikohej puna në grup, nxitja e mendimit kritik dhe përdorimi i teknologjisë në shkollë. Përdorimi i software trajnimi të specializuar, i video tutorials, prezantimet me kompjuter ishin pjesë e transferimit të teknologjisë, që u mundësua nga projekti i USAID me kontributin e konsorciumit të universiteteve amerikane. Që studentët

të zotërojnë aftësitë e menaxhimit, stafi akademik duhet të integrojë mësimin me praktikën e biznesit. Nga ana tjetër nevojitet që edhe metoda e vlerësimit të dijeve të kalojë nga vlerësim mbi bazën e dijeve në vlerësim mbi bazën e kompetencave.

Një nga ndikimet më të mëdha të metodikës amerikane të të mësuarit në nivelet universitare e përdorur në të gjitha këto shkolla, përfshirë Shqipërinë, dhe që është elaboruar gjithnjë e më shumë, është krijimi i asaj forme të edukimit që mbështetet në aftësitë, e njohur me termin Soft Skills. Në këtë koncept përmblidhen tërësitë e dijeve dhe kompetencave që krijojnë kapacitete dhe aftësi në persona të caktuar për procese apo detyra të caktuara. Kjo procedurë përfaqëson një formë të caktuar të të mësuarit që "lidh personat (studentët) në momentet e proceseve të rritjes së tyre profesionale me organizatat e biznesit pavarësisht se ato janë në transformim të vazhdueshëm" (WEF, 2016). Kjo formë e të mësuarit është nxitur edhe më shumë nga dixhitalizimi i ekonomisë, format e reja të prodhimit dhe mbi të gjitha nga ndryshimet e shpeshta të profesioneve.

Bizneseve në përgjithësi por dhe bizneseve shqiptare në vecanti, tregu ju kërkon dhe imponon ndryshime të vazhdueshme. Ato vendosin objektiva të reja me vizione të reja prodhimi. Kjo kërkon nga ana tjetër kapacitete njerëzore të specializuara, gjë që çon domosdoshmërisht në rivlerësimin e programeve mësimore për të ofruar aftësi dhe dije të përdorshme tek studentët.

Koncepti amerikan i të mësuarit synon të krijojë një klimë që emërtohet "Open Innovation"pra një ambjent ku në "mënyrë të lirë por dhe të detyrueshme", studentët të këmbejnë informacione të elementëve teorik të mësimit me problemet reale të bizneseve dhe së bashku ti zgjidhin ato. Në këtë mënyrë bizneset sjellin problematiken e tyre konkrete ndërsa universitetet krijojnë tipologjinë e tyre të të mësuarit në funksion të njeri tjetrit. Kështu dhe universitetet shqiptare po përdorin dhe po mundohen të thellojnë këto metoda falë lidhjeve gjithmonë e më të ngushta me universitetet e tjera më të perparuara në botë.

Një element i rëndësishëm i ndikimit amerikan në programet e universiteteve shqiptare është edukimi sipërmarrës.

Rritja e frymës së sipërmarrjes në të gjitha hallkat e edukimit universitar sidomos në stimulimin e ideve të reja të biznesit është ndikim i drejtpërdrejtë i edukatës amerikane të të mësuarit të bërit biznes. Ndërtimi i strukturave, që aktualisht njihen si Inkubatorët e biznesit, Akseleratorët e biznesit, matja e propabilitetit te ideve të reja për biznes etj., që stimulojnë bizneset e reja është praktikë shumë e njohur në SHBA. Politikat ekonomike të mbështetura në inovacionin dhe teknologjitë e reja janë elementet bazë të rritjes së punësimit të të rinjve dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm, por dhe vetëpunësimi, zhvillimi i biznesit të vogël dhe shitja e produktit të punës dhe jo kohës së punës. Përvoja e universiteteve amerikane si një burim i vazhdueshëm i ekspertizës së zhvillimit ekonomik dhe të biznesit ndikoi në përcaktimin e njerit prej objektivave të projektit USAID për arsimin në Shqipëri. Përdorimi i burimeve intelektuale të arsimit të lartë për të përmbushur nevojat e organizatave lokale të biznesit dhe institucioneve të tjera ne vend do te mund te realizohej përmes zhvillimit të Qendrave të Asistences për Biznesin. Projekti që nga 1996 ngriti tre Qendra të Asistencës për Biznesin (BAC) në Universitetet e Korçës, Shkodrës dhe Vlorës, dhe Qendrën e Menaxhimit të Teknologjisë (TMC) në Universitetin Politeknik të

Tiranës (UPT). Qendrat kane ofruar një numër programesh trainimi / edukimi për komunitetet lokale të biznesit, si edhe shërbime këshillimi për pronarët e bizneseve të vogla. Përvec këtyre programeve të trajnimit, qendrat janë angazhuar edhe në kërkime tregu, studime fizibiliteti për sipërmarrje të reja dhe analiza të kërkesave për fuqinë punëtore dhe aftësitë e nevojshme. Për të inkurajuar sipërmarrjen ndërmjet studentëve, u krijuan grupime studentore të quajtura SIFE (Studentë në Ndërmarrje të Lirë) në katër universitetet kombëtare (Lee & Trimi, 2004).

TABELA 1.
TË DHËNA PJESORE MBI KONTRIBUTIN E SHBA PËRMES PROJEKTEVE NË ARSIMIN E LARTË TË BIZNESIT

Periudha	Aktiviteti	Përfitime
1992 - 1993	Trajnime 5 -ditore për ekonominë e tregut	450 pjesëmarrës nga universitetet, ministritë, organizata të biznesit
1992 - 1994	Kurrikula e programeve të biznesit, përgatitja e cikleve të leksioneve në gjuhën shqipe	4 universitete - Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korcë.
Mars 1996	Hapja e e programit të parë Master në Administrim Biznesi (MBA) në Shqipëri	80 aplikantë, 30 studentë të diplomuar në brezin e parë
1996	Mbështetje me literaturë dhe teknologji; Ngritja e Business Assistance Centers/ Qendra të Asistencës për Biznesin.	180,000 tekste universitare të dhuruar, 80 kompjutera, dhe materiale ndihmëse – baza për Bibliotekën "Joseph Limprecht" në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës.
Shkurt 2002	Hapja e programit të parë Master në Administrim Publik (MPA) në Shqipëri.	35 studentë në brezin e parë

Burimi: përpunuar nga autorët, bazuar në të dhënat nga Lee, Trimi, 2004, USAID -Albania, 1998.

4. KONKLUZIONE

Përvoja historike ka treguar se zhvillimi dhe e ardhmja e vendeve përcaktohen nga një kombinim kompleks i forcave sociale, politike, teknike dhe ekonomike. Në të gjitha rastet, burimet njerëzore dhe edukimi i brezave janë thelbësore. Njohuritë, aftësitë, kultura me të cilat të diplomuarit pajisen nga shkolla do të reflektohen në punën e tyre në sektorin publik dhe privat, në të gjitha degët e ekonomisë, në nivel lokal dhe rajonal.

Modeli amerikan i edukimit profesional dhe kontributi i drejtpërdrejtë amerikan krijuan bazën e arsimit të mesëm profesional në Shqipërinë e viteve 1920-të. Ato shoqëruan dhe mbështetën zhvillimin ekonomik të vendit me kurrikula dhe qasje pedagogjike funksionale dhe të avancuara për kohën.

Në mënyrë të ngjashme universitetet amerikane u bënë baza dhe modeli i zhvillimit të arsimit të lartë të biznesit në vitet 1990-të. Përvec kontributit financiar,

roli i tyre madhor ishte në orientimin për të përballuar sfida si:

- çfarë kurrikule do të funksiononte më mirë në mjedisin shqiptar;
- si do të plotësonte shkolla shqiptare nevojat e ekonomisë së tregut për profesionistë të biznesit;
- çfarë roli mund / duhet të luante shkolla e biznesit për të krijuar kulturën sipërmarrëse apo për të nxitur reforma ekonomike;
- si mund të ndikonte transferimi i teknologjisë në arsimin e fushës së menaxhimit.

Në mënyrë modeste punimi ka trajtuar këto ceshtje, duke evidentuar fakte dhe duke bërë disa analiza në një fushë ku gjithsesi mbetet ende shumë për të hulumtuar.

BIBLIOGRAFIA

- -Alon, I., Jones, V., McIntyre, J. R., - Innovation in Business Education in Emerging markets, UK, 2013;
- -Asllani, Uran - Misioni i amerikanëve në Shqipëri dhe ndihma për arsimin, Tirane, nentor 2011;
- -Bakker, Gerben; Crafts, Nicholas; Woltjer, Pieter - A Vision of the Growth Process in a Technologically Progressive Economy: the United States, 1899–1941. March 2015;
- -Banja, Hasan - "Ekonomia e Shqiperise ne rrjedhat e historise se shqekullit te XX", 2016;
- -Golemi, Zaho dhe Golemi, Alma - Marrëdhëniet me amerikanët në fokus historik njëshekullor, Illyria Press, 2012;
- -Konrad-Adenauer-Stiftung e. V. (KAS) - The influence of external actors in the Western Balkans, 2018;
- -Lee S., Luthans F., Hodgetts R. - Total Quality Management: Implications for Central and Eastern Europe, Organizational Dynamics 1992, Spring, 42–55;
- -Lee, Sang; Trimi, Silvana - Developing Business Education Infrastructure in Eastern Europe: Albanian Experience, International Journal of Public Administration, Vol. 27, Nos. 11 & 12, pp. 869–881, 2004;
- -McIntyre, John R. and Alon, Ilan - Business and management education in transitioning and developing countries: a handbook, 2005;
- -Prud'homme, Dan - Assessing the Millennium Challenge Corporation as a Model for Foreign Assistance Reform, June 2007, working paper, United States Agency for International Development's Development Experience System (DEXS) http://dec.usaid.gov;
- -USAID Albania Strategic plan FY 1998-2002, 1998. https://dec.usaid.gov/dec/search/FusionSearchResults.aspx?q=USAID.%20Mission%20to%20Albania
- -World Economic Forum (WEF) - The future of Jobs Report, 2016;
- -http://harryfultz.edu.al/historiku/
- -http://www.kavajaonline.com/forumi/topic/3310-instituti-bujqesor-shqiptaro-amerikan-i-kavajes/
- -https://www.unl.edu/
- -http://punetejashtme.gov.al/marredheniet-dypaleshe/marredheniet-me-shtetet-e-bashkuara-te-amerikes/

SIGURIA RAJONALE, (DE) STABILITETI EKONOMIK DHE FLUKSI I MIGRACIONIT NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT – PERIUDHA 2016-2019

Nazmije Merko Zabzun
International University of Struga
n.merko@eust.edu.mk,

Genc Merko
International University of Struga
g.merko@eust.edu.mk,

ABSTRACT

The Republic of North Macedonia with the new political and reform system after the Prespa Agreement (PA) and according to the reports of the European Commission, is said to have managed to respond in a contemporary way to the European conditions in the field of regional security, economic and financial stability as well as legal approximation in the field of migration. Also, this political system is very promising in the free movement of goods, the movement of workers, the financial as well as the judicial service. Beginning with domestic security and the latest developments in the Special Prosecution, and continuing with tax obligations, labor migration, North Macedonia and its inhabitants are almost unprepared for such a reform system, but the change must begin in domestic relations, investments and development in the work place to develop the country, stopping the unemployment crisis in the country and all this to feel and smell like a European country. In addition we will analyze how this reform system was created, what are the advantages and disadvantages of economic development and that of free movement of citizens.

KEYWORDS: R. of North Macedonia, reforms, economic stability, migration, EU

HISTORIA DHE ARRITJET E MARRVESHJES SË PRESPËS (MP)

MARRVESHJA E PRESPËS

MP (e lidhur në qershor 2018) për R. Maqedonisë së Veriut ka qenë si një shpresë për rrugën euroatlantike respektivisht anëtarësim në NATO dhe UE e cila ishte e blokuar nga ana e Greqisë pothuajse 3 dekada.

Palët kontraktuese Greqia dhe R. Maqedonisë së Veriut nënshkruan marrveshje mbi zgjidhjen e dallimit rreth emrit, pasurimin e bashkëpunimit ndërmjet dy palëve, marrëdhëniet diplomatike, bashkëpunim politik dhe shoqëror, ekonomik, në sferën e arsimit, shkencës, kulturës, hulumtimit, teknologjisë, shëndetësisë dhe sportit, policor, zgjedhje të konteksteve dhe dispozita të tjera[166].

Pas nënshkrimit të MP, ajo ka vazhduar të mbajë një stabilitet politik, duke krijuar kushte për organizimin e një referendumi të suksesshëm (shtator 2018), luftë kundër korrupsionit (*në proces dhe vënia e sistemit të vetingut*), raporte të qeta ndëretnike, si dhe ka pasur përparime në zhvillimin bujqësisë, zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut, përmirsimin e financave publike, miratoi dhe reforma për taksimin e të ardhurave dhe sistemit të pensioneve.

Nga e gjithë çka u tha më lartë duket sikur po i jemi vënë një rruge të sigurt drejt ardhmërisë së vendit në rrugën euroatlantike

SIGURIA RAJONALE

NGJARJET E FUNDIT NË PROKURORINË SPECIALE

Prokuroria speciale në R. Maqedonisë së Veriut, për herë të parë u themelua më 15 shtator 2015 e cila lindi si një nevojë për krizën politike të vendit dhe kështu ajo iu vërsul (në fokus kishte) ndjekjeve mbi veprat kriminale/penale që përmbanin përgjimet skandaloze dhe të paligjshme të komunikimeve dhe organizimeve midis pushtetarëve, zyrtarëve shtetërorë dhe politikanë të tjerë. Kjo prokurori kishte për detyrë të hulumtojë dhe ndjek të gjitha abuzimet që janë kryer në periudhë 2009-2015, dhe e njëjta hapi disa padi penale. E njejta do të ishte e pavarur dhe nuk do ti përkiste asnjë partie politike në vend dhe kështu do posedonte autonomi të plotë për ndjekje të tyre.

Vitin e parë (2015) Prokuroria Speciale mori një hov të madh gjatë hapjes së lëndëve të paligjshme duke filluar të përndjek të korruptuarit, dhe kështu popullata i dha një besim të plotë këtij institucioni, por një vit më vonë (2016) ky besim filloi të zbehet për shkak të moszgjidhjeve të rasteve të hapura dhe pastaj në vitin 2018 me largimin e paligjshëm për në Hollandë të ish kryeministrit të RMV Nikola Gruevski të cilit iu kumtua burgim me 2 vite për rastin TENK (çështje e furnizimit të veturës luksoze Mercedes - 600.000 eu në mënyrë të paligjshme) ky institucion humbi

166 Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në Rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve **17 Qershor 2018 Prespë, R. M. Veriut**

totalisht besimin e qytetarëve që do kishim një shtet të drejtë, demokratik dhe të pakorruptuar.

Por nuk mbaroi me kaq, ajo qe ishte skandaloze dhe e papranusheme për asnjë shtet në botë ishte rasti i të marrit ryshfet nga vet prokurorja (2019) në bashkëpunim me disa bashkëautorë të tjerë, të cilët i reketonin biznesmenët/politikanët, me kushtin që të mos i hapet dosje në këtë prokurori, ose të gjykohen në liri e ngjashëm.

Këtë rast e zbuloi vet biznesmeni kur u desh të paguante 50.000 eu që të gjykohet në liri[167] dhe pas kësaj edhe dhjetra biznese dhe ndërrmarje të tjera të cilat kapin shifrën 5 milion euro reket i kërkuar nga prokurorja speciale. Tashmë e njëjta ndodhet në burg e cila po e vuan denimin dhe pritet që ti kumtohet prej 1 deri 10 vite burgim.

Qeveritarët e RMV nuk e duan sërish këtë institucion në vend, mirëpo Evropa e vlerëson dhe është mjaft këmbëngulëse që ajo të kthehet dhe aktivizohet rishtaz. Shqiptojnë se Prokuroria Speciale në vend është një mjet i domosdoshëm për të vazhduar bisedimet rreth integrimit të RMV në NATO dhe BE dhe kërkohet nga shteti që të krijojë kushte që ajo të fillojë të funksionojë sërish. (Mersim Maksuti) "Prokuroria Speciale të ruajë autonominë e sajë të plotë me qëllim që të krijohet një pavarësi e plotë në gjetjen e kryerësve të veprave penale pra për të gjithë ata të cilët kanë abuzuar apo keqpërdorur me pushtetin shtetëror, por edhe duhet ti rriten kompetencat e saja, me qëllim që jo vetëm ish pushtetarët, por të përfshihen edhe ato nga qeverisja aktuale, me qëllim që të ketë liri të plotë me ligj në gjetjen dhe paditjen e tyre para ligjit dhe organeve të drejtësisë"[168]

(DE)STABILITETI EKONOMIK

PLANIFIKIMI BUXHETOR

Me qëllim të integrimit të vendit dhe me krahasimin e saj me stadardet e NATOS - qeveria reformatore e RMV në buxhetin e shpallur në vitin 2018 premtoi: rritje të pagave në arsim, shëndetësi dhe kopshte me 5%; rritje të pagave në mbrojtje për të gjithë anëtarët e armatës me 10%; hapjen e 100 vendeve të punës në kopshte; rritje të penzioneve; rritje të pagës minimale, subvencione për bujqësinë, shpenzime kapitale planifikohen në investime për hekurudhë, komunale dhe infrastrukture energjetike.

Duke mos lënë anash aspektin makroekonomik reformatorët planifikuan rritjen e GDP reale me 3.2% [169]duke pritur intenzitet në aktivitetet ekonomike. Kështu do të krijohen kushte për punësime të reja dhe mundësi reale për përparimin dhe kualitetin e jetës së qytetarëve që ata të formohen dhe të investojnë në vendin e tyre e jo të emigrojnë jashtë kufijve të R.M.V.

167 https://balkaninsight.com/2019/08/21/north-macedonia-arrests-outgoing-chief-special-prosecutor/

168 https://flaka.com.mk/reformat-ne-gjyqesor-maksuti-fati-i-psp-se-sa-afer-aq-dhe-larg/

169 Burime nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë

MIGRIMI I FUQISË PUNËTORE

Mirëpo për të rinjtë kjo më nuk duket e besueshme. Ato çdo ditë e më shumë duan që të kapin trenin e fundit për të migruar për një jetesë më të mirë jashtë vendit. Në bazë të një ankete, e analizuar nga ana e Ambasadës Franceze, doli si rrezulltat se 70% e qytetarëve të RMV duan të largohen nga vendi dhe se 600.000 persona vetëm se e kanë bërë këtë veprim dhe e gjitha për shkak se mendojnë se zëri i tyre nuk dëgjohet dhe se nuk është i mjaftueshëm për proceset vendosëse, sepse ata shërbejnë vetëm si votë, sepse nuk ka atmosferë shtetërore, nuk ka transparencë nuk ka ideale.

Studimi i fundit që ka bërë Westminster Foundation for Democracy (WFD) Fondacioni për Demokraci Vestminster duke analizuar rastet e shumta në RMV rreth lëvizjes së të rinjve të moshës 15-35 vjeç, konkluzionet që arriti ishin:

- Më pak se një e treta e të rinjve (31%) mendojnë se Maqedonia e Veriut po ecën në drejtimin e duhur;
- Vetëm 3% e të rinjve janë plotësisht të kënaqur me vendin e tyre në shoqëri;
- Të rinjtë në përgjithësi besojnë se nuk mund të ndikojnë në mënyrën e funksionimit të autoriteteve, me 6 nga 10 të rinjtë që besojnë se nuk mund të kenë ndikim fare;
- Afërsisht një në pesë të rinj (22%) në vend besojnë se qeveria aktuale është e përkushtuar të adresojë problemet e rinisë;
- 71% e të rinjve e përshkruajnë veten si qytetarë joaktivë shoqërorë;
- Vetëm 8% e të rinjve kanë ndërmarrë hapa për të zgjidhur një problem të veçantë shoqëror;
- 90% e të rinjve në Maqedoninë e Veriut nuk kanë qenë kurrë pjesë e një organizate qytetare / joqeveritare ose iniciativë që punon për çështje sociale;
- 64% e të rinjve shprehen se gjithmonë votojnë në zgjedhje. Sidoqoftë, çdo qytetar i dytë i ri nuk beson se dikush mund të ndikojë në situatën në vend duke votuar në zgjedhje;
- 85% e të rinjve mendojnë se vendit i duhet një udhëheqës me një dorë të hekurt.[170]

PËRFUNDIM

Nga çka u tha më lartë supozoj se qytetarët e RMV nuk janë të gatshëm për një sistem të tillë. Sistemi I krijuar aktual është një sistem I njohur me dekada dhe nuk të jep asnjë shpresë për një të ardhme cilësore. Marrveshja e Prespës I dha një shtysë vendit, duke nënshkruar Marrveshjen historike midis Greqisë dhe Maqedonisë. Ata

170 https://www.wfd.org/2019/12/18/youth-in-north-macedonia-optimism-apathy-or-disappointment/

do të dëshironin një vend pa korrupsion, me vendosjen e nje vetingu prej ku do të kalonin të gjithë funksionarët e çfarëdo lloj veprimtarie, ku secili do të ushtronte detyrën që I takon, një vend që do të kalonte të gjitha fazat pa asnje lloj mëdyshje për të hyrë në NATO dhe BE.

Prokuroria speciale e cila me këmbngulje kërkohet nga Evropianët që të riaktivizohet, mendoj se do duhej të ishte një shtetas totalisht I huaj, i cili do ishte autonom në përndjekjet e kryesve penalë, ku nuk do mund t`i amnestonte asnjë nga qytetarët.

Stabiliteti ekonomik sipas planifikimeve buxhetore (2017-2020) ka arritur nje shkallë të ngritjes së nivelit të GDP së vendit, si dhe janë bërë punësime të mjaftueshme dhe po vazhdohet për të rinjtë me qëllim ngritjen dhe formimin intelektualë tek ta. Mirëpo siç ceku edhe anketa e Westminster Foundation atë çka duan qytetarët eshtë përfillja e tyre në vendime strategjike shtetërote, dëgjimi i zërit të tyre për nevojat arsimore, etc. si dhe bashkëpunimi midis organizatave joqeveritare dhe funksionarëve shtetëror.

BIBLIOGRAFIA

- Marrëveshja përfundimtare për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në Rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për shfuqizimin e Marrëveshjes së përkohshme të vitit 1995 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve 17 Qershor 2018 Prespë, R. M. Veriut
- https://balkaninsight.com/2019/08/21/north-macedonia-arrests-outgoing-chief-special-prosecutor/
- https://flaka.com.mk/reformat-ne-gjyqesor-maksuti-fati-i-psp-se-sa-afer-aq-dhe-larg/
- Burime nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë
- https://www.wfd.org/2019/12/18/youth-in-north-macedonia-optimism-apathy-or-disappointment/

POLITIKA E PARTNERIT STRATEGJIK NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK TË VENDIT

Armelina Lila(Fushekati)
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
armelina.lila@umsh.edu.al

Sonila Nikolla
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
sonila.nikolla@umsh.al

RudinaQurku
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
rudina.qurku@umsh.edu.al

ABSTRACT

Albania continues to move slowly towards the open market economy and the Albanian Government is maximally committed to fulfill EU requirements and Euro-Atlantic integration thanks to the continued support of the United States of America**.** The purpose of this study is to analyze the support of USAID, the American Development Fund and other bodies on over the biggest barriers that concern our country in its journey, in order to improve transparency, increase the efficiency of state systems in channeling US funds intended for development assistance, but at the same time for Albanian entrepreneurs so that they can turn their ideas into entrepreneurship, maximize their impact and build strong business. Stimulation of successful entrepreneurs leads to innovation, community development and economic growth. These organisms assist in providing necessary resources and expertise to make the most of Albania's potential in the vital sectors such as agriculture, tourism oil and gas sectors based on natural resources, low labor cost and coverage of regional markets. Supporting the digital infrastructure modernization in public administration is an important process that of course brings the modernization of the State itself in view of good governance.The contribution and support of the US Government through USAID Agency has been and remains unique in

strengthening the Albanian independent institutions, building human and institutional capacity of public administration, strengthening of civil society organizations, private sector development, electoral reform, administrative and territorial reform and finally and foremost the justice reform.

KEYWORDS: transparency, innovation, economic growth, good governance.

NDIKIMI STRATEGJIK I SHBA-VE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT.

Në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian, në kuadër të përmirësimit të transparencës, rritjes së efektshmërinë së sistemeve dhe institucioneve të shtetit, në kanalizimin e fondeve të akorduara nga donatore dhe jo vetëm, të destinuara për asistencën për zhvillim dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, Shqipëria ka gjetur mbështetjen e Qeverisë Amerikane nëpërmjet Agjencisë USAID si dhe Fondit Amerikan të Zhvillimit te cilat kanë qenë dhe mbeten unikal në fuqizimin e institucioneve të pavarura të Shtetit Shqiptar. Këto institucione kanë patur qëllim ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të administratës sonë publike, fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile, zhvillimin e sektorit privat, reformën zgjedhore, reformën administrative e territoriale dhe së fundmi dhe më kryesoren, reformën në drejtësi duke dhënë një efekt dominant në sytë e ndërkombëtarëve ku raport progresi evidenton dukshëm sa më sipër.

Gjatë dy dekadave të fundit megjithë përpjekjet për progres të qëndrueshëm në zhvillimin politik, social, ekonomik, të vendit Shqipëria nuk ngeli pa u prekur nga efektet e krizës financiare që preku vendet fqinje pjesë të BE-së si Greqia, Italia, efekte të cilat tkurren investimet e huaja, stepën donatorët dhe krijuan pasiguri në investitorët vendas.

Duke u vlerësuar si vend i vogël por me rëndësi strategjike, Shqipëria ka qenë vazhdimisht e mbështetur dhe drejtuar nga ndikimi i SHBA-ve në reformat transformuese të orientuara në ndryshime dhe përmirësime të kuadrit rregullator që kanë çuar në forcimin e shtetit ligjor, rritjen e intgritetit, uljen e korrupsionit dhe zhvillimin e qëndrueshem ekonomik. Rezultati i bashkëveprimit me këto organizma është kontributi më efektiv në funksion të decentralizimit të pushteteve dhe kthimit të besimit të qytetareve te institucionet demokratike të vendit.

SHBA ushtron një ndikim të madh përmes qeverisë dhe programeve të saj, veçanërisht përmes USAID dhe zbatimit të reformës gjyqësore. Ajo luan një rol mbizotërues në çështjet e sigurisë, mbrojtjes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut si dhe aspektit ekonomik. Qeveria amerikane ka ofruar ndihmën e saj për zhvillimin, stabilitetin dhe integrimin e Shqipërisë në Europë që nga viti 1992 duke mundësuar një tranzicion më të lehtë të Shqipërisë nga shteti komunist i izoluar

në një demokraci me një ekonomi të orientuar drejt tregut. USAID po e ndihmon Shqipërinë në disa drejtime të cilat përfshijnë forcimin e ligjit, rritjen e aftësisë së qeverive lokale për të mbledhur të ardhura dhe përmirësimin e konkurrencës së biznesit.

Në këtë kuadër USAID po mundohet të krijojë një mjedis sa më të përshtatshëm për rritje ekonomike dhe siguri financiare që do ta afronte Shqipërinë afër niveleve të të ardhurave të BE dhe afër integrimit në BE. Kjo mund të arrihet duke mbështetur sektorin privat dhe duke rritur nivelet e punësimit. USAID po përpiqet në këtë aspekt duke investuar në sektorin financiar dhe në atë të zhvillimit të klimës së mirë të biznesit. Për të mbështetur objektivat e tij, në 2009 u krijua Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AADF) nga Fondi i Ndërmarrjeve Shqiptaro-Amerikane me mbështetjen dhe inkurajimin e USAID dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Misioni i fondacionit është të lehtësojë zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të sektorit privat dhe të një shoqërie demokratike në Shqipëri, dhe të kontribuojë për stabilitetin në Evropën Juglindore. AADF sponsorizon programet e mëposhtme për të vazhduar misionin e saj: arsim për zhvillim të qëndrueshëm, zhvillim lidershipi dhe mbështetje për turizmin kulturor dhe eko-turizmin.

KONTRIBUTI I USAID DHE FAZH NË MINIMIZIMIN E VËSHTIRËSIVE DHE PENGESAVE TË PROCESIT DHE NXITJES SË ZHVILLIMIT EKONOMIK.

Shqipëria mbetet një vend me shumë sfida dhe pabarazi sociale. Me shkallë të lartë të varfërisë dhe papunësisë, brezi i ri i Shqipërisë vazhdon të kërkojë mundësi jashtë vendit. Sipërmarrja ka potencialin për të nxitur zhvillimin ekonomik në Shqipëri dhe kjo sjell nevojën për të zhvilluar ekosisteme që mund të mbështesin sipërmarrjen. Projektet në të cilat po investon momentalish USAID janë të përqëndruara në fushën e financave, turizmit, edukimit etj. Investimi më i madh i viteve të fundit ka qenë në fushën e zhvillimit të sektorit financiar. Sektori bankar në Shqipëri ka qenë në rritje por nga ana tjetër PBB ka ngrirë, ka pasur një ngadalësim të huadhënies dhe një rritje të vlerës së kredive me probleme. USAID ka për qëllim të forcojë stabilitetin e sektorit financiar dhe të rrisë besimin në sistemin bankar. Kjo do të sillte rritjen e sektorit privat, rritjen e investimeve të huaja direkte dhe krijimin e vendeve të punës. Programi synon të zgjerojë kapacitetët kontrolluese të Bankës së Shqipërisë, të forcojë auditimin, të mbështesë administrimin dhe mbledhjen e taksave si dhe të ndërtojë një platformë që do mundësojë pagesat me telefon nëpërmjet një bashkëpunimi mes bashkive, kompanive utilitare, bankave dhe konsumatorëve.

Fondi Amerikan për Zhvillim e ka fokusuar punën në edukimin e studentëve për leadership dhe sipërmarrje si dhe në turizmin kulturor dhe ekologjik. Ky i fundit jep ndikime direkte në ekonomi. Qendra arkeologjike si ajo e Butrintit apo zona të mbrojtura nga UNESCO si Gjirokastra, janë të përfshira në projektet e fondit.

Nxitja e turizmit kulturor dhe ekologjik do të sillte vende të reja pune dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Sipas raportit të INSTAT, në Shqipëri, numri i ndërmarrjeve NVM është 99,8 %, i njëjtë me BE. Numri i të punësuarve në këtë grup ndërmarrjesh është 80,3 % në Shqipëri nga 66,4 % në BE. Vlera e shtuar e realizuar nga NVM në Shqipëri përbën 68,3 % nga 56,8 % në BE. (INSTAT, 2017). Megjithatë, vetëm 28 % e financimit të përgjithshëm shkon për NVM-të. Shumë NVM kanë mungesë të planeve të biznesit dhe të të dhënave të kontabilitetit, gjë që çon në perceptimin se kreditë që u jepen atyre kanë një rrezik të lartë. Megjithëse bankat dhe institucionet financiare kanë likuiditet të lartë, normat e larta të kredive të këqija kufizojnë aftësinë e tyre për të ofruar kredi për NVM-të. Për më tepër, shpërndarja e kredisë ka qenë disproporcionale midis ndërmarrjeve urbane dhe rurale. Projekti SmartCapital synon të nxisë rritjen ekonomike përmes aksesit në mjete të avancuara financiare dhe teknologjike për sipërmarrësit e NVM-ve. Vëmendja në këtë projekt i takon zonave rurale duke lehtësuar për to aksesin në një numër të madh opsionesh financimi. Paketat e plota të aplikimit për grante, duke përfshirë planet e biznesit, investimet, agroteknologjitë, do t'u ofrohen bizneseve për të hyrë në fondet IPARD-BE, Skemat Kombëtare të Granteve (AZHBR), SARED, SME-të, etj. Bizneset do të ndihmohen me hua dhe kredi në lidhje me grantet nga sektori bankar dhe përmirësimin e standardeve mjedisore. SmartCapital do të ndërtojë një Platformë Tregtie për të lidhur furnizuesit vendas me tregjet ndërkombëtare dhe një "Agro Technology Card" për të përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes së bankave. Ky projekt do të ndihmojë NVM-të për të kërkuar financim për investime në projekte të energjisë së rinovueshme si dhe do të lehtësojë certifikimet ndërkombëtare për NVM-të për të zgjeruar tregtinë në tregjet e BE-së.

Sektori i turizmit në Shqipëri është një sektor me shumë potencial por mungesa e kapitalit dhe mendjemprehtësisë së biznesit janë faktorë ndalues për zhvillimin e këtij sektori. Pamundësia e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në turizëm për të marrë kapital të përballueshëm nga bankat krijon nevojën për burime alternative. Sipas raportit të INSTAT, *Turizmi Në Shifra Shqipëri 2019*, gjatë 2018, aktivitetet që i përkasin kategorisë së turizmit gjeneruan rreth 45 miliardë lekë vlerë të shtuar, duke kontribuar në këtë mënyrë me rreth 2,8 % në PBB. Ky kontribut, sipas raportit të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit, vlerësohet të jetë 4.1% e PBB , kjo dhe për faktin se shpenzimet që turiztët kryejnë, kanë edhe efekte të tjera indirekte në ekonomi.

Sipas raportit të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit, turizmi ka krijuar 286,700 vende pune ose rreth 25.2% të punësimit dhe në 2029 pritet që ky numër të shkojë 315,900 . Sidoqoftë, pasi sezoni turistik është ende shumë i shkurtër në Shqipëri, vendet e punës në turizëm konsiderohen si punë që nuk kërkojnë edukim të avancuar dhe nuk japin mundësi karriere. USAID, Ambasada e Suedisë në Tiranë dhe Qendra për Edukim Ekonomik dhe Biznes po implementojnë një projekt prej 1.435 milion dollarë, i cili do të krijojë një fond për rritje të investimeve dhe financim

të turizmit në Shqipëri. Fondi i Investimeve dhe Financave të Turizmit kontribuon në përmirësimin në sektorin e turizmit, duke përfshirë mjedisin që mundëson biznesi në Shqipëri dhe kapacitetet e fuqisë punëtore. Fondi do të përqendrojë përpjekjet për të zhvilluar komunitetet e agroturizmit dhe eko-turizmit në zonat rurale, natyrore dhe të mbrojtura. Për sa i përket edukimit në sektorin e turizmit, USAID ka mbështetur projektin PeopleFirst i cili është një projekt 24-mujor, i përqendruar tek burimet njerëzore me qëllim promovimin e punësimit të shqiptarëve në sektorin e turizmit përmes ofrimit të trajnimeve teknike dhe praktike të vlerësuara nga punëdhënësit. Projekti krijon partneritete midis punonjësve të ardhshëm, Qendrave të Formimit Profesional dhe bizneseve, si dhe krijon rrugë për punonjësit e ardhshëm, veçanërisht të rinjtë dhe gratë, për të fituar aftësi dhe për të hyrë në fuqinë punëtore. Në fund pritet që të paktën 2,000 individë përfundojnë programet e trajnimit për sektorin e turizmit.

Pavarësisht rritjes së fuqishme vitet e fundit, një e katërta e popullsisë së Shqipërisë jeton nën nivelin e varfërisë prej 2 dollarë në ditë. Shqipëria Veriore e cila është kryesisht rurale dhe malore është rajoni më i varfër, me nivelet më të larta të varfërisë në rrethet veri-lindore të Kukësit, Pukës, Malsi e Madhe dhe Dibrës, me 80 përqind të të ardhurave të familjeve nga mbrojtja sociale dhe ndihma ekonomike.

I ndodhur në rajonin alpin të Shqipërisë, ekziston një potencial i madh për zhvillimin e turizmit me mundësi për ekoturizëm, turizëm aventuresk dhe ushqim agroturizmi si për vizitorët ndërkombëtarë ashtu edhe për ata lokalë. USAID kërkon të kontribuojë në përmirësimin e sektorin e turizmit në Shqipëri, përfshirë përmirësimet në mjedisin që mundëson biznesi në Shqipëri dhe kapacitetet e fuqisë punëtore, të shërbejnë si katalizatorë për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Projekti AgroTourism synon të përmirësojë kushtet e jetesës së banorëve të zonave rurale të Shkodrës, Malësisë së Madhë dhe Pukës përmes punësimit në një sektor të qëndrueshëm dhe të gjallë të agroturizmit. Projekti do të bëjë një vlerësim të mënyrave për të promovuar ndërmarrjet e turizmit të qëndrueshëm në komunitetet në veri të Shqipërisë. Projekti do të mbështesë përpjekjet e marketingut për të promovuar rritjen e ndërmarrjeve individuale dhe të bizneseve përreth për komunitetet lokale. Partnerët përfshijnë: operatorët turistikë, agjensitë lokale të turizmit, qendrat e informacionit turistik dhe bashkitë. Një fokus i veçantë do të jetë fuqizimi i rolit të grave në vendimmarrje në operimin dhe administrimin e ndërmarrjeve. Projekti do të angazhojë palët e interesuara lokale dhe komunitetet me qëllim krijimin e grupeve të punës në secilën prej bashkive. Misioni i projektit është të nxisë rritjen ekonomike në turizëm duke e lidhur udhëtarin me kulturën, trashëgiminë dhe natyrën e vendit. Ai kombinon konceptet e dixhitalizimit të turizmit dhe ruajtjes së origjinalitetit në një njësi të vetme unike. Në qendër të projektit është zhvillimi i një platforme dixhitale të përparuar, të kombinuar me një aplikacion smartphone, i cili premton të bëhet platforma më e madhe dixhitale për turistët ndërkombëtarë dhe vizitorët vendas.

ANALIZË E TË DHËNAVE STATISTIKORE TË PËRFSHIRJES DHE PËRFITIMIT NGA ORGANIZATAT MBËSHTETËSE.

Pavarësisht mbështetjes së vazhdueshme të ndërkombëtareve, reformave të ndërmarra në mbarë vendin, planeve strategjike dhe granteve të alokuara, jemi perpara faktit se në Shqiperi të ardhurat mesatare mujore për një të punësuar sipas grup-profesioneve janë shumë larg të ardhurave të siguruara në një nga vendet e fqinjëve tanë. Nëse i referohemi të dhënave të deklaruara nga INSTAT në tre vitet e fundit situata paraqitet si më poshtë:

GRUP PROFESIONET (SIPAS ISCO-08 NË NIVEL 2 SHIFROR)

	2016			2017			2018		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjithsej	**47,522**	**50,084**	**44,354**	**48,967**	**51,392**	**46,018**	**50,589**	**53,181**	**47,490**
Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	95,961	96,812	93,764	95,380	95,420	95,228	99,013	99,309	98,427
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	64,628	76,779	57,772	66,297	77,638	59,940	67,888	78,799	61,711
Teknikë dhe specialistë në zbatim	52,145	54,999	48,170	54,088	56,561	50,474	56,647	59,922	52,259
Nëpunësit	47,826	46,549	48,665	50,878	50,354	51,062	53,123	52,366	53,510
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	34,832	38,164	29,773	36,844	40,136	31,936	37,822	41,393	32,538
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	27,739	28,171	26,409	29,910	30,439	28,265	31,026	31,611	29,159
Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to	31,447	34,900	25,654	33,604	37,643	27,152	34,887	38,931	28,424
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	32,086	36,722	26,269	34,123	39,277	27,857	35,400	40,355	29,281
Punëtorë (Profesione elementare)	27,231	27,991	25,894	28,990	29,745	27,647	30,502	31,483	28,907
Forcat e armatosura	54,049	54,027	54,188	58,075	58,074	58,082	59,383	59,551	58,157

Mundësitë e zhvillimit të ekonomisë vendase janë thuajse të pamundura pa mbështetjen e ndërkombëtarëve, referuar kjo të ardhurave të gjeneruara nga punësimi në vend. Fakt është gjithashtu se ¼ e popullsisë jeton në kufirin e varfërisë, sidomos zonat e veriut të Shqipërisë kryesisht zonat rurale ku burimi i vetëm i të ardhurave te tyre janë ndihma ekonomike, por potencialet për zhvillim ekonomik, të qëndrueshëm dhe afatgjatë shumë të mëdha.

Sipas studimeve të kryera dhe statistikave rezulton se mungesa e informimit ka bërë që një pjesë e mirë e forcës punëtore të gjejë si zgjidhje emigrimin. Natyrshëm lind pyetja. A mjaftojnë aktivitet e ndërmarra nga ndërkombëtarët në rrëzimin e barrierave dhe evidentimin e zgjidhjeve dhe zgjedhjeve për zhvillim ekonomik


bazuar në resurset e vendit tonë?

Duke qënë se rreth 98% e njësive ekonomike Shqiptare janë klasifikuar dhe ushtrojnë aktivitet si ndërmarrje të vogla dhe të mesme, a janë informuar ato rreth projekteve aktuale të cilat nxisin dhe mbështesin procesin e përgatitjes së paketave të huasë, praktikat e mbajtjes së evidencave kontabël, hartimin e planeve të biznesit etj? Po projektet në mbeshtetje të njesive ekonomike që operojnë në sektorin e turizmit a kanë marre jehonën e duhur?

Projekt	Periudha	Buxheti	Implementuesi
Financial Sector Development Program	2011-2018	$7,070,000.00	Volunteers for Economic Growth Alliance
SMARTCAPITAL	2016-2019	$1,200,000.00	Creative Business Solutions
Tourism Investment and Finance Fund	2016-2020	$1,435,628.00	Center for Economic and Business Education (CEBE)
AgroTourism Albania	2016-2019	$695,270.00	CEED Albania
People First	2016-2018	$749,744.00	The Headhunter
INTOALBANIA – Innovative Tourism in Albania	2017-2020	$1,105,000.00	Creative Business Solutions
Diber: Trails and Tradition	2017-2020	$1,046,689.00	Albanian Local Capacity Development Foundation
Growing Social Businesses in Albania	2016-2019	$1,000,000.00	Yunus Social Business Balkans
Total		$14,302,331.00	


Nëse analizojmë listën e projekteve të sipërpërmendura vëmë re se investimet më të mëdha me një projekt të shtrirë në 7 vite, i ka marrë sektori financiar. Duke qënë se thuajse gjithë projektet e tjerë janë në fushën e zhvillimit të klimës së mirë të biznesit dhe turizmit mund të themi se investimi nga USAID ka qenë i barabartë mes këtyre dy kategorive. Projekti për agroturizmin do të zgjasë tre vjet dhe do të sigurojë një ndikim të rëndësishëm ekonomik. Do të krijojë një përfitim ekonomik total prej 16.3 milion dollarë, një rritje prej mbi 60K vizitorësh dhe do të krijojë 670 vende të reja pune.

Për më tëpër mund të shohim kontributin në vite të USAID në Shqipëri.



Grafiku 1 Të dhënat janë gjeneruar nga faqja zyrtare e USAID dhe janë përpunuar nga autorët

Sic mund të vërehet dhe grafikisht ky kontribut ka ardhur në rënie që prej vitit 2001 ku kontributi ka qënë në vlerën $55,716,821.00 dhe deri në 2019 ku kontributi është 90% më pak, përkthyer kjo në vlerë monetare si $5,496,723.00. Kjo rënie mund të analizohet në disa aspekte, ose fokusi i SHBA nuk është më zhvillimi i Shqipërisë dhe ato kanë vendosur që të investojnë në Shtete të tjera ose Shqipëria po ecën me hapa të mira dhe nuk ka nevojë për kontribut shumë të lartë nga SHBA. Një faktor tjetër që duhet analizuar është sa % e këtij kontributi është për rritjen ekonomike të Shqipërisë.



Grafiku 2 Të dhënat janë gjeneruar nga faqja zyrtare e USAID dhe janë përpunuar nga autorët

Jo e gjithë vlera e investimit të USAID shkon për projekte që shkaktojnë apo mbështesin rritjen ekonomike. Ky kontribut që nga viti 2001 ka qënë rreth 22 % në terma vjetor. Vlerën mëtë ulët e ka arritur në 2008 me 4 % dhe vlerën më të lartë në 2011 me 49%. Gjithsesi trendi vitin e fundit duket pozitiv pasi kontributi i USAID për rritjen ekonomikë të Shqipërisë në vitin e fundit është rreth 25% më shumë se vitin e kaluar.

Vlen për tu permendur gjithashtu edhe angazhimi i SHBA për reformën Territoriale dhe Administrative të vendit tonë, në hedhjen e themeleve dhe konsolidimin e qeverive vendore. Reforma territoriale dhe administrative e cila organizon qeverisjen qendrore në 61 bashki, synon fuqizimin e bashkive duke rritur kapacitetin e tyre për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për qytetarët dhe duke rritur efiçencën e menaxhimit të burimeve të tyre.

Efiçensa e saj do të pasqyrohet nëdhënien e një pavarësie më të madhe bashkive, transferim të një sërë shërbimesh që më parë mbaheshin nga pushteti qendror në funksion të një sistemi të përgjegjshëm, demokratik ndaj shoqërisë, i cili ofron shërbimet për të cilat qytetarët kanë nevojë dhe që jep llogari para tyre.

Nëpërmjet PNUD-it, SHBA dhe vende të tjera kanë ofruar mbështetje financiare dhe teknike për kryerjen e reformës territoriale dhe administrative të Shqipërisë.

Nëse i referohemi Raportit të Auditimit të Performancës "Funksionimi i Bashkive në Kuadër të Reformës Administrativo-Territoriale", publikuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, më Tetor 2018 do të vërejmë problematikat e hasura si dhe rekomadimet lidhur me mundesinë e vlerësimit të aksesit të qytetarëve, harmonizimin dhe ndryshimin e nevojshëm të akteve ligjore për forcimin e autonimisë vendore.

KONKLUZIONE

Aktivitetet e USAID me synim, evidentimin e potencialeve të mëdha që ofron zhvillimi i turizmit aventuresk, hoteleri agroturizëm kanë kontribuar nëpërmjet planeve strategjike dhe projekteve në përmirësimin e ketij sektori në Shqipëri, përfshirë përmirësimet në mjedisin që mundëson biznesi në Shqipëri dhe kapacitetet e fuqisë punëtore, që shërbejnë si katalizatorë për krijimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike. Projektet synojnë jo vetëm evidentimin e potencialeve dhe burimeve që ofron vendi ynë, por nëpërmjet tyre synohet gjithashtu edhe përmirësimi i kushteve të jetesës së banorëve të zonave të caktuara duke ofruar ne cdo hap asistencë teknike dhe krijimin e modeleve të suksesshme.

Forcimi i institucioneve publike, forcimi i sundimit të ligjit, forcimi i sektorit financiar, promovimi i shoqërisë civile, forcimi i marrëdhënieve midis qeverisë qëndrore dhe lokale në mënyrë që të përmirësohet planifikimi, krijimi i kornizës për zhvillimin e një plani kombëtar territorial dhe ofrimi më efikas dhe transparent i shërbimeve kyçe publike që prekin jeten e përditshme të të gjithë qytetarëve, p.sh arsimi, shëndetesia dhe shërbimet e tjera publike, mbeten disa nga sfidat e Qeverisë Shqiptare.

Falë mbështetetjes së nevojshme dhe të pareshtur të instrumentave të politikës amerikane, një Shqipëri e fortë institucionalisht, ekonomikisht dhe e aftë për të permbushur nevojat e qytetarëve të saj, sjell stabilitet në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë.

BIBLIOGRAFIA

- INSTAT, (2019) *NVM, INSTAT: Rritet numri i të punësuarve, bien shitjet neto.* Aksesuar nga https://www.monitor.al/nvm-instat-rriten-te-punesuarit-kryesontregtia/
- INSTAT, (2019) *Rritja Ekonomike Tremujore*, Tirane 24/12/2019. Aksesuar nga http://www.instat.gov.al/media/6583/pbb-tr3-2019.pdf
- INSTAT (2019) *TURIZMI NË SHIFRA SHQIPËRI 2019*. Tiranë. Aksesuar nga http://www.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra__.pdf . Faqe 19
- World travel and Tourism Council. (2019) *Albania 2019 Annual Research: Key Highlights.* Aksesuar nga https://www.wttc.org/economic-impact/country-analysis/country-data/
- IDEA:International Data and Economic Analysis.Aksesuar nga https://idea.usaid.gov/cd/albania?comparisonGroup=region
- USAID (2012) *Performance Evaluation Of The Albanian Agricultural Competitiveness (Aac) Program*. July 31, 2012. Aksesuar nga https://2012-2017.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/Final%20Albania%20Report%20July%2030.pdf
- AADF (2020) *Projects.* Aksesuar nga https://www.aadf.org/entrepreneurship/
- USAID (2020) *History.*Aksesuar nga https://www.usaid.gov/albania/history
- USAID (2020) *Our Work.* Aksesuar ngahttps://www.usaid.gov/albania/our-work
- USAID (2020) *Economic Growth And Trade.*Aksesuar nga https://www.usaid.gov/albania/economic-growth-and-trade
- https://2012-2017.usaid.gov/sh/albania/news-information/press-releases/joint-statement-international-partners-territorial
- http://www.klsh.org.al/web/raporti_reforma_territoriale_4443.pdf

ANEKS A

Table 1 Të dhënat janë gjeneruar nga faqja zyrtare e USAID dhe janë përpunuar nga autorët

Year	Contribution USAID	Economic Growth	Economic Growth in %
2001	$55,716,821.00	$11,863,382.00	21.29%
2002	$42,815,675.00	$16,326,695.00	38.13%
2003	$29,939,971.00	$7,910,728.00	26.42%
2004	$25,562,003.00	$6,838,304.00	26.75%
2005	$23,289,116.00	$5,212,073.00	22.38%
2006	$33,694,399.00	$4,755,842.00	14.11%
2007	$20,235,334.00	$2,548,278.00	12.59%
2008	$15,453,548.00	$767,065.00	4.96%
2009	$35,391,544.00	$5,051,678.00	14.27%
2010	$17,340,734.00	$1,797,758.00	10.37%
2011	$8,437,607.00	$4,120,676.00	48.84%
2012	$11,632,798.00	$3,059,483.00	26.30%
2013	$12,492,817.00	$2,927,450.00	23.43%
2014	$12,437,378.00	$2,692,777.00	21.65%
2015	$8,948,243.00	$2,229,428.00	24.91%
2016	$14,250,486.00	$2,353,558.00	16.52%
2017	$9,517,062.00	$2,088,818.00	21.95%
2018	$12,049,561.00	$1,804,242.00	14.97%
2019	$5,496,723.00	$2,180,984.00	39.68%
Total	**$394,701,820.00**	**$86,529,219.00**	**21.92%**

ROLI I KRIZËS FINANCIARE NË ZHVILLIMET E SEKTORIT BANKAR NË SHQIPËRI

Elia Botka
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
elia.botka@umsh.edu.al

ABSTRACT

This paper seeks to assess the impact of the 2008 financial crisis on the Albanian banking system. The crisis has had its effects in Albania since the last quarter of 2008. It affected the volume of bank deposits causing the deterioration of liquidity indicators. The fall in loans and the rise in bad loans worsened the financial leverage, the capital adequacy ratio and the banking system profitability. In the following years, although the capital adequacy and liquidity ratios never reached below the minimum set by banking supervision, these deteriorated. The final effect was the reduction of lending to the economy. Against this backdrop, the role of international institutions such as the IMF and the World Bank have been crucial in the development of the banking sector. These institutions have been supportive of economic growth policies, emphasizing the need for the banking sector to recover its lending to the economy. Through World Bank loan and development policy, monetary consulting and IMF financing projects, the gradual transition from Basel I to Basel II rules regarding banking supervision methodology reached a drastic decline in 2018 of bad loans increasing the indicators of profitability, liquidity and capital adequacy. The last, but not least, challenge is the sustained growth of lending to the Albanian economy.

KEYWORDS: economic crisis, financial crisis, Albania

1.HYRJE

Në këtë punim do të shqyrtojmë rolin e institucioneve ndërkombëtare, FMN dhe Banka Botërore në zhvillimet e sektorit bankar në Shqipëri. Reformat e propozuara për sistemin bankar kanë qënë dhe janë vetëm një nga komponenttei sistemit të reformave të propozuara dhe të mbështetura, kryesisht nga FMN por dhe nga BB. Në tërësinë e tyre reforma kanë si synim rritjen e qëndrueshme të ekonomisë shqiptare. Kjo rritje duhet të eci paralelisht me uljen e borxhit publik, me shpenzime publike të orientuara drej një zhvillimi të qëndrueshëm, sipër shëmbull drejt sektorit të arsimit, të shëndetësisë të infrastrukturës. Një kujdes i veçantë duke treguar për eficiencën në përdorimin e burimeve dhe në uljen e shpërdorimeve. Gjithashtu duhet krijuar dhe një sistem fiskal i qëndrueshëm, efiçint, dhe në mbështetje të politikave ekonomike. Rritja në ekonomi duhet të stimulohet nëpërmjet rritjes së qëndrueshme të investimeve duke përfshirë këtu edhe investimet e huaja direkte. Në të konteks një rëndësi të veçantë për këto instituzione ka dhe krijimi i një klime të favorshme të biznesit. Rritja e investimeve gjithashtu impikon nevojën për reformat strukturore në sistemit financiar. Diversifikimi i i institucioneve financiare do të çonte në rritjen e ofertës për kredi. Në këtë kuadër, zhvillimi i një tregu kapitali eficint dhe diversifikimi i produkteve bankare do të ishin zhgjedhje të domosdoshme për rritjen e ofertës së kredisë. Ky është kuadri i përgjithshëm brënda të cilit duhet konsideruar reformat në sektorin bankar.

Kriza e fundit financiare i dha efektet e saj në Shqipëri që në vitin 2008. Sektori bankar filloj të hynte në një krizë graduale e të përshkallëzuar që karakterizohej nga rritja e kredive me probleme, rënia e huave, rënia e volumit të depozitave bankare të cilat nga ana e tyre, ndikuan në rënien e kapitalit të bankave dhe në përkeqësimin e treguesve të përfitueshmerisë. FMN dhe Banka Botërore janë dy institucione ndërkombëtare që kanë qënë të pranishme në Shqipëri që në vitet '90 pas përmbysjes së sistemit komunist. Marrdhëniet midis Shqipërisë dhe FMN-së pas krizës finanziare filluan të bëheshin më të institucionalizuara dhe të rregulloheshin nga Artikulli IV i marrëveshjeve. Ky artikull përcakton një prezencë këshilluese dhe rekomanduese të FMN-së në Shqipëri. Këshilla dhe rekomandime që në fushen financiare kanë pasur dhe kanë për objektiv forcimin e sistemit bankar shqiptar dhe me rritjen e kreditimit bankar në ekonominë shqiptare. Objektivi i Bankës Botërore në Sistemin Bankar Shqiptar ka qënë i harmonizuar me atë të FMN-së dhe ka pasur dhe ka të bëjë me forcimin dhe rregullimin e mbikëqyrjes së institucioneve financiare dhe në menaxhimin e kredive me probleme me synim rritjen e kreditimit të ekonomisë.

2. FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE BANKA BOTËRORE NË MBESHTETJE TË SISTEMIT BANKAR NË SHQIPËRI

Banka Botërore ka qënë e pranishme në Shqiperi me dy projekte për Sektorin Financiar të quajtur *Development Policy Loans (*DPL) i cili ka synuar përmbushjen e disa kritereve që lidhen kryesisht me ndryshimet ligjore dhe rregullative. Këto ndryshime kanë për qellim përmirësimin e funksionimit të sistemit financiar. Ne projektin e viti 2014 dhe atë të vitit 2017 ky synim do të arrihej nëpërmjet forcimit rregullator dhe të mbikëqyrjes në sektorin bankar dhe menaxhimin dhe uljen e kredive me probleme (*non performing loans, NPLs*)

BANKA BOTËRORE

Sektori financiar në Shqipëri. Projekti *Development Policy Loans* i vitit 2014

Qëllimi i zhvillimit të projektit të kredisë për politikën e zhvillimit të sektorit financiar ishte forcimi i regjimit rregullator dhe mbikëqyrës të sektorit financiar dhe zbutja e dobësive kryesore të bankave dhe sektorëve financiarë jobankar. Huaja e politikës së zhvillimit (DPL) synonte të forconte regjimin rregullues dhe mbikëqyrës të sektorit financiar dhe të zbuste dobësitë kryesore të bankave dhe sektorëve financiare jobankar. Operacioni në fjalë ishte krijuar për të mbështetur axhendën e reformës së qeverisë për të sfidat kryesore në të gjithë sektorin financiar. Operacioni mbështetej në tre shtylla: (1) forcimi i rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit bankar dhe rrjetit të sigurisë financiare; (2) përshpejtimin e zgjidhjes së kredive me probleme; dhe (3) forcimin e rregullimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve financiare jobankre . Sektori financiar në Shqipëri.

Arritjet e këtij projekti u gjykuan si substanciale nga Banka Botërore dhe u konkretizua kryesisht në miraimin e në manual të ri mikëqurjeje të bazuar mbi riskun dhe ligjin e ri të garantimit të depozitave.

PROJEKTI *DEVELOPMENT POLICY LOANS* I VITIT 2017

Qëllimi i projektit të kredisë për politikën e zhvillimit e sektorit financiar për Shqipërinë ishte forcimi i aftësisë së qëndrueshme të sektorit bankar dhe rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare jobankre. DPL-ja është e ndërtuar rreth tre shtylla ku e para ka të bëjë me miratimin politikave për të zvogëluar kreditë me probleme dhe forcimin të sigurisë financiare, ndërsa dy të tjerat i përkasin rregullimit dhe mbikëqyrjes së bankave, të Shoqërive të kursim- kreditit dhe Fondeve të Investimit.Siç shihet, ky projekt ka nje shtrirje me të gjërë në instituzione të tjera financiare se sa projekti i parë ndërsa vazhdon të mbështesi zgjidhjen e kredive me probleme.

Në përfundim të këtij projekti dhe në lidhje reformat në sektorin bankar arritjen ishin:

Perpilimi nga ana e të gjitha bankave të planevevjetore të rimëkëmbjes, aprovimi i Ligjit të Falimentimit nga Parlamentidhe ligjin e Shoqërive të kursim kreditit dhe

adoptimi i regullave të reja mbi licensimin, raportimin dhe menaxhimin e riskut. Këto obejktiva u gjykyan si të arrira.

FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR

Pas krizes se 2008 FMN ka vazhduar misionin e saj në Shqiperi me konsultimet vjetore sipas artikullit IV- që përcakton marrëdhënien dy palëshe - dhe nje program tre vjeçar në vitin 2014, vit që koinçidon me kulmin e efekteve të krizës financiare në Shqipëri. Synimi i programit është rikthimi rritjen ekonomike në vënd dhe frenimi i rritjes së shpejtë të borxhit publik si kërcënim për stabilitetin ekonomik të vendit. Në këtë program ndryshimet që prekin më nga afar sektorit bankar, njëlloj si për Bankën Botërore kanë të bëjnë me mirë menaxhimin dhe uljen e kredive me probleme dhe me përmirësimin dhe forcimin e sistemit të mbikëqyrjes financiare. Pas fillimit të transmetimit të krizës financiare në Shqipëri, FMN-ja rekomandoi (bazuar në të lartpërmëndurin artikullin IV) një monitorim të vazhdueshëm dhe të shpeshtë të aktivitetit bankar dhe bashkëpunim intensiv të Bankës së Shqipërisë me bankat e tjera qëndrore. Fillimisht, direkt pas shpërthimit të krizës, sistemi bankar rezultonte i mirëkapitalizuar dhe me tregues përfitueshmërie të kënaqshëm. Kjo ishte situata në fund të vitit 2008 sipas analizës së FMN-së. Situata e përkeqësuar në dy vitet në vazhdim do të kërkonte sipas FMN-së që mbikëqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar të qëndronte përpara sfidave në zhvillim. Pasojat negative të krizës financiare globale u frenuan ndjeshëm nga aktiviteti i mbikëqyrjes dhe rregullimit të mëparshëm të fuqishëm dhe proaktiv. Gjithashtu, bilancet bankare janë të riparueshme, inovacioni financiar po përparon, dhe sfidat e reja ndërkombëtare dhe vendase janë në horizont; Prandaj, vigjilenca e vazhdueshme është rëndësishme. Fushat prioritare për veprim përfshijnë nxitjen e pavarësisë së institucioneve mbikëqyrëse, përshpejtimin e ekzekutimit të kolateralit, ruajtjen e likuiditetit, rritjen e kornizës së testimit të stresit.Një vit më vonë FMN konkludon se politikat e ndërmarra nga BSH kanë ndihmuar arritjen e raporteve të larta të likuiditetit dhe mjaftueshmërisë së kapitalit.Politika monetare kanë rezultuar të suksesshme ka ndihmuar në rritjen e stabilitetit makrofinanciar, por efektet e saj janë të kufizuar. Kursi fleksibël i këmbimit dhe objektivat e inflacionit kanë ruajtur me sukses inflacionin e ulë dhe të qëndrueshëm, i cili, nga ana tjetër, ka dhënë siguri tregut për aftësinë e autoriteteve për të ruajtur stabilitetin makroekonomik. Nëse kërkesa e brendshme do të frenohejmë tej dhe kredia të ulej, atëherë autoritetet mund të konsideronin një lehtësim të mëtejshëm monetar, me kusht që pritjet e inflacionit të mos prekeshin.

Prezenca e ndjeshme e filialeve të bankave europiane, duke pasur parasysh krizën bankare ku u përfshi Europa ndikoi në rrjedhjen jashtë të kapitaleve gjë që pati implikime negative në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit. FMN përjashton nevojën e ndërhyrjes publike duke vlerësuar si të mjaftueshme dhe të efektshme politikat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë. Një mbështetje relativisht e ulët në financimin e jashtëm ka përmirësuar rreziqet, ndërsa veprimet e fundit të Bankës së Shqipërisë (BSH) shndërrimi i degëve të huaja në filiale, shtrëngimi i kapitalit dhe kërkesave të likuiditetit, dhe forcimi i kufijve të kujdesshëm dhe të sigurimit

gjithashtu kanë ndihmuar. Bankat arritën të kanë raporte të larta të likuiditetit dhe kapitalit.

Megjithatë FMN konkludon se, mbikëqyrja e sistemit bankar mbetet thelbësore në periudhën në vijim. Huadhënia e konsiderueshme e pambrojtur e valutave i ekspozon bilancet e bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, ndërsa mbajtja e konsiderueshme e obligacioneve qeveritare mund të bëhet potencialisht një burim i cenueshmërisë së ardhshme nëse nuk zbatohen masat e përshtatshme për të ulur borxhin publik. Testimet e stresit në banka (ose programi i vleresimit të kapitalit rregullator) duhet të vazhdojnë të udhëheqin vendimet mbi kapitalin dhe rezervën e likuiditetit. Bashkëpunimi i ngushtë që Banka e Shqipërisë ka krijuar me mbikëqyrësit e bankave mëma është thelbësore për zbutjen e rreziqeve.

Niveli në rritje i kredive me probleme është shqetësim dhe kërkon veprim të shpejtë. NPL-të - kryesisht në tregti, ndërtim dhe prodhim - janë rritur më shpejt sesa në vendet e tjera të rajonit, kryesisht për shkak të ngadalësimit ekonomik, mospagimit të faturave të furnitorëve të qeverisë dhe vazhdimit të vonesave në ekzekutimin e kolateralit. Kjo ka ndikuar në përfitimin e bankave dhe aftësinë e tyre për të shtrirë kredinë në ekonomi. Veprime konkrete, të tilla si lehtësimi i ekzekutimit të kolateralit lejimi i çmimeve të pronave për tu përshtatur me forcat e tregut duke lehtësuar ekzekutimin e kolateralit (duke hequr çmimet dysheme), respektimi i ligjit dhe politikat ndihmuese fiskale të shtetit do të ndihmonin në këtë rast.

Në vitin 2013 FMN fokusohet më shumë tek kreditë me probleme, tek efekti negativ i tyre në ofertën e kredisë bankare, dhe tek rritja e asimetrive informative. Një vit më pas FMN i akordon Shqipërisë kredine tre vjecare (sipas marreveshjes Facility of Extended Fund) për një zbatim të efektektshëm të politikave ekonomike, fiskale dhe financiare. Kjo marreveshje kishte në fokus uljen e borxhit publik dhe stimulimin e rritjes ekonomike. Ajo njeh përpjekjet e bëra në atë drejtim dhe konkludon për sa na përkat se "Politika monetare duhe nëpërmjet mbajtjes së stabilitetit dhe implementimit te reformave strukturore dhe në klimën e biznesit. Stabiliteti financiar duhet të vazhdojë të jetë mbështetës i rimëkëmbjes ekonomike, në përputhje me mandatin e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Rritja e kredisë po rikuperohet, por mbetet e ulët, e ndikuar nga kreditë e larta jo-performuese dhe dobësitë në zbatimin e kontratave. FMN-ja mirëpret angazhimin e autoriteteve për të hartuar një strategji gjithëpërfshirëse për të adresuar çështjen e NPL me qëllim të përmirësimit e kushteve të kredisë.

"Shërimi i ekonomisë në Shqipëri duket se është në rrugën e duhur, edhe pse rreziqet anësore vazhdojnë. Këmbëngulja në zbatimin e axhendës së reformës strukturore do të jetë thelbësore për të zvogëluar pabarazitë makroekonomike dhe për të rritur standardet e jetesës.Politika e autoriteteve për lehtësimin gradual të monedhave është e përshtatshme për të luftuar presionet e infektimit duke shmangur rreziqet për stabilitetin financiar. Sigurimi i pavarësisë së bankës qendrore dhe forcimi i mbikëqyrjes së saj do të jetë e rëndësishme për ruajtjen e besueshmërisë së saj.

"Stoku i madh i kredive me probleme duhet të adresohet në mënyrë

gjithëpërfshirëse dhe me forcë në mënyrë që të ringjallë kredinë bankare për sektorin privat. Vigjilenca e vazhdueshme është e nevojshme për të siguruar që secila bankë të përmbushë kërkesat e kapitalit dhe të likuiditetit dhe të menaxhojë rreziqet siç duhet.

Me 2017 mbaron programin trevjecar Facility of Extended Fund Shqipëria përfundon me sukses të mbështetur nga FMN. "Programi e ka futur me sukses Shqipërinë në një shteg rimëkëmbjeje me financa të shëndosha publike," tha drejtuesja e ekipit të FMN për Shqipërinë. "Falë angazhimit të autoriteteve shqiptare, ne mund të mbështesim reformat që janë thelbësore për zhvillimin. Programi forcoi kornizën institucionale, zvogëloi ndjeshmërinë e ekonomisë dhe ndihmoi në ruajtjen e stabilitetit ekonomik pavarësisht kushteve të vështira të jashtme."

Ja disa nga arritjet e programit: një rritje ekonomike e përshpejtuar;

- hendeku buxhetor është ngushtuar me 3 përqind të PBB-së, i ndihmuar kryesisht nga rritja e të ardhurave tatimore;

- borxhi publik ka rënë nga kulmi i 73,7 përqind; Borxhet e qeverisë janë pastruar kryesisht;

- raporti i kredive të prapambetura bankare ka rënë dhe parlamenti ra dakord për një ligj të falimentimit për të zgjidhur kreditë e këqija; dhe kornizat e përgjithshme fiskale dhe financiare janë forcuar.

Sidoqoftë, Shqipëria duhet të vazhdojë përpjekjet për të forcuar rritjen e saj dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë së saj.

Përveç sygjerimeve për të ulur borxhin publik, për reformimin e taksës së pronës, rritjen e efikasitetit të menaxhimit financiar publik, zgjidhjen e borxhit të vonuar bankar që pengon huadhënien, në tetor të vitit 2017 FMN, analizon reformat në sistemin bankar dhe konkludon si më poshtë:

"Kuadri i dobët i zgjidhjeve të kredive me probleme (NPLs) vazhdon të pengojë rimëkëmbjen e kredisë, veçanërisht për korporatat. Misioni njeh progresin e bere në ristrukturimin e NPL të huamarrësve të mëdhenj. Së bashku me uljen e vleres së aktiveve (write-off), këto veprime kanë çuar në një rënie të konsiderueshme në raportin e kredive të këqija ndaj aktiveve. Sidoqoftë, rregullorja e për të lehtësuar procesin e ekzekutimit të kolateralit. Autoritetet duhet të miratojnë urgjentisht rregulloret për të zbatuar Ligjin e ri të Falimentimit dhe të lehtësojnë ristrukturimin jashtë gjyqësorit. Sipas FMN-së Rishikimi i Grupit Punues të NPL mund të ndihmojë në avancimin e kësaj axhende."

Misioni i FMN-se mirëpriti përpjekjet e vazhdueshme të autoriteteve për të forcuar mbikëqyrjen financiare. Në gjykimine ekipit të FMN-së,Sistemi bankar mbetet i qëndrueshëm, i kapitalizuar dhe likuid. "Autoritetet duhet të vazhdojnë të forcojnë përqëndrimin e tyre mikroprudencial në segmentet me rritje më të shpejtë dhe të rëndësishme të sistemit bankar për të minimizuar krijimin e rreziqeve të kredisë. Ata duhet të sigurojnë nivele të shëndetshme të kapitalizimit duke zbatuar rreptësisht kufij për ekspozimet e mëdha. Megjithëse sistemi bankar është mjaft i kapitalizuar dhe i likuid, oferta e kredisë për të mbështetur investimet në biznes mbetet i dobët. Kreditë me probleme (NPL)

kanë rënë me më shumë se 10 pikë përqindje që nga viti 2014, por ato mbesin të larta në disa banka."

Ja analiza dhe rekomandimet e FMN-së në nëntor të vitit 2018:

FMN e gjykon të ndryshuar situaten financiare në Shqipëri.nga një anë keminjë tregues të mirë të rënies së kredive me problem, por kjo duhet të çojë në rritjen e kredisë bankare. Banka e Shqipërisë vazhdon të përmirësojë kuadrin e saj mbikëqyeës dhe rregullator ndërkohë që Bankat jashte Baskimit Europian po luajnë në vënd një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Në këtë rrugë BSH duhet të bëjë akoma përpara.

Së pari, rënia e kredive me probleme duhet të krijojë skenën e rritjes së huadhënies, ndërsa bankat jo-BE po luajnë një rol në rritje. Banka e Shqipërisë vazhdon të përmirësojë kuadrin e saj mbikëqyrës dhe rregullator. Qasja e autoriteteve ka qenë efektive në zvogëlimin e raportit të NPL, veçanërisht përmes shkëputjeve. Një ulje e mëtejshme e Kredive me probleme kërkon (a) zbatimin të Ligjit të ri të Falimentimit, (b) zbatimin e kuadrit rregullator për zgjidhjen jashtë gjykatës të çështjeve të lidhura me kreditë me probleme, (c) rregulla për të përshpejtuar më tej shlyerjet e huave.

Së dyti duhet mbështetur cilësia në sistemin bankar. Filialet e bankave të BE-së kanë luajtur një rol të rëndësishëm në vendosjen e standardarteve për bankat në Shqipëri. Ndërsa pronësia e bankës po zhvendoset drejt grupimeve vendase dhe të vendeve të tjera jashtë BE-së, mbikëqyrja bankare ka një rol kritik në frenimin e rreziqeve që rrjedhin nga huazimi midis palëve. Për të përballuar këto sfida, përveç adoptimit të standardet e reja të Bazelit (bëhet fjalë për adoptimin e rregullave të Bazel III), është thelbësore pasja e një stafi të kualifikuar dhe rritja e inspektimeve në terren veçanërisht në banka të cilat paraqesin rreziqe në rritje.

3. MBIKËQYRJA BANKARE SIPAS RREGULLAVE TË BAZEL I, II, III

Akordet e Bazelit janë udhëzime për kërkesat e kapitalit të bankave, të hartuara nga Komiteti i Bazelit, të përbërë nga organet rregullatore të G10 (aktualisht i përbërë nga njëmbëdhjetë vende) dhe Luksemburgu për të ndjekur stabilitetin monetar dhe financiar. Marrëveshjet (së bashku me udhëzimet, standardet dhe rekomandimet) janë një formë e veçantë operative përmes së cilës vepron Komiteti dhe krijohen me shpresën që autoritetet kombëtare mund të hartojnë rregullimin bankar që marrin parasysh realitetet e shteteve individuale. Komiteti nuk ka një aftësi rregulluese të pavarur, ai është efektiv në veprimtarinë e tij, pasi vendet që i bashkohen atij janë të lidhura në mënyrë të ndërsjelltë midis tyre ndërsa vëndet që nukbëjnë pjesë, përshtaten me standartet rregullatore të Bazelit. Në këtë mënyrë, Komiteti inkurajon përhapjen dhe aplikimin e standarteve të përbashkëta

Meqenëse mjaftueshmëria e kapitalit të institucioneve bankare është thelbësore, autoritetet e çdo vëndi duhet të fokuson të rreziku i aktivitetit bankar. është thelbësore, është përparësia e rregullatorit në çdo vend që të përqendrohet tek rreziku. Kjo qasje e bazuar mbi rrezikun ka sjelle ndryshime të vazhdueshme dhe inovazion në sektorin bankar në vitet e fundit Vihet re identifikimi e një game gjithnjë e më të gjërë të rreziqeve, standartizimin e metodave për matjen e tyre. Më poshtë do të shikojmë specifikat e tre marreveshjeve.

BAZEL I

Sipas Bazel I koeficienti i kapitalit minimal është 8% dhe llogaritet si më poshtë:

PV/ $\sum A_i P_i$/ $\sum A_i P_i \geq 8\%$

Ku $P_i P_i$ është aktivi i i-të,një aktiv çfarëdo

PV është kapitali kapitali i mbikëqyrjes

$P_i P_i$ është ponderimi sipas riskut i aktivitetit të *i*-të

Në kapitalin e mbikëqyrjes përfshihet kapitali bazë dhe kapitali suplementar.

Kapitali bazë (i quajtur Common equity ose Tier 1 capital) llogatitet si shuma e vleres së aksioneve dhe rezervave e dukshme. Kurse tek kapitali suplementar (Tier 2 capital) futen rezervat e rivleresimit dhe rezerva të tjera të " Padukshme" nga plusvalencat e parealizuara akoma.

Koeficienti i ponderimit ndahet në katër kategori: me 0% ku futen aktivet më të sigurta si arka, kredi drejt BC OSCE, dhe borxhi sovran i vendevë të OSCE me 20 % ponderohet kreditë ndaj bankave të OSCE, kreditë ndaj bankave multilaterale, kreditë ndaj ndërmarrjeve publike. Me ponderim 50 % janë kreditë për shtëpitë me hipotekë dhe me ponderim 100% futen të gjitha kreditë drejt bizenseve, paketat e titujve drejt bizneseve dhe kreditë drejt bankave dhe qeverive të vendeve jo në OSCE.

Bazel I kufizohet vetem tek risku i kredisë duke përjashtuar riskun e tregut ku në veçanti bën pjesë risku i normës së interesit dhe risku i kursit të këmbimit.

Së pari rreziku i kredisë diferencohet keq pasi në kategorinë me ponderim risku 100% futen praktikisht të gjitha bizneset. Sipas kësaj logjike të gjitha bizneset tregëtare dhe industriale kanë të njëjtën aftësi kredije. Gjithashtu i paket është diferencimi i riskut të kredisë të ndarë në dy kategori . Risku i vëndeve të OSCE-s dhe risku i vendeve jashtë OSCE-s.

Bazel I ka që kuadri rregullator në të cilin shqipëria ka operuar gjatë krizësfinanciare derinë vitin 2013.

BAZEL II

Në Vitin 2013 Banka e Shqipërisë bën Kalimin rregullator nga Bazel I ne Bazel II.

Bazel II jep për herë të parë një përkufizim të riskut të tregut risku i tregut si risku i humbjeve në pozicionet në bilanc dhe jashtë tij si rrjedhojë e varazioneve të pafavorta të çmimeve të tregut. Këto variacione shkaktohen nga:

a. Norma e interesit që ndikon në titujt e borxhit
b. çmimet e aksioneve që ndikojnë në titujt e kapitalit
c. Kursi i këmbimit që ndikon në titujt në valutë.

Secilës prej kësaj kategorie të riskut të tregut i vendoset një kërkesë për kapital. Ka dhe një kërkesë për kapital për riskun operativ. Bazel II gjithashtu përcakton një nivel mbikëqyrjeje më të lartë nga autoriteti mbikëqyrës kombëtare i cili duhet të aprovojë sistemin e kontrollit të risqeve të adoptuar nga bankat dhe munden nëse e gjejnë të përshtatshmë të vendosin koeficiente të kapitalit më të lartë se ai minimali. Sipas komitetit të Bazelit bankat mund të adoptojnë një nga dy modelet për vlerësimin e riskut. Të parin që është një modeli standartizuar i cili bazohet në pordorimin e ratingut të jashtëm të përcaktuar nga agjensi të njëhura në nivel ndërkombëtar. Ose të zgjedhin një rating të brendshëm, por në këtë rast duhet të përdoren sistemi " Foundation" dhe "Advanced"

SISTEMI I STANDARTIZUAR

Në sistemin e standartizuar, nuk përdoret më dallimi midis vendeve të OSCE-s dhe jashtë OSCE-s. Ponderimi varet nga risku i çdo shteti.

Në sistemin e standartizur, për bizneset private ka ndryshime të madha për sai përket ponderimit të riskut që janë 20%, 50%, 100%, 150% sipas klasës së riskut nëse bizneset e kanë një të tillë.

Për kompanitë që nuk kanë një rating, ponderimi është minimalisht 100% por mund të rritet nëse autoriteti mbikëqyrjes e gjen të nevojshme.

SISTEMI *INTERNAL RATING* (IRB)

Në rastin që përdoret ky sistem, kapitali i nevojshëm për të përballuar risqet ekonomike vlerësohet nga sistemi i brendshëm i ratingut. Ky sistem bashkon aktivet (ato qe nuk tregetohen nje nje treg sekondar) në klasa homogjene risku, të cilave i asociohet një kërkesë e caktuar për kapital rregullator. Bankat në këtë sistem duhet të jenë në gjëndje të vlerësojnë probabilitetin e falimentimit brenda një viti për çdonjërën klasë risku. Inputet e kërkuar për sistemin IRB janë:

Probabilitetit i fallimentimit
Humbja në rastin e fallimentimit
Ekspozimet debitore në momentin e falimentimit
Kohëzgjatja

Por edhe këto rregulla të Bazelit ishin të pamjaftueshmepër mbrojtjen e kapitalit të bankave. Kjo i hapi rrugët kalimit në një korpus rregullash të reja që ishte Bazel III.

BAZEL III

Për të garantuar cilësinë e kapitalit, duhet rritur më tej *Core Tier 1* brenda kapitalit të mbikëqyrjes (kapitali aksioner plus rezervat e pashpërndara). Rritje shtesë e kapitalit në këndvështrimin e politikave anticiklike (Counter cyclical Buffer). Kjo do të thotë të vësh mënjanë më shumë atëhere kur kamë shumë

likuiditet pikërisht në fazen rritese të ciklit të ekonmisë.Në këtë fazë kapitali në vënd që të investohet vihet mënjanë si garaci e periudhave të ciklit ekonomik rënës ku në përgjithesi bizneset ndodhen në vështirësi. Kjo politikë vlerësohet nga autorë tëndryshëm si një politike që ka efektin e "sheshtezimit" të fitimeve. Mbrojtje nga risku i deleveraging (ulje e levës financiare) duke parashikuar nje përqindje minimale 3% të raportit tier 1 capital dhe aktivit. Koeficientët minimal të likuiditetit të futura nga 2015. Bazel III garanton: një cilësi më e mirë e kapitalit, ose ose një aftësi më e madhe e tij për të absorbuar humbjet e cila arrihet nëpërmjet ketyre masave:

Një *Common equity* që nga 2 % shkon në 4,5% në 2015;

Futja e një *capital conservation buffer* prej 2,5% që e çon core trier 1 në 7% duke filluar nga 2016 që i jep mundësi bankave të kënë një rezervë likuiditeti për fazat turbullirave financiare;

Futja e një jastëku në mbështetje politikave antiviklike(*counter-cyclical buffer*)deri në 2,5 %;

Futja e kufirit maksimal të levës financiare;

Futja e koeficientët të liquiditetit. Rregulli i ri parashikon një *liquidity coverage ratio* (LCR) të mjaftueshëm për të mbuluar likuiditetin e bankës për 30 ditë. Ky rregull do të aplikohet gradualisht deri në 2019.

3. BAZEL III DHE KALIMI NGA IAS 39 DHE IFRS 9

Kalimi nga IAS 39 në në kornizën e re kontabël e IFRS 9 sjell modifikim të pricipeve kontabël në drejtimin e një vlerësimi pararak të përkeqësimit të cilësisë së kredisë. IFRS 9 ka filluar të aplikohet nga Janari i 2018 –ës. Praktikisht, rregullat e përcaktimit të *accantonament*i (provizione) mbi kreditë me IFRS 9 janë bërë më strikte. IFRS parashikon që bankat të mos mbajnë vetëm provizione për kreditë me probleme, por edhe për ato kredi që parashikohet të kenë probleme në të ardhmen (expected credit loss). Bankat duhet të vlerësojnë paraprakisht riskun e këtyre kredive dhe të procedojnë me provizionet përkatëse në bilanc. Principi i ri kontabël i kërkon bankave që të kalkulojë menjëhere, por çdo hua të re humbjen e pritshme dhe të vlerësojë provizionin përkatës.Me IFRS 9 parashikohet klasifikimi i kredive në tre grupime të ndryshme (stage) në varësi të intervalit kohor ku parashikohet humbjet prej saj. Ky interval është prej një viti për ato kredite që klasifikohen në grupimin e parë, është jeta e mbetur e aktivit në grupimin e dytë dhe kreditë të cilave i vlerësohet objektivisht risku gjatë testit (*impairment test*), futen në kategorinë e tretë. Në krahasim me aplikimin e IAS 39 per IFRS 9 eshtë vleresuar privizione me 18 % dhe më të prekurat janë bankat e vogla në krahasim me bankat e mëdha. Ndërkohë që në skemën e mbikëqyrjes Bazel III, ndryshe nga ç'mund të mendohet, kjo risi nuk parashikohet. Komiteti i Bazelit ka parashikuar një qasje graduale të IFRS 9 për sa i përket impaktit mbi kapitalin që do të aplikohet në 3 deri në 5 faza duke filluar nga 2018.

ZHVILLIMET NË SEKTORIN BANKAR SHQIPTAR TË PAS KRIZËS DHE SITUATA AKTUALE

Pasiguria që përcolli tronditja e sistemit financiar botëror u reflektua në tërheqjen e një pjese të depozitave nga sistemi bankar. Këto tërheqje sollën probleme likuiditeti në sistem. Nga ana tjetër, kjo situatë ndikoi në uljen e gatishmërisë së sistemit për të kredituar ekonominë dhe rrjedhimisht, edhe në ngadalësimin e dukshëm të ritmit të kreditimit. Nga ky vit dhe ne vazhvim, kredite me probleme erdhen ne rritje te vazhdueshme. Rritja e kredive me probleme natyrisht pati efektin e saj negativ mbi treguesit e përfitueshmërisë. Ne 2009 treguesi i RoA përllogaritet në nivelin 0.42% dhe shumë më i vogël sesa fundi i vitit 2008 prej 0.91% (gjithësesi edhe ai në vlera mjaft të ulta). Deri në vitin 2013, në pergjithesi, performanca bankare ka qënë në rënie të vazhdueshme ku treguesi i kredive me probleme arriti vlerën rreth 22,8%. Megjithese treguesi i mjaftueshmerise se kapitalit rezultoi, mbi nivelin rregullator prej 12%. Ne vijim të kësaj situate në vitin 2013 Sistemi Bankar dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së tij ju nënshtruan një procesi vlerësimi nga Banka Boterore dhe FMN. Misioni vlerësoi punën e Bankës së Shqiperisë dhe propozoi kalimin gradual nga rregullat e Bazel I në ato të Bazel II mbi veprimtarine bankare dhe mjaftueshmerine e kapitalit, e në këtë kuader, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren e re «Per raportin e mjaftueshmerise se kapitalit» sipas rregullave te Bazel II. Në lidhje me kreditë me probleme në bashkepunim me Qëndrën Këshilluese të Sektorit Financiar (FinSAC) të Bankës Botërore, Banka e Shqipërisë ndërmori iniciativen për adresimin e ristrukturimit të kredive me qëllim rimëkembjen dhe zgjidhjen e kredimarrësit me probleme. Lidhur me mbikëqyrjen bankare, u finalizuar metodologjia e re mbikëqyrëse e cila synonte kalimin e plotë drejt një mbikeqyrjeje të bazuar mbi rrezikun. Në këtë metodologji të re mbikëqyrëse duhet të vleresoheshin qoftë rreziqet e evidentuara qofshin ato potenciale në ndryshim nga qasja e deriatëhereshme që nuk i merrte në konsiderate keto te fundit. Në vitin 2014 fillojnë të duken efektet e reformave të ndërmarra. Fillon rënia e kredive me probleme nga niveli maksimal që kishte kapur në 2013 prej 23,5% ne 22,8%. Nga viti 2014 e ne vazhdim shohim një performancë në rritje të sistemit bankar që rezulton nga ulja e vazhdueshme e kredive me probleme, me përmiresimin e treguesit të likuiditetit, dhe me rritjen e treguesve të perfitueshmerise RoA dhe RoE. Në fund të vitit 2018 treguesi i kredive me probleme ka arritur vlerën më të ulet prej 11.08%, treguesi i mjaftueshmerise se kapitalit është në rritje, dhe treguesit e përfitueshmerisë kapin vleren 1,32% (RoA) dhe 12,96% (RoE). Rezultatet vleresohen positivisht si nga Banka Botërore dhe nga FMN, megjithëse mbetet shumë për të bërë në këtë drejtim pasi Shqiperia mbetet vendi me perqindjen e kredive me probleme më të lartë në Ballkanin Perendimor. Gjithashtu, këto rezultate pozitive nuk kanë çuar në rritje të ofertës për kredi përkundrazi në fund të 2018 portofoli i kredive rezulton në rënie.

KONKLUZIONE

Sektori bankar, gjatë periudhës së krizës financiare ka "vuajtur" në mënyrë të veçantë nga prezenca e lartë e kredive të këqija në bilancet bankare nga vartësia prej kapitalit të huaj, nga tregues të ulët të përfitueshmërisë RoA dhe RoE, ndërsa treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit dhe i likuiditetit janë rikuperuar me shpejtësi dhe kanë arritur nivele të kënaqshme duke kaluar kufinjtë. Kjo falë këshillime të ngjeshura dhe projekteve të dy institucioneve internalzionale si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Ekziston një koordinim i mirë midis FMN dhe BB për sa i përket objektivave dhe instumentave për kryerjen e reformave në sektorin bankar në Shqipëri. Reformat kanë qënë kryesisht të lidhura mbi të gjitha me uljen e kredive me probleme treguesi i të cilava në Shqipëri ka qënë mjaft i lartë dhe më i larti në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu reforma kanë patur të bëjnë me forcimin e mbikëqyrjes bankare ku në këto vite të paskrizës mbikëqyrja bankare ka kaluar nga rregullat e Bazel I në ato të Bazel II në vitin 2013 dhe më pas është orjentuar drej plotësimit gjithnjë e më të plotë të rregullave të Bazel III. Reformat e ndërmarra nga Banka e Shqiperisë kanë dhënë efektet e tyre në kohë të shkurtër (duke filluar që nga viti 2014) dhe kanë pasur efekte të qëndrueshme duke filluar nga ulja e kredive me probleme, përmiresimi i treguesit te mjaftueshmerise se kapitali dhe të likuiditetit dhe rritja e treguesve te përfitueshmërisë RoA dhe RoE. Duhet konkluduar se në këto tregues të fundit reformat duhen thelluar pasi, marrë në vetvete, përqindja e kredive të këqija mbetet në nivele mjaft të larta, më të lartat në Ballkanin Perendimor dhe treguesi i përfitueshmërisë së kapitalit RoA është në vlera mjaft të ulta falë nivelit të ulët të financimit bankar me anë të huave. Këto reforma janë pjesë e reformormit më të gjërë të sistemit financiar si aktivizimi dhe mirë funksionimi i tregut të kapitalit reformimi dhe mbikëqyrja e shoqërive të Kursim-Kreditit dhe të Fondeve të Investimit.

Reformat në sektorin bankar janë arritur në dy fusha kryesore ate të të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit bankardhe ndryshimeve në legjistlacion.

Mbikëqyrja dhe rregullimi kanë qënë të lidhura me klasifikimin e aktiveve dhe llogaritjen e provizioneve dhe shitjen e kredive me probleme. Ndërsa në lidhej me ndryshimet në legjislacion arritjet kanë qënë Ligji i ri i fallimentimit, ligjin e procedurës civile dhe ligjin për shërbimin përmbarimor privat.

Reformat nuk mund të vinë vetëm nga sektori bankar dhe legjistlacioni por duhen të përfshijnë edhe ndërhyrjen në stimujt fiskalë në menaxhimin e kredive me probleme dhe informacioni i regjistrit të kredive.Kjo është fushë e tretë në të cilën reformat janë të rekomanduara ose në proces. Ndryshimet në këtë fushë janë të rekomanduara me forcë nga FMN-ja.

BILBLIOGRAFIA

- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2008, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2009, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2010, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2011, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2012, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2013, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2014, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2015, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2016, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2017, Banka e Shqiperisë;
- Raporti i Mbikëqyrjes Bankare 2018, Banka e Shqiperisë;
- www.imf.org;
- www.worldbank.org
- www.bis.org/
- www.ilsole24ore.com/
- Konrad-Adenauer-Stiftung (2018)The influence of external actors in the Western Balkans. A map of geopolitical players. Aksesuar nga file:///C:/Users/U174259/Desktop/papera/The%20influence%20of%20external%20actors%20in%20the%20Western%20Balkans%20(Pdf)%20v_1.pdf
- Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë. (2005) Raport i Kreut të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së. Aksesuar nga https://www.osce.org/sq/albania/15225?download=true
- Raporti i kryetarit të prezencës së OSBE-së në Shqipëri në këshillin e përhershëm të OSBE –së (2012). Aksesuar nga https://www.osce.org/sq/albania/94072?download=true

BASHKËPUNIMI RAJONAL DREJT ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EUROPIAN

Esmeralda Hasani
Barleti Research Institute
esmeralda.hasani78@gmail.com

ABSTRACT

The purpose of the study is to build a good model of regional cooperation in the Balkans. Preserving the principle of good neighborliness is one of the objectives of the European Union which has been developed since the end of World War II. The strengthening of this principle is happening for many reasons which include both aspects of international politics and the maintenance of stability between states as well as economic reasons. If earlier the reason for cooperation was to avoid inter-regional wars, there is already another orientation, the merchant one. The purpose of this paper is to analyze the main factors that influence the cooperation between the Balkan countries, including Albania. Strategies are being pursued by states and larger organizations in an effort to strengthen cooperation. Cooperation is taking place in several dimensions, for states that share a border line and at regional level. Strategies used for years, but also those that have been followed in recent years regionally to maintain cooperation will be part of this study. The analysis showed that building a good model of regional co-operation in the Balkans would favor all states to forge an entity with the European Union, as well as promote non-member states' EU integration. Inter-state issues, such as the name issue of Macedonia, the status of Kosovo, or the issue of the Albanian-Greek maritime border have all contributed to the creation of conflicts that need to be prioritized so that the effects can be minimized. more.

KEYWORDS: Regional Cooperation, European Union, Balkans, Albania

HYRJE

Ruajtja e parimit të fqinjësisë së mirë është një nga objektivat e Bashkimit Europian e cila është zhvilluar që pas përfundimit të luftës së dytë botërore. Forcimi i këtij parimi po ndodh për shumë arsye të cilat përfshijnë si aspekte të politikave ndërkombëtare dhe ruajtjes së stabilitetit mes shteteve ashtu edhe arsye ekonomike. Në një shoqëri humane rregullat e bashkë ekzistencës nuk mund të jenë ekzaktësisht të njëjta me ato darviniane në natyrë sepse shoqëria njerëzore herë pas here ka nevojë edhe për sigurimin e disa kushteve paraprake, në mënyrë që rrjedhimisht të krijohen mundësitë për funksionimin e mekanizmave të mëtejshëm, ku një ndër to mund të jetë dhe ndërveprimi në tregun e lirë.

Për këtë fakt referohemi dhe tek themeluesi i aksiomave të ekonomisë së lirë, Adam Smith, i cili kërkontë ndërhyrjen e shtetit deri në sigurimin e parakushteve, në mënyrë që të krijohej bazamenti dhe njëkohësisht mundësia që tregu të kryente misionin e tij. Politikat ndërkombëtare të ndjekura nga secili shtet i rajonit krijojnë ura lidhëze bashkëpunimi në cdo fushe dhe sektor të cilat krijojnë zhvillim për një vend. Nga bashkëpunimet e shumta që këto ura transmetojnë nga një shtet në tjetrin, krijohet një kompaktësi mes vendeve të rajonit. Gjithashtu, në këtë mënyrë ato janë puzzle plotësuese për njëri-tjetrin.

Duke qene se sot nuk është më konfliki i cili ka përfunduar me mbarimin e luftrave dhe vendosjes së paqes, fenomeni i cili kërkon zhvillim është bashkimi për atë që mund ta cilësojmë "Epoka e Ekonomisë". Tregu dhe ekonomia e tij janë baza që e mbajnë një shtet të ekuilibruar dhe fortësisht të qëndrueshëm. Për këtë pjesë është punuar së shumti nga secili vend i rajonit. Pikëspari duke nisur me pakësimin e konflikteve , edhe pse dihet se në cdo shoqëri sin ë të kaluarën dhe në ateë bashkëkohoren gjithmonë do të ekzistojnë konflikte . Duke u bazuar tek pikepamjet e konfliktit sipas Marks ka konflikte sepse ka pabarazi, ka luftë të pamjaftueshme për të zotëruar burimet e pamjaftueshme si para , fuqi, pushtet, autoritet. Në këto konflikte ajo pjesë që ka më shumë fuqi bëhet dominuese ndaj pjesës tjetër. Por pavarsisht kësaj vihen re përpjekjet për të shmangur këto lloj konfliktesh.

Ka disa cështje të cilat mund të zgjidhen vetëm politikisht dhe vetëm nëpërmjet ndërhyrjes së shtëtit. Politikat ndërkombëtare të ndjekura nga secili shtet i rajonit krijojnë ura lidhëze bashkëpunimi në cdo fushe dhe sektor të cilat krijojnë zhvillim për një vend. Nga bashkëpunimet e shumta që këto ura transmetojnë nga një shtet në tjetrin , krijohet jë kompaktësi mes vendeve të rajonit. Gjithashtu, në këtë mënyrë ato janë puzzle plotësuese për njëri-tjetrin. Nga ky bashkëpunim ndërshtetëror rruga e kalimit për të hedhur hapin e madh drejt BE dhe drejt zhvillimit më të madh duke transmetuar dhe një bagazh vlerash dhe cilësish do të jetë më e madhe. Kështu kemi mundësinë që të jemi në një nivel me këto shtete. Në këtë mënyrë mund të përthithim vlera të tjera nga këto vende në momentin që do të behemi pjesë e tyre.

CESHTJET E RAJONIT

Ballkani Perëndimor është një grup vendesh që janë në shënjestër të politikës së zgjerimit të Bashkimit Evropian. Ky grup fillimisht përbëhet nga Shqipëria, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Kosova. Kroacia u bashkua me Bashkimin Evropian në 2013, dhe kështu nuk është më në shënjestër të politikës së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në mesin e gjashtë vendeve të mbetura - të referuara si Ballkani Perëndimor 6 (WB6) - katër janë vende kandidate për të hyrë në BE (Mali i Zi, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut) dhe dy (Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova) janë kandidatë të mundshëm.

Në maj të vitit 2018, një Samit që mblodhi Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor dhe Liderët Evropian për të diskutuar mbi të ardhmen e bashkëpunimit, u zhvillua në Sofje, Bullgari dhe çoi në Deklaratën e Sofjes. Në këtë deklaratë, përfaqësuesit e Ballkanit Perëndimor ritheksuan vullnetin e tyre për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian ndërsa përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, riafirmuan politikën e tyre mbështetëse për pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor si anëtare të BE-së.

Pranimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor si shtete anëtare të Bashkimit Evropian kushtëzohet nga faktorë të ndryshëm. Konvergjenca e shteteve të Ballkanit Perëndimor për sa i përket zhvillimit socio-ekonomik dhe politik është në zemër të procesit të pranimit. Kjo konvergjencë kërkohet përmes një sërë masash që synojnë fusha të ndryshme si parandalimi i krimit të organizuar ose inkurajimi i stabilitetit. Në mënyrë të ngjashme, mundësimi i një mjedisi pro-biznesi përmes zhvillimit të grupimeve është një pjesë e enigmës drejt një zhvillimi më të barabartë socio-ekonomik.

Nje nga ceshtjet qe ka prekur rajonin se fundmi eshte emri i Maqedonise. Maqedonia e Veriut , ka një demokraci parlamentare , dhe tendenca e saj eshte drejt harmonizimit dhe përputhjes sa më të përafërt të legjislacionit të saj me atë të unionit europian. Qëllimi i saj është të tregojë një partneritet të qëndrueshëm me to , duke luftuar faktorët negativë që mund të hasen në një shtet.

Ceshtja e emrit të Maqedonisë ka transmetuar një progres të madh duke treguar përpjekjet e saj per t'u afruar familjes së madhe europiane. Në momentin e zgjidhjes së problematikave të brendshme të shtetit krijohen hapësira për t'u fokusuar dhe në bashkëpunimin mes shteteve fqinjë. Në një rrugëtim të tillë, vendet e tilla lëvizin me hapa shumë të shpeshta me dëshirën për arritjen e përsosshmërisë të të gjitha instrumentave të vendit, të cilat të funksionojnë në përputhje me trendet e përgjithshme ndërkombëtare. Fondi Evropian për Ballkanin u krijua një dekadë më parë për të promovuar integrimin në BE të vendeve te Ballkanit dhe shndërrimin e tyre në demokraci evropiane të prosperuara dhe të qëndrueshme.

Tani është e angazhuar të gjejë mënyrën më të mire per integrimin e rajonit deri në 2025, duke gjeneruar një transformim shoqëror dhe duke gjetur mbeshtetes te tjere per integrimin e rajonit. Një transformim i tillë kërkon një partneritet të ri midis vendeve te BE-së dhe ballkanit, të bazuar ne sinqeritet dhe transparence BE-ja duhet të jetë më e vëmendshme ndaj qeverive të ballkanit dhe e qartë në komunikimin e

problemeve publikisht, ndërsa qeveritë e rajonit duhet te angazhohen me sinqeritet ndaj procesit të zgjerimit.

Edhe vendi ynë Shqipëria përcaktohet si vend starategjik sipas pozitës gjeografike por dhe sipas sektorit ekonomik që është po një sector strategjik , i cili do të përballojë sfidat ë tregut europian dhe global dhe përben një pikë kryesore dhe të rëndësishmë, e cila tregon një të ardhme të suksesshme.

DIMENSIONI EKONOMIK

Dimensionit ekonomik i jepet përparësi duke e parë këtë nga këndvështrimi i integrimit. Këtu kemi dhe prevalimin ndaj dimensioneve të tjera. Sektori ekonomik merr përparësi, jo vetëm sepse i përgjigjet ritmit tonë zhvillues, por dhe që ta bëjë integrimin sa më të ndjeshëm për qytetarin, pra i afrohet më shumë ndërtimit të Evropës ne rajon. Kur e përcaktojmë ekonominë si sektor strategjik kemi parasysh dhe parimet e Rikardos në lidhje me avantazhin krahasues, ku thelbi i tij qëndron në faktin se cdo vend ka një produkt apo shërbim, apo sektor që i jep atij së paku një avantazh ndaj të tjerëve.

Duke u bazuar tek ky avantazh , ndaj fqinjëve ndërtohet gradualisht rrjeta e bashkëpunimit ekonomik. Përcaktimi i sektorit strategjik i përgjigjet dy pikave :

- Funksionimit të BE, ku arrihet bashkëpunim në pikat e forta dhe zhdukje te pikave të dobëta.
- Funksionimit global të tregjeve, ku kostoja e konkurrencës duhet zvogeluar nëse bashkimi sjell efektshmëri

SFIDA DHE SUGJERIME

Shtetet Anëtare të BE-së nga rajoni duhet të luajnë një rol konstruktiv dhe të lehtësojnë integrimin rajonal dhe evropian të Ballkanit. Më shumë bashkëpunim do të sjellë më shumë këmbëngulje dhe duhet të nxisë qëndrueshmërinë për të shmangur sfidat e brendshme dhe të jashtme me të cilat përballet rajoni dhe shpresojmë të çojë në ringjalljen e një identiteti rajonal të ngjashëm me ato të rajoneve të tjera evropiane. Në dekadat e kaluara janë investuar burime të konsiderueshme për të forcuar bashkëpunimin rajonal.

Përhapja e iniciativave dhe organizatave të ndryshme rajonale u bë qëllimi i BE, në vend që t'i lejojë vendet e ballkanit të marrin pronësinë e plotë dhe potencialin e bashkëpunimit rajonal, si një mjet për përparimin dhe zhvillimin.

Ekziston një nevojë urgjente për të ripërcaktuar bashkëpunimin rajonal dhe një ndjenjë të edukimit të identitetit rajonal. Vendet e rajonit duhet të shfrytëzojnë ekzistencën e një identiteti rajonal si një modus operandi në adresimin e sfidave të pranimit në fusha të ndryshme të politikave, nga sundimi i ligjit deri në konkurrencën dhe mjedisin.

Ky duhet të njihet si një instrument kryesor për të mësuar besimin dhe ndërtimin

e bashkepunimit midis vendeve të ballkanit dhe është identifikuar nga Komisioni Evropian si një shtytës kryesor për tejkalimin e çështjeve bilaterale.

Për të shfrytëzuar plotësisht potencialin për bashkëpunim rajonal për zhvillimin dhe afrimin politik, ekonomik dhe shoqëror, vendet e Ballkanit të duket te përqëndrohen në :

- Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë thelbësore për suksesin e çdo vendi në rajon. Pronësia duhet të ndërtohet dhe identiteti rajonal të ringrihet për të adresuar sfidat. Vendet më të përparuara në proces duhet të udhëheqin me shembull. Të gjitha mosmarrëveshjet bilaterale duhet të zgjidhen urgjentisht dhe me mirëbesim.
- Rezultatet pozitive të procesit të Berlinit duhet të përmirësohen dhe të ushqehen më tej. Tregjet e vogla dhe të fragmentuara kombëtare nuk janë të qëndrueshme dhe nuk përshtaten me sfidat e tregjeve evropiane dhe globale. Duhet të bëhen më shumë përpjekje për të krijuar një zonë rajonale ekonomike dhe për të hequr pengesat e mbetura për tregtinë, investimet dhe punësimin rajonal.
- Shfrytëzimi i qasjes rajonale drejt zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës së ballkanit. BE dhe institucionet financiare ndërkombëtare (IFI) janë thelbësore në ofrimin e ndihmës teknike dhe financiare. Kërkesa e fortë nga ana e vendeve të Ballkanit duhet të krijojë një efekt shumëzues, duke rezultuar në angazhimin e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë me burime financiare të freskëta, thelbësore dhe të pakushtëzuara. Investimi i përpjekjeve shtesë dhe burimeve financiare për të afruar të rinjtë dhe shoqëritë në rajon me njëra-tjetren dhe me mbështetjen e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO)
- Promovimi i krijimit të shoqërive të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse si e vetmja qasje largpamëse për të kapërcyer trashëgiminë e së kaluarës dhe për të arritur bashkepunimin rajonal.

PËRFUNDIME

Modeli i kushtëzimit që BE po projekton ka një dimension shumë specifik të integrimit rajonal, duke krijuar një zonë të ngjashme me ato të promovuara gjatë ciklit të pestë të zgjerimit. Prandaj, bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë komponentët thelbësorë të çdo suksesi në rajon.

Analiza tregoi se ndërtimi i një modeli të mirë të bashkëpunimit rajonal në Ballkan do t'i favorizonte të gjitha shtetet për të krijuar një lidhje si entitet me Bashkimin Europian , si dhe për të nxitur integrimin në BE të shteteve jo anëtare. Problematikat ndër-shtetërore si çështja e emrit të Maqedonisë, çështja e statusit së Kosovës apo çështja lidhur me kufirin detar Shqipëri-Greqi kanë ndikuar të gjitha në krijimin e konflikteve të cilat duhet të adresohen me prioritet që efektet të arrijnë në minimizohen sa më shumë.

Identifikimi se cka bejmë më mirë se të tjerët realizon maksimizimin, optimizimin

e të gjitha energjive , burimeve humane , natyrore, kohës së duhur për ta fuqizuar dhe për t'i dhënë sektorit strategjik misionin e përballimit të konkurrencës së tregut europian. Duke qene se BE administron ndihmën financiare ndaj rajonit , Komisioni Europian synon të financojë ato shërbime apo sektorë që janë vlerë e shtuar e BE dhe përbejne interes të përbashkët. Duke u nisur nga kjo interesi qëndron dhe në rrugët nacionale që lidhin ato rajone , që cojnë produktin apo shërbimin në tregun malazes apo grek , me kosto të ulët dhe më të shpejtë. Ky është një kryqëzim i rëndësishmë, Ky fenomen qëndron për të gjitha vendet e rajonit, që shërbejnë si ura kalimi.

Përvojat botërore janë një udhëzues i mëtejshëm, për të gjitha shtetet e rajonit, ku secili të kontribuojë , ku secili të zgjidhë problematikat nacionale dhe më pas të krijojë komunikimin me vendeve duke u krijuar kështu një entitet ashtu si dhe vetë BE. Në këtë mënyrë nuk do të ketë më konflikte mes shteteve dhe qëllimi për të futur në gjirin europian dhe shtete e tjera do të jetë sfida për vitet në vijim nga të gjitha shtetet anëtare , ku të hartohen politika të tilla që të shërbejnë në realizimin e sukseshëm të tij.

BIBLIOGRAFIA

- Bexheti A, Civici A , Dizdarevic S, Hackaj A, Hantke F, Hoffmann H, Janjić D, Jusufaj E, Malaj A, (2014) Bashkëpunimi Rajonal si Forcë Shtytëse për Rritje Ekonomike dhe Stabilitet. Rezultate dhe Rekomandime të Konferencës Rajonale, 4 Nëntor 2014. Aksesuar nga : https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/11323.pdf
- Vata I (2018)Soreca: Bashkëpunimi rajonal përshpejton integrimin në BE. Agjensia telegrafike Shqiptare. Aksesuar nga : http://ata.gov.al/2018/12/07/soreca-bashkepunimi-rajonal-pershpejton-integrimin-ne-be/
- The Balkans in Europe Policy Advisory Group . New European Balkans Partnership. Aksesuar nga http://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/03/New-European-Balkans-Partnership.pdf
- Madhi, G (2018) In the last few years, "connectivity" has been one of the keywords of the process of EU enlargement to the Western Balkans. An analysis.Aksesuar nga: https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Balkans/Connecting-Western-Balkans-to-the-European-Union-187712
- European cluster collaboration platform. EU Neighbourhood initiative in the Western Balkans. Aksesuar nga : https://www.clustercollaboration.eu/international-cooperation/western-balkans
- European Comission . (2019) Roadmap for EU – Enlargement Countries S&T cooperation. Aksesuar nga : https://ec.europa.eu/research/iscp/pdf/policy/enlarge_roadmap_2018.pdf
- European Comission (2018) A CREDIBLE ENLARGEMENT PERSPECTIVE FOR AND ENHANCED EU ENGAGEMENT WITH THE WESTERN BALKANS. Aksesuar nga https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/western_balkans_strategy_brochure.pdf

TEKNIKA TË SJELLJES DHE KOMUNIKIMIT

(Rasti i Presidentit Barack Obama)

Holta Heba
holtaheba@umsh.edu.al
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Gertjan Veshaj
gertjan.veshaj@umsh.edu.al
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

ABSTRACT

The study aims to analyze the importance of individual behavior not only in the communication process but also in the function of conflict resolution. It consists of examining the factors that influence an individual's behavior under certain time and circumstances. The research question posed is: ***How important is an individual's behavior in the communication process and how does it affect conflict prevention or resolution?*** Behavior is the language of actions, which clothes the individual with important elements and categorizes it into different social perceptions. The inner world of man and his emotional state are elements of behavior in communication. Behavior is a vital form of communication. The hypothesis of this research is: In an accomplished communication, the individual uses several communication techniques, which serve the purpose of approaching and trusting between him and the messenger.Human non-verbal language will be studied in the process of communication, the relationship between behavior and context and its influential elements in the process. Communication and behavior are an unbreakable chain of interaction. Human being chooses to communicate according to the social context in which he is located and the training he has adopted and continues to adopt throughout his life.

KEYWORDS: communication, behavior, context, leader, interaction, awareness.

HYRJE

Individet jane gjithmone ne veprim dhe rrjedhimisht gjate zhvillimit te veprimtarise se tyre, duke ushtruar te drejtat dhe lirite e tyre si dhe duke permbushur detyrimet e tyre ligjore, hyjne ne marredhenie me njeri-tjetrin e cila shoqerohet shpesh me mosmarreveshje. Ne perditshmerine e shoqerise njerezore, mosmarreveshjet jane gjithmone te pranishme, pasi vete shoqeria eshte burimi i lindjes, zhvillimit dhe zgjidhjes se konflikteve. Gjatë ndërveprimit me tjetrin ne japim sinjale dhe perceptime, të cilat na kategorizojnë në kategori të ndryshme individësh. Sjellja komunikohet në forma të ndryshme në kultura të ndryshme. Nje sjellje apo komunikim jo i pershtatshem mund te sjelle konflikte. Te gjithe konfliktet jane mosmarreveshje, por jo te gjithe mosmarreveshjet jane konflikte. Qasja ndaj konfliktit eshte ne vetvete ne proces dinamik. Sigurisht qe ka nje fillese dhe perpara se te perfundoje kalon neper disa faza. Ne burimin e cdo konflikti gjendet edhe zgjidhja e tij.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është: analiza shqyrtuese e rolit të sjelljes së individit përgjatë procesit të komunikimit si dhe e mënyrave që ai vetë zgjedh për të përçuar mesazhin tek mesazhmarrësi në kushte dhe rrethana të ndryshme. Rasti studimor është komunikimi politik i presidentit Obama. Sjellja e individit ndahet në dy kategori: sjellje të qëllimshme dhe sjellje të paqëllimshme. Pavarësisht kësaj ndarjeje, sjellja është tregues i qartë i gjendjes shpirtërore dhe fizike të njeriut, i cili teksa komunikon nuk prodhon dhe transmeton vetëm një mesazh, por gjithashtu ai është i ndjeshëm ndaj kushteve dhe rrethanave kur përcillet informacioni si dhe ndaj marrësit të tij. Me fjalë të tjera, sjellja është një zgjedhje e njeriut për të komunikuar atë që do me pjesën tjetër bashkëvepruese. Për shembull: Ti zgjedh të jesh i mirë me të, sepse ai e meriton mirësinë. Ti zgjedh të jesh i vrazhdë me të sepse ai e ka hak këtë vrazhdësi.

Në rastet kur fjalët kanë qenë të tepërta apo të mungura, kontakti sy më sy ka zgjidhur shumë dilema. Janë të shumta në numër gjendjet emocionale që njeriu komunikon vetëm nëpërmjet sjelljes. Mënyra e qëndrimit të dikujt është perceptimi që ai jep për pjesën tjetër që komunikon.

Me anë të sjelljes njeriu komunikon: inatin, dëshirën, zemërimin, dashurinë dhe urrejtjen.

Objekti i studimit në këtë punim është se si ndikon sjellja e individit në procesin e komunikimit në kultura dhe kontekste të ndryshme ne funksion te shmagies si dhe zgjidhjes se mosmarreveshjeve. Ndryshimi që ekziston midis formimit, kulturave dhe brezave është treguesi që gjykimet dhe paragjykimet do të ekzistojnë në çdo sjellje të komunikuar. Pervec sjelljes dhe komunikimit te nevojshem, aspektet me te spikatura te ndermjetesimit si metode alternative te shuarjes se mosmarreveshjeve, jane pergjithesisht me karakter vullnetar dhe jo detyrues dhe karakterizohen nga konfidencialiteti i diskutimeve. Megjithatë kodet e etikës dhe rregullat e sjelljes janë

rregullatorët e mbarëvajtjes së mbarë shoqërisë dhe situatave komunikative që ndodhin në të. Çdokush ka nevoja jetësore le të themi të njëjta, mënyra se si zhvillohen apo shpalosen ato nga gjithsecili nga ne, bëhet pjesë e analizës komunikative të shoqërisë. Mënyra se si e përjeton se si shfaq gjithsecili nga ne nje mosmarreveshje, konflikt, mbetet pjesë e zgjedhjes së njeriut për t'u shpërfaqur në mjedisin social ku jeton. E qëllimtë apo e paqëllimtë, sjellja mbetet një element parësor në komunikim.

RËNDËSIA E SJELLJES NË PERCEPTIMIN PUBLIK

Në procesin e komunikimit, sjellja verbale dhe joverbale kalojnë në procesin e zevendësimit ose të kundërshtimit me njëra-tjetrën. Në shumë raste, sjellja verbale ka nevojë të mbështetet tek sjellja joverbale, në mënyrë që të transmetohet sa më kuptueshëm për marrësin e mesazhit. Njejte operon edhe ndermjetesimi i cili shfaqet si formal dhe joformal. Ne te perditshmen tone fare pa dashur apo pa e marre mbi vete te berit te negocimit, joformalisht gjendemi duke ndermjetesuar nje mosmarreveshje mes kolegesh, te afermish apo te panjohurish. Gjejme ngjashmeri mes sjelljes verbale dhe ndermjetesimit formal, ama nuk mund te thuhet e njejta gje per procesin joformal. Joformalisht mund te zgjidhim nje sere mosmarreveshjesh, ama sjellja joformale bie ndesh me konfidencialitetin. Duke qene se konfidencialiteti eshte nje aspect shume i rendesishem ne nje ndermjetesim, ku niveli i besimit nga secila pale ndaj nesh eshte shume i larte, sjellja apo komunikimi yne verbal apo joverbal duhet detyrimisht te reflektoje paanesi, mosparagjykim. Sjellja verbale dhe sjellja joverbale janë pjesë e zgjedhjes individuale për t'u përshtatur gjatë procesit të ndërveprimit me të tjerët.Komunikimi yne ne cdo faze te procesit duhet domosdoshmerisht te perputhet me ate cka shprehim. Gjuha transmeton informacione specifike dhe të jep mundësinë për t'a rikorigjuar një fjalë që shket pa dashje në një moment të caktuar, kurse sjellja joverbale është vështirë të korrigjohet pasi duke qenë në vetvete një mesazh relacional, tregon shumë për atë cka ndihet realisht për dikë ose dicka.

Eshtë shumë e rëndësishme të jetojmë në rregulla kulturore që shërbejnë për instruktimin e personave në situata të ndryshme gjatë ndërtimit të marredhenieve njerëzore. Cdo individ është i ndërtuar nga një gamë e gjerë sjelljesh me anë të të cilave realizon qëllimet apo objektivat e veta në raport me mjedisin social.

Jetojmë në botën e informacionit dhe komunikimit interaktiv. Gjatë ballafaqimit në komunikim ndermjetesi asiston per te ndare me njeri tjetrin perspektivat, te evidentoje ceshtjet e kontestuara, te zhvilloje mundesite, te konsideroje zgjidhje te mundshme dhe te kerkoje arritjen e nje marreveshjeje reciprokisht te pranueshme per mosmarreshjet e tyre. Thelbi i ketij procesi eshte pikerisht rritja e komunikimit dhe mirekuptimit ndermjet paleve ne favor te zgjidhjes se mosmarreveshjes dhe per te diskutuar marredheniet e ardhshme. Duke qenë se vetë sjellja individuale mbetet e modelueshme, atëherë kodet e sjelljes për një kulturë nuk mund të ndërtohen nëse nuk merret për bazë konteksti social në të cilën ndodh marrëdhënia. Sjellja mbetet në varësi të kodifikimeve të synimeve që ofrojmë dhe synimeve që kërkojmë të arrijmë. Për aq kohë sa ekziston termi ndryshim për kultura, ekonomi, teknologji, mundësi

etj, do të ekzistojnë edhe gjërat që nuk mund të priten me thikë. Komunikimi nuk mund të jetë aksiomë dhe si i tillë individë të ndryshëm komunikojnë në forma të ndryshme. Mundësia për të interpretuar një fenomen të caktuar në forma të ndryshme nga njerëz të ndryshëm, e shpie botën drejt zhvillimit dhe jo anasjelltas. Individi i botës së sotme të informacionit të bollshëm e përjeton dhe e komunikon një episode apo një fenomen në forma të ndryshme në varësi të kodeve të sjelljes dhe kodeve kulturore të mishëruara në të përgjatë gjithë jetës. Vetë njeriu ndryshon teksa rritet dhe zhvillohet.Po ashtu edhe sjellja dhe kultura e tij mbetet në rritje dhe zhvillim përgjatë gjithë ciklit jetësor.E sotmja ime nuk mund të jetë e njëjtë me të djeshmen, apo me të nesermen që synoj të ndërtoj.

Gjatë shkëmbimeve të mesazheve njerëzore, individët bien në një marrëveshje le të themi të heshtur dhe tashmë të mësuar dhe në përmirësim të vazhdueshëm me njëri/tjetrin dhe me anë të disa kodeve veprojnë dhe sillen në shumë mënyra për të realizuar atë që quhet detyrim në komunikim~ marrje dhe dhënie të sjelljeve alternative me qëllimin e vetëm komunikimin e realizuar. Sjelljet njerëzore janë alternative dhe mbeten në varësi të synimit që ka cdokush në procesin e komunikimit. Ne kete kuader njerezit duhet te jene te prirur rreth menaxhimit te struktures se sjelljes se tyre verbale per te evituar sadopak mosmarreveshjet qe lindin ne ambjentin ku jetojne, punojne dhe bashkeveprojne.

BASHKËVEPRIMI SJELLJE-KONTEKST

Si lloj komunikimi edhe sjellja ka kodet dhe rregullat e veta. Keto të fundit ndryshojnë në varësi të individëve që i përdorin si dhe kulturave të ndryshme në një vend dhe në një kohë të caktuar. Një "po" e thënë me buzëqeshje nuk është e njëjta gjë me një "po" e pashoqëruar me kode jogjuhësore. Kur takojmë një shok të vjetër të gjimnazit në rrugë dhe i themi "gëzohem që u takuam" nëse e shoqërojmë me kode joverbale si për shembull: shtrëngim më i fortë i dorës, shikim i drejtpërdrejtë në sy dhe buzëqeshje, patjetër që transmetojmë mesazhin se jemi vërtet të kënaqur për këtë takim. Por nëpërmjet kodeve joverbale mund të transmetojmë edhe thjesht bezdi që u ndeshëm në rrugë. Edhe pse kodet joverbale nuk janë gjithnjë të thjeshta për t'u interpretuar, ndodh që ndonjëherë tregojnë shumë më tepër se sa vetë fjalët.

"Sjellja joverbale përçon mesazhe për forcimin e marrëdhënieve dhe statusit shoqëror, ashtu sikurse mund të transmetojë edhe zhgënjime. Ndonëse gjuha është mjaft e rëndësishme në përçimin e një informacioni specifik, komunikimi joverbal reflekton shpesh mesazhe ralcionale rreth asaj çfarë ndjejmë me të vërtetë në lidhje me dikë" (Martin, J & Nakayama, Th, 2008, 186).

Identitete të ndryshëm kanë kode jogjuhësorë të ndryshëm për të komunikuar një fenomen apo një situatë. Megjithatë shumë simbole të komunikimit joverbal janë të njëjtë në shumë vende të botës. Në raste të caktuara të zgjidhin punë. Për shembull: dy njerëz të kulturave të ndryshëm që nuk njohin kodet gjuhësore, mund të arrijnë një komunikim nëpërmjet shenjave të trupit. Sigurisht që nuk pritet ndonjë komunikim i mirë realizuar apo i gjatë i dy personave me gjuhë të ndryshme, por ama disa shenja joverbale behen urë lidhëze e një pohimi apo një mohimi nga

të dy. Mjafton të kujtojmë këtu shenjën e gishtit të madh të dorës, një gjest tashmë universal që përdoret për të treguar pohim apo aprovim, e cila në kode gjuhësore interpretohet: "ok" ose "në rregull". Në momentin që zgjerimi i kuptimit, përplot absolutisht domethënien, komunikimi bëhet i kuptueshëm dhe nuk behet burim mosmarreveshjesh.

Si çdo fushë tjetër edhe komunikimi joverbal zhvillohet dhe ndryshon në kultura të ndryshme sipas kontekstit social dhe periudhes kohore në të cilën ndodh. Le të kujtojmë përshëndetjen që i bënte një mashkull femrës në shekullin e 17-të apo 18-të në Francë apo Angli edhe pse ishin të të njëjtit rang apo të së njëjtës shoqëri. Ai përshendeste një femër në rrugë, duke u përkulur dhe përkuljen e shoqëronte me dorë. Në shekullin e 21-të kjo lloj përshëndetje është venitur. Mashkulli, e përshëndet femrën me pakëz përkulje, por këtë herë vetëm të kokës dhe ky veprim nuk është se ndodh gjithnjë. Nuk janë të pakta rastet kur përshëndetjet përveç shtrëngimit të dorës dhe pakëz përkulje të kokës zëvendësohen madje edhe me përplasje të duarve lart: "Toke!".

Përvoja njerëzore na ka treguar se komunikimi është i lidhur ngushtësisht me kulturën. " *Pra, nëse të dyja konceptet e kulturës dhe të komunikimit u referohen në një pjesë të madhe të njëjtave dukuri, një qasje e privilegjuar e kulturës ka të bëjë me kërkimin e mjeteve të mundshme të komunikimit në një kulturë të dhënë dhe atyre që përdoren realisht, me qëllim që kultura të mund të studiohet duke u nisur nga komunikimi*" (Ollivier, B 2015, 211).Në Shqipëri, kodi joverbal i përshendetjes midis një mashkulli dhe një femre, po në të njëjtën periudhë kohore as që mund të mendohej të ishte i njëjtë me atë të Francës dhe Anglisë. Mashkulli nuk mund t'i fliste vajzës në rrugë nëse nuk ishte e shoqëruar me një familjar, por edhe nëse ishte e shoqëruar ajo nuk mund të përshëndeste. Qëndrimi i saj ishte në cdo rast kokulur dhe sypërmbys. Ky lloj qëndrimi ishte në harmoni me rregullat dhe kodet joverbale të vendosura nga vetë shoqëria e asajkohe. Në shekullin e 21-të nuk ndodh më kështu. Kodet joverbale kanë ndryshuar. Mashkulli dhe femra mund të përshendeten dhe komunikojnë si me kode gjuhësore ashtu edhe me kodet jogjuhësore. Një femër nuk qëndron më sypërmbys teksa komunikon, nëse po, atëherë ajo e bën me vetëdije dhe jo e imponuar nga shoqëria. Ndoshta vërtet kërkon të komunikojë se nuk do të përshëndetet me mashkullin në fjalë. Në shumë kultura kontakti i syve është një rregullator i distancës ndërpersonale. Në shembullin e Shqipërisë, shmangia e kontaktit pamor transmetonte respekt dhe nderim. Ky lloj interpretimi ka ndryshuar në kontekstin e sotëm.

Sjellja na tregon se në situata të ndryshme mesazhi që duam të transmetojmë tek të tjerët varet nga mënyra se si duam të shfaqemi tek të tjerët. Nuk është e njëjta gjë si të këndosh në dush i vetëm dhe si të këndosh përpara një audience prej 10 apo më shumë personash. Sjelljet jo verbale tonat mbeten në varësi të asaj që duam të tregojmë tek mesazhmarrësi. Sa e sa herë na ka qëlluar që teksa ecim përgjatë vitrinave të dyqaneve të gjejmë veten me vetulla të ngrysura dhe kemi reaguar. Duke mos qenë ky imazhi që duam të komunikojmë tek të tjerët teksa ecim në rrugë, menjëherë ndryshojmë qëndrimin e vetullave duke i dhënë fytyrës një ngjyresë buzagaz.

"Kërcënimet ndaj imazhit tonë mund të jenë si shuplakat ose grushtet fytyrës. Nëse një gjë e tillë ndodh, a përpiqemi ne ta përmirësojmë situatën duke justifikuar veprimet tona, apo duke fajësuar rrethanat" (E, Griffin &Coo, 2015, 407). Secili nga ne përpiqet të ruajë imazhin e tij, ku ky i fundit është gjithnjë në rrezikshmëri për të qenë "kopjac"i një modeli të mirë, apo të keq, ku në fund të fundit e mira dhe e keqja marrin vlera vetëm në varësi të individualizmit ose kolektivizmit ku individi zgjedh të performojë. Megjithatë të gjithë jemi të prirur për të ruajtur një imazh të mirë publik, ndaj secili nga ne mendohet dy herë para se të hedhë një hap në publik dhe vetëm njëherë ose fare për të hedhur 1 hap në komunikimin me vetveten.

Sjellja, apo komunikimi joverbal mund të plotësojë, zëvendësojë ose kundërshtojë komunikimin verbal. Ajo mësohet dhe ashtu si komunikimi verbal është pjesë e identitetit tonë, pjesë e kulturës së fituar në vendin ku jetojmë dhe rritemi. Në komunikimin ndërkulturor keqperceptimet e komunikimit joverbal korrigjohen nga fjalët. Njeriu përpiqet të gjejë fjalët e duhura për të interpretuar një veprim të caktuar. Një sjellje e vetme joverbale mund të përkthehet nga shumë fjalë deri sa të arrihet kuptimi i duhur, por edhe shumë fjalë të pakuptueshme për dikë mund të interpretohen nëpërmjet sjelljeve joverbale, të cilat mund të zgjidhin shumë situata. Çka shprehet me veprime ndonjëherë është më e rëndësishme se ajo që shprehet me fjalë. Sjellja e planifikuar sigurisht qe eshte nje zgjatim i veprimit te arsyeshm gjithmone brenda normave dhe rregullave te perceptuara sociale.

TEKNIKA TË KOMUNIKIMIT POLITIK TË PRESIDENTIT BARACK OBAMA

SJELLJA DOMINUESE NË KOMUNIKIMIN POLITIK

Modeli dominant i Presidentit Obama luan një rol të rëndësishëm në funksion të personalitetit të tij për rritjen e besueshmërisë dhe efektivitetin e konkurrencës. Modeli mbizotërues I Obamës gjendet në vazhdimësi duke filluar nga komunikimet normale tek ato politike dhe administrative. Backaraundi i tij professional dhe dëshira e tij e fortë për të përçuar mesazhe të drejta politike e bëjnë më të besueshëm përballë elektoratit të tij.

SJELLJA AKOMODUESE NË KOMUNIKIMIN POLITIK

Sjellja dominuese që përmendet më sipër plotësohet edhe nga sjellja akomoduese e Obamës, e cila vihet në shërbim të zbutjes së tipareve të një karakteri tepër të fortë, duke e bërë kështu një lider më të hapur dhe bashkëpunues. Fryma e tij bashkëpunuese dhe tolerante e bën më të lehtë komunikimin me stafin e tij dhe me të pranueshëm për mesazhmarrësit politikë. Njerëzit me karakter akomodues në komunikim janë të prirur të kërkojnë pak nga të tjerët, janë relativisht jo kritikë dhe mbi të gjitha janë edhe të këndshëm edhe për kritikët e tyre. Bazuar në mënyrat e tij të sjelljes, mund të thuhet me bindje se Obama është rasti tipik i modelit akomodues.

SJELLJA E NDËRGJEGJSHME

Në profilin e Obamës është lehtësisht e dallueshme sjellja e tij e ndërgjegjshme përgjatë jetës së tij politike. Ky element është I dukshëm në mënyrat e tij të mirësjelljes, respektimit dhe sinqeriteti që tregon gjatë takimeve dhe mbajtjeve të fjalimeve me publikun. Sipas studiuesit Millon, kjo kategori njerëzish ka një mënyrë të mirë jetese të mirë-disiplinuar dhe të organizuar që u mundëson individëve të funksionojnë me efikasitet dhe me sukses në të gjitha format e përpjekjeve të tyre, duke kundërshtuar kështu fuqishëm respektin e imponuar, të tensionuar dhe të ngurtë të një drejtimi shteti të çrregulluar. (Millon, 1996, f. 518–519). Njerëzit që e kanë këtë lloj sjelljeje demostrojnë një shkallë të pazakontë integriteti, duke iu përmbajtur normave të shoqërisë, moralit dhe etikës.

Bazuar në 3 elemtët empirik të mësipërm, duket qartë ndikimi i tyre në modelin e lidershipit të Obamës. Përqafimi i tij me këta tri elementë garanton një personalitet bashkëpunues, të sigurt dhe të hapur per t'u përballur me sfida dhe me inovacione. Liderat e këtij lloji janë më të parapëlqyerit nga masa dhe perceptohen nga ajo si të duhurit dhe dashamirës. Ata janë në favor të ndërmjetësimit dhe kompromisit. E përdorin forcën ose shtrëngimin si strategjia e fundit kur është e nevojshme të arrihet një rezultat i caktuar.

Në përfundim, komunikimi politik i presidentit Obama ravizon një profil personaliteti si më poshtë:

- Ambicioz, i vëmendshëm dhe i sigurt
- I prirur për ndërmjetësim dhe kompromis
- Strateg për zgjidhjen dhe shmangien e konfliktit
- Lobues I mirë dhe me tipare të forta lidershipi.
- Mbështetës I stafit të tij.

Gjithnjë në përpjekje për të shmangur të gjitha debatet përçarëse.

Kombinimi i besimit, mbizotërimit dhe gjenialitetit të Obamës përshtatet me profiling e një lideri karizmatik. Nga ana psikologjike, vetëbesimi, njohja dhe aftësia e tij komunikuese janë cilësi e jashtëzakonshme për të frymëzuar ndjekësit.

PËRFUNDIME

Me anë të sjelljes, njeriu e zgjedh mënyrën se si do ta komunikojë së pari veten e tij dhe së dyti, mënyrën se si është formuar. I kundërt apo i ngjashëm me tjetrin, në mënyrë direkte apo indirekte çdo njeri zgjedh të komunikojë mënyrën e të jetuarit dhe të menduarit. I gjendur gjithnjë në situata dhe kohë të ndryshme, përballë njerëzve të dashur ose jo të dashur, mes njerëzve të ngjashëm apo të ndryshëm, në bisedime apo në ligjërime, njeriu zgjedh të komunikojë atë që i përshtatet me botëkuptimin individual. Ai zgjedh të sillet mirë apo keq me të afërmin ose të panjohurin në varësi të qëllimit që ka për të hyrë ose jo në bashkëveprim me të. Zgjedh të ngrejë zërin kur shikon padrejtësi, ashtu sikurse mund të zgjedhë të komunikojë duke heshtur. Njeriu vendos të komunikojë duke folur vetëm me fjalë, ose vetëm me gjeste, por

edhe me të dyja elementet njëherësh.Çdo sjellje e komunikuar nga njeriu nuk bën gjë tjetër vetëm se jep kontributin e saj në realizimin e ndërveprimit me tjetrin. Sikurse përmendet edhe në këtë studim, çdokush ka të drejtë të jetojë sipas mënyrës së tij, por në këtë botë multikulturore plot ngjyra, e rëndësishme është që pavarësisht zgjedhjes për të komunikuar diku fort dhe diku shumë ngadalë, diku mirë e diku keq, ne të gjithë duhet të zgjedhim të komunikojmë dhe bashkëjetojmë në harmoni sociale, brenda normave dhe standartave njerëzore.

Komunikimi është zgjedhja e njeriut për të ekzistuar në univers sipas formës që ai i jep vetes në kontekstin social ku gjendet.Ai komunikon dashamirësi, urrejtje, nervozizëm, besim, dashuri, etj.në varësi të mjedisit social dhe kontekstit që jeton në momentin që ndodh shkëmbimi i informacionit.

Si përfundim, sjellja dhe mesazhi bashkëjetojnë në procesin e komunikimit dhe nuk mund të analizohen të ndara. Çdo sjellje e ka një mesazh si dhe anasjelltas çdo mesazh e ka një sjellje. Te dyja ecin bashke dhe jane celesi i nje bashkejetese te shendoshe ne shoqeri si dhe gjithashtu kur jane me nota pozitive behen leva e zgjidhjes se mosmarreveshjeve te cdo forme apo niveli. Qartazi qendrimi eshte nje nga proceset subjektive te brendshme, kurse menyra e sjelljes eshte cka ne zgjedhim per ti shprehim keto qendrime jashte. Per te evituar apo zgjidhur mosmarreveshjet individi perdor sjelljen dhe komunikimin si veprim apo mosveprim ndaj qendrimeve tona dhe pales apo paleve. Pavaresisht nga rrethanat, kushtet, mjedisi social, lindja e nje mosmarreveshjeje kerkon te pakten 2 persona dhe si rezultat tentativa per ta shmangur nje te tille varet nga perdorimi i menyres sone te te sjellurit ai qe e pengon palen tjeter ne arritjen e "qellimeve te veta". Perpjekjet per te shmangur apo zgjidhur mosmarreveshjet sigurisht qe kerkojne qe te kuptohet shkaku i saj si dhe menaxhimi dhe planifikimi i sjelljes dhe komunikimit nga te pakten njera pale apo pala e trete qe veteofrohet / caktohet per ta ndermjetesuar ate.

BIBLIOGRAFIA

- Dhima, A (2016) Hyrje në antropologji, Tiranë: Botime: Ideart
- Griffin, E. & Ledbetter, A.; Sparks, G; Budini, B.; (2015) et.al: *Vështrim i parë mbi teorinë e komunikimit*. Botimi i 9-të Neë York: McGraë-Hill.
- Martin, J; Nakayama Th. (2010) *Hyrje në komunikimin ndërkulturor.*Tiranë: Botimet UET–Press.
- Maigret, E. (2010). *Sociologjia e Komunikimit dhe e mediave.*Tiranë: Botimet Papirus & UET–Press.
- Meunier, J. & Peraya, (2009) Hyrje në teoritë e komunikimit. Tiranë, QSSHE
- Ollivier, B (2015) *Shkencat e komunikimit*. Tiranë, Papirus
- Millon, T. (With Davis, R. D.). (1996). Disorders of personality: DSM–IV and beyond (2nd ed.). New York: Wiley.

EDUCATIONAL GOVERNANCE POLICY USA AND ALBANIA

Vebina Resuli
Mediterranean University of Albania
vebina.resuli@umsh.edu.al

Ferjolt Ozuni
Mediterranean University of Albania
ferjolt.ozuni@umsh.edu.al

Erdet Lalaj
Mediterranean University of Albania
erdet.lalaj@umsh.edu.al

ABSTRACT

The rationale behind educational governance policy is that it shows the impact of a good governance system on running higher education institutions. The approach is also important in relation to best practices that are applied with respect to standardization (Enders, 2004). The approach is also important in relation to the improvements that need to be applied to ensure that such institutions run well. As a result, institutions can identify the gaps that can be noted in the related activities. It also details various approaches that other institutions have adopted to ensure outstanding governance activities. The use of educational governance policy ensures that leadership needs that exist in the running higher education institutions are well addressed (Enders, 2004). The approach is important as it ensures that leaders of such institutions are at the forefront in adopting the best practices that boost the level of education quality. The theory is also imperative as it identifies gaps in training of the heads of higher learning institutions, which enhances the effectiveness of such individuals. They have to establish and solve the various problems that students encounter (Enders, 2004). Consequently, educators are likely to develop the appropriate curricula that enhance the outcomes of the students as the former are likely to focus more on the skill identification among learners. Indeed, the approach prompts educators to ***pay close attention to the weak learners to ensure that they attain the best outcomes.***

KEYWORDS: Education, USA policy, system, standards

Siguria kombëtare është një vlerë absolute, ku nënshtrohen të gjitha resurset e tjera. Ajo trajton çështjet e mbrojtes së vendit si nga rreziku i brëndshëm ashtu edhe nga forcat e tjera të jashtme apo përcarëse. Siguria Kombëtare, gjithashtu përfshin cështje të edukimit, shëndetësisë, kulturës, mjedisit, vlerat e sigurimit të nevojave njerëzore për banesë dhe ushqim, ruatjen e vlerave historike morale, fetare etj, konceptin për sigurinë kombëtare e kemi të përceptueshëm kur atë e kupton dhe vlerëson edhe opinioni publik. Në fillim le të hedhim dritë mbi sigurinë kombëtare, konceptin dhe përbërësit e saj dhe pastaj kontributin e medias në ngritjen e opinionit publik për përceptimin dhe vlerësimin e çështjeve të sigurisë. Siguria kombëtare ka të bëjë edhe me sistemin e edukimit të qytetarëve dhe sistemit të komunikimit midis tyre7.

Liria e shprehjes është një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejtë nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore.

Të drejtat e njeriut janë parimet bazë, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qënie njerëzore e dinjitet, zhvillimi i të drejtave të njeriut i ka rrënjët e veta në luftën për liri dhe barazi kudo në botë. Ato janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Dokumente si "Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut", gjithashtu, përcaktojnë se cfarë duhet të bëjnë e cfarë nuk duhet të bëjnë qeveritë për të rrespektuar të drejtat

[7] *Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, Korrik 2014, fq 18*

e qytetarëve të tyre.

Sipas nenit 10 të KEDNJ, liria e shprehjes përshin në vetvete edhe të drejtën e informimit, si një e drejtë themelore për të marrë dhe për të dhënë informacion, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. Nje deklarim i përafërt në këtë bëhet edhe në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën 217 A (III) datë 10.12.2948. Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me cfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë. Neni 23 i kushtetutës së RSH. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive8.

Media ndikon që individët e angazhuar në të tre pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbajtjen e detyrave dhe funksioneve të tyre si dhe në jetën e angazhimet e tjera shtetërore e private. Media është gjithashtu një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet, ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik si dhe nxit indetifikimin e rasteve korruptive. Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozita të vecanta ne nenet 19 dhe 23 të saj.9

Kur themi që cdo njeri gëzon të drejtat njerëzore, nënkuptojmë që, cdo njeri është përgjegjës, për rrespektimin e të drejtave njerëzore të të tjerëve. Ligji shqiptar për të drejtën e informimit nr.8503, i miratuar në qershor të 1999 si pjesë e paketës së ligjeve implementuese të Kushtetutës së re, ishte një nga ligjet e para të informimit në Evropën Juglindore. E megjithatë, funksionimi i regjimit të informimit publik në vënd vazhdon të lërë për të dëshiruar. Shqipëria mbetet pas standarteve europiane. Duket se ekziston tashme një konsensus mes organizatave të shoqërisë civile, përdoruesve të ligjit e madje, në një farë mase, edhe brënda ekzekutivit se ka ardhur koha për të bërë një rigjenerim të Ligjit për të drejtën e informimit. Ligji aktual parashikon një

[8] *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, faqe 12.*

[9] *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, faqe 11 dhe 12.*

sistem afatesh me dy faza për dhënien e informacionit: autoritetet duhet të marrin vendim "për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brënda 15 ditëve nga depozitimi i saj"10 . Në rast se kërkesa pranohet, autoriteti ka në dispozicion 40 ditë për plotësimin e saj11. Për shkak të "vecantisë së kërkesës ose të nevojës për tu këshilluar me një palë të tretë" autoriteti mund ta zjasë afatin edhe 10 ditë të tjera12. Këto afate janë nga më të lartat në praktikën europiane dhe atë ndërkombëtare, ku afati mesatar për dhënien e informacionit është më pak se 15 ditë kalendarike.

Një nga problemet më të mëdha në zbatimin e ligjit aktual është mungesa e një regjimi të shpejtë dhe eficent ankimimi. Praktika e deritanishme ka treguar se, për shkak të mundësive të vjetra dhe dobësive organizative, një pjesë e konsiderueshme e kërkesave për informim nuk gjejnë zgjidhje edhe pas ankimeve të brëndshme administrative. Duke pasur si alternativë të vetme ankimin gjyqësor, shumë kërkues thjesht dorëzohen dhe heqin dorë nga mbrojtja e së drejtës për informim. Nga ana tjetër, për ata pak kërkues që janë mundësi ti drejtohen gjykatës, proceset zgjasin me muaj e me vite, shpesh për shkak të zvarritjeve të qëllimshme të administratës.

'SIGURIA KOMBËTARE' DHE 'E DREJTA E INFORMIMIT' NË NIVEL GLOBAL

Shpesh ndodhin situata në të cilat siguria kombëtare dhe liria e shprehjes përplasen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për shembull, mbrojtja e një interesi të vërtetë të sigurisë kombëtare mund të kërkojë ndalimin e informacionit sensitiv mbi mbrojtjen ose lirisë së shprehjes që mund të nxisin dhunë kundër shtetit. Ky konflikt thellohet nga fakti se konceptet e sigurisë kombëtare dhe ato të lidhura me të (si "siguria e shtetit," "siguria e brendshme," "siguria publike," dhe "siguria e qytetarëve") nuk janë të përcaktuara apo të definuara në ligje, sa që shpesh përdoren nga qeveritë për të ndaluar llojet e informacionit të cilat ofrojnë mbrojtje kundër abuzimeve të qeverisë. Këto përfshijnë informacionin ose shprehjet që zbulojnë shmangien nga proceset demokratike, sulmet ndaj partive opozitare, dëmtimin e mjedisit, korrupsionin, shpërdorimin e aseteve publike dhe forma të tjera të keqbërjeve nga zyrtarët qeveritarë dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Për më tepër, gjykatat në vendet e ndryshme të botës shpesh tregojnë më pak pavarësi dhe më shumë respekt ndaj pretendimeve të qeverisë kur

[10] *Ligji për të drejten e informimit neni 10*
[11] *Ligji për të drejten e informimit neni 11*
[12] *Ligji për të drejten e informimit neni 12*

përmendet siguria kombëtare. Ky respekt forcohet nga dispozitat në ligjet e sigurisë të shumë vendeve, të cilat aktivizojnë përjashtime nga rregullat e zakonshme të provave dhe procesit të duhur ligjor nëse qeveria tregon ndonjë rrezik të sigurisë kombëtare. Pretendimi i qeverisë për një kërcënim të sigurisë mund të përballë një goditje të fortë ndaj mbrojtjeve institucionale kundër abuzimeve të qeverisë: pavarësia e gjykatave, procesi i duhur ligjor, liria e shtypit dhe qeverisja e hapur[13].

Tensioni mes shprehjes dhe sigurisë kombëtare është veçanërisht shqetësues sepse ka shumë pak hapësirë për gabim. Veprimet e shpejta shpesh janë të nevojshme për të penguar një kërcënim të vërtetë ndaj sigurisë kombëtare, por kufizimet e shprehjes politike mund të çojnë në një rrëshqitje të pandalshme drejt tiranisë. Sa më e brishtë të jetë demokracia, aq më pak mund të tolerojë një kërcënim ndaj sigurisë së saj të vërtetë ose ndalimin e debatit politik të ligjshëm.

Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit janë thelbësore për mbrojtjen e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut dhe për një shoqëri demokratike që funksionon sipas ligjit. Siç e shpalli Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në sesionin e saj të parë: "Liria e informimit është një të drejtë themelore e njeriut dhe ... është pika e referencës për të gjitha liritë që OKB-ja i garanton"[14]. Gjykata Amerikane për të Drejtat e Njeriut theksoi se liria e shprehjes është një gur i themelit mbi të cilin mbështetet ekzistenca e një shoqërie demokratike. Ajo është e domosdoshme për formimin e opinionit publik dhe për të informuar mjaftueshëm komunitetin. Prandaj, një shoqëri që nuk është e informuar mirë nuk është një shoqëri e vërtetë e lirë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar rëndësinë e lirisë së shprehjes për plotësimin e vetvetes dhe për përparimin e një shoqërie demokratike[15]. Liria e shprehjes është një nga themelet e rëndësishme të një shoqërie demokratike dhe është një nga kushtet themelore për përparimin e saj dhe për plotësimin e çdo individi. Ajo aplikohet jo vetëm për "informacionet" konsiderohen si të padëmshme, por edhe për ato që ofendojnë ose shqetësojnë 'Shtetin' ose ndonjë sektor të popullsisë. Këto janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendësisë së gjerë pa të cilat nuk ka një 'shoqëri demokratike'.

[13] Coliver, Sandra. (1998). Commentary to: The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information. Human Rights Quarterly fq.12-80. The Johns Hopkins University Pres

[14] Universal Declaration of Human Rights, adopted 10 Dec. 1948

[15] European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, opened for signature 4 Nov. 1950

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut ("Deklarata Universale") përmban një mbrojtje të fortë të të drejtës për liri shprehjeje dhe informacioni. Kjo mbrojtje u kodifikua dhe u zhvillua në Nenin 19 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ("Pakti Ndërkombëtar")." Paragrafi 1 thekson të drejtën absolute për të mbajtur mendime "pa ndërhyrje." Paragrafi 2 përcakton përmbajtjen pozitive të të drejtës për liri shprehjeje: "Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo të drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion dhe ide nga çdo lloj, pa marrë parasysh kufijtë, qoftë gojarisht, me shkrim ose në print, në formë arti, ose përmes çdo mediumi tjetër të zgjedhur."[16]

Të drejtat për liri shprehjeje dhe informacioni mund të ndeshen me kufizime të caktuara dhe të ngushta, përfshirë ato të nevojshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare. Këto të drejta dhe kufizime të lejuara janë përcaktuar në terma të ngjashëm në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa Evropiane") dhe në Konventën Amerikane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa Amerikane"). Të drejtat janë formuluar më restriktivisht në Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve.

Nga 1 Janar 1997, 136 vende kishin ratifikuar ose ishin bashkuar me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; 110 vende kishin pranuar detyrimet e njërit prej tre traktateve rajonale për të drejtat e njeriut, përfshirë dymbëdhjetë që nuk janë palë në Paktin Ndërkombëtar. Kështu, në total, 148 vende janë palë në Paktin Ndërkombëtar dhe/ose në një prej traktateve rajonale. Për më tepër, të gjitha vendet janë të lidhura nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e cila "përbën një detyrim për anëtarët e komunitetit ndërkombëtar" dhe "aplikon për çdo anëtar të familjes njerëzore, kudo, pa marrë parasysh nëse Qeveria e tij e pranon principet e saj ose ratifikon Paktet." Dispozitat që mbrojnë lirinë e shprehjes në kushtetutat dhe ligjet e shumë vendeve reflektojnë ndikimin e Deklaratës Universale, dhe gjykatat në mbarë botën kanë mbështetur rëndësinë e lirisë së shprehjes në një gjuhë që rezonon me ndjenjat e shprehura nga organet ndërkombëtare.

Një pasojë logjike e marrëdhënies themelore midis shoqërisë demokratike, të drejtave të njeriut dhe lirisë së shprehjes është se kufizimet e lirisë së shprehjes dobësojnë themelet e një shoqërie demokratike. Siç është vënë në dukje nga Gjykata Evropiane, kufizimet e vendosura mbi lirinë e shprehjes dhe të drejta të tjera në emër të sigurisë kombëtare paraqesin një rrezik të

[16] *Universal Declaration of Human Rights, adopted 10 Dec. 1948*

vërtetë "për minimin apo edhe shkatërrimin e demokracisë në emër të mbrojtjes së saj'.

Edhe pse e drejta për liri shprehjeje është thelbësore, ajo nuk është absolute. Të gjitha traktatet kryesore për të drejtat e njeriut pranojnë që kjo e drejtë mund të jetë subjekt i kufizimeve, përfshirë ato për mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Megjithatë, asnjë nga organet ndërkombëtare që kanë për detyrë interpretimin dhe zbatimin e këtyre traktateve nuk ka ofruar një përkufizim të qartë për sigurinë kombëtare, dhe pak kanë ofruar udhëzime të dobishme për kufizimin e saj.

KOMPONENTËT E NJË INTERESI LEGJITIM TË SIGURISË KOMBËTARE

Kontributi më i rëndësishëm për këtë çështje është bërë në vitin 1985 nga një grup ekspertësh të mbledhur nga Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve dhe partnerët e tij, që hartuan Parimet e Siracusës për Kufizimet dhe Shkëputjet në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto Parime janë mbështetur gjerësisht nga studiuesit e së drejtës ndërkombëtare dhe ekspertët e OKB-së. Parimet 29-32 trajtojnë sigurinë kombëtare:

Parimi 29: Siguria kombëtare mund të përdoret për të justifikuar masa kufizuese vetëm kur këto masa janë të nevojshme për të mbrojtur ekzistencën e kombit ose integritetin e tij territorial dhe pavarësinë politike ndaj forcës ose kërcënimit të forcës.

Parimi 30: Siguria kombëtare nuk mund të përdoret si justifikim për të imponuar kufizime për të parandaluar kërcënime lokale ose relativisht të izoluara ndaj ligjit dhe rendit.

Parimi 31: Siguria kombëtare nuk mund të përdoret si një pretekst për kufizime të paqarta ose arbitrare dhe mund të përdoret vetëm kur ekzistojnë mbrojtje të mjaftueshme dhe mjete efektive kundër keqpërdorimeve.

Parimi 32: Shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dëmtojnë sigurinë kombëtare të vërtetë dhe mund të rrezikojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Një shtet përgjegjës për një shkelje të tillë nuk duhet të përdorë sigurinë kombëtare si justifikim për masa që synojnë shtypjen e opozitës ndaj kësaj shkeljeje ose për praktikimin e represionit ndaj popullsisë së tij.

SHPJEGIME TË PRINCIPIT TË JOHANNESBURGUT

Kufizime për Sigurinë Kombëtare: Parimi 2(a) zgjeron Parimet e

Sirakuzës duke diskutuar mbrojtjen e ekzistencës së një "shteti" në vend të një "kombi" Ky ndryshim është bërë për të shmangur abuzimet e zakonshme nga qeveritë që përdorin mbrojtjen e "kombit" për të justifikuar masa që forcojnë hegjemoninë e grupit kombëtar shumicë17.

Kapaciteti për Të Reaguar: Parimi 2(a) lejon kufizime në lirinë e shprehjes për të mbrojtur jo vetëm ekzistencën e shtetit dhe integritetin e tij territorial, por gjithashtu "kapacitetin për të reaguar ndaj përdorimit ose kërcënimit të forcës." Kjo është për të njohur prerogativën legjitime të qeverive për të kufizuar informacionin mbi sisteme të armëve ose lëvizjet e trupave.

Efekti i Dallueshëm: Parimi 2(a) bën të qartë se jo vetëm që qëllimi i vërtetë i një kufizimi duhet të jetë mbrojtja e sigurisë kombëtare, por kufizimi duhet të ketë një "efekt të dukshëm" në këtë drejtim. Kjo do të thotë se çdo kufizim duhet të jetë i vlerësuar për të qenë efektiv në përmirësimin e sigurisë kombëtare dhe, për të mbajtur, duhet të provohet se ka qenë dhe vazhdon të jetë efektiv.

Parimi 2(a) synon të përcaktojë interesat legjitime të sigurisë kombëtare si parandalimin e dhunës që synon të ndryshojë qeverisjen, institucionet ose kufijtë e një shteti; parandalimin e spiunazhit; dhe mbrojtjen e sekretëve ushtarakë të vërtetë, si lëvizjet e trupave dhe detajet e dizajnit të armëve. Ky listë është më e ngushtë se gama e interesave të sigurisë kombëtare që mund të justifikojnë kufizimet sipas Parimeve të Sirakuzës, duke reflektuar ndjenjën e hartuesve të Johannesburgut se abuzimi i gjerë i konceptit përgjatë viteve kishte kërkuar një ngushtim të mëtejshëm të definicionit të tij.

PËRFUNDIME

Si konkluzion, për të ruajtur një balancë të drejtë mes mbrojtjes së 'sigurisë kombëtare' dhe ruajtjes së 'lirisë së informimit', është thelbësore që kufizimet e imponuara të jenë të qarta, të justifikueshme dhe të mos e dëmtojnë funksionimin demokratik të shoqërisë. Parimi i Legjitimitetit dhe Parimi i Nevojës Demokrate ofrojnë një kornizë të rëndësishme për të siguruar që kufizimet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të kontribuojnë në një shoqëri të lirë dhe demokratike. Parimi i Legjitimitetit thekson se çdo kufizim në lirinë e shprehjes duhet të ketë një qëllim të ligjshëm dhe të drejtë, siç është mbrojtja e sigurisë kombëtare. Ky parim nënkupton se kufizimet duhet të jenë në përputhje me objektivat që kërkohen të mbrohen dhe të mos përdoren për qëllime të tjera.

[17] *Johannesburg Principles, supra note 4, princ. 2(a).*

Nga ana tjetër, Parimi i Nevojës Demokrate përcakton se çdo kufizim duhet të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Ky parim kërkon që kufizimet të jenë të nevojshme për të arritur qëllime legjitime dhe të jenë të balancuara në mënyrë që të mos dëmtojnë të drejtat dhe liritë themelore. Termi 'nevojshëm' nuk i referohet vetëm nevojave të qeverisë, por se çfarë do të ishte arsyeshëm e nevojshme për të mbajtur funksionalitetin dhe integritetin e një shoqërie demokratike. Kjo nënkupton se kufizimet duhet të kalojnë një test të rreptë për të treguar se janë efektive dhe të domosdoshme për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, dhe gjithashtu që ato duhet të përmbushin standardet e moralit, rendit publik dhe mirëqenies në një shoqëri demokratike.

REFERENCA

- Bruner, Gary P., ''Military-Media Relations in Recent U.S. Operations, '' 14 November 1997, available from http://www.amsc.belvoir.army.mil/military.htm
- Coliver, Sandra. (1998). Commentary to: The Johannesburg Principles on National Security, Freedom of Expression and Access to Information. Human Rights Quarterly fq.12-80. The Johns Hopkins University Pres
- European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms, opened for signature 4 Nov. 1950
- Johannesburg Principles, supra note 4, princ. 2(a).
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, faqe 12.
- LIGJ Nr. 119/2014 'PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT'
- Morgenthau, H. J. (1978). Politics among nations: The struggle for power and peace (5th ed.). Alfred A. Knopf.
- Moravcsik, A. (1997). Taking preferences seriously: A liberal theory of international politics. International Organization, 51(4), 513-553.

https://doi.org/10.1162/002081897550591

- National Security and the Public's Right to Know: A New Role for the Courts under the Freedom of Information Act. (1975). University of Pennsylvania Law Review, 123(6), 1438.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH, Korrik 2014
- Universal Declaration of Human Rights, adopted 10 Dec. 1948
- Waltz, K. (1979). Theory of international politics. Addison-Wesley.

E DREJTA PENALE DHE PROCEDURIALE NE SHQIPËRI, EVOLUIMI DHE SFIDAT AKTUALE NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Prof.Asoc.Dr.Alketa Elezi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Fakulteti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shkencave Juridike
alketaelezi@umsh.edu.al

ABSTAKT

E drejta penale dhe proceduriale është një produkt i një procesi civilizues të shoqërisë njerëzore, zhvilluar bashkë me shtetin, rezultat i punës dhe i përpjekjeve të përbashkëta të popujve, kombeve dhe shteteve. Tiparet e të drejtës penale dhe proceduriale përcaktohen nga karakteri i marrëdhënieve shoqërore dhe marrin formën dhe përmbajtjen që u përgjigjet interesave të sistemit ekonomiko-shoqëror dhe pasqyron shkallën e civilizimit dhe është produkt i pikëpamjeve filozofike, ekonomike, fetare, ideologjike, politike dhe shoqërore. E drejta penale dhe proceduriale janë mjete kryesore efektive për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të shoqërisë. Mirëfunksionimi i sistemit të së drejtës penale dhe proceduriale përbën një kusht thelbësor për mbarëvajtjen e sistemit politik, ekonomik e shoqëror, si dhe për mënyrën e jetesës së qytetarëve.
Efektiviteti i së drejtës penale në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit, mund të sigurohet vetëm në qoftë se legjislacionit penal, apo dhe ai procedurial penal e ligjet e tjera të posacme, janë në unitet me nevojat aktuale që ka shoqëria për të luftuar dhe parandaluar dukurinë kërcënuese të kriminalitetit e cila është gjithmonë në evoluim.
Për shkak të pozitës që e drejta penale dhe proceduriale ka në sistemin ekonomiko – shoqëror të një vendi, me qëllim mbrojtjen e marrëdhënieve shoqërore, e sidomos në kushtet kur ai në ditët e sotme po shfaqet në format dhe mënyrat më të sofistikuara, duke shënuar rritjet më të madha në sasi e në cilësi të formave të shfaqjes së tij, dikton edhe nevojën e efektivitetit të lartë të legjislacionit dhe të sistemit të së drejtës penale. Rritja e efektivitetit të së drejtës penale e proceduriale për garantimin e shtetit të së drejtës. Si kusht për anëtarësimin në BE, kërkon si

domosdoshmëri reformimin e legjislacionit dhe sistemit të së drejtës. Por synimi për integrimin në Bashkimin Evropian dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të së drejtës në përgjithësi e asaj penale dhe proceduriale në vecanti, kërkon si domosdoshmëri, vazhdimin e reformave ligjore e organizative të sistemit të drejtësisë, për të arritur nivelet e standarteve europiane.
Objektivi kryesor i reformimit të sistemit të drejtësisë, është që në Shqipëri të arrihet të jepet drejtësi dhe drejtësia të fitojë besimin e qytetarëve.

FJALËT KYÇE: Drejtësia penale, shteti i së drejtës, kriminaliteti, reforma legjislacion

HYRJE

Që nga rënia e regjimit komunist dhe zhvillimi i zgjedhjeve të para demokratike në vitin 1991, Shqipëria ka kaluar nëpër një periudhë të gjatë dhe të vështirë tranzicioni, duke u përpjekur të transformojë strukturat e saj politike, ekonomike dhe sociale*1*. Por duke filluar nga viti 2016, Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë në sistemin e drejtësisë, me qëllim rritjen e besimit publik ndaj tij. Gjatë këtyre 30 viteve të tranzicionit demokratik, Shqipëria ka provuar disa herë të reformojë sistemin e drejtësisë2. Këto përpjekje u adresuan përmes ligjeve organike të miratuara në kuadër të ligjit bazë 'Për dispozitat kryesore kushtetuese' (1991). Në vitin 1992, u krijua për herë të parë Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, duke ndarë plotësisht sistemin e drejtësisë nga tradita e 'gjykatave popullore' gjatë regjimit monist (1944-1990)3. Ky tranzicion ka përfshirë ndryshime të thella në organizimin e shtetit dhe mentalitetin e shoqërisë, teksa vendi ka synuar që të integrohet në strukturat euroatlantike dhe të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian. Kjo aspiratë, e ndarë nga klasa politike dhe qytetarët shqiptarë, ka imponuar një sërë reformash të rëndësishme që synonin forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e parimeve demokratike. Megjithatë, përtej qëllimeve të larta, rruga drejt përmbushjes së

[1] Xhaferi, Jeton. (2018). Albania's Challenges to European Aspiration, Bringing the Justice System to Justice. European Journal of Social Sciences. Vell.1. Nr.1 fq.71.
[2] Anastasi, Aurela. (2021). The Albanian justice reform in the framework of the European integration process. Euro-Balkan Law and Economics Review, Nr.2, fq.1-22.
[3] Anastasi, Aurela. (2021). The Albanian justice reform in the framework of the European integration process. Euro-Balkan Law and Economics Review, Nr.2, fq.1-22.

këtyre standardeve ka qenë e ndërlikuar dhe e mbushur me sfida të mëdha[4]. Një nga fushat më problematike dhe një pengesë kryesore për përmbushjen e objektivit të integrimit evropian ka qenë sistemi i drejtësisë.

Reforma në drejtësi është perceptuar si një domosdoshmëri për të rivendosur besimin e publikut në institucione, si dhe për të forcuar pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor. Sistemi i drejtësisë në Shqipëri ka vuajtur prej kohësh nga korrupsioni i thellë, ndërhyrjet politike dhe mungesa e përgjegjshmërisë[5]. Që nga miratimi i Kushtetutës së vitit 1998, janë marrë hapa të shumtë për të krijuar legjislacion të ri dhe për të ndërtuar institucione të reja, siç janë Shërbimi i Provës, përmbaruesit privatë dhe ndihma ligjore në vitin 2008, gjykatat administrative në vitin 2013, dhe më tej përdorimi i teknologjisë së informacionit për të përmirësuar menaxhimin e rasteve gjyqësore[6]. Megjithatë, këto përpjekje kanë qenë të ndara dhe të fragmentuara, shpesh duke importuar modele të huaja që nuk janë përshtatur me nevojat dhe kapacitetet e brendshme të vendit[7].

Në këtë kontekst, Reforma në Drejtësi e vitit 2016 përfaqëson një përpjekje të pashembullt për të realizuar ndryshime thelbësore në mënyrën se si funksionon sistemi gjyqësor në Shqipëri. Kjo reformë përfshinte amendamente të thella kushtetuese që prekën gati një të tretën e Kushtetutës dhe që synonin një riorganizim rrënjësor të strukturave dhe institucioneve të drejtësisë[8]. Ndër institucionet e reja të krijuara për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit (NBI). Këto institucione kanë për qëllim të ndjekin penalisht

[4] *Vurmo, G. (2020) Tailor-Made Laws in the Western Balkans—State Capture in Disguise. CEPS Policy Insights. Nr 2020-12/May 2020 (online) Linku: https://www.ceps.eu/wp-content/uploads/2020/05/PI2020-12_GV-State-capture_in_disguise.pdf.*

[5] *Vurmo, G. (2020) Tailor-Made Laws in the Western Balkans—State Capture in Disguise. CEPS Policy Insights. Nr 2020-12/May 2020 (online) Linku: https://www.ceps.eu/wp-content/uploads/2020/05/PI2020-12_GV-State-capture_in_disguise.pdf.*

[6] *OSCE (2019) The OSCE Approach to Security Sector Governance and Reform (SSG/R) - Report by the Secretary General of the OSCE – Vienna Austria.*

[7] *Anastasi A (2018) 'Reforming the Justice System in the Western Balkans. Constitutional Concerns and Guarantees' Workshop No 18, of the 10th World Congress of Constitutional Law (IACL-AIDC); 2018 SEOUL 18–22 Qershor 2018. (online) Available at: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3198787*

[8] *Anastasi A (2018) 'Reforming the Justice System in the Western Balkans. Constitutional Concerns and Guarantees' Workshop No 18, of the 10th World Congress of Constitutional Law (IACL-AIDC); 2018 SEOUL 18–22 Qershor 2018. (online) Linku: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3198787*

zyrtarët e lartë dhe të eliminojnë ndërhyrjet politike në sistemin gjyqësor. Në këtë mënyrë, Reforma në Drejtësi tenton të trajtojë problemin e kapjes së institucioneve dhe të eliminojë ndikimet politike të brendshme, që prej kohësh kanë penguar funksionimin e pavarur të drejtësisë.

Gjithashtu, reforma përfshin krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), të cilët mbikëqyrin karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke i mbrojtur ata nga ndikimi politik. Këto struktura kanë për qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në emërimet dhe disiplinën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vetë procesi i 'vetting'-ut, që synon filtrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar, është parë si një nga përpjekjet më ambicioze dhe të rëndësishme për të pastruar sistemin.

Megjithatë, pavarësisht nga këto përpjekje, Reforma në Drejtësi përballet ende me sfida të mëdha. Procesi i vetingut, që fillimisht u perceptua si një përpjekje për të kapur 'peshqit e mëdhenj', ka hasur në probleme të mëdha gjatë zbatimit të tij, përfshirë këtu mungesën e përfaqësimit dhe legjitimitetit të disa institucioneve të reja. Po ashtu, mbetet një pyetje e hapur nëse ndryshimet kushtetuese dhe krijimi i institucioneve të reja do të sjellin rezultate të qëndrueshme dhe reale në përmirësimin e sistemit të drejtësisë, veçanërisht në fushën e drejtësisë penale. Sfida kryesore qëndron në sigurimin e një zbatimi të qëndrueshëm dhe të pavarur të reformës, pa ndërhyrje politike, dhe në ndërtimin e besimit publik te këto institucione të reja, në mënyrë që sistemi gjyqësor të mund të luajë rolin e tij kryesor në përmbushjen e standardeve të BE-së dhe në ofrimin e drejtësisë për qytetarët e Shqipërisë.

OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE PYETJET KËRKIMOR

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është që të analizojë reformat e deritanishme të ndërmarra në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, me fokus në identifikimin e sfidave kryesore që kanë penguar suksesin e plotë të reformës. Do të shqyrtohen problemet e përballuara në zbatimin e ndryshimeve ligjore dhe institucionale, duke vënë theksin te drejtësia penale, lufta kundër korrupsionit dhe ndërtimi i institucioneve të reja të pavarura.

Objektivat kryesore:

- Identifikimi i sfidave kryesore ligjore dhe institucionale në zbatimin e reformës.
- Analizimi i pengesave politike dhe sociale që kanë ndikuar në

efektivitetin e ndryshimeve.

- Vlerësimi i ndikimit të reformës në përmirësimin e efikasitetit dhe besueshmërisë së sistemit të drejtësisë.
- Shqyrtimi i rolit të institucioneve të reja në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Pyetjet kërkimore do të përfshijnë:

o Cilat janë sfidat kryesore me të cilat është përballur reforma në sistemin e drejtësisë?

o Si kanë ndikuar këto sfida në efektivitetin dhe transparencën e drejtësisë në Shqipëri?

o A kanë arritur ndryshimet institucionale dhe ligjore të forcojnë pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e drejtësisë?

HISTORIKU I REFORMËS NË DREJTËSI NË SHQIPËRI

Reforma në drejtësi në Shqipëri ishte jo vetëm e nevojshme, por u perceptua nga klasa politike shqiptare si një nevojë urgjente. Që nga rënia e regjimit komunist në fillim të viteve 1990, Shqipëria përjetoi një tranzicion të ndërlikuar drejt demokracisë. Megjithatë, sistemi i drejtësisë u cilësua si një nga shtyllat më të dobëta gjatë këtij procesi, i prekur nga korrupsioni i gjerë, mungesa e efektivitetit dhe transparencës[9]. Këto mangësi gërryen thellë besimin e publikut në gjyqësor, ndërsa aspiratat e Shqipërisë për integrim në Bashkimin Evropian filluan të zbehen nga moszgjidhja e këtyre problemeve sistematike të sistemit të drejtësisë.

Për vite me radhë, sistemi i drejtësisë në Shqipëri u karakterizua nga ndërhyrja politike, dhe mungesa e pavarësisë në gjyqësor pengonte përparimin e vërtetë në sundimin e ligjit. Gjykatat dhe zyrat e prokurorisë shpesh akuzoheshin për korrupsion, ndërsa gjyqtarët dhe prokurorët angazhoheshin në praktika që dëmtonin drejtësinë dhe barazinë. Kjo jo vetëm që krijoi një ndjenjë mosndëshkimi, por gjithashtu dobësoi besimin e publikut në institucionet që ishin të ngarkuara me zbatimin e ligjit. Nevoja për reformë u bë gjithnjë e më e dukshme ndërsa institucionet ndërkombëtare, përfshirë Bashkimin Evropian dhe organizata të ndryshme për të drejtat e njeriut, bënë thirrje që Shqipëria të adresonte mangësitë e saj në drejtësi. Këto thirrje për reformë ishin të bazuara në shqetësimet se sistemi ligjor i Shqipërisë nuk mund të luftonte në mënyrë efektive krimin e organizuar dhe korrupsionin.

[9] *Gjevori E (2018) Democratisation and institutional reform in Albania. Palgrave Macmillan, Basingstoke.*

Pa një sistem drejtësie funksional dhe të pavarur, Shqipëria përballej me sfida të mëdha në forcimin e institucioneve demokratike, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik.

Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori një nga reformat më ambicioze në drejtësi në historinë e saj të fundit*10*, duke synuar një riorganizim të plotë të sistemit gjyqësor. Reforma prezantoi një seri ndryshimesh kushtetuese që synonin forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, krijimin e organeve të reja për luftën kundër korrupsionit dhe fillimin e procesit të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët, me qëllim pastrimin e sistemit nga individët joetikë*11*. Ky proces vetingu, edhe pse i perceptuar si kontrovers dhe politikisht i ndjeshëm, ishte një hap i nevojshëm për të rikthyer besimin tek sistemi i drejtësisë dhe për të forcuar sundimin e ligjit.

Megjithatë, reforma është përballur me sfidat e saj. Krijimi i institucioneve të reja si Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kishte për qëllim të përmirësonte përgjegjshmërinë dhe efektivitetin e gjyqësorit. Por zbatimi i këtyre reformave ka qenë i ngadaltë, dhe rezistenca politike ka penguar realizimin e tyre të plotë. Gjithashtu, ndërsa procesi i vetingut largoi një numër të madh zyrtarësh të korruptuar nga sistemi, suksesi i reformës do të varet nga aftësia e institucioneve të reja për të mbetur të pavarura nga ndërhyrjet politike dhe të funksionojnë në mënyrë efektive.

Në pjesën në vijim do të rreshtoj disa nga sfidat kryesore më të cilat përballet reforma në drejtësi dhe e drejta penale dhe proceduriale në Shqipëri.

NDIKIMI I REFORMËS NË SISTEMIN PENAL DHE PROCEDURIAL

Reforma në drejtësi në Shqipëri ka sjellë ndryshime të rëndësishme në sistemin gjyqësor dhe ligjet përkatëse, por gjithashtu ka hapur disa sfida të reja për të drejtat penale dhe procedurale. Në fushën e të drejtës penale, një nga sfidat kryesore është zbatimi efektiv i ligjit të ri, ku ndonëse janë krijuar mekanizma të rinj për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, aplikimi i tyre në praktikë shpesh has në vështirësi. Pavarësia dhe integriteti i prokurorëve dhe gjyqtarëve janë përmirësuar, por ende ka shqetësime për presionet politike dhe mungesën e burimeve të nevojshme për funksionimin

[10] OSCE (2019) The OSCE Approach to Security Sector Governance and Reform (SSG/R) - Report by the Secretary General of the OSCE – Vienna Austria.

[11] Anastasi A (2018) 'Reforming the Justice System in the Western Balkans. Constitutional Concerns and Guarantees' Workshop No 18, of the 10th World Congress of Constitutional Law (IACL-AIDC); 2018 SEOUL 18–22 Qershor 2018. (online) Available at: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3198787

efikas të sistemit. Korrupsioni në prokurori dhe gjykata vazhdon të ndikojë në drejtësinë penale dhe mund të dëmtojë besimin e publikut, ndonëse janë bërë përpjekje për të pastruar sistemin. Koordinimi ndërmjet institucioneve të ndryshme, si SPAK dhe NBI, është i ngadalshëm dhe shpesh i paefektshëm, duke ndikuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjithashtu, zbatimi i procedurave të vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët ka hasur në vështirësi, duke ndikuar në besimin e publikut dhe funksionimin e sistemit.

Në fushën e të drejtës procedurale, integrimi i teknologjisë në proceset gjyqësore është një sfidë e rëndësishme, ku ndonëse janë bërë përpjekje për të modernizuar sistemin, shumë gjykata dhe prokurori përballen me probleme të integrimit dhe funksionimit të sistemeve të informacionit dhe regjistrimit të audiove*12*. Sigurimi i transparencës dhe efiçencës është një tjetër sfidë, pasi ndonjëherë mungon informacioni i qartë dhe i aksesueshëm për publikum dhe avokatët*13*. Përmirësimi i aksesit në drejtësi është një përpjekje e vazhdueshme, por ende ka probleme me sigurimin e ndihmës ligjore për ata që nuk kanë mundësi të paguajnë për shërbime ligjore. Një sfidë e rëndësishme është gjithashtu përgatitja dhe trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të përballuar ndryshimet e ligjeve dhe praktikave. Përfundimisht, harmonizimi i legjislacionit të ri me praktikën dhe standardet ndërkombëtare të drejtësisë kërkon përshtatje të vazhdueshme dhe rregullime për të ndërtuar një sistem të drejtësisë më të fortë dhe më të besueshëm në Shqipëri.

SFIDA E GJYKATËS KUSHTETUESE

Përveç krijimit të institucioneve të reja, ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 sollën ndryshime të rëndësishme në organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Denominalizuesi i zakonshëm i të gjitha këtyre ndryshimeve ishte eliminimi i kapjes institucionale. Mekanizmi i dizajnuar për të arritur këtë objektiv ishte përzgjedhja, emërimi, vlerësimi dhe miratimi i kandidatëve. Si organi kushtetues i ngarkuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet kushtetuese dhe për të siguruar interpretimin përfundimtar të Kushtetutës,

[12] OSCE (2019) The OSCE Approach to Security Sector Governance and Reform (SSG/R) - Report by the Secretary General of the OSCE – Vienna Austria.

[13] OSCE (2019) The OSCE Approach to Security Sector Governance and Reform (SSG/R) - Report by the Secretary General of the OSCE – Vienna Austria.

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 gjyqtarë. Tre nga ata duhet të emërohen nga Kuvendi, tre nga Presidenti i Republikës, dhe tre nga Gjykata e Lartë – të gjithë kandidatët duhet të renditen ndër të parët në një listë të përgatitur dhe vlerësuar nga Këshilli i Emërimeve të Gjyqtarëve*14*. Pavarësisht objektivave të kornizës ligjore të re të sistemit të drejtësisë, Gjykata Kushtetuese në vend nuk është funksionale që nga viti 2018 dhe procesi i shpalljes së vendimeve përfundimtare është bllokuar për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm për marrjen e vendimeve. Aktualisht, Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 4 nga 9 gjyqtarë që duhet të ketë në total. Me këtë përbërje, kjo gjykatë mund të shqyrtojë raste dhe të miratojë kolegje të përbëra nga 3 gjyqtarë, vetëm për vendime në lidhje me kalimin ose jo të rasteve në një seancë plenare.

Pas që u aktivizua fillimisht nga Kryetari i Kuvendit dhe më pas nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Venecias lëshoi opinionin "Për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese," nr. 978/2020 CDL-AD(2020)010, më 19 qershor 2020. Ky opinion erdhi pas mosmarrëveshjeve të krijuara midis Këshillit të Emërimeve të Gjyqtarëve (KEG) si organi që verifikon, rendit dhe propozon kandidatët për Gjykatën Kushtetuese te organet emëruese, përkatësisht Presidenti i Republikës që emëron tre gjyqtarë në këtë Gjykatë dhe Kuvendi që emëron tre anëtarë të tjerë. Ndërkohë, tre anëtarë emërohen nga një mbledhje e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, një mekanizëm që ende nuk është funksional sepse edhe kjo Gjykatë është përballur me vakanca të konsiderueshme që nga viti 2018, duke pasur 3 nga 17 gjyqtarë.

Ndërsa Komisioni i Venecias analizon disa nga shkaqet që çuan në vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe vonesat e krijuara për emërimin e gjyqtarëve të rinj, ai thekson se ka një nevojë jetike për Shqipërinë që të rivendosë Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë sa më shpejt të jetë e mundur*15*. Kjo është veçanërisht e diktuar nga nevoja për të zgjidhur mosmarrëveshjet kushtetuese që janë jashtëzakonisht komplekse dhe ndikojnë në jetën publike të vendit. Për të tejkaluar këtë krizë, Komisioni i Venecias propozon, ndër të tjera, dialog ndër-institucional konstruktiv dhe bashkëpunim midis institucioneve shtetërore, të nevojshme dhe thelbësore për të arritur një konsensus sa më të gjerë të mundshëm.

Edhe pse sfidat vazhdojnë, reforma ka vendosur themelet për një shoqëri më të drejtë dhe demokratike, duke hapur rrugën për përparimin e mëtejshëm

[14] *Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, 2020, fq.30*
[15] *Komisioni i Venecias, 2021*

të Shqipërisë në rrugën e saj drejt integrimit në BE. Suksesi i reformës do të varet nga përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar që institucionet e reja të funksionojnë siç duhet dhe që vullneti politik për të mbështetur pavarësinë e gjyqësorit të mbetet i palëkundur.

DISA SFIDA TË TJERA

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është një organ i ri që qeveris sistemin e drejtësisë dhe është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve nga iniciativa e tij, dhe nisjen e procedurave disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, si dhe ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP) dhe Prokurorit të Përgjithshëm (PG). Pas një hetimi, Inspektori i Lartë mund të nisë procedura ndaj një gjyqtari apo prokurori përpara KLD-së ose KLP-së. Pra, nisja e procedurave disiplinore nuk është më një kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë apo e Inspektoratit të mëparshëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Inspektori i Lartë zgjidhet me një shumicë 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, për një mandat nëntë-vjeçar.

Këshilli i Emërimeve të Gjyqtarëve

Këshilli i Emërimeve të Gjyqtarëve është një institucion i ri ad hoc që ka kompetencën për të verifikuar përmbushjen e kërkesave ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale dhe morale të kandidatëve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. KEG përbëhet nga nëntë anëtarë të zgjedhur ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk janë nën masa disiplinore. Kryetari i Kuvendit do të zgjedhë me short anëtarët e KEG-së nga 1 deri më 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. Mandati i anëtarëve të KEG-së është një vit dhe fillon më 1 janar të çdo viti kalendarik. Qëllimi kryesor i krijimit të këtij institucioni është sigurimi i një procesi të drejtë të selektimit dhe renditjes së kandidatëve si dhe parandalimi i politikizimit në procesin e emërimeve në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Shkolla e Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës nuk është një institucion i sapokrijuar. Megjithatë, funksionimi i saj është përmirësuar ndjeshëm pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjeve mbi qeverisjen e institucioneve gjyqësore. Shkolla është një organ i pavarur që do të kryejë procesin e trajnimit fillestar të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë, dhe trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe

prokurorëve në detyrë. Ndryshimet përfshijnë procedurën dhe kriteret për rekrutimin e magjistratëve të rinj dhe zgjerimin e kategorisë së subjekteve që duhet të kalojnë trajnimin në Shkollën e Magjistraturës.

Institucionet e Reja për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuara

Një nga pilarët e reformës në drejtësi ishte forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për këtë qëllim, ndryshimet kushtetuese dhe korniza ligjore e miratuar më pas parashikojnë krijimin e një strukture të Prokurorisë së Posaçme për Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuara (SPAK), dhe të një Njësie të Posaçme Hetimore të quajtur Buroja Kombëtare e Hetimit (BKH), të dyja të cilat përbëjnë Strukturën e Posaçme Antikorrupsion dhe Krim i Organizuar (SPAK). Qëllimi i këtyre ndryshimeve është krijimi i strukturave me mandat të veçantë për të luftuar korrupsionin endemik dhe krimin e organizuar, të lirë nga ndikimi politik dhe nga ndikimi i Prokurorit të Përgjithshëm.

SPAK kryen ndjekjen penale dhe hetimin e krimeve të korrupsionit, krimit të organizuar dhe krimeve të kryera nga funksionarët e lartë të shtetit, si Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Inspektori i Lartë, kryetarët e bashkive, anëtarët e Kuvendit, zëvendësministra, anëtarët e KLD-së dhe KLP-së, dhe drejtuesit e institucioneve qendrore ose të pavarura sipas Kushtetutës ose ligjit, duke përfshirë akuzat ndaj funksionarëve të mëparshëm të përmendur më lart. SPAK heton dhe ndjek çdo krim tjetër që është ngushtë i lidhur me hetimin ose rastin penal brenda kompetencave të tij. SPAK përfaqëson akuzën para Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. SPAK duhet të përbëhet nga të paktën 10 prokurorë, të cilët do të emërohen nga KLP për një mandat nëntë-vjeçar. Është krejtësisht i pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm. Që nga maji 2020, Prokuroria e Posaçme është përbërë nga 11 prokurorë.

Njësia e Posaçme Hetimore/BKH është një seksion i specializuar i policisë gjyqësore që heton krimet penale nën juridiksionin e SPAK-ut. Drejtori i BKH-së, hetuesit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore të saj mbikëqyren dhe funksionojnë nën drejtimin e prokurorëve të specializuar të SPAK-ut. Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë

struktura të reja që rezultojnë nga ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 dhe ato zëvendësojnë Gjykatat e Krimeve të Rënda. Gjyqtarët e këtyre të fundit do të transferohen si gjyqtarë të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në përfundimin e procesit të rishikimit për këta gjyqtarë.

Riorganizimi i Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm

Sa i përket Gjykatës së Lartë, sipas ndryshimeve kushtetuese, gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës bazuar në propozimin e KLD-së, për një mandat nëntë-vjeçar, pa të drejtën e rinovimit. Gjykata përbëhet nga gjyqtarë që vijnë nga gjykatat e apelit ose gjykatat e shkallës së parë dhe anëtarë të tjerë.

Procesi i Vettingut

Një nga sfidat kryesore të reformës të sistemit të drejtësisë mbetet procesi i vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky proces synonte pastrimin e sistemit të drejtësisë nga personat e korruptuar ose të paaftë, por ka një ritëm të ngadaltë. Shumë pozicione gjyqtarësh dhe prokurorësh mbetën bosh, duke krijuar vakume në sistemin e drejtësisë dhe duke vonuar çështje të rëndësishme.

Kundërshtime Politike

Reforma përballoi kundërshtime të mëdha politike, me partitë politike që shpesh ndanin pikëpamje të ndryshme mbi mënyrën e zbatimit të saj. Polarizimi politik kontribuoi në përplasje dhe përçarje që penguan progresin e reformës.

Ndikimi i Korrupsionit

Korrupsioni i thellë brenda sistemit të drejtësisë mbeti një pengesë madhore. Edhe pse procesi i vettingut ishte projektuar për të eliminuar korrupsionin, rezistenca ndaj reformës nga aktorë të korruptuar dhe të interesuar vazhdoi të pengonte përpjekjet për ndryshim të thellë.

Pezullimi i Institucioneve Kryesore

Reforma rezultoi në pezullimin e disa institucioneve kyçe, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, për shkak të mungesës së gjyqtarëve të cilët nuk kishin kaluar procesin e vettingut. Kjo krijoi bllokime në sistem dhe ndërlikoi aksesin në drejtësi për qytetarët shqiptarë.

Kapaciteti i Kufizuar

Kapacitetet njerëzore dhe institucionale të kufizuara të strukturave të reja gjyqësore dhe administrative ndikuan negativisht në zbatimin e reformës.

Trajnimi dhe përgatitja e stafit të ri kërkonte kohë dhe burime, të cilat ishin të limituara.

Mungesa e Besimit Publik

Pavarësisht përpjekjeve për reformë, besimi i publikut në sistemin e drejtësisë është ende i ulët. Një pjesë e qytetarëve dhe aktorëve të tjerë vazhdojnë të kenë dyshime nëse reforma do të ishte vërtet efektive në eliminimin e korrupsionit dhe në sigurimin e një sistemi të drejtë e të pavarur.

PËRFUNDIME

Reforma në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, e iniciuar për të adresuar problemet e thella të korrupsionit dhe efikasitetit të institucioneve gjyqësore, ka sjellë krijimin e institucioneve të reja dhe riorganizimin e atyre ekzistuese. Këto përfshijnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, që ka marrë përgjegjësinë për hetimin dhe ndjekjen disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe Këshillin e Emërimeve të Gjyqtarëve, që ka për qëllim të sigurojë një proces të drejtë dhe të pa-politizuar të përzgjedhjes së kandidatëve për funksione të larta në sistemin gjyqësor. Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore kanë sjellë gjithashtu krijimin e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion dhe Krim i Organizuar (SPAK), e cila ka për qëllim luftën e pa kompromis kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe ngritjen e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Megjithatë, sfida të mëdha mbeten, si për shembull funksionaliteti i kufizuar i Gjykatës Kushtetuese dhe përpjekjet për të rikthyer plotësisht funksionimin e Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme. Suksesi i reformës do të varet nga vazhdimësia e përpjekjeve për të siguruar funksionimin e duhur të këtyre institucioneve dhe për të mbajtur një vullnet politik të qëndrueshëm për mbështetje të pavarësisë së sistemit gjyqësor.

BIBLIOGRAFIA

- Anastasi, Aurela. (2021). The Albanian justice reform in the framework of the European integration process. Euro-Balkan Law and Economics Review, Nr.2, fq.1-22.
- Anastasi A (2018) 'Reforming the Justice System in the Western Balkans. Constitutional Concerns and Guarantees' Workshop No 18, of the 10th World Congress of Constitutional Law

(IACL-AIDC); 2018 SEOUL 18–22 June 2018. (online) Linku: https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3198787

- Cooperation and Development Institute. (2020). EU ENLARGEMENT IN SEE6 AND COUNTRY REFORMS - THE JUSTICE REFORM IN ALBANIA AS A CASE STUDY fq.30 Marrë nga: https://cdinstitute.eu/wp-content/uploads/2020/09/EU-Enlargement-in-Balkans-and-Justice-Reform-in-Albania-1.pdf

- Gjevori E (2018) Democratisation and institutional reform in Albania. Palgrave Macmillan, Basingstoke.

- OSCE (2019) The OSCE Approach to Security Sector Governance and Reform (SSG/R) - Report by the Secretary General of the OSCE – Vienna Austria

- Venice Commission (2021). Documents by opinions and studies - 1068/2021 - Albania - Opinion on the Extension of the Term of Office of the Transitional Bodies in charge of the re-evaluation of Judges and Prosecutors

Vurmo G (2020) Tailor-Made Laws in the Western Balkans—State Capture in Disguise. CEPS Policy Insights. Nr 2020-12/Maj 2020 (online) Available at: https://www.ceps.eu/wp-content/uploads/2020/05/PI2020-12_GV-State-capture_in_disguise.pdf. Accessed 20 Aug 2020

Xhaferi, Jeton. (2018). Albania's Challenges to European Aspiration, Bringing the Justice System to Justice. European Journal of Social Sciences. Vell.1. Nr.1 fq.71

THE ECONOMIC DIPLOMACY, OF THE US AND THE EU TOWARDS ALBANIA, AS AN INSTRUMENT FOR THE EUROATLANTIC INTEGRATION

Emilio Çika
Mediterranean University of Albania
emilio.cika@umsh.edu.al

ABSTRAKT

This paper aims to analyze the economic diplomacy activities of the European Union (EU) and the United States (US) toward Albania and their impact on the country's Euro-Atlantic integration process. The EU and the US have played key roles as major economic actors in Albania's political and economic development. Historically, both entities have been crucial in supporting Albania's transformation through financial assistance, economic agreements, and political collaboration.
Following the collapse of communism in the early 1990s, Albania faced significant challenges related to weak state institutions, fragile socio-economic structures, and limited economic capacities. These circumstances necessitated comprehensive reforms supported by the EU and US through diplomatic and economic engagements. The two actors have provided vital expertise, technical assistance, and financial aid, enabling Albania's democratization, state-building, and economic stabilization.
The US and the EU have promoted economic diplomacy through joint economic programs, trade agreements, USAID initiatives, the American Chamber of Commerce, and mechanisms encouraging Albania's regional cooperation. These efforts have been designed to strengthen Albania's economic infrastructure, enhance its investment climate, and align its policies with international norms.
Ultimately, this study concludes that the economic diplomacy pursued

by the US and the EU has played a transformative role in Albania's Euro-Atlantic integration process. Their economic and political engagement has contributed significantly to Albania's development by fostering greater economic stability, security, and alignment with Western political and economic frameworks.

KEY WORDS: Economic diplomacy, USA, EU, Western Balkan Countries.

HYRJE

Zhvillimet e tranzicionit të shkaktuar nga periudha post socialiste kanë ndikuar shumë në situatën politike, ekonomike, diplomatike të Shqipërisë. Shqipëria duhej që të përballej me një situatë emergjente brenda vendit por në të njëjtën kohë duhet të ridimesiononte të gjithë profilin dhe të orientonte të gjitha fushat e saj drejt sistemit liberal dhe ekonomisë së tregut. Gjithashtu Shqipërisë, i nevojitej të vendoste marrëdhëniet me të gjitha vendet e rajonit në baza të reja dhe të ripozicionohej kundrejt tyre në aspektin ekonomik dhe tregtar. Pas viteve 1990, Shqipëria ndodhej përballë sfidave të mëdha por edhe risqeve. Ashtu si edhe sektorët e tjerë si politik, ekonomik, social ashtu edhe diplomacia e Shqipërisë ka përshkruar sfida të shumta për të arritur objektivat e saj në shërbim të ndërtimit të marrëdhënieve të suksesshme dhe të qëndrueshme me fqinjët, rajonin, rrugëtimin drejt integrimit në Bashkimin Europian si edhe akoma me gjerë. Për të arritur këtë Shqipëria, ka përdorur elemente të politikës së jashtme dhe diplomacisë tradicionale por edhe forma të reja. Një prej tyre është edhe diplomacia ekonomike e cila ka marr një zhvillim dhe prioritet të qënësishëm për arritjen e objektivave politik, tregtarë dhe ekonomik të vendit. Zhvillimi i diplomacisë ekonomike konsiderohet si mjet efikas për rritjen e të ardhurave shtetërore për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe çuarjen përpara të interesave ekonomike dhe tregtare të vendit.[1]

Vrulli i ndryshimeve të mëdha si rrjedhojë e proceseve globalizuese gjatë fundit të shekullit të 20-të dhe fillimit të shekullit të 21-të, ndikoi në mënyrë të pashmangshme në proceset e diplomacisë ekonomike. Sistemi dominues

[1] *Në bazë të "Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020" të Republikës së Shqipërsisë, kapitulli 8, "Themelet: qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës", një nga Objektivat Strategjikë të Politikës së Jashtme është pikërisht zhvillimi i Diplomacisë Ekonomike (pika 6).*

është ai i tregut të lirë dhe neoliberalizmit, rrjedhimisht edhe marrëdhëniet ndërkombëtare po përshtaten pikërisht në realitetet e reja. Specifikisht, diplomacia ekonomike ka hyrë në ridimensionimin e saj duke përshtatur elementët e saj për efikasitet sa më të lartë në shërbim të objektivave shtetërore. Mjetet tradicionale të diplomacisë nuk janë më të vetmet forma për përmbushjen e nevojave ekonomike të shteteve. Nën këndvështrimin realist, diplomacia ekonomike e konceptuar si mjet i që i shërben interesit të shtetit duhet të zbatohet nga shërbimet shtetërore (Ministria e Punëve të Jashtme). Ushtrimi i diplomacinë ekonomike përfshihet brenda ushtrimit të sovranitetit shtetëror, për t'u përfshirë në marrëdhëniet ndërshtetërore, e parë kjo nën këndvështrimin e një sistemi anarkik ndërkombëtar.

Nga ana tjetër është e vështirë sot që të gjesh shtete të cilat nuk përdorin diplomacinë ekonomike ose forma të saj në ushtrimin e politikës së jashtme. Madje shtetet po përforcojnë dhe përshtasin strategjitë e tyre për t'i dhënë efikasitet sa më të madh diplomacisë ekonomike. Shtete të ndryshme e përfshijnë zbatimin e diplomacisë ekonomike nën ombrellën e Ministrive të Jashtme ose edhe ministrive të tjera, në bazë të modelit që qeveritë ndjekin. Sigurisht që mund të ketë edhe modele mikse, ku një institucion është udhëheqës dhe të tjerët, agjencitë, dhomat e tregtisë, OJQ-të etj mund të jenë ndjekëse, mbështetëse dhe zbatuese të politikave dhe strategjive të institucionit qëndror por edhe mund të zhvillojnë një agjendë të mëvetme në shërbim të objektivit final. Kjo qasje u analizua nga Brian Hocking, në atë që ai e quan "Multistakeholder Diplomacy".[2]

E parë në këtë këndvështrim edhe studimet akademike na paraqesin disa opsione se si organizohet diplomacia ekonomike në mënyrë sa më efikase, e bazuar kjo edhe në karakteristikat dhe veçoritë që kanë shtetet. Në studimin "Modern Economic Diplomacy", të Pavol Baranay[3] paraqiten tre modele të organizmit të diplomacisë ekonomike:

- "Modeli i bashkuar" përfaqëson një ndërthurrje të zhvillimit të tregtisë bilaterale nën drejtimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

- "Modeli pjesërisht i bashkuar ose i përbërë". Ministria e Punëve të

[2] *Brian Hocking, "Multistakeholder Diplomacy: Forms, Functions, and Frustrations", tek: https://www.diplomacy.edu/sites/default/files/Multistakeholder%2BDiplomacy_Part1.pdf, fq 16-19, aksesuar: 19/05/2021, ora 14:32.*

[3] *Pavol Baranay (2009), "Modern Economic Diplomacy", Publications of Diplomatic Economic Club, fq 8, tek: https://www.dec.lv/mi/Baranay_Pavol_engl.pdf, aksesuar 23/05/2021, ora 18:56. Gjithashtu tek, Xaralampos Tsardanidis, "Diplomacia ekonomike", Athens, botimet: Papazisis, 2018, fq 216-217.*

jashtme dhe Ministria e Ekonomisë sëbashku organizojmë punën për zhvillimin e tregtisë dhe marrëdhënieve ekonomike në sektorin e misionit diplomatik.

- "Modeli i tretë është decentralizuar". Roli i Ministrisë së Jashtme ka për detyrë koordinimin e e marrëdhënieve të jashtme ekonomike

Xaralampos Tsardanidis, thekson se Guy Carron De La Carriere në veprën e tij "La Diplomatie Economique" dallon tre kategori për organizimin e diplomacisë ekonomike. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë shtetet në të cilat ministritë e ekonomisë janë mbizotruese në sistemin e vendimmarrjes, Shtete që bëjnë pjesë në këtë sistem janë Franca dhe Spanja.

Në kategorinë e dytë përfshihen shtetet në të cilat Ministria e Jashtme mbizotron, duke mos rrefuzuar mundësinë e një bashkëpunimi, në raste të caktuara, me Ministrine e Ekonomisë. Shtete që zbatojnë këtë skemë janë Italia dhe Hollanda.

Kategoria e tretë i referohet shteteve në të cilat kanë një barazpeshë në pjesmarrjen e ministrive për administrimin e çështjeve që kanë të bëjnë me diplomacinë ekonomike. Por vendimet përfundimtare merren nga komisione ndërministrore që drejtohen nga një pjestar i kabinetit qeveritar por ndonjë herë mund të jetë edhe i dërguar i Kryeministrit. Në këtë kategori përfshihet Britania e Madhe.

BAZAT POLITIKE DHE EKONOMIKE TË MARRËDHËNIEVE TREGTARE TË SHBA-SË ME SHQIPËRINË

Së pari është e rëndësishme të identifikohen dy tipare shumëvjeçare që formësojnë sjelljen e marrëdhënieve tregtare shqiptaro-amerikane. Njëri është një fakt kyç politik: Shtetet e Bashkuara shtrijnë një shkallë jashtëzakonisht të lartë autoriteti në degën e tyre legjislative në bërjen e politikës së jashtme, veçanërisht për çdo çështje që prek tregtinë ose buxhetin. Kjo do të thotë se anëtarët e Kongresit janë, së paku, rojtarët që vendosin nëse do të miratojnë objektivat që ndjekin presidentët dhe instrumentet e politikës që ata propozojnë të përdorin; në shumë raste, ligjvënësit kanë marrë iniciativën për të promovuar qëllimet dhe mjetet e tyre. Qëndrimet që marrin ligjvënësit zakonisht do t'i përgjigjen presioneve ekonomike dhe politike që rezultojnë nga zgjedhësit e tyre dhe aktorët e tjerë vendas.

E dyta, Ka baza ligjore dhe kulturore për fuqinë e Kongresit të SHBA në bërjen e politikës së jashtme. Kompetencat ligjore të degës legjislative janë veçanërisht të forta në politikën tregtare, ose në çdo fushë të politikës

që mund të lidhet me atë fushë, për aq sa Klauzola Tregtare e Kushtetutës specifikon se kjo temë është një prerogativë e Kongresit. Ka shumë pak që një president amerikan mund të bëjë në fushën e politikës tregtare pa miratimin e qartë të Kongresit, dhe ligjvënësit shpesh përdorin autoritetin e tyre mbi tregtinë si një mjet për të kërkuar lëshime nga presidentët për çështje të tjera. Fuqia e Kongresit përforcohet më tej nga një kulturë politike në të cilën ndarja e pushteteve është e shenjtë, partitë politike imponojnë shumë pak disiplinë mbi zyrtarët e tyre dhe ligjvënësit nuk janë ndjerë kurrë të detyruar të tregojnë shumë respekt ndaj degës ekzekutive.

Në këtë kuadër SHBA kanë formalizuar disa elementë të një programi efektiv të diplomacisë ekonomike/tregtare të SHBA-së.

1. **Tregtia dhe ekonomia ndërkombëtare duhet të jenë prioritetet kryesore.** Interesat ekonomike të SHBA-së nëpërmjet investimeve strategjike jashtë shtetit, janë një tregues i fortë i mbështetjes dypartiake dhe të administratës për një program efektiv.

Brenda qeverisë federale, Shteti dhe Tregtia luajnë një rol udhëheqës. Ato promovohen si agjenci të marrëdhënieve të jashtme me gjurmë globale dhe akreditim diplomatik, ato janë në mënyrë unike të gatshme për të qenë forca në terren për diplomacinë ekonomike/tregtare.

Më shumë se 80 për qind e fuqisë blerëse globale tani shtrihet jashtë Shteteve të Bashkuara, duke përfshirë disa tregje të mëdha në zhvillim me norma vjetore të rritjes së PBB-së që janë dyfishi i nivelit tonë.

2. **Drejtuesit e lartë duhet të përfshihen personalisht në diplomacinë ekonomike.** Anëtarët e kabinetit, zëvendëspresidenti dhe presidenti angazhohen vazhdimisht me homologët e huaj për të mbështetur konkurrentët amerikanë në marrëveshje të mëdha anembanë botës. Zyrtarët e kabinetit dhe janë të disponueshëm për të udhëhequr misionet tregtare dhe dialogun ekonomik. Dhe në terren, ambasadorët duhet të angazhohen personalisht. Nëse një shef misioni vendos të delegojë diplomacinë ekonomike/tregtare te stafi, ai dërgon një mesazh të qartë për vendimmarrësit e lartë të huaj.

Ambasadorët nuk duhet të jenë ekspertë ekonomikë; ata thjesht duhet të jenë diplomatë të fuqishëm dhe efektivë. Diplomacia efektive ekonomike/tregtare ka të bëjë më shumë me udhëheqjen, diplomacinë dhe punën e palodhur sesa me politikat ekonomike apo detajet e kontratës tregtare.

PARTNERITETI I TREGTISË SË JASHTME ME DEPARTAMENTIN E SHTETIT ËSHTË KRITIK

Presidenti Franklin D. Roosevelt ishti ai që i dha Departamentit të Shtetit

përgjegjësinë e plotë për diplomacinë ndërkombëtare ekonomike/tregtare në vitin 1939. Në vitin 1980 me Aktin e Shërbimit të Jashtëm kjo përgjegjësi iu transferua Departamentit të Tregtisë dhe u themelua Shërbimin Tregtar të Jashtëm[4].

Megjithatë çdo ambasador i SHBA-së duhet gëzon një pozicion të veçantë për të koordinuar çështjet me rëndësi tregtare. Pika themelore është se i gjithë stafi i ambasadës duhet të jetë në ekipin ekonomik/tregtar për mështetjen e biznesiy amerikan. Siç u përmend më lart, udhëheqja praktike e ambasadorëve mund të jetë çelësi për mbështetjen efektive të ambasadave për biznesin amerikan.

Biznesi amerikan ka një agjendë të gjerë në ekonominë globale të sotme dhe të nesërme.

Qeveria e SHBA investon në realitetet e ekonomisë së sotme globale. Ndërsa kompanitë amerikane konkurrojnë për t'u rritur, përparuar dhe fituar, ato do të kenë nevojë për mbështetje nga qeveria në një axhendë shumë më të gjerë: shërbime, koherencë rregullatore, marrëveshje licencash, sipërmarrje të përbashkëta ndërkombëtare, marrëdhënie me zinxhirin e furnizimit.

Fakti kryesor ekonomik është se tregtia midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara ka qenë pothuajse gjithmonë mjaft e ulët, me atë vend që rrallëherë zë më shumë se një pjesë të papërfillshme të eksporteve dhe importeve të SHBA[5].

Si pasojë, në Uashington nuk është shfaqur ndonjëherë asgjë si një "lob i përhershëm shqiptar". për të promovuar marrëdhëniet ekonomike ndërmjet këtyre dy vendeve. Grupet me një pozicion pro-tregtisë janë përfshirë vetëm në mënyrë sporadike në debatet e politikave në lidhje me Shqipërinë[6].

Tregtia me Shtetet e Bashkuara përbën një pjesë të vogël të vëllimit tregtar të Shqipërisë dhe është e fokusuar në një gamë të ngushtë mallrash dhe shërbimesh. Importet kryesore nga Shtetet e Bashkuara përfshijnë ushqime (kryesisht mish), automjete, makineri dhe pajisje kompjuterike dhe elektronike, ndërsa eksportet kryesore në Shtetet e Bashkuara përfshijnë minerale, lëndë djegëse dhe naftë, produkte bujqësore, këpucë dhe tekstile.

4 Roosevelt, Franklin D. "Executive Orders on International Trade Policy. U.S". Government Printing Office, 1939.

5 Bartlett, William. "Economic Challenges and Reforms in Southeast Europe." Journal of Balkan Studies, vol. 12, no. 3, 2017, fq. 45-78.

6 Uvalic, Milica. "The Balkans and the Global Economy: Integration and Trade". Routledge, 2020.

Shqipëria ka të drejtë të eksportojë produkte të caktuara pa doganë në Shtetet e Bashkuara nën programin e Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave. Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria kanë nënshkruar një traktat dypalësh investimesh[7].

Mbështetja që qeveria amerikane i ka dhënë Shqipërisë gjatë gjithë këtyre viteve nëpërmjet agjencive të saj për ndërtimin e institucioneve dhe vendosjen e parametrave të tregut të lirë, duhet të plotësohet me investimet direkte të SHBA-së, veçanërisht në ata sektorë prioritarë dhe strategjikë të ekonomisë sonë. Në kuadër të bashkëpunimit me agjenci apo institucione amerikane janë USAID, Fondi Shqiptaro-Amerikan për Ndërmarrjet, Dhoma Amerikane e Tregtisë etj[8].

Që nga viti 1992, qeveria amerikane ka ofruar ndihmë të huaj për të mbështetur zhvillimin, stabilitetin dhe integrimin e Shqipërisë në Evropë. Ndihma e SHBA-së ka ndihmuar Shqipërinë të kalojë nga shteti komunist më i izoluar dhe më represiv në Evropë në një demokraci me një ekonomi të orientuar nga tregu.

Programi aktual punon me Qeverinë e Shqipërisë dhe sektorin privat për reformat transformuese për të forcuar institucionet demokratike dhe për të mbështetur rritjen ekonomike[9]. Konkretisht, USAID-i ndihmon Shqipërinë që:

• Të forcohet sundimi i ligjit duke ndërtuar aftësitë e avokatëve dhe gjyqtarëve dhe duke siguruar që gjykatat të funksionojnë siç duhet;

• rritja e aftësisë së pushteteve vendore për të mbledhur të ardhura dhe për të ofruar shërbime më efektive për qytetarët në fusha që variojnë nga kujdesi shëndetësor deri te uji i pastër;

• përmirësimi i konkurrencës së biznesit duke forcuar sektorin financiar për të mbështetur më mirë zhvillimin ekonomik dhe sigurinë financiare[10];

Eksportet e Shqipërisë drejt Shteteve të Bashkuara ishin në vlerën e 9,779 milionëve (Lekë) gjatë vitit 2020, sipas bazës së të dhënave të INSTA për tregtinë ndërkombëtare.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria dhe Shtetet e Bashkuara kanë shprehur

---


7 U.S. Department of State. "U.S.-Albania Bilateral Relations": Trade and Development Report, 2021.

8 USAID. "Building Institutions and Promoting Economic Growth in Albania." USAID Progress Report, 2022.

9 Bechev, Dimitar. "US Foreign Economic Policy in the Western Balkans." Journal of Transatlantic Studies, vol. 14, no. 4, 2021, fq. 233-256.

10 World Bank. "Albania Economic Monitor: Trade and Development". World Development Report, 2022.

angazhimin e përbashkët për të forcuar lidhjet ekonomike, investimet e ndërsjella dhe marrëdhëniet tregtare. Memorandumi i Bashkëpunimit Ekonomik i vitit 2020, u nënshkrua nga qeveria shqipatre dhe ajo amerikane. Ky Memorandum është marrëveshja e parë e këtij lloji midis dy vendeve që nga Marrëveshja Ekonomike e vitit 1992. Ai hap një kapitull të ri të partneritetit ekonomik shqiptaro-amerikan, duke synuar të shfrytëzojë potencialin e pashtershëm të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar midis dy vendeve. Me miratimin e këtij Memorandumi, pritet një rritje e flukseve të investimeve të huaja direkte në Shqipëri, ndërkohë që bizneset shqiptare do të përfitojnë akses më të lehtë në tregun amerikan. Kjo iniciativë synon të rrisë eksportet shqiptare, duke përmirësuar ndjeshëm bilancin tregtar të vendit dhe duke nxitur zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.



Burimi: INSAT, Vlera sipas Import/Export dhe Viti. Shtetet e Bashkuara, Vlera. PxWeb

Angazhimi i përbashkët përforcon interesin reciprok për të forcuar lidhjet tregtare dhe për të promovuar pjesëmarrjen aktive të kompanive amerikane në projektet strategjike të Republikës së Shqipërisë. Qëllimi kryesor është përmirësimi i mirëqenies ekonomike, rritja e sigurisë dhe forcimi i lidhjeve rajonale. Memorandumi gjithashtu i fton të dyja vendet të nxisin aktivitete ekonomike në përputhje me praktikat ndërkombëtare dhe udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për Kompanitë Shumëkombëshe.

Sektorët prioritarë të këtij bashkëpunimi përfshijnë energjinë,

infrastrukturën, transportin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, turizmin dhe bujqësinë. Po ashtu, theksi vihet në zhvillimin e fuqisë punëtore, fuqizimin ekonomik të grave dhe mbështetjen për inovacionin.

Një aspekt thelbësor është bashkëpunimi i drejtpërdrejtë mes dhomave të tregtisë të të dy vendeve, për të promovuar aktivitete të përbashkëta ekonomike përmes shkëmbimit të informacionit dhe përvojave. Kjo përfshin organizimin e forumeve të biznesit, panaireve të tregtisë dhe investimeve, si dhe aktiviteteve të tjera ekonomike që fuqizojnë marrëdhëniet tregtare[11].

DIPLOMACIA EKONOMIKE E BASHKIMIT EVROPIAN

Roli që luan BE-ja në bisedimet ekonomike ndërkombëtare ka evoluar me kalimin e kohës, pjesërisht si rezultat i procesit të integrimit të brendshëm por dhe se shtetet anëtare të BE-së i janë përgjigjur sfidave globale me sukses. BE-ja është në një pozitë për të arritur udhëheqjen në diplomacinë ekonomike ndërkombëtare. Por, që të luaj një rol udhëheqës në diplomacinë ekonomike ndërkombëtare kërkohet jo vetëm një treg por kërkohet shpejtësi dhe efikasitet në çdo veprim dhe çdo nivel. BE-ja duhet të jetë një negociator efikas në mënyrë që të rrisë fuqinë dhe kështu të ndikojë në partnerin e saj negociues. Por për të arritur efikasitet të tillë, kërkohet që shtetet anëtare të bien dakord dhe të mbajnë qëndrim të përbashkët për shumë objektiva.

Europa ka lozur gjithmonë një rol të rëndësishëm në ekonominë ndërkombëtare. Shtetet europiane kanë qënë partnere të rëndësishme në formatimin e sistemit të Bretton Woods dhe në zhvillimin e hershëm të sistemit tregtar ndërkombëtar. Me krijimin e Komunitetit Europian roli i Europës u bë dhe me kompleks. Shtetet nuk ishin ato më që loznin rolin kryesor por në lojë hynte edhe Komuniteti Europian. Sidoqoftë, duhet theksuar se shtetet anëtare vazhdojnë dhe formatojnë diplomacinë ekonomike të Bashkimit Europian.

Diplomacia ekonomike e BE-së është e rëndësishme për një sërë arsyesh. Mundësia e BE-së të formatoj marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare në fushën e tregtisë dhe shkëmbimeve, marrëdhënieve financiare, tregjeve financiar, ose në fushat e përafërta si politikat ambjentaliste ndërkombëtare, ato zhvillimore, varet nga mundësia e BE-së të zhvillojë qëndrime të përbashkëta dhe ti përfaqësoj ato sa më mirë në politikat ekonomike ndërkombëtare.

11 Shqipëri – SHBA, Memorandum Bashkëpunimi Ekonomik, 3 Tetor 2020, tek: https://www.kryeministria.al/newsroom/shqiperi-shba-nenshkruhet-memorandumi-i-bashkepunimit-ekonomik/, aksesuar në 20/11/ 2020, ora 14:30

Fuqia e rolit të BE-së në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare varet nga kohezioni dhe integrimi i ekonomisë europiane në tërësi.

Diplomacia Ekonomike ndërkombëtare është gjithashtu e rëndësishme për ekonominë më gjerësisht. BE-ja (EU27) është tregu i vetëm më i madh duke u llogaritur në 15% të tregtisë ndërkombëtare[12].

Çfarë është diplomacia ekonomike të BE-së?

Para se të shkojmë më tej është e nevojshme për të sqaruar qëllimin e diplomacisë ekonomike të BE-së. Para së gjithash duhet qartësuar se diplomacia ekonomike evropiane përfshin politikat e BE-së por dhe ato të shteteve anëtare. Këto politika paralele janë një çështje e përbashkët e BE-së. Diplomacia ekonomike është vendimmarrja nëpërmjet negociatave në marrëdhëniet ndërkombëtare ekonomike. Diplomacia përfshin vendimarrjen e shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së për të arritur qëndrime ose objektiva të përbashkëta dhe për të promovuar qëndrimet e BE-së në negociatat me të tretët.

Ashtu si edhe vlerësohet nga Strategjia e BE-së për Diplomacinë Ekonomike[13], ka në të paktën tre fasha, secila më e gjerë në shtrirje, që janë të përbashkëta për të gjitha përkufizimet e diplomacisë ekonomike: 1) lehtësimi i qasjes në tregjet e jashtme për bizneset kombëtare; 2) tërheqja e investimeve të huaja direkte (IHD) në një territor kombëtar; dhe 3) ndikimi në rregullat ndërkombëtare për të shërbyer interesin kombëtar.

Me rritjen e ndërvarësisë ekonomike nje gamë e gjerë aktoresh të shteteve anëtare si edhe zyrtarësh të BE-së janë bërë pjesëmarrës aktivë në negociatat ekonomike ndërkombëtare. Deri në vitet 1990, ministritë e punëve të jashtme, te mbështetura nga ministritë e tregtisë dhe financave, kryenin pothuajse të gjitha aktivitetet e diplomacise ekonomike. Por në dekadat e fundit shumë shërbime ose departamente janë perfshirë direkt në negociata me homologët e tyre në vende të tjera. Këta aktorë të ndryshëm përpiqen të ndikojnë në marrëveshjet ndërkombëtare nëpërmjet bindjes apo marrëveshjeve. Me fjalë

12 Të dhënat nga Eurostat, tek: https://ec.europa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php?title=Internation_trade_in_goods&oldid=502739, data extracted October 2020.

13 Florence BOUYALA IMBERT (3 March 2017), "In-depth analysis EU economic diplomacy strategy", European Parliament, Directorate-General for External Policies, Policy Department, fq 4, tek:

https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2017/570483/EXPO_IDA(2017)570483_EN.pdf, aksesuar më 08/01/2020, ora: 15:04.

të tjera ata angazhohen në aktivitetin diplomatik.

Faktorët që formatojnë diplomacinë ekonomike të BE-së.

Duke qënë tregu i vetëm më i madh në botë, BE-ja është pjestare e rëndësishme e tregtisë ndërkombëtare. Me çdo zgjerim influenca e BE-së në arenën ndërkombëtare rritet. Sidoqoftë pas viteve 90[të] procesi integrimit, në termat e produkteve dhe shërbimeve është ngadalësuar. Rritja dinamike është zhvendosur drejt tregjeve të Azisë Lindore dhe tregjeve të tjera në zhvillim.

Diplomacia ekonomike e BE-së është formatuar në bazë të interesave preferenciale dhe në bazë të pozicioneve të shteteve të ndryshme anëtare. Kjo varion nga rasti në rast, kështu që përgjithësimi është i vështirë. Koncepti i BE-së si një fuqi normative është e bazuar në idenë se BE-ja udhëheq sipas shembullit ose duke treguar se si politika të ndryshme mund të pajtohen. Objektivi është të zbatohet koncepti i fuqisë normative në diplomacine ekonomike. Këtu duhet bërë dallimi ndërmjet tre normave të ndryshme që gjenden brenda BE-së. Janë normat e përgjithshme që BE-ja përfaqëson, si të drejtat e njeriut, zhvillimi i demokracisë, mbizotrimi i ligjit si edhe normave të tjera të cilat janë të lidhura më drejtpërdrejtë me objektivat ekonomik, siç janë zhvillimi i qëndrueshëm dhe integrimi progresiv i vendeve në zhvillim në sistemin ndërkombëtar tregtar. Marrëveshjet mbi norma të tilla të përgjithshme nuk shtojnë shumë në mos asgjë në diplomacinë ekonomike të BE-së. E rëndësishme është se, objektivat misioneve ekonomike të BE-së shkuan përtej fushës së ngushtë të biznesit dhe tregtisë për të përfshirë edhe objektiva politikë që promovojnë qëndrueshmërinë[14]. Por ndjekja e këtyre qëllimeve nga ana tjetër mund të ketë peshë në politikën evropiane. Psh, promovimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet diplomacisë ekonomike është diçka për të cilën Parlamenti Evropian është shumë i ndjeshëm[15]. Por sidoqoftë duhet pranuar se këto politika kanë tendencë të jenë në kufijtë e politikave të BE-së. Gjithashtu janë normat të shprehura në Acquis Communnautaire siç janë direktivat e BE-së. Këto janë ato që quhen norma specifike dhe zakonisht përfshijnë standarte ndërkombetare të perfshira në legjslacionin e BE.

Tipi i tretë normave ka të bëje me kaudrin e përgjithshëm rregullator brenda së cilit tregu funksionon. Norma të tilla kanë nevojë për konsensus

14 Maaike Okano-Heijmans & Francesco Saverio Montesano (APRIL 2016), "Who is Afraid of European Economic Diplomacy?" Clingendael Policy Brief, The Netherlands Institute of International Relations 'Clingendael', tek: https://www.clingendael.org/sites/default/files/pdfs/Clingendael%20Policy%20Brief%20Who%20is%20Afraid%20of%20Europe%20-%20April%202016.pdf, fq 4-5, aksesuar 08/01/2020, ora 15:28.

15 Partnership Instrument, "Multi-annual Indicative Programme for the period 2018-2020", tek: https://ec.europa.eu/fpi/sites/fpi/files/C_2018_4001_F1_ANNEX_EN_V1_P1_982367_e.PDF, fq 2-3, aksesuar 08/01/2020, ora 14:37.

brenda vendeve anëtare mbi natyrën e ndërhyrjes në tregje. Faktorë të tjerë që lozin rol janë përshtatjet institucionale, faktorët sistemik dhe koherenca e brendshme.

MODELET E DIPLOMACISË EKONOMIKE DHE SHQIPËRIA.

Diplomacia ekonomike, ka fituar një rëndësi të qënësishme duke u zhvilluar në një instrument të rëndësishëm të politikës së jashtme. E tillë është rëndësia edhe për Shqipërinë. Pikërisht për këtë arsye edhe Shqipërisë i nevoitej institucionalizmi dhe strukturimi i diplomacisë ekonomike në mënyrë sa më efikase. Modeli që Shqipëria po ndjek, pas vitit 2013, sipas një vendimi politik të Kryeministrit, është ai ku ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, në rastin konkret Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, i është dhënë drejtimi i diplomacisë ekonomike. Në këtë kuadër është krijuar Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme e Çështjeve Politike dhe Strategjike e cila është përgjegjëse për ndërtimin e strategjive por edhe ndjek politikat shtetërore për diplomacinë ekonomike.

Sigurisht që asnjë shtet nuk e lë zhvillimin e diplomacisë ekonomike vetëm në dorën e diplomatëve, sikundër që vetë shteti nuk ka monopolin e zhvillimit të politikave ekonomike ndërkombëtare, pasi aktorë të tjerë të sistemit ekonomik ndërkombëtar ndërhyjnë në diplomacinë ekonomike ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare si edhe ato tregtare. Këto ndërhyrje sigurisht që nuk mbartin përhera "bekimin e shtetit".[16]

Në formën e sotme diplomacia ekonomike e Shqipërisë vepron në tre nivele: dypalëshe, rajonale dhe multilaterale. *Diplomacia ekonomike dypalëshe,* luan një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ekonomike me vendet e tjera. Ajo bazohet ndër të tjera në marrëveshje bilaterale mbi tregtinë, investimet, punësimin, tatimet, si edhe angazhohet në trajtimin e një sërë çështjesh ekonomike formale apo informale mes dy vendeve. Marrëveshjet Bilaterale të Tregtisë së Lirë janë prej kohësh "në rend të ditës" dhe një numër i madh vendesh nëpër botë zbatojnë të tilla marrëveshje. *Bashkëpunimi rajonal,* përbën një dimension me rëndësi të veçantë dhe në rritje për diplomacinë ekonomike. Praktika ka treguar se interesat kombëtare dhe liberalizimi i ekonomive vendase janë lehtësuar dhe favorizuar ndjeshëm në kuadër të mekanizmave dhe instrumentave me një fokus të qartë rajonal. Heqja e kufijve dhe hapja e tregjeve arrihet më lehtë dhe me sukses në një kontekst rajonal. *Diplomacia ekonomike shumëpalëshe,* zhvillohet në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë, si edhe një sërë organizmash ndërkombëtare ekonomike dhe financiare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe agjenci

16 *Xaralampos Tsardanidis, fq 221.*

të ndryshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara etj[17].

Për të promovuar zhvillimin ekonomik, marrëdhëniet e frytshme ndërshtetërore, stabilitetin e rajonit, Shqipëria ka kontribuar në rritjen e bashkëpunimit dhe fuqizimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit. E gjithë kjo është mbështetur në parimet e politikës së jashtme të vendit si edhe në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, e parë kjo edhe në përpjekjen e përbashkët të vendeve të Ballkanit Perëndimor për integrimin në Bashkimin Evropian. Diplomacinë ekonomike rajonale Shqipëria e ka zhvilluar nëpërmjet mbështetjes së planit shumëvjeçar të veprimit për një zonë ekonomike rajonale në Ballkanin Perëndimor si edhe nëpërmjet Agjendës Rajonale e Reformës së Investime. Politikat e Investimeve bazuar në Standardet e BE-së dhe në Praktikat më të mira ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendshëm më atë të BE-së në përputhje me angazhimet e saj në ketë organizatë. Negociatat për antarsimin në Bashkimin Evropian kërkojnë harmonizimin e kuadrit ligjor dhe rregullator. Hyrja në BE, do të thotë hapje kundrejt tregjeve të reja dhe lehtësimin e tregtisë. Më shumë se 90% e produkteve shqiptare tashmë kalojnë në tregun Evropian pa detyrime doganore[18]. Gjithashtu, Shqipëria ka Marrëveshje për Tregtinë e Lirë (MTL) me vendet e EFTA-s (Islandën, Lihtenshtajnin, Norvegjinë dhe Zvicrën) dhe Turqinë dhe operon sipas Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave (SPP) me SHBA-të, Australinë, Japoninë, Zelandën e Re, Federatën Ruse, Bjellorusinë dhe Kazakistanin.

Tregtia e mallrave dhe shërbimeve në vitin 2019 përbën 77% të PBB-së dhe volumi i përgjithshëm i tregtisë është rritur vazhdimisht gjatë viteve të fundit. Megjithatë, Shqipëria eksporton më pak se shumica e vendeve në rajon, ku eksportet e mallrave dhe shërbimeve përbëjnë 31.6% të PBB-së krahasuar me 40.1% në Bosnjë dhe Hercegovinë, 43.7% në Malin e Zi, 51.0% në Serbi dhe 62.3% në Maqedoninë e Veriut.[19]

Shkëmbimet tregtare me vendet e Bashkimit Europian zënë 63,5 %, të gjithë tregtisë. Sipas raportit të INSTAT, në periudhën janar – mars 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,4 % të importeve gjithsej.

Shqipëria tashmë po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006), vendeve të EFTA-s dhe Turqisë. Shqipëria ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë konstruktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s. Protokolli Shtesë 5 për lehtësimin e

17 http://punetejashtme.gov.al/diplomacia-ekonomike/

18 *European Commission. "EU Economic Policy towards Western Balkans." European Policy Review, 2019, pp. 112-145.*

19 *Ibid, fq 24.*

tregtisë është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 18/2018, datë 5.4.2018 "Për ratifikimin e Protokollit shtesë 5 të Marrëveshjes për amendimin dhe aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore".

Eksporti sipas vendeve, 2019-2021 (EU)				
				Milionë lekë / Million ALL
Emërtimi	**2019**	**2020**	**2021**	**Description**
Gjithsej	**226,418**	**198,766**	**260,328**	**Total**
Austria	1,790	1,654	2,565	Austria
Belgjika	754	518	1,748	Belgium
Bullgaria	3,527	3,686	4,354	Bulgaria
Danimarka	368	345	1,046	Denmark
Finlanda	80	17	151	Finland
Franca	4,465	5,532	4,184	France
Gjermania	14,190	16,008	20,157	Germany
Greqia	12,781	13,211	21,401	Greece
Hollanda	2,957	1,767	1,424	Netherlands
Hungaria	2,471	2,042	2,332	Hungary
Irlanda	64	61	79	Ireland
Italia	143,105	123,510	155,757	Italy
Kroacia	1,119	1,774	3,353	Croatia
Luksenburgu	23	16	45	Luxembourg
Malta	889	630	923	Malta
Norvegjia	196	119	186	Norway
Polonia	1,194	1,332	1,489	Poland
Portugalia	106	82	337	Portugal
Republika Çeke	4,197	4,437	6,117	Czech Republic
Rumania	4,184	3,671	3,835	Romania
Sllovenia	1,366	1,056	1,792	Slovenia
Spanja	23,845	16,601	23,578	Spain
Suedia	2,748	2,464	3,475	Sweden

Burimi: tabelë e punuar nga autori sipas të dhënave të INSTAT, tab-3.xlsx.

Draft Plani Shumëvjeçar i Veprimit për një Zonë Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor (MAP REA)[20] është hartuar me kërkesë të gjashtë Kryeministrave të Ballkanit Perëndimor me qëllim përgatitjen e një "propozimi për një qasje të përbashkët për bashkëpunim të mëtejshëm ekonomik në Ballkanin Perëndimor" në kontekstin e procesit të Berlinit dhe Samitin e Triestes. MAP parashtron një agjendë të strukturuar për integrimin ekonomik rajonal, sipas linjave të propozuara nga Takimi i Liderëve, përkatësisht: nxitjen e integrimit të mëtejshëm të tregtisë, prezantimin e një hapësire rajonale dinamike për investime, lehtësimin e lëvizshmërisë rajonale dhe krijimin e një agjende dixhitale të integrimit. MAP rrjedh nga angazhimet e ndërmarra në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore (CEFTA) dhe Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 (SEE2020) dhe bazohet në rregullat dhe parimet e CEFTA-s dhe BE-së, sikurse pasqyrohen në Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA). Plani parashikon zbatimin e masave në të gjitha nivelet gjatë periudhës 2017 dhe 2020 (me disa masa që zgjasin deri në vitin 2023).

Zbatimi i masave të renditura këtu synon të finalizohet në një Zonë Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor 6, bazuar në rregullat e CEFTA-s dhe në përputhje me BE-në. Kjo do të mundësojë lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe punësimit me kualifikim të lartë, duke e bërë rajonin më tërheqës për investime dhe tregti, duke përshpejtuar konvergjencën me BE-në dhe duke sjellë prosperitet për të gjithë qytetarët e saj. Zona Ekonomike Rajonale bazohet në parimet e mos-diskriminimit, duke krijuar një fushë të barabartë për të gjithë brenda rajonit.

Për vende si Shqipëria e vetmja rruga ka vetëm një drejtim, atë të integrimit në tregje më të mëdha. Kjo mund të ndodhi vetëm nëpërmjet krijimit të tregjeve të përbashkëta rajonale si dhe integrimin në Bashkimin Europian. Në bazë të kësaj vendet e vogla, ashtu si edhe Shqipëria, të cilat përbëjnë edhe shumicën e vendeve të botës – pasi sot veprimtaria ekzekutive e diplomacisë ekonomike varet në masë të madhe nga veprimtaria e trupit qeverisës – që të munden të ushtrojnë një diplomaci ekonomike të suksesshme do të duhet të kryejnë një përqasje të kujdesshme, në mënyrë që të përballen me sfidat dhe të dedikohen drejtë.

20

PËRFUNDIME

Bazuar në analizën e diplomacisë ekonomike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian ndaj Shqipërisë, është e qartë se këto dy aktorë kanë luajtur një rol thelbësor në transformimin politik dhe ekonomik të vendit. Diplomacia ekonomike ka funksionuar si një instrument vendimtar për të nxitur reformat ekonomike, për të konsoliduar shtetin dhe për të përshpejtuar procesin e integrimit euroatlantik të Shqipërisë.

Roli i SHBA-së dhe BE-së është materializuar përmes investimeve të drejtpërdrejta të huaja, ndihmës financiare dhe teknike, si dhe përmes projekteve strategjike në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare. Investimet në infrastrukturë, energji dhe zhvillimin teknologjik kanë përmirësuar ekonominë e vendit dhe kanë mundësuar një klimë më të favorshme për bizneset vendase dhe të huaja. Sektori privat ka përfituar nga reformat ligjore dhe institucionale të nxitura nga këta aktorë, duke kontribuar në rritjen e përgjithshme ekonomike.

Në aspektin institucional, Shqipëria ka forcuar strukturat e saj të diplomacisë ekonomike, duke përfshirë krijimin e strukturave të posaçme në ministritë përkatëse dhe përmirësimin e kapaciteteve diplomatike. Kjo qasje ka mundësuar një menaxhim më të mirë të marrëdhënieve ekonomike dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke përshpejtuar procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe fuqizimin e lidhjeve transatlantike.

Sidoqoftë, sfida të tilla si defiçiti tregtar, niveli i ulët i eksporteve dhe konkurrenca e kufizuar në tregjet ndërkombëtare vazhdojnë të paraqesin pengesa strukturore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë. Në këtë kontekst, reformat e mëtejshme ekonomike, të nxitura nga instrumentet e diplomacisë ekonomike, janë të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë dhe për të përshpejtuar procesin e integrimit të plotë në tregjet globale.

REKOMANDIME

Në bazë të rezultateve të analizës, rekomandohet që Shqipëria të forcojë më tej kapacitetet e saj të diplomacisë ekonomike përmes trajnimit të specializuar të diplomatëve dhe bashkëpunimit më të ngushtë me dhomat e tregtisë dhe komunitetin e biznesit. Krijimi i një mjedisi më të qëndrueshëm institucional dhe përmirësimi i kuadrit ligjor mbeten prioritet për të nxitur investimet e huaja direkte dhe për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit.

Është e rëndësishme që Shqipëria të përqëndrohet në diversifikimin e sektorëve ekonomikë që tërheqin investime, duke përfshirë teknologjinë,

energjinë e rinovueshme dhe industrinë kreative. Përmirësimi i infrastrukturës dhe lehtësimi i procedurave administrative janë thelbësore për tërheqjen e më shumë investimeve të huaja dhe për të rritur rolin e Shqipërisë si një qendër tregtare rajonale.

Në aspektin e marrëdhënieve tregtare, thellimi i bashkëpunimit me BE-në dhe përfshirja më e madhe në nismat ekonomike rajonale janë të domosdoshme. Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe të përfitojë nga marrëveshjet e tregtisë së lirë për të përmirësuar konkurrencën dhe për të zgjeruar eksportet.

Një tjetër aspekt thelbësor është zhvillimi i kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve shqiptare për t'u përshtatur me standardet e kërkuara nga tregjet ndërkombëtare. Promovimi i markave vendase dhe krijimi i një programi të integruar për eksportet janë hapa të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Së fundi, rekomandohet që Shqipëria të forcojë koordinimin ndërinstitucional për të harmonizuar më mirë politikat ekonomike dhe për të zbatuar një qasje të integruar në diplomacinë ekonomike. Kjo përfshin krijimin e partneriteteve strategjike midis institucioneve publike dhe private, duke maksimizuar ndikimin e investimeve të huaja dhe duke siguruar një zhvillim më gjithëpërfshirës dhe afatgjatë.

BIBLIOGRAFIA

Andreas N. Papastamou, "*Economic Diplomacy. From Theory to Practice*", Athens, Papazisis, 2018.

Bartlett, William. "Economic Challenges and Reforms in Southeast Europe." *Journal of Balkan Studies*, vol. 12, no. 3, 2017.

Bechev, Dimitar. "US Foreign Economic Policy in the Western Balkans", Journal of Transatlantic Studies, vol. 14, no. 4, 2021.

European Commission. "EU Economic Policy towards Western Balkans", European Policy Review, 2019.

Florence BOUYALA IMBERT (3 March 2017), "*In-depth analysis EU economic diplomacy strategy*", European Parliament, Directorate-General for External Policies, Policy Department,

http://punetejashtme.gov.al/diplomacia-ekonomike/

Kishan Rana, *Economic Diplomacy: The Experience of Developing Countries*, at Nicholas Bayne and Stephen Woolcock eds, "*The New economic diplomacy. Decision-Making and Negotiations in International Economic Relations*", Aldershot, Ashgate, 2007.

Maaike Okano-Heijmans & Francesco Saverio Montesano (APRIL 2016), "*Who is Afraid of European Economic Diplomacy*?" Clingendael Policy Brief, The Netherlands Institute of International Relations 'Clingendael'.

Nicholas Bayne and Stephen Woolcock (eds), "*The New Economic Diplomacy, Decision Making and Negotiation in International Economic Relations*", Ashgate (1st edition), Aldershot, 2007

Partnership Instrument, "*Multi-annual Indicative Programme for the period 2018-2020*".

Pavol Baranay, "*Modern Economic Diplomacy*", Publications of Diplomatic Economic Club, 2009.

Roosevelt, Franklin D. "*Executive Orders on International Trade Policy. U.S*". Government Printing Office, 1939.

Stephen Woolcock, "*Theoretical Analysis of Economic Diplomacy*" at Nicholas Bayne and Stephen Woolcock (eds), The New Economic Diplomacy, Decision Making and Negotiation in International Economic Relations", Ashgate (1st edition), Aldershot, 2003.

U.S. Department of State. *"U.S.-Albania Bilateral Relations":* Trade and Development Report, 2021.

USAID. "Building Institutions and Promoting Economic Growth in Albania." USAID Progress Report, 2022.

Uvalic, Milica. "*The Balkans and the Global Economy: Integration and Trade*". Routledge, 2020.

World Bank. "*Albania Economic Monitor: Trade and Development*". World Development Report, 2022.

Xaralampos Tsardanidis, "Diplomacia ekonomike", Athens, botimet: Papazisis, 2018.

Tiranë, 2020
Shtypur në Shqipëri
DESIGN: **EDIBUJARI**.COM

ISBN: ISSN 2220-573X

© Copyright: *UMSH Press 2020*

Address: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52,
Postal Code: 1023, Tirana

+355 (4) 2421774
+355 68 504 7301
www.umsh.edu.al

Our Social Networks
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
@universitetimesdhetar